

# EDUKATA ISLAME

REVISTË SHKENCORE, KULTURORE ISLAME, TREMUJORE | viti XLIX, nr.117



Prishtinë, 2019

# **Edukata Islame**

*Revistë shkencore, kulturore islame, tremujore  
Viti XLIX nr. 117 / 2019*

**Boton: Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës**

*Kryeredaktor:*

**Sabri Bajgora**

*Redaksia:*

Dr. Abdulla Hamiti, Mr. Adnan Simnica, Ahmet Sadriu,  
Dr. Fahrush Rexhepi, Kasim Gërguri, Dr. Sadik Mehmeti, Vedat Sahiti

email: **edukataislame@bislame.net**

*Redaktor gjuhësor:*

Dr. Hysen Matoshi

*Ballina:*

Bashkim Mehani

*Redaktor teknik &*

*Operator kompjuterik:*

Nuhi Simnica

*Shtypi:*

“ViPrint” - Mitrovicë

Tirazhi: 500

# **Edukata Islame**

**Revistë shkencore, kulturore islame, tremujore**  
**Viti XLIX nr. 117 / 2019**



Prishtinë  
2019



## **HIXHRETI PIKËKTHESA HISTORIKE E YMETIT ISLAM**

Hixhreti i Resulullahit s.a.v.s., përveçqë na kthen kujtesën historike duke evokuar ngjarjet që i paraprinë dhe atyre që e pasuan atë, në anën tjetër na sjell mesazhe dhe porosi shumëdimensionale, të cilat duhet të jenë moto për të vazhduar tutje drejt sukseseve dhe përparimit.

Nëse kthehemi pak në retrospektivë, do të shohim qartë se këto porosi edhe sot janë po aq aktuale, siç ishin atëherë, e do të jenë të tilla deri në Ditën e Fundit të jetës mbi këtë tokë.

Hixhreti si një ngjarje historike shpreh triumfin ndaj dhunës, urrejtjes e mosdurimit, e në të njëjtën kohë promovon lirinë, paqen, respektin dhe mirëbesimin. Kur kujtojmë Hixhretin, kujtojmë Pejgamberin tonë, Muhamedin a.s., i cili la Mekën dhe migroi në Medinë, me qëllim që të realizonte misionin që i qe ngarkuar nga i Madhi Zot. Me këtë veprim të të Dërguarit a.s., u krijuan bazat themelore për përhapjen e besimit, kulturës e të qytetërimit islam, si dhe për themelimin e një shoqërie të re që do të jetonte e lirë, në paqe e me mirëkuptim.

Hixhreti i Pejgamberit a.s. dhe i myslimanëve, nuk ishte shpërngulje e “hijeve dhe e shpirtrave të trazuar” nga frika për jetën e tyre, Jo, jo! Përkundrazi, ishte vendosmëri e paluhatshme dhe një planifikim i urtë e largpamës. Ishte shpërngulje e njerëzve në lirinë, fisnikërinë dhe dinjitetin e tyre. Ishte ngritje në çiltërsinë dhe dëlirësinë shpirtërore dhe shpëtim i ndërgjegjieve të tyre të pastra; Ishte shpërngulje nga dobësia në fuqi dhe nga pesimizmi në shpresë,

Ngjarjen e hixhretit, sipas konceptit islam duhet parë dhe kuptuar si një zgjim dhe lëvizje, plot energji pozitive, për të demonstruar gatishmërinë e sakrifikimit drejt të së vërtetës. Kjo ngjarje duhet regjistruar si një nxitje që buron nga ndjenja e thellë e besimit dhe dashurisë ndaj të vërtetës, si nxitje pa kompromis drejt ruajtjes dhe kultivimit të vlerave humane. Hixhreti nuk ishte ikje nga beteja, por ecje e guximshme në arenën e betejës, për të sfiduar të pavërtetën, pavlerën dhe tiraninë.

Hixhreti nuk nënkupton dorëzim dhe nënshtrim ndaj të keqes, por fillim i sfidimit të së keqes. Hixhreti nuk nënkupton ikje nga lodhjet dhe torturat e kësaj bote, por nënkupton ngritje të vetëdijes, marrje të përgjegjësisë për ta luftuar të keqen dhe vullnet për të vendosur rend e drejtësi.

Kjo ngjarje me rëndësi të veçantë në historinë islame, përveç se përcjell porosi shumëdimensionale e të qarta, në realitet pasqyron edhe gjendjen faktike jo vetëm të kohës së ngjarjes, por pasqyron edhe aktualitetin pragmatik të kohës që ne po jetojmë. Madhështia dhe rëndësia e hixhretit të Pejgamberit a.s. nënkuptohet nga fakti, se kjo ngjarje ka lënë gjurmë të pashlyeshme edhe në formën e organizimit, zhvillimit, sistemit dhe sistematizimit të obligimeve dhe të drejtave individuale dhe grupe në shoqërinë njerëzore. Aktualiteti i kësaj ngjarje reflektohet në mësimet se, si nuk duhet të solidarizohemi me të keqen për asnjë çmim, si duhet luftuar krimin, padrejtësinë dhe tiraninë me çdo mjet, deri sa të ekzistojë kjo botë.

Ngjarja e hixhretit na mëson se për të arritur diçka, nuk mjafton vetëm dëshira dhe vullneti, por duhet bërë lëvizje dhe veprime konkrete për t'u liruar nga fenomenet negative të shoqërisë. Në anën tjetër nga lëvizjet dhe hapat konkretë që i ka bërë Pejgamberi a.s. pasi emigroi në Medinë, japin të kuptojnë se lëvizjet duhet të jenë të planifikuara, të analizuara dhe të harmonizuara edhe me shkaqet praktike që i kërkon nevoja. Andaj ngjarja e hixhretit ishte një shkëndijë prej ku fillon rrezatimi i dritës, lirisë dhe sigurisë njerëzore. Ishte një mësim se, e keqja nuk mund të luftohet e as të evitohet me oportunitet, e as në mënyrë individuale, por detyrimisht kërkon ngritjen e zërit me një organizim të sinqertë të mbarë shoqërisë.

Pikërisht për këto arsye, hixhreti do të mbetet një pikëkthese historike për Ymetin islam, sepse kjo ngjarje, përfundimisht mundësoi ndërtimin e një shoqërie mbi bazamentin e dashurisë dhe respektin e ndërsjellë.

Sot kur bota po përballet me luftë, konflikte, refugjatë e të zhvendosur, mesazhet dhe mësimet e hixhretit duhen kuptuar drejt: në funksion të ndaljes së konflikteve, forcimit të paqes, solidaritetit, dashurisë e respektit të ndërsjellë

Vetëm me punë dhe përkushtim, duke shfaqur vlerat tona paqësore dhe duke bërë hixhret nga mëkatet dhe dukuritë negative, ne mund të arrijmë majat më kulmore të përparimit.

**Sabri Bajgora**  
*Kryeredaktor*  
*shtator, 2019*





Sabri BAJGORA

**ABDULHAMID MUHAMED KISHKU  
DHE TEFSIRI I TIJ “FI RIHABI-T-TEFSIR”**

**Abstrakt**

Nëpër shekujt më të vështirë të Islamit pati njerëz që i ndriçuan rrugët e të tjerëve, duke e flijuar jetën dhe rehatinë e tyre për lartësimin e Fjalës së Allahut. Këta ishin dijetarët mendjendritur që përhapën dijen dhe mësimet e tyre në kushte e rrethana shumë të rënda. I këtillë ishte edhe Abdulhamid Kishku, një thirrës i madh islam, që u torturua nëpër burgjet më famëkeqe të Egjiptit, vetëm për shkak të qëndrimeve të tij të patundura në mbrojtje të fesë. Ai, me plot të drejtë, u quajt kalorës i minberit. Është autori i shumë veprave, ndër të cilat edhe i tefsirit të mirënjohur bashkëkohor “*Fi Rihabi-t-Tefsir*”, me shqyrtimin dhe analizën e të cilit do të merremi gjatë këtij studimi..

***Fjalët çelës:*** Abdulhamid Kishk. Egjipt, Az’har, *Fi Rihabi-t-Tefsir* etj.

## Biografi e shkurtër

Abdulhamid Abdulaziz Muhamed Kishk u lind më 10 mars të vitit 1933 në fshatin Shebrahit të provincës Behira të Egjiptit.<sup>1</sup> Rrjedh nga një familje e devotshme islame. Kishte katër vëllezër e dy motra.

Dijetari i nderuar kishte lindur pa asnjë sëmundje, por në moshën 6 vjeçe, mori një infektim në syrin e majtë, nga i cili, për shkak të moskujdesit të duhur, e humbi shikimin në atë sy. Edhe syri i djathtë iu dobësua në masë të madhe, në mungesë të një kujdesi të shtuar mjekësor, për shkak të kushteve të vështira materiale, nëpër të cilat po kalonte familja e tij, sikur shumica e popullit të Egjiptit atëkohë. Nga biografia e tij e ndritshme, të cilën fatmirësisht e shkroi vetë, në formë të një përshkrimi të tij jetësor "*Kissatu ejjami*", mësojmë se ai qysh në fëmijëri, u shqua me urtësi dhe dashuri të flaktë ndaj Kuranit fisnik me të cilin filloi të shoqërohej dhe ta mësonte përmendsh qysh nga mosha 6-vjeçare.

Shkollën fillore e kreu në Institutin Fetar të Aleksandrisë, në moshën 13 vjeçe. Kurse të parët edhe në syrin e djathtë e humbi përfundimisht në moshën 17 vjeçe<sup>2</sup>, por këtë mungesë Allahu i Plotfuqishëm do t'ia kompensonte me dhuntinë e diturisë, kështu që Abdulhamid Kishku do të bëhej njëri ndër dijetarët më eminentë të botës islame. Emri i tij gjithnjë do të përmendet me dashuri dhe admirim nga masat e gjera të popullit në mbarë botën arabe dhe islame.

Ndonëse i sprovuar me verbëri, ai nuk u zbraps nga kërkimi i dijes, kështu që e regjistroi shkollën e mesme në Institutin e Az'harit në Kajro, në të cilën ishte më i dalluari.

Pas kësaj etape të shkollimit u regjistrua në Universitetin e famshëm të Az'harit, në Fakultetin "*Usuli Din*", të cilin e përfundoi në vitin 1957. Edhe në studimet e tij u dallua nga të tjerët duke fituar epitelin e studentit më të mirë në Universitet, gjë që automatikisht i siguroi vendin e asistentit. Megjithatë, para studentëve në cilësinë e asistentit e mbajti vetëm një ligjëratë dhe më pas u regjistrua në Katedrën për Specializim në Mësimdhënie.

<sup>1</sup> Abdulhamid Kishk, *Autobiografi -Kissatu ejjami*, Kajro 1986, f. 7.

<sup>2</sup> Po aty, f. 21.

Arsyeja pse nuk vazhdoi punën si asistent, e më pas edhe si mësimdhënës në Universitet, ishte dashuria e tij e flaktë ndaj minberit dhe ligjëritimit në xhami. Ai gjatë tërë kohës së studimeve, që prej vitit 1954, kishte shërbyer nëpër shumë xhamia të Kajros dhe rrethinës, në kuadër të Programit trajnues të Ministrisë së Vakëveve për vaizë dhe hatibë, derisa përfundimisht në vitin 1962, u emërua si imam i rregullt i një xhamie në lagjen *Esh-Sherabije*.<sup>3</sup>

Ndërsa në vitin 1964 u emërua imam, hatib dhe vaiz në xhaminë “*Aj-nul Hajat*” në lagjen *Hadaikul Kubbe* të Kajros, në të cilën do të shërbente deri në arrestimin e tij të dytë. Gjatë viteve sa shërbeu si imam dhe hatib në këtë xhami, ai e shndërroi xhaminë në një kompleks shkollor, mjekësor, konsultativ etj.

Në vitin 1965 u martua dhe Allahu i fali tetë fëmijë, pesë djem e tri vajza.

Dijetari i madh, edhe pse i hendikepuar për shkak të verbërisë, ishte shumë i vendosur, që të ngjallte ndjenjën fetare te masat e përgjumura nga rrëmuja politike dhe gjendja e mjerueshme sociale që mbretëronte në vend. Megjithatë, suktesi i tij dhe depërtimi në masat e popullit me ligjëratat e tij, lëvizën ziliqarët, të cilët dërgonin ankesa tek institucionet e sigurisë, se gjoja Shejh Kishku po shkaktonte probleme në atë xhami, duke cenuar rendin dhe sigurinë publike. Këto ankesa ishin shkak i burgosjes së tij në vitin 1966<sup>4</sup>, ku gjatë dy viteve të qëndrimit në burg, u torturua mizorisht nga ana e gardianëve të burgjeve famëkeqe të kohës së Xhemal Abdu Naserit. Nga burgu u lirua në vitin 1968, për të vazhduar sërish punën në xhaminë ku kishte ligjëruar edhe më parë. Me kalimin e viteve, fama e tij sa vinte e rritej. Në ligjëratat e tij, që tashmë kishin kaluar kufijtë e Egjiptit, po edhe të botës arabe, ai kritikonte ashpër dukuritë negative në shoqërinë egjiptiane, e nuk i kursente as personalitetet kryesore fetare e politike, e në këtë rast as vetë presidentin e atëhershëm Enver es-Sadat.

Zaten këto ligjëratat e tij ishin shkak që ai sërish të arrestohej në vitin 1981. Gjatë katër muajve sa ishte në burg, ndodhi atentati ndaj Sadatit

<sup>3</sup> *Autobiografi-Kissatu ejjami*, f. 46; Shih edhe: <http://mugtama.com/archive-pdf.html?task=document.viewdoc&id=1255#page=36>

<sup>4</sup> <https://majles.alukah.net/t132808/>

dhe vrasja e tij. Ai gjatë kësaj kohe iu nënshtrua torturave më çnjerëzore, por falë një amnistie të përgjithshme nga presidenti i ri Husni Mubarek, ai përfundimisht u lirua nga burgu në janar të vitit 1982, por me kusht që kurrë më të mos kthehej në minberin e xhamisë së tij, duke qëndruar në shtëpi, pothuajse si një i burgosur shtëpiak.<sup>5</sup>

Gjatë kësaj periudhe të jetës, ai kurrë nuk prajti së punuari për çështjen e shenjtë islame, së cilës ia kushtoi tërë jetën. Përpos 2.000 audio dhe video kasetave të incizuara e të përhapura në të katër anët e botës, Abdulhamid Kishku la pas vetes edhe 108 vepra të shkruara në fusha të ndryshme të studimeve islame. Megjithatë, fryti më i madh i punës së tij ishte dalja në dritë e tefsirit *“Fi Rihabi-t-Tefsir”*, i cili me plot të drejtë konsiderohet si njëri ndër tefsirët më të njohur bashkëkohorë.

Edhe pse dijetari i madh gjatë kësaj kohe pati oferta të shumta për t’u shpërngulur në ndonjërin prej shteteve islame, si në Arabinë Saudite, Emirate të Bashkuara Arabe, Libi, Kuvajt, madje edhe Amerikë e Britani të Madhe<sup>6</sup> etj., prapëseprapë kurrë nuk mendoi që ta braktiste Egjiptin, por vazhdoi punën e tij të fisnike në tefsirin *“Fi Rihabi-t-Tefsir”* derisa arriti që, me ndihmën e Allahut, ta përfundonte pak para vdekjes.

Abdulhamid Kishku i ishte lutur Allahut që t’i dhuronte jetë, aq sa ta përfundonte tefsirin e filluar *“Fi Rihabi-t-Tefsir”*, të cilin lutje Allahu ia kishte pranuar dhe të mos vdiste ndryshe përveçse me ballin e tij në sexhde të namazit, e cila dëshirë po ashtu iu plotësua. Ai vdiq ditën e xhuma, në kohën sa po thirrej ezani i namazit të xhumasë, më 6 dhjetor 1996, në moshën 63 vjeçe.<sup>7</sup>

Ashtu siç ka rrëfyer bashkëshortja e tij, ai një ditë para se t’ia dorëzonte shpirtin Allahut, e kishte parë një *“rru’je”*, teksa i Dërguari i Allahut Muhamedi a.s. e kishte marrë për dore dhe së bashku me të, kishin shkuar për ta takuar Umerin r.a. dhe i kishin dhënë selam. Pas kësaj, i Dërguari a.s. i kishte thënë Umerit r.a.: *“Ulma këtu dhe shtrima që ta pastroj me duart e mia”*. Umeri r.a. më mori për dore - kishte rrëfyer Shejh Kishku -

<sup>5</sup> *Autobiografi-Kissatu ejjami*, 264.

<sup>6</sup> Dëshmi nga djali i tij i tretë, Muhamed Abdulhamid. Shih: Muhamed Abdullah Semman: *“Esh-Shejh Kishk fî rihabi-l vefai ve-r-rrethai”*, Kajro, 1997, f. 18.

<sup>7</sup> Shih dokumentarin: <https://www.youtube.com/watch?v=QkTHiG6ZZEA>

dhe më shtriu në tavolinë dhe unë sa nuk fjeta. Ndërkohë e shihja të Dërguarin e Allahut duke më pastruar, ashtu siç pastrohet një i vdekur, kurse Umeri r.a. i sillte ujë.” Pasi ishte zgjuar nga gjumi dhe ua kishte rrëfyer familjarëve këtë “*rru’je*” Shejh Kishku dukej shumë i lumtur, saqë vazhdimisht, tërë ditën, i kishte përsëritur fjalët: “*Allahumme leke-l hamdu ve leke-sh-shukru*” - “*O Allah vetëm ty takon lavdërimi dhe falënderimi*”<sup>8</sup>

Në përcjellje të xhenazes së tij ishin miliona njerëz, saqë nga shumë dëshmitarë është thënë se në Egjipt nuk mbahet mend një varrim më madhështor sesa i Shejh Abdulhamid Kishkut. Në lidhje me varrimin e tij, prof. Muhamed Abdullah es-Semani, njëri prej shokëve të tij më të ngushtë dhe i bashkëburgosur me të, thotë: “Gjatë jetës sime kurrë nuk kam parë përcjellje më madhështore të xhenazes sesa të Shejh Abdulhamid Kishkut. E pyeta veten: prej nga erdhën këto turma të mëdha njerëzish, pasi që mjetet e informimit thuajse e injoruan tërësisht lajmin e vdekjes apo varrimin të tij”.

Ndërsa myftiu i Australisë, Shejh Taxhuddin el Hilali, shkruante se gazeta prestigjioze britanike “*Daily Telegraf*” me një titull të madh e pompoz, në faqen kryesore, e portretizoi kështu vdekjen dhe varrimin e tij: “Përcjellje e paparë ndonjëherë në historinë e njerëzimit e një xhenazeje. Katër milionë njerëz në përcjellje të xhenazes së një njeriu të famshëm të fesë në Egjipt.”<sup>9</sup>

## Mësuesit dhe nxënësit e Abdulhamid Kishkut

Abdulhamid Kishku mësoi nga dijetarët më të mëdhenj të Az’harit, në atë kohë, por rrallëkush i ka përmendur ata me emër, më tepër nga frika, për shkak të bindjeve dhe të burgosjes disavjeçare të Kishkut. Mbase pikërisht, për këtë arsye, biografët nuk kanë pasur guximin e mjaftueshëm që të flasin rreth jetës së tij deri në këto detaje. Por, Shejh Kishku në autobiografinë ka përmendur me emër dy prej këtyre dijetarëve të nderuar, ndaj të cilëve shprehet me shumë pietet, për shkak të ndikimit të

<sup>8</sup> Semr Umer Muhamed es-Safedi, *Menhexhu-sh-shejh Abdulhamid Kishk fi tefsirih*, Gazë-Palestinë, 2002, f. 23.

<sup>9</sup> Kujtime personale nga Dr. Ali Uthman Xheradi, shih më gjerësisht: <https://saidacity.net/news/16130/> علي-جرادي--مذكرات-الشيخ-كشك-(9-)-الحلقة-الأخيرة

madh që kanë pasur në formimin e personalitetit të tij si imam: shejh Ahmed el Kumi, në lëmin e Fikhut, hadithit dhe tefsirit dhe shejh Muhammed Mustafa Xhad, njohës i thellë i gjuhës arabe, i gramatikës (sintaksës dhe morfologjisë) dhe i letërsisë arabe, nga të cilët, u ndikua për dashurinë e madhe ndaj këtyre shkencave.<sup>10</sup>

Ndërsa, sa u përket nxënësve të tij, mund të themi se ai pati shumë nxënës, jo në kuptimin “klasik”, si profesor i tyre në shkollë, por si vaiz dhe hatib e mësues shpirtëror, të cilët morën dije në mexhliset e tij për dhjetëra vite. Madje, sot prej tyre ka personalitete të mëdha në arsim, gazetari, publicistikë, biznesmenë etj.

### **Pozita e tij në dije dhe vlerësimet e dijetarëve për Abdulhamid Kishkun**

Ndonëse koha në të cilën jetoi dhe veproi Shejh Kishku ishte e rëndë dhe e përcjellë me vlime të mëdha politike, të cilat në një mënyrë determinuan jetën e tij, megjithatë, ai gëzonte respekt të madh në të katër anët e botës arabe dhe islame. Ligjëratat e tij të guximshme në plasimin e të vërtetës, arritën pothuajse në çdo shtëpi myslimane. Ai ishte i guximshëm në të vërtetën dhe kurrë nuk u dorëzua para presioneve të pushtetit. Ai, madje, ashtu siç përmendëm më parë, kishte refuzuar disa herë ofertat e majme nga aspekti material, nga Arabia Saudite dhe nga vendet e Gjirit, sepse dëshironte që të qëndronte pranë xhematit të vet besnik, derisa u burgos dhe iu ndalua ligjërimi në xhami.

Edhe përkundër faktit se pushteti i kishte halë në sy edhe ata njerëz që e përkrahnin atë nga distanca, duke i ndjekur e burgosur, megjithatë vlerësimet e njerëzve dhe dijetarëve nuk munguan për ta përshkruar personalitetin dhe dijen e tij.

- Njëri nga profesorët e Fakultetit të Edukimit, Abdurrahman Ahmed Semaha, ende sa ishte gjallë Shejh Kishku, dhe po qëndronte në burgun shtëpiak duke u marrë me tefsirin e Kuranit, i kishte thurur një poezi të fuqishme, të cilën u mundova ta përshtatja, pak a shumë, pa ndonjë rimë, teksa për të thotë:

---

<sup>10</sup> *Autobiografi-Kissatu ejjami*, f. 8.

*“Do të mbetesh imami ynë o Abdulhamid,  
edhe përkundër mizorisë dhe padrejtësisë së armiqve ndaj teje,  
Përfjetësisht do të mbetesh këshilluesi ynë,  
me Kuranin si udhëzues.*

*Një ditë e tërë bota do të dëshmojë se ti vërtet je kalorës,  
o bir i fisnikëve dhe zotëri i kalorësve të hakut.*

*Na freskove me “Rihabin”<sup>11</sup> dhe na udhëzove,  
andaj mos u ndal së sqaruari për ne, kuptimet e këtij Libri të Hakut”.*<sup>12</sup>

- Z. Xhemal Muhamed el Mehdi në një letër të cilën ia kishte shkruar Shejh Kishkut, i thoshte: *“Mbase disa gjëra që në pamje të jashtme duken të dëmshme, janë të dobishme. Ty të privuan nga minberi dhe detyra e imamit, për ta dobësuar aktivitetin tënd intelektual në lëmin e davetit, por Vullneti i Allahut është më i fuqishëm sesa intrigat e tyre, sepse të radhiti ty në regjistrin e mufesirëve më të njohur në botë...”*<sup>13</sup>

- Me të njëjtat epitete, për të shprehet edhe botuesi i tefsirit të tij z. Jahja Ahmed, themeluesi i shtëpisë botuese *“El-Mekteb el Misrijj el hadith”*, i cili në parathënien e vëllimit të parë, ndër të tjera shkruan: *“Në shtator të vitin 1981, Shejh Kishkut iu ndalua të hipte sërish në minber, e po ashtu iu ndalua të takonte edhe xhematlinjtë e tij të dashur në ndeja e këshillime. Por, nganjëherë dëmi edhe mund të jetë i dobishëm... Shejh Kishku këto vite u përqendrua fort në tefsirin e Kuranit fisnik, duke qëndruar për net të tëra e të gjata pa gjumë, për të sqaruar e komentuar ajetet e tij...”*<sup>14</sup>

- Shejh Muhamed Hasan kur shkoi te bijtë e Shejh Kishkut për ngushëllime iu tha atyre: *“Nuk kam ardhur për t’ju ngushëlluar, por për t’ju përgëzuar. Ju keni plot të drejtë ta ngrini kokën lart, sepse jeni bijtë e luf-tëtarit të hakut, Abdulhamid Kishkut”.*

Po ashtu, Shejh Muhamed Hasani, në një ligjëratë të tij, *“Çka pas Ramazanit”* rrëfen në lidhje me Shejh Kishkun e thotë: *“Dy muaj pas vdek-*

<sup>11</sup> Këtu ka për qëllim tefsirin e tij *“Fi Rihabi-t-Tefsir”*.

<sup>12</sup> *Fi Rihabi-t-Tefsir* (8/7297).

<sup>13</sup> *Fi Rihabi-t-Tefsir* (2/124).

<sup>14</sup> *Fi Rihabi-t-Tefsir*, (1/8).



jes së Shejh Kishkut, pikërisht në natën e 27 të Ramazanit, e cila ndoshta mund të ketë qenë edhe nata e Kadrit, ndonëse kjo është vetëm në dijen e Allahut, pasi që e fala namazin e sabahut, sytë mu rënduan nga gjumi dhe fjeta. Në ëndërr po e shoh Shejh Abdulhamid Kishkun të ulur në një kolltuk, të praruar në ar të pastër. I dhashë selam, dhe ai ma ktheu selamin, me atë edukatën dhe mirësjelljen që e karakterizonte personalitetin e tij. I thashë si me shaka: O Shejh i nderuar, përse më dukesh paksa i mërziur, ndërsa ai me akcentin-dialektin popullor egjiptian ma ktheu: O Muhamed, o biri im! A thua, ka dikush që e ndjen veten të mërziur në Xhenet, përkundrazi, unë jam në kopshte të rrethuar me lumenj, në një vend të kënaqshëm, te Sunduesi i plotfuqishëm.” Muhamed Hasani vazhdon e thotë: E pashë Shejhun e nderuar, shikimin e kishte të mprehtë (e jo siç ishte i verbër në dynja), me pamje të bukur, andaj e lusim Allahun që edhe ne të kemi përfundim të mirë, sic e pati imami ynë i nderuar!”

- Gjiganti botëror mediatik *Al Jazeera* ia ka kushtuar një artikull të gjerë jetës dhe veprës së tij me titull: “*Shejh Kishku jetoi si kalorës dhe vdiq në sexhde*”.<sup>15</sup>

- Shejh Taxhuddin el Hilali e kishte vizituar Shejh Kishkun në Kajro, disa ditë para vdekjes së tij dhe ishin çmallur së bashku. Kurse gjatë kohës së ngushëllimit, ai iu drejtua qeverisë së Egjiptit me këto fjalë: “*Besoje se tashmë erdhi koha që ato duar të mpira e të shtangura, që prangosën ‘Fjalën e Allahut’ dhe dijetarët, të zgjohen e të përmenden nga gjumi. Di-jeni se armikun e kemi para derës. Zgjohuni o njerëz. Çështja vërtet është serioze, sepse ne nuk ia kemi dhënë besën Egjiptit... që t’i hajë (vrasë) bijtë e saj!*”

- Prof. Mustafa Mesh’hur, udhëheqësi suprem i “Vëllezërve Mysli-manë”, ka thënë: “*Shkuarja e Thirrësve të mëdhenj tek Allahu si: Abdu-rreshid Sakr dhe Shejh Kishku, na shtyn të ankohe mi me sinqeritet e devotshmëri tek Allahu për gjendjen në të cilën gjendemi... Shejh Kishku ishte një prej kalorësve të minbereve, të cilët mund të numërohen në gish-ta. Ai ishte prej thirrësve më të sinqertë, dhe të gjithë jemi mërziur për*

<sup>15</sup> <https://www.aljazeera.net/news/politics/2019/3/10/الشيخ-كشك-عاش-فارسا-ومات-ساجدا>

të. *E lusim Allahun që të kemi dobi prej diturisë së tij, e cila e ka mbushur dynjanë dhe i ka ndriçuar mendjet e njerëzve*".

- Dr. Abdul Mun'im el Berri, kryetar i Lidhjes së Ulemave të Az'harit, thotë: *"Pikëllimi im për Shejh Kishkun nuk mund të krahasohet me asnjë pikëllim tjetër, sepse unë isha zëvendës i tij, kur atë e privuan nga minberi i tij. Afërsia vëllazërore me të vazhdoi për 35 vjet me radhë dhe përgjatë këtyre viteve, unë e kam konsideruar atë si një prej luanëve të hakut, i cili për hir të Allahut, është i gatshëm të flijojë gjithçka. Ai e llogariste veten si një ushtar në fushëbetejë. Për këtë arsye, ai disa herë kishte refuzuar largimin nga Egjipti, edhe përkundër ofertave të parezistueshme nga jashtë. Mbi të gjitha ai thoshte: Ikja e ulemave-dijetarëve nga Egjipti, gjatë kësaj periudhe të rëndë historike, i ngjason ikjes nga fronti i fushëbetejës, sepse Egjipti është zemra e Botës Islame, e nëse zemra vdes, atëherë vdes i tërë trupi"*.<sup>16</sup>

Myftiu i Arabisë Saudite, Abdulaziz bin Baz, kur kishte dëgjuar për vdekjen e Shejh Kishkut, se ai ia kishte dorëzuar shpirtin Allahut duke qenë balli i tij në sexhde, në ditën e xhumasë, kishte thënë para njerëzve-dijetarëve që ishin në mexhlin e tij: *"Mashallah, Mashallah, Rahmetullah, Rahmetullah! Ky është vëllai ynë dhe është prej nesh. Qoftë i përgëzuar më mëshirën e Allahut për këtë përfundim të mirë. E lusim Allahun që të na dhurojë edhe neve përfundim të mirë."* Shejh Bin Bazi vazhdoi të qante me ngashërim, e së bashku me të qanin edhe të pranishmit.<sup>17</sup>

Dr. Omer Abdulkafi për të ka thënë: *"Ne jemi nxënës të këtyre kolosëve. Nuk më ka rastisur të udhëtoj në ndonjë vend, e të mos e takoj dikë që është udhëzuar nga dëgjimi i ligjëratave të Shejh Kishkut nga kasetat e tij."*<sup>18</sup>

Ndërsa njëri prej publicistëve bashkëkohorë islamë, Mahmud el Ka-ud, në një artikull të titulluar: *"Abdulhamid Kishku-Cunami që erdhi nga Shebrahiti"*, në vitin 2007, kishte shkruar: *"Ai e ngjalli një Umet, të cilin e kishte kapluar agonia e vdekjes, duke shkaktuar dridhje e shkundje të fuqishme në shoqëri, pikërisht siç bëri "cunami" në Sumatra të Indo-*

<sup>16</sup> <https://saidacity.net/news/16130/> الحلقة-الأخيرة (-۹-) -كشك-

<sup>17</sup> Po aty.

<sup>18</sup> Po aty.

nezisë në fund të vitit 2004. Por dallimi në mes cunamit të Indonezisë dhe tërmetit-dridhjes që shkaktoi Shejh Kishku, është se cunami shkaktoi vdekjen e një çerek milioni njerëz, ndërsa tërmeti i Shejh Kishkut ngjalli me qindra-mija njerëz, duke i kthyer ata në natyrshmërinë e tyre si robër të devotshëm dhe duke i bërë ata të dobishëm për shoqërinë. Ai ua hoqi nga zemrat ndryshkun e shtresuar, duke i bërë njerëzit të mëshirshëm në mes vete, në një kohë e cila nuk njihete as mëshirë e as mirësjellje. Ai i zgjoi njerëzit nga letargjia, duke e ua tërhequr vërejtjen për ballafaqimin me vdekjen e vërtetë!”<sup>19</sup>

### Veprat e shkruara nga Shejh Kishku

Shejh Abdulhamid Kishku la pas vetes 108 libra të shkruar.<sup>20</sup> Pa dyshim, kryevepra e tij është tefsiri tashmë i mirënjohur në mesin e dijetarëve dhe studiuesve të fesë “*Fi Rihabi-t-Tefsir*”. Sa për korrektësi, ne këtu do të përmendim vetëm titujt e disa nga veprat e tij.

1. *Tariku-n-nexhat*
2. *Rijadu-l xhenneti*
3. *El-Jevmu-l hakk*
4. *Suver min adhameti-l Islam*
5. *Irshadu-l Ibad*
6. *Advaun mine-sheriat-l garraë*
7. *El-Ba'thu ve-l xhezaë*
8. *Shifau-l kulub*
9. *Hakaik ve hadith ani-rruh*
10. *Hadith mine-l kalb*
11. *Es-Salatu re'su-l ibadat*
12. *El-Islamu ve udulu-t-terbijjeti*
13. *El-Vesaja el ashri fi-l Kurani-l Kerim*
14. *Verethetu-l Firdevs*
15. *El-Huda ve-n-Nur*
16. *Xheddid es- sefinete*

<sup>19</sup> [https://makaoud.blogspot.com/2007/10/blog-post\\_2432.html](https://makaoud.blogspot.com/2007/10/blog-post_2432.html)

<sup>20</sup> <https://alwasateia.com> - منهج-الشيخ-عبد-الحميد-كشك-في-تفسير-القران

17. *Eid ez-zad*
18. *El-Futuhāt er-Rrebbanijjeti*
19. *Rihletun ila Daril-ahireti*
20. *Sum ani-d-dunja ve-ftir ale-l mevt*
21. *Es-Sirau bejne-n-nefsi vel mal*
22. *Ihli el amel fe inne en-Nakidu besir*
23. *Sahibu-r-rrisaletu-l asmau*
24. *Sijahatun mubareketun*
25. *Fadlu-l Kurani jevme-l hashri*
26. *Musariu-dh-dhalimine*
27. *Es-Sulhu mea Allah*
28. *En-Nasu bi hajrin ma tenessahu*
29. *El-Vukufu bejne jedejji-l-lahi teala*
30. *Ala maideti-l Islam*
31. *Gidhau-r-rruh*
32. *Halat mine-n-nur*
33. *Sa'at mea safai-n-nefsi*
34. *Fi Rihabi-s-sekineti*
35. *El-Islamu shexheretu-t-tajjibeti*
36. *Idha dhukire Allah nezeleti-t-tama'nine*
37. *Resai-l rahmanijeti-n-nefehat*
38. *Min xhivari-l halk ila rihabi-l hak*
39. *Mantiku-l hakki-l mubin*
40. *Fi sahati-l hisab*
41. *Ja Rabbi kejfe eshkurek*
42. *Hadith ani-s-salihine*
43. *El-Hayfu ve-r-rrexhau*
44. *Shuaun min nuri-l Iman*
45. *Kissatul besherijjeti*
46. *Sehaibu-r-rrahmeti*
47. *El-Emnu fi dhil-lil Islam*
48. ***Fi Rihabi-t-Tefsir*** (30 pjesë, e në disa botime, 9 vëllime)
49. *En-Nexhatu fil i'tisami bil-lahi teala*
50. *Kul-lu neimu dunel Xhenneti hakim*

51. *Ixhtenibu es-seb'al mubikat*
52. *Seb'atun fi dhil-li-r-Rrahman jevme-l hashri,*
53. *El-Butuletu fi dhil-li-l akideti*
54. *Nefehat mine-d-dirasatil islamijjeti*
55. *Hajatu-l insan*
56. *Mea-t-tevhidi ve-l ahlak,*
57. *Fetava shehj Kishk - Humum el muslim el jevmije (9 vëllime), etj..<sup>21</sup>*

### **Veprat me të cilat është shërbyer Abdulhamid Kishku në tefsirin tij**

Si shumica e mufessirëve bashkëkohorë, Abdulhamid Kishku, me besnikërinë dhe përgjegjësinë më të madhe shkencore, gjatë tefsirit të tij, përdori burime nga librat e kolosëve të tefsirit para tij, si nga ata të hershmit, po ashtu edhe nga bashkëkohorët, e madje edhe nga bashkëkohësit e tij.

Në lëmin e **Tefsirit:**

- *Xhamiul Bejan* - nga Taberiu, etj.
- *Tefsirul Kurani Adhim* - nga Ibn Kethiri
- *Ed-Durrul Menthur* - nga Sujutiu
- *Ahkamul Kuran* - nga Kurtubiu
- *Ahkamul Kuran* - nga Xhessasi
- *Medariku-t-Tenzil* - nga Nesefiu
- *Et-Tefsirul Vadih* - Mahmud Hixhazi
- *Envaru-t-Tenzil* - nga Bejdaviu
- *Tefsirul Xhelalejn* (në disa versione të redakturës)
- *Keshafî* - i Zemahsheriut
- *Ahkamul Kuran* - të Ibnul Arebiut
- *El-Bahrul Muhit* - nga Ebi Hajan el Endelusi
- *Mefatihul Gajb* - të Fahru-r-Rraziut
- *Ruhul Meani* - nga Alusi
- *Revaiul Bejan fi tefsiri ajatik Kuran* - nga Muhamed Sabuni

<sup>21</sup> Shih kopertinën e fundit të tefsirit *Fi Rihabi-t-tefsir*, në të cilën gjendet lista e librave të Shehj Kishkut; Shih *Kissatu ejjami*, ff. 265-286; Për më gjerësisht shih: <https://www.abjjad.com/author/2812510208-عبد-الحميد-كشك/books/>; <http://www.makbtbna2211.com/sub-category/116>.

**Në Shkencat Kuranore:**

- *Besairu dhevi-t-temjiz* - nga Fejruzabadi
- *El-Mufredat fi garibi-l Kuran* - nga Asfehani
- *Meani-l Kuran ve I'rabuhu* - nga Zuxhaxhi
- *Lisanu-l Arab* - nga Ibn Mendhur
- *I'rabu-l Kuran* - nga Nehhasi
- *Meani-l Kuran* - nga Ferrai, etj.

**Në shkencën e Akaidit:**

- Librat e klasikëve të kësaj sfere,
- *El-Vahju-l Muhammedij* - nga Reshid Ridaja
- *Alemu-l melaike-ti-l ebrar* - Omer el Eshkar, etj.

**Në shkencën e Hadithit:**

- *Sahihu-l Buhari*
- *Sahihu Muslim*
- Sunenët, etj.

**Nga lëmi i Sires:**

- *Siretu Ibni Hisham*
- *Zadu-l Mead*, etj.

**Nga shkencat e Fikhut:**

- *Librat e klasikëve të katër medhhebeve*,
- *Fikhu-s-Sunneti* - nga Sejid Sabik, etj.<sup>22</sup>

---

<sup>22</sup> Shih: *Menhexhu-sh-shejh Abdulhamid Kishk fi tefsirihi*, ff. 44-65.

### Karakteristikat e tefsirit Fi Rihabi-t-Tefsir

Tefsiri i dijetarit të njohur bashkëkohor Abdulhamid Kishk, i titulluar “*Fi Rihabi-t-Tefsir*”, është një prej tefsireve që ka pasur praninë të madhe, si nga ana e dijetarëve, ashtu edhe nga masa e gjerë e lexuesve. Botimi i parë i këtij tefsiri, si i pjesshëm ashtu edhe komplet, është botuar nga Shtëpia Botuese “*El-Mekteb el Misriyy el hadith*” në Kajro, në 30 vëllime, me gjithsej 8260 faqe. Tefsiri i tij fillon me një parathënie, në të cilën kryesisht ka folur rreth Kuranit famëlartë, vlerës së tij, zbritjes, tubimit dhe kujdesit që duhet ta kenë gjeneratat e ardhshme islame për të. Pastaj fillon me komentimin e sures *El-Fatiha* dhe përfundon me komentimin e asaj *En-Nas*. Botimi i tij, pjesë-pjesë, ka zgjatur disa vite, duke filluar nga viti 1988, sepse atë që Shejh Kishku e përfundonte, menjëherë botohej si një *xhuz* i veçantë, derisa nuk e përfundoi të tërin pak para vdekjes. Më vonë, ky tefsir është botuar në 9 vëllime të mëdha, jo vetëm në Egjipt, por anekënd botës arabe dhe asaj islame. Ne para vetes në shqyrtim dhe analizë e kemi botimin e parë të këtij tefsiri në 30 vëllime mesatare.

- Ky tefsir konsiderohet si këpujë-lidhëse ndërmjet tefsireve nga thesari i mëhershëm tradicional dhe i atyre bashkëkohorë racionalë. Lexuesi nga ky tefsir përfiton edhe për faktin se nuk e shpëput lidhjen me tefsiret e mëhershme, por orientohet edhe nga horizontet e reja që shfaqen nga penat e mufesirëve të rinj bashkëkohorë.

- Abdulhamid Kishku, gjatë komentimit, ka përdorur në një masë të madhe komentimin e Kuranit me Kuran, siç do ta shohim më vonë tek metodologjia tradicionale e komentimit. Po ashtu nuk e ka lënë anash as burimin e dytë të tefsirit, hadithet e Resulullahit s.a.v.s., fjalët e ashabëve, të tabi’injve etj.

- Këtë tefsir e karakterizon edhe komentimi tematik. Shejh Kishku nuk mjaftohej vetëm me komentimin analitik, por një tematike të caktuar, ia kushtonte një hapësirë të madhe, mbase nganjëherë edhe të stërzgatur.

- Karakteristikë tjetër e këtij tefsiri është se secili lexues e gjen veten në të, pavarësisht se cilit nivel intelektual i takon.

- Ky tefsir karakterizohet për një qasje mjaft studimore edhe nga aspekti gjuhësor, letrar, nga aspekti i retorikës, i shkaqeve të zbritjes, i transmetimit të haditheve të vërteta, pastaj të shumë ngjarjeve të cilat i cek edhe Kurani fisnik, etj.

- Në anën tjetër, përpos shumë karakteristikave pozitive, ky tefsir është pothuajse plotësisht i pastër nga rrëfimet israilite - “*israiliatet*”, të cilat pashmangshëm i imponuan një numri të konsiderueshëm të mufesirëve të mëparshëm. Shejh Abdulhamid Kishku rrallëherë e ka përmendur ndonjë *israiliat*, por kur e ka përdorur, e ka sjellë shkurtimisht sa për ta demantuar si të shpifur dhe të dëmshëm.

- Tefsiri i lartpërmendur është një tefsir i thurur në atë formë dhe metodë, prej të cilit, pa dyshim, më së tepërmi mund të përfitojnë thirrësit islamë. Mënyra e ligjëritimit të Kishkut gjatë derseve në minber hetohet në një masë të konsiderueshme edhe në fletët e këtij tefsiri, gjë që megjithatë aspak nuk zbeh vlerën e pakontestueshme të tij.

### **Vërejtjet e disa studiuesve ndaj këtij tefsiri**

Gjatë analizës që i kanë bërë këtij tefsiri, dijetarët i kanë dhënë edhe disa vërejtje, të cilat po të analizohen më thellësisht, nuk mund të quhen as si vërejtje të mirëfillta.

- Përsëritjet në këtë tefsir, mbase mund të jenë një prej atyre pikave të dobëta, sipas studiuesve, sepse autori shpeshherë e ka përsëritur të njëjtën tematikë në disa sure. Atij do t’i mjaftonte që vetëm të jepte shenjë se kjo tematikë është përsëritur më detajisht, p.sh. në suren *El-Bekare* e të mos përsëritej deri në detaje f.v. edhe në suren *Ali Imran*.

- Mossqarimi nga ana e tij për metodologjinë e ndjekur në këtë tefsir nga ana e vetë autorit, gjë që do t’ua lehtësonte punën studiuesve të këtij tefsiri.

- Kundërshtimet e pakta ndaj grupeve të devijuara apo fraksioneve, në lidhje me çështjet e besimit.

- Stërzgjatja në komentim në disa tematika të caktuara, të cilat te ndonjë lexues edhe mund të shfaqin indiferencë dhe mosinteresim për të vazhduar tutje me lexim, sepse nganjëherë ndodh që tema të dalë jashtë kornizave të ajetit që është duke e komentuar<sup>23</sup> etj.

- vijon -

<sup>23</sup> *Menhexhu-sh-shejh Abdulhamid Kishk fi tefsirihi*, ff. 328-332.



Sabri BAJGORA

**ABDUL HAMID MOHAMMED KISHK  
AND HIS TAFSIR “FI RIHABI-T-TAFSIR”**

**(Summary)**

Even in the most difficult times for Islam, there were people who illuminated the path for others, sacrificing their lives and their own comfort to spread the word of Allah. These were bright-minded scholars who spread their knowledge and their teachings in very difficult circumstances. Kishk was one of the greatest Islamic speakers of our era, who was tortured in some of the most notorious prisons in Egypt because of his relentless stance in defence of his religion. He was rightly known as the knight of the minbar. He is the author of many works, including the well-known “*Fi Rihabi-t-Tafsir*”, which we will analyze in this paper.

صبرى بايجورا

**عبد الحميد محمد كشك وتفسيره "في رحاب التفسير"**

**(خلاصة البحث)**

خلال أصعب العصور من تاريخ الإسلام ، كان هناك أشخاص ينيرون طرق الآخرين ، ويضحون بحياتهم لإعلاء كلمة الله. كان هؤلاء العلماء الافاضل ينشرون علمهم وتعاليمهم في ظل ظروف صعبة للغاية. و من هؤلاء العمالقة الشيخ الجليل عبد الحميد كشك ، الداعية الإسلامي الكبير، الذي تعرض للتعذيب في السجون المصرية لسنوات عديدة بسبب مواقفه الثابتة دفاعا عن الدين. كان بحق يلقب بفارس المنبر. وهو مؤلف عديد من الكتب، بما في ذلك التفسير المعاصر المعروف "في رحاب التفسير" الذي سنتناوله تحليله من خلال هذه الدراسة.

Dr. Belkasim EL-GALI

## IMAM MATURIDIU DHE ARGUMENTIMI I EKZISTENCËS SË ALLAHUT - (II)

### 8. Ekzistimi i së keqes në gjithësi, argument për ekzistencën e Allahut (وجود الشر في العالم دليل علي وجود الله)

Prej argumenteve më të rëndësishme, me të cilin ka lulëzuar mendimi i Maturidiut, në fushën e argumentimit të ekzistencës së Allahut, është pikërisht argumenti mbi ekzistimin e së keqes në gjithësi. Sepse, “gjithësia, sikur të ishte e vetëkrijuar, atëherë, çdo gjë që ajo do të krijonte në të, do të përzgjidhte pozitat më të mira, më të bukura dhe atributet më të përsosura, dhe për pasojë, e keqja dhe e shëmtuara nuk do të ekzistonin fare! Por, pikërisht, ekzistimi tyre (e keqja, e shëmtuara, etj.), dëshmon se kjo gjithësi nuk është vetekzistuese, por e ngjarë nga një faktor i jashtëm, e Ai është Allahu.”<sup>1</sup>

Maturidiu, i cili këtë argument e ka shndërruar në metodologji për argumentimin e ekzistencës së Allahut, konsiderohet themelues i këtij argumenti. Përveç kësaj, ai është i pari që e ka përdorur këtë argument. Është e vërtetë se filozofët dhe kelamologët, në përgjithësi, kanë diskutuar për çështjen e së mirës dhe të bukurës, si një fakt, që argumenton ekzistencën

<sup>1</sup> El-Maturidiu, *Kitabu-t-Tevhid*, f.17.

e Allahut, siç ka bërë Platoni, ose siç ka vepruar Aristoteli me argumentin teologjik, por, ata nuk e kanë shfrytëzuar këtë argument.<sup>2</sup>

Mirëpo, Maturidiu i ka kushtuar rëndësi këtij argumenti, pasi që, në disponim kishte një argument shumë të pastër. Sepse, gjithësia, përmban mangësinë, të keqen dhe të shëmtuarën, të cilat mund t'i vërtetojë edhe mendja njerëzore, sado që është e kufizuar. Shtrohet pyetja: Sikur gjithësia të ishte krijuese e vetvetes, a do të pajtohej që brenda saj të ekzistonin mangësitë, siç janë e keqja dhe e shëmtuara? Absolutisht, jo! Ajo, sikur të ishte vetekzistuese, do të për zgjidhte pozitat më të mira, më të bukura, përfshirë edhe cilësitë. Atëherë, kjo na vërteton se kjo gjithësi është e sajuar nga një faktor i jashtëm, e ai krijues është Allahu.

Allahu i Madhërishëm, megjithatë ka caktuar urtësi në ekzistimin e të keqes, për qëllime të caktuara të cilat Maturidiu i ka sqaruar, kur thotë: “Nuk ka lëndë të keqe, veçse ajo e ka një urtësi të qartë, por disa e kanë të fshehtë dhe mendja nuk ka mundësi ta konceptojë”.<sup>3</sup> Sa e sa prej lëndëve të hidhura apo helmuese, kanë në përmbajtjen e tyre efektin e ilaçit për ndonjë sëmundje të rëndë!? Kjo ia tërheq vërejtjen secilit vrojtues se për një lëndë të caktuar, nuk mund të konkludojë apriori se është vetëm e mirë apo se është vetëm e keqe, përkundrazi, çdo lëndë mund të përmbajë dëmin dhe dobinë. Bile, pikërisht kjo krijimtari konsiderohet prej argumenteve më madhështore për Njëshmërinë e Krijuesit të gjithësisë.<sup>4</sup>

Pra, siç shihet, Maturidiu është themelues i këtij lloji të argumentit. Në të vërtetë, kjo rikonfirmon pozitën e tij shumë të rëndësishme në historinë e mendimit islam, e posaçërisht në shkollën synite hanefite, pasi që, Maturidiu, u veçua për nga aspekti i debateve logjike dhe i aftësisë në parashtrimin e ekzistencave, perceptimin e objektivave dhe synimeve të tyre.

<sup>2</sup> Fet'hullah Hulejfi, *Mukaddimetu Kitabi-t-tevhid*, f. 34 m.

<sup>3</sup> El-Maturidiu, *Kitabu-t-Tevhid*, f.108.

<sup>4</sup> El-Maturidiu, *Kitabu-t-Tevhid*, f.110.

## 9. Argumenti i përkujdesjes apo nënshtrimit

### (دليل العناية أو التسخير)

Është prej argumenteve më të njohura në lidhje me ekzistencën e Allahut. Po ashtu, është i atillë, që më së shumti ka ndikuar, ka gjetur pëlqim, si dhe është më i kapshmi për mendjen njerëzore. Kurani famëlartë i ka kushtuar mjaft rëndësi këtij argumenti, duke e artikuluar në versione të ndryshme, në shumë citate kuranore, andaj edhe është emërtuar si argument i fesë.

Forma e tij është ashtu siç e ka karakterizuar Maturidiu, në fletët e librit të tij, “Kitabu-t-Tevhid”: *“Allahu i ka krijuar njerëzit në formën më të bukur dhe atyre ua ka nënshtruar për shfrytëzim çdo gjë prej mirësive që gjenden në tokë e qiell.”*<sup>5</sup> Ideja është se çdo ekzistencë që manifestohet sipas një synimi të përcaktuar, është e dedikuar për interesin e njeriut, dhe ky dedikim apo nënshtrim, nuk është një punë e rastësishme apo aksidentale.

Ky observim mund të kategorizohet si në vijim:

- 1) Allahu e ka krijuar njeriun në formën më të bukur, një krijim perfekt dhe madhështor;
- 2) Allahu e ka krijuar tokën dhe çdo gjë tjetër prej mrekullive;
- 3) Allahu e ka krijuar qiellin dhe çdo gjë që përmban ai prej trupave qiellorë, e që njeriu nuk ka kapacitete t’i numërojë, si mirësi me të cilat rrethohet.

Njeriu, nëse mediton me kujdes rreth këtyre trupave qiellorë, do të gjejë se Allahu përmes tyre ka realizuar një përkujdesje gjithëpërfshirëse ndaj njeriut, sepse çdo fenomen në gjithësi është në koherencë me zhvillimin e njeriut dhe njëkohësisht kompatibil me gjendjet e tij dhe fleksibil me jetën e tij. Kjo strukturë mjaft delikate nuk mund të jetë një rezultat i rastësishëm, kur dihet se natyra vetvetiu e ka të pamundur që të realizojë një gjë të tillë. Kjo është ajo fusha për të cilën kemi shumë zbulime në periudhën bashkëkohore, në disiplina dhe shkenca të ndryshme.

<sup>5</sup> El-Maturidiu, *Kitabu-t-Tevhid*, f.178.

Edwin Conklin\* thotë: Ideja se jeta është rezultat i “ngjarësisë së rastësishme” për nga qëllimi, ngjason me atë sikur ne të përgatisnim një fjalor madhështor dhe i njëjti, vetvetiu, në mënyrë krejt të rastësishme fluturon edhe shkon e hyn në shtypshkronjë!”<sup>6</sup> Kur i kemi parasysh të gjitha llojet e ekzistencave, që i manifeston ky realitet i mahnitshëm, arrijmë të vërtetojmë se çdo krijesë duke filluar prej atyre më madhështore e deri te ato më të thjeshtat, janë në shërbim të llojit njerëzor. Allahu i Lartmadhërishtëm thotë:

**“Edhe kafshët Ai krijoi dhe në saje të këtyre ju mund të mbroheni (nga të ftohtit), keni edhe dobi të tjera dhe prej tyre hani. Në to (në kafshët) ju shihni hijeshi (idili) kur në mbrëmje ato i ktheni (nga kullosa) dhe kur në mëngjes i lëshoni (për në kullosë). Ato bartin barrën tuaj (të rëndë) në ndonjë vend (të largët) që ju do të arrinit atje me shumë vështirësi (me gjysmë shpirti). Vërtet, Zoti juaj është shumë Bamirës dhe shumë Mëshirues. Edhe kuajt (i krijoi), edhe mushkat edhe gomarët, për t’ju hipur atyre dhe si stoli, e Ai krijon (për hipje) çka ju (tash) nuk dini.”** (El-En’am, 5-8).

Andaj, në kontekst të sqarimit të Maturidiut mbi këtë argument themi: Në qiell ka yje të shpërndara gjithandej, përfshirë dhe Hënë, e cila posedon një pozitë të rëndësishme. Por aty është edhe Dielli, i cili konsiderohet prej yjeve dhe trupave më të ndritshëm. Sikur Dielli të afrohej pak më shumë se sa ajo që e ka të përcaktuar, prej nxehtësisë së madhe do të shkatërrohej çdo gjallesë apo bimë në Tokë, po edhe në të kundërtën, sikur të largohej pak, do të shkatërrohej njerëzimi prej të ftohtit dhe ngricave, me ç’rast do të rrënoheshin katër stinët si dhe do të mbaronte jeta mbi të. Allahu i Madhërishtëm, thotë:

**“Për ata është argument edhe nata, prej të cilës largojmë ditën, kurse ata mbesin në terr.”** (Ja-sin, 37)

Prandaj, çdo gjë në këtë gjithësi, e ka qëllimin, synimin e përcaktuar si dhe linjën në të cilën lëviz. Allahu i Lartësuar thotë:

\* Edwin Conklin (1863-1952), është shkencëtar amerikan, i njohur në fushën e biologjisë dhe zoologjisë. Më gjerësisht shih, [https://en.wikipedia.org/wiki/Edwin\\_Conklin](https://en.wikipedia.org/wiki/Edwin_Conklin). (O.B.).

<sup>6</sup> Vehidud-din Han, *El-Islamu jetehad-da*, botimi i gjashtë, Kajro, 1976, f.66.

**“Ai është që për ju lëshoi nga (lart) qielli ujë, që prej tij të keni për të pirë dhe prej tij të keni bimë që në to do t’i kullotni (bagëtinë). Me atë (shiu) mbijnë, për të mirën tuaj, të lashtat, ulla, hurmat, rrushnajat dhe nga të gjitha frutat (e pemëve). Në këto (të mira) ka argumente për një popull që vështron. Dhe për ju nënshtroi natën e ditën dhe Diellin e Hënën. Edhe yjet janë të nënshtuar me urdhrin e Tij. Vërtet, në këto ka argumente për një popull që mendon.”** (En-Nahl, 10-12).

E, kur çështja është e tillë me qiellin, atëherë çështja me tokën është akoma më madhështore, pasi që aty ka turbulenca, kodra, miniera, kafshë, bimë. Se cila prej tyre përmban mirësi të shumta dhe dobi për njeriun, si strumbullar i kësaj gjithësie. Thotë Allahu i Lartësuar:

**“Ne, vërtet nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit), u mundësuar të udhëtojnë hipur në tokë e në det, i begatuam me ushqime të mira, i vlerësuar ata (i lartësuar) ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam.”** (El-Isra, 70).

Atëherë, marrë parasysh këtë pozitë të rëndësishme, që Allahu, me dashuri ia ka dhënë njeriut, qartësohet se në mes të njeriut dhe natyrës nuk ka kundërthënie, përkundrazi ajo është e nënshtuar ndaj njeriut, për të sjellë të mira për interesin e tij. Allahu i Lartësuar thotë:

**“A nuk e dini j se Allahu nënshtroi për të mirën tuaj çka në qiej e çka në tokë dhe plotësoi ndaj jush të mirat e Tij të dukshmen e të fshehta...”** (Lukman, 20).

pastaj,

**“Si nuk kanë parë ata se Ne e sjellim ujin në tokën e thatë dhe me të nxjerrim bimë që prej tyre ushqehen kafshët e tyre, bile edhe ata vetë, A nuk janë duke parë (e të kuptojnë)?”** (Es-Sexhde, 27).

Po ashtu, i Lartmadhërishtmi, ka thënë:

**“Pastaj, Ai është që nënshtroi detin, që prej tij të hani mish të freskët, e prej tij të nxirrni stoli që i bartni (i vishni), e i sheh anijet si çajnë (lundrojnë) në të (me ushtri, e çajnë ujin në det). Ua nënshtroi që të shfrytëzoni nga begatitë e Tij dhe ashtu të falënderoni (Zotin).”** (En-Nahl, 14).

Pra, bëhet e qartë se gjithësia është e përshtatshme për njeriun dhe në shfrytëzim të atij. E kur është e këtillë, ajo në fakt është e ngjarë, e krijuar tjetër nuk ka përveç Allahut të Lartësuar. Përfundimisht, Maturidiu këtë argument e ka nxjerrë drejtpërdrejt prej Kuranit Fisnik, i cili është përplot me citate, që dëftojnë kujdesin hyjnor ndaj njeriut dhe nënshtrimin e krijesave në shërbim të tij.

Shumë prej hulumtuesve shkencorë e vlerësojnë Maturidiun si themelues të këtij argumenti. Dr. Mahmud Kasim, duke konfirmuar një gjë të tillë, thotë: Me të vërtetë, nuk mund të themi se Maturidiu, nuk e popullarizoi shfrytëzimin e këtij argumenti, që konsiderohet prej argumenteve më të fuqishme, ngase e përbashkon arsyen dhe traditën në një kontekst të vetëm.<sup>7</sup>

Në anën tjetër, ky argument, është ai, në të cilin janë ndarë filozofët dhe kelamologët, sikurse e vërteton edhe Ibni Ruzhdi, por vlera e tij bashkë me “argumentin e shpikjes”, është mbi të gjitha argumentet e tjera. Ai (Ibni Ruzhdi), i kritikon kelamologët, për futjen e tyre, kinse në një argument të tillë, që sipas tij, prodhon dyshim, në vend se të hyjnë në ndonjë tjetër, i cili shumë më direkt shpie në besimin e sigurt!<sup>8</sup> Por, pavarësisht kritikave, duket qartë se ky argument, është shndërruar në argumentin kryesor, që argumenton ekzistencën e Allahut, në periudhën bashkëkohore. E, sidomos, pas zbulimeve madhështore të fizikës, matematikës, mbi lëvizjen e yjeve, përfshirë edhe shqyrtimet e hollësishme rreth atmosferës, pasi që ajo, nuk është e tëra oksigjen, por, 20% ka oksigjen, ndërsa 80% nitrogjen.<sup>9</sup> Pikërisht, ky ekuilibër, është ai që e ruan jetën dhe prodhon harmonizimin në mes njeriut dhe natyrës.

E, nëse, këto fenomene kozmologjike dhe shumë të tjera, që i ka zbuluar shkenca, apo që nuk i ka zbuluar, dëftojnë një harmonizim absolut, atëherë, ngjashëm me këtë, vetë akti i funksionalizmit të këtij harmonizimi, konsiston ekzistimin e Allahut. Këtë parashtrim, në mënyrë brilante e ka përzgjedhur Maturidiu. Bile, hulumtimet e tij rreth kësaj tematike, janë shumë gjithëpërfshirëse, që e ndriçojnë edhe më shumë këtë argument.

<sup>7</sup> Mahmud Kasim, *Mukad-dimetu menahixhi'l edil-leti*, f.21.

<sup>8</sup> Ibni Ruzhd, *Menahixhu'l edil-leti*, f.134, e tutje.

<sup>9</sup> Cressy Morrison, *El-Ilmu jedu' ilel iman*, f.64, përktheu Mahmud Salih El-Felekij.

## 10. Argumenti i sistemit të gjithësisë (دليل نظام العالم)

Ky argument është quajtur edhe argument i përsosmërisë (الإتقان), pastaj argument i përcaktueshmërisë (التقدير) si dhe argument i urtësisë (الحكمة). Vetë sistemi i gjithësisë, duke nisur nga fillimësia e gjithësisë, krijimi i përsosur, urtësia në shpikje, llogaritjet e hollësishme, nuk janë një rezultat i një fuqie të verbër, e as e çastit të rastësisë, sikurse pretenojnë materialistët. Përkundrazi, pas saj qëndron një fuqi e madhe, planifikues absolut dhe i gjithëdijshëm. Ai e ka krijuar çdo gjë me masë të caktuar dhe, përcaktimin e gjërave, e ka sajuar me një urtësi, duke e përsosur krijimin e çdo gjëje në gjithësi, “sikurse është nata dhe dita, përfshirë depërtimin e ndërsjellë, në masë të nevojshme”.<sup>10</sup> Në fakt, kjo përbën një sistem të mrekullueshëm, siç dëfton argumenti në vijim:

**“...Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë kontrast...”** (El-Mulk, 3).<sup>11</sup>

Po ashtu, Krijuesi thotë:

**“...Tek Ai, çdo send është me masë të caktuar.”** (Er-Rra'd, 8).

Po ashtu, Krijuesi thotë:

**“... Ai krijoi çdo gjë, duke e përsosur në mënyrë të qartë e të matur.”** (El-Furkan, 2)

Po ashtu, Krijuesi thotë:

**“... Dhe Allahu çdo gjëje ia ka caktuar kohën (afatin).”** (Et-Talak, 3)

Po ashtu, Krijuesi thotë:

**“Ne çdo send kemi krijuar me masë të caktuar.”** (El-Kamer, 49).

Mbi këto principe, Maturidiu ka argumentuar kundër çdo njërit që e mbron idenë e rastësisë në gjithësi. Sepse, një sistem mrekulli, sikurse është ky, mbetet argumenti më i fuqishëm se qeniet nuk janë krijuar rastësisht apo kot. Përkundrazi, krijesat, që të gjitha, i nënshtrohen një urtësie specifike, një qëllimi të përcaktuar dhe kështu rrugëtojnë drejt ob-

<sup>10</sup> El-Maturidij, *Kitabu-t-Tevhid*, f. 22.

<sup>11</sup> El-Maturidij, *Kitabu-t-Tevhid*, f. 21, 22.



jektivit të tyre, në pajtueshmëri me synimin e tyre. I Lartmadhërishmi thotë:

**“Dielli dhe hëna udhëtojnë sipas një përcaktimi të saktë. Edhe yjet dhe bimët i bëjnë përulje (dëshirës së Rrahmanit).” (Er-Rrahman, 5-6);**

**“Edhe dielli udhëton për në kufirin e vet (në cakun përfundimtar). Ai është (udhëtim) përcaktim i ngadhënjyesit, të dijsmit. Edhe hënës i kemi caktuar (pozicionet) derisa të kthehet në trajtën e harku (rrem i hurmës së tharë). As dielli nuk mund ta arrijë hënën, e as nata para ditës po secili noton në një galaktikë.” (Jasin, 38-40)**

Një pjesë e madhe e filozofëve thonë se, ne nuk mund ta njohim urtësinë e shumë prej krijesave. Maturidiu iu përgjigjet atyre me faktin se mendja e njeriut është fare e kufizuar për ta njohur urtësinë e vetë njeriut. E, derisa është kështu, atëherë a është logjike përfshirja e çdo krijese, me urtësinë në krijim!?<sup>12</sup> Në këtë drejtim, Maturidiu, në më shumë se një vend në librin e tij “Kitabut-tevhid”, sinjalizon, duke përdorur shprehjet: “harmonizim - lidhje logjike” (الإتساق) dhe “përsosje” (الإتقان),<sup>13</sup> si dhe “sistem unik” (السنن الواحدة).<sup>14</sup> Analizimi i hollësishëm i të gjitha krijesave, pra çdo gjë, manifeston përmbajtjen e sistemit në vetë qenien e tij si dhe relacionin e tij me krijesat e tjera. Dhe, kur e shqyrtojmë mirë e mirë këtë argument, pra zanafillën e tij në kuadër të shkollës maturidiste, gjejmë se Ebu Hanife, veçse pati dhënë shkëndijat e para të këtij argumenti, përmes një shembulli të shkëlqyer. Ai pati thënë: për mendjen është e pamundur, që një anije e stërm bushur me barrë, e rrethuar nga valët e detit, që e godasin pandërprerë erërat e fuqishme nga të gjitha anët, që ajo vetvetiu të lundrojë drejt, pa u anuar nga asnjëra anë dhe të mos ndalojë për asnjë çast, pavarësisht përballjes me furtunat e fuqishme. E vërteta është se një gjë e tillë është e pamundur. Andaj, gjithashtu, është e pamundur për mendjen njerëzore që të besojë në ngritjen e kësaj gjithësie, prej qiejve e to-

<sup>12</sup> El-Maturidij, *Kitabu-t-Tevhid*, f. 113.

<sup>13</sup> El-Maturidij, *Kitabu-t-Tevhid*, f.112 dhe f. 142.

<sup>14</sup> El-Maturidij, *Kitabu-t-Tevhid*, f. 21.

kës dhe gjithë çka ka në mes tyre, ndryshimi i gjendjeve, nga lëvizjet e qiejve e sforcimi i tokës, veçimi i njeriut në fizionomi, përbashkimi i llojeve përplotësuese, që të gjitha këto, pra është e papranueshme që të jenë krijuar pa një Krijues që është Qenie e Domosdoshme.<sup>15</sup> Kështu që, kjo tregon se si ai e filloi hulumtimin e këtij argumenti të shkëlqyer, përpara të gjithë kelamologëve.

Këtë argument, kur e vështrojmë në kontekst të shkollës maturidiste, do të vërtetojmë ruajtjen e formës së tij, bashkë me transformimin e tij përmbajtjesor, veçanërisht, në sferën e mrekullive në krijimin e gjithësisë. Kemaludin El-Bejadi El-Hanefij thotë:

“Soditja e mrekullive të ngjara në natyrë, që përmbajnë madhështi për nga përsosmëria dhe urtësia, është akti më i lartë, që impulson zgjuarsi dhe në një farë aspekti e sfidon imitimin pasiv. Po ashtu, njeriun e vetëdijeson detyrimisht se ato nuk mbështeten në një fuqi të thjeshtë apo të përbërë, por absolutisht në një fuqi që perceptohet se është e pafillim.” Pastaj, autori El-Bejadij, vazhdon edhe me një pasus tjetër rreth asaj çfarë përmbajnë njerëzit dhe kafshët: “Soditja e asaj që përmbajnë kafshët, përfshirë pamjen, formën, përcaktimin e kapaciteteve, produktet, ndjesia e tyre në mëshirë, pastaj ajo që ato dallojnë për nga aspekti i pamjeve të ndryshme, fuqisë, pra nga ato që shihen prej urtësive dhe mirësive të tyre, njeriu sfidohet. E, numri i atyre, për të cilat ka informacion, sipas librave mbi dobitë e llojeve të kafshëve, përfshirë format, kapacitetet, produktet e tyre, është 5 mijë, por ato që nuk dihen saktë, mund të jenë akoma më shumë se sa ky numër.<sup>16</sup>”

Ky realitet i padiskutueshëm, pra prej fenomeneve të krijimit të njeriut dhe kafshët, si dhe fenomeneve të tjera të ndryshme të natyrës, e të cilat nuk mund të përthekohet e as të numërohen, që të gjitha janë argumente që dëshmojnë se pas kësaj gjithësie të përsosur dhe të sistemuar, është Një i Gjithëdijshëm dhe i Urtë, që e ka dizajnuar. Sepse, mendja e njeriut

<sup>15</sup> El-Bejadij, *Isharatu'l meram*, f.85.

<sup>16</sup> Kemaludin El-Bejadij El-Hanefij, *Isharatu'l meram min ibarati'l imam*, f.93. (Autori, e ka përmendur shifrën prej pesë mijë, pasi që në atë kohë, 1949, kur është shkruar ky libër, mund të ketë qenë evident vetëm ky numër. Përndryshe, numri i tyre shtë shumë më i madh - O.B.)

nuk e pranon që ky sistemi i mahnitshëm dhe ky rend i shpikur, të ndodhë vetvetiu, pra pa krijuesin e tyre.

E kur e kemi parasysh këtë ekuilibër akaidologjik, përfshirë atë që e ka zbuluar shkencë bashkëkohore me saktësi e hollësi, në gjithësi e hapësira të ndryshme, arrijmë në bindjen e thellë, kundër çdo dyshimi që ka mundur të infiltrohet prej intrigave të filozofëve materialistë.

## 11. Argumenti i shpikjes apo krijimit (دليل الإختراع او الخلق)

Argumenti i shpikjes, konsiderohet prej atyre argumenteve më madhështore për vërtetimin e ekzistencës së Allahut, me të cilin janë marrë mjaft shumë mendimtarët dhe filozofët<sup>17</sup>, konform ambientit dhe kulturës së tyre. Në këtë drejtim, ata kanë arritur zbulime interesante në sfera të ndryshme të njohjes. Maturidiu e ka titulluar këtë argument si “*provë e argumentimit përmes krijimit*” (برهان الإستدلال بالخلق)<sup>18</sup>. Kur’ani Kerim është përplot citate që konsistojnë këtë argument.

Ndërsa Rraziu e ka quajtur “*argumenti i horizonteve dhe njerëzve*” (دليل الآفاق والأفان)<sup>19</sup>, duke u bazuar në citatin kuranor:

***Ne do t’u bëjmë atyre të mundshme që të shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre deri që t’u bëhet e qartë se ai (Kur’ani) është i vërtetë.*** (Fussilet, 53)

Ajetet e Kuranit Kerim, janë përplot me thirrjen për meditim në mrekullitë e krijesave dhe shpikjen e krijimit të tyre. Bile, një pjesë e këtyre ajeteve, përfundojnë me fjalën e Allahut: “***Këto argumente janë për një popull që mendon***” (لَايَاتٍ لِّقَوْمٍ يَعْقِلُونَ) (El-Bekare, 164); ose “***...ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt.***” (لَايَاتٍ لِّأُولِي الْأَبْصَابِ) (Ali

<sup>17</sup> Është për qëllim Ibn Ruzhdi me argumentin e “shpikjes” dhe “kujdesit”, dhe i cilëson si dy argumente, për të cilat ka urdhëruar shpallja, si dhe i ka kritikuar esh’arinjtë dhe mutezilët, kur ka bërë parashtrimin e argumentit të substancave dhe aksidencave dhe të tjera, prej argumenteve, me të cilat triumfojnë argumentuesit. Shih: Ibn Ruzhd, *Menahixhu’l edil-leti*, f.194; po ashtu, shih: Muhamed Atif El-Irakij, *En-Nez’atu’l aklj-jetu fi felsefeti ibn Ruzhd*, f. 230; po ashtu shih: El-Maturidij, *Kitabu-t-Tevhid*, f.21.

<sup>18</sup> El-Maturidij, *Kitabu-t-Tevhid*, f.21.

<sup>19</sup> Er-Rrazij, *Kitabu’l erbeine*, f.90. Po ashtu, shih: El-Maturidij, *Kitabu-t-Tevhid*, f.10.

*Imran, 190*); ose “...*A nuk po mendoni.*” (أَفَلَا تَعْتَلُونَ) (*El-Bekare, 44*). Dhe, kjo formë përsëritet 13 herë, ndërsa materia e “mendjes”, përsëritet 50 herë.<sup>20</sup>

Në kuadër të këtij ajeti, Kurani nuk shkon shumë larg njeriut, por e këshillon atë që të shikojë në atë që e rrethon atë:

**“A nuk i shikojnë devetë se si janë krijuar? Edhe qiellin se si është ngritur lart! Edhe kodrat se si janë vendosur! Edhe tokën se si është shtruar!”** (*El-Gashijetu, 17-20*).

Prandaj, kjo thirrje e Krijuesit, për të vështruar shtatin e këtyre ekzistencave, në formën “si” (كيف), flet për shpirtin e shkencës bashkëkohore, sepse, shkenca, në të kuptuarit e dijetarëve, konsiston metodologjinë e hulumtimit. E si e tillë, është përgjigje në pyetjen “si”, e nuk është përgjigje në pyetjen “përse” (لماذا). Që do të thotë, se thirrja e Krijuesit, ka të bëjë me preokupimin tonë për të sqaruar se si është ngritur apo përbërë një fenomen, e jo për hulumtimin e qëllimit të tij.<sup>21</sup>

Dhe, manifestimi i krijimit në gjithësi, nuk është përgjithshëm, por konsiston kufizim dhe limitim në veçori, sikurse janë gjendjet: toka, minierat, bimët, bota shtazore, prej shpendëve, zvarranikëve, milingonave, bletëve, përfshirë edhe mënyrat e të kuptuarit në mes tyre, nga secili lloj. Allahu i Lartësuar, thotë:

**“Nuk ka asnjë gjallesë në tokë dhe as shpendë që fluturojnë me dy krahe e që nuk janë të ndara në grupe (të ndryshme), sikurse edhe ju (Zoti i krijoi, i pajisi si juve)...”** (*El-En'am, 38*). Apo, sikurse janë yjet, lëvizjet dhe gjurmët e tyre, pastaj gjendjet që lidhen me ato, shpejtësia proporcionale me një akordim preciz dhe ruajtja e distancës në raport me diellin, po kështu edhe rrotullimet e tyre përreth qendrave të tyre.

Maturidiu, gjersa flet se sistemi i gjithësisë funksionon vetëm nga një drejtues dhe assesi nga dy të tillë, thotë: Ndryshimi i stinëve dimër-verë, pastaj stina e mbirjes së bimëve dhe korrja e tyre, krijimi i qiellit dhe tokës, lëvizja e diellit, hënës, yjeve, rregullimi i mekanizmave, që e siguroj-

<sup>20</sup> Jusuf El-Kardavi, *Ed-Dinu fi asri'l ilmi*, boton el-asrij-jetu, Imaratet arabe, 1978, f.8.

<sup>21</sup> Ebul Vefa El-Gunejmij Et-Taftazani, *Hulumtim rreth gjithësisë*, publikuar në Mexhel-leti'l alemi'l fikr, nr.3, 1970, f.107.

në gjallërinë e gjallesave dhe ushqimeve për krijesat, që të gjitha këto, kanë një bosht të vetëm, një udhëheqjeje të njëjtë, si dhe funksionojnë sipas një sistemi natyror unikat. Që do të thotë se ato, nuk mund të funksionojnë në mënyrë kaq perfekte, po qe se janë dy drejtues. Pikërisht për këtë arsye, duhet konkluduar se ka vetëm një Krijues të vetëm.<sup>22</sup>

Ndërsa në tefsirin e tij, Maturidiu thotë: Mrekullia më mahnitëse në argumentimin e Njëshmërisë së Allahut të Madhërishëm dhe të qenët e Tij Krijues është pikërisht çështja e krijimit. Sepse, krijesat, sikur të bashkohen që të gjithë për formësimin e një krijese, të kategorisë së mushkonjës apo mizës, përfshirë sajimin e organeve të nevojshme, siç janë goja, hunda, këmbët, duart, nuk do të mundën asnjëherë.<sup>23</sup>

Në këtë mënyrë, Maturidiu tërheq vërejtjen për fenomenin e krijimit dhe karakteristikat e tij, duke filluar nga procedurat e krijimit e deri në shfaqjen e gjallërisë dhe se, si ka ngelur njeriu i magjepsur përballë kësaj enigme deri në ditët e sotme!? Edhe pse lënda e parë, prej të cilës përbëhet akëcila krijesë është e ditur, megjithatë, njeriu nuk ka mundësi të japë jetë / gjallëri. Allahu i Lartmadhërishëm thotë:

**“...Vërtet ata që po i adhuroni në vend të Allahut, ata nuk mund të krijojnë asnjë mizë, edhe nëse tubohen të gjithë për të...”** (El-Haxh, 73).

Atë, për të cilën ka dëftuar Maturidiu me sqarimet e tij, që u cituan mbi argumentet paraprake, pra, që kishte të bëjë me shfaqjen e përsosmërisë dhe kujdesit në krijimin e qiejve dhe të tokës, shkenca bashkëkohore, veçse e ka vërtetuar. Për shembull, lëvizjet apo rrotullimet e yjeve, janë prej gjërave më delikate. Po qe se një yll e ndryshon distancën, apo e ngadalëson shpejtësinë e lëvizjes, do të ndodhte një përplasje në mes yjeve dhe do të bëhej një katastrofë e madhe, në fakt do të mbaronte gjithësia. Allahu i Lartësuar thotë:

**“A nuk vështruan ata me vëmendje pushtetin e madh në qiej e në tokë dhe çka krijoi Allahu prej sendeve...”** (El-A'raf, 185). Po ashtu thotë i Lartmadhërishmi thotë:

<sup>22</sup> El-Maturidij, *Kitabu-t-Tevhid*, f.21.

<sup>23</sup> El-Maturidij, *Tevlatu ehli-sunneti*, vëll.I, f.78.

*“A nuk shikojnë ata me vëmendje kah qielli se si mbi ta kemi ndër-tuar atë, e kemi zbukuruar atë duke mos pasur në të ndonjë zbrazë-ti. Edhe tokën se si e kemi shtrirë, e në të kemi vendosur kodra përforcuese dhe kemi bërë që në të të mbijnë gjithfarë bimësh të bukura. (i bëmë ashtu) Dëshmi të dukshme dhe përkujtuese për se-cilin njeri që ka drejtuar mendjen (te Zoti). Ne, nga qielli lëshuam shiun e dobishëm dhe më të bëmë që të kultivohen kopshte e drithë-ra të korren. Dhe rritëm trungje të gjata hurmash me fruta të palo-sura njëri mbi tjetrin.” (Kaf, 6-10). Po ashtu, i Lartmadhërishti thotë:*

*“Thuaj: “Vështroni me vëmendje çka në (nga argumentet) në qiej e në tokë.” (Junus, 101).*

Falë këtij argumenti, që Maturidiu e ka nxjerrë prej Kuranit, ne mund të rrugëtojmë në horizonte e rezultate të ndryshme që i ka zbuluar shkenc-a, e që argumentojnë për madhësitinë e krijimit / shpikjes. Prej tyre, është edhe ky:

Allahu i lartësuar, prej çdo krijese, nga bota e kafshëve dhe bimëve, ka krijuar çiftin, andaj secila prej këtyre qenieve e ka edhe çiftin, disa janë që shihen e disa janë fshehta, e që mendja njerëzore akoma nuk ka arritur perceptimin e tyre. E Maturidiu thotë se gjersa mendja njerëzore është e kufizuar për ta perceptuar urtësinë njerëzore, çfarë do të mund të themi për perceptimin e urtësisë hyjnore në krijim!<sup>24</sup> Duke dëftuar për dukurinë e çiftit, i Lartmadhërishti thotë:

*“I pastër nga të metat është Ai që krijoi të gjitha llojet (çiftet) nga çka mban toka, nga vetë ata dhe nga çka ata nuk dinë.” (Jasin, 36).*

Edhe më tej, fenomeni i krijimit nuk kufizohet vetëm në botën bimore e as në botën e qenieve të gjalla, të cilat i ka shpikur Allahu dhe ka përsosur krijimin e tyre, përkundrazi ai përmban edhe shumë ekzistenca të tjera, prej atyre që ka arritur mendja njerëzore t’i perceptojë apo që akoma nuk ka arritur. Por është vërtetuar shkencërisht se qeniet e gjalla janë manifestim i botëve që përmbajnë botë të tjera brenda tyre. Për këtë arsye, shkencë, për gjatë historisë së saj, ka mbetur e magjepsur, e pafuqishme,

<sup>24</sup> El-Maturidij, *Kitabu-t-Tevhid*, f.113.

për të treguar rrëfimin rreth tyre. Ajo, edhe nëse arrin të zbulojë diçka, megjithatë pjesën kryesore, nuk mund ta zbulojë fare.

Të gjitha këto botë, duke filluar prej krijimit të qiejve e të tokës, lëvizjes së Diellit, Hënës dhe yjeve, si dhe planetët e tjerë të shumtë në gjithësi, Maturidiu i ka shfrytëzuar për të argumentuar ekzistimin e Allahut. Ai, me këtë qasje, ka lënë gjurmë të jashtëzakonshme në mendimin islam, si klasik ashtu edhe modern. E, ndoshta, prej atyre degëve më të rëndësishme të këtij argumenti është: Argumentimi përmes krijimit të njeriut dhe fenomenet e shpikjes në krijimin e tij.

### **Krijimi i njeriut është argumenti më madhështor për vërtetimin e ekzistencës së Allahut (خلق الإنسان أعظم أية علي وجود الله)**

Tek sa vështrojmë krijimin e trupit të njeriut, shohim se përmban mrekullitë më mahnitëse, duke filluar nga madhështia e ekuilibrit, preciziteti i projektimit si plan, si dhe koordinimi i funksionimit të organeve. Këtë realitet Maturidiu e ka artikuluar mjaft mirë, me thënien e tij të njohur: “*Kush arrin të njohë veten, ai veçse e ka njohur Krijuesin e vet*” (من عرف نفسه فقد عرف ربه). Sipas të dhënave, kjo thënie është përdorur edhe nga doktrinën e ndryshme fetare, të mëhershme, sikurse janë hebraizimi, dualizmi etj., e të cilat e kanë përpunuar si argument, në kontekst të besimit të tyre. Madje, si fjalë e urtë, ajo është e njohur akoma më herët, pra para grekëve dhe të tjerëve, natyrisht në forma të ndryshme, si: “*kush e njeh vetveten, ai e ka njohur botën*”, “*njihe vetveten nëpërmjet vetvetes!*”. E, ndërkohë, kjo thënie e urtë, është hasur si mbishkrim në hyrje të një faltoreje të vjetër greke.<sup>25</sup>

Mirëpo, duhet theksuar se Maturidiu, gjatë citimit të kësaj faje të urtë, nuk është bazuar te asnjë burim tjetër, por është mbështetur në urtësinë kuranore, ku Allahu i Lartësuar thotë:

**“Po edhe në veten tuaj keni argumentet. A nuk jeni kah e shihni?”**  
(Edh-Dharijat, 21).

<sup>25</sup> Muhamed Gulab, *El-Ma`rifetu inde`l mufek-kiri`l islam*, f.134.

Thjesht, ky ajet, është një artikulum brilant në formë të pyetjes së shkurtër, duke inkurajuar njeriun për meditim dhe vrojtim mbi vetveten dhe rreth asaj që ai përmban prej mrekullive të krijimit.

Nuk ka asnjë dyshim, krijimi i njeriut, është prej atyre mrekullive më mahnitëse. Maturidiu, duke e definuar njeriun, citon një thënie të njerëzve të urtë, të cilët, qenien e njeriut e kanë quajtur “*gjithësia e vogël*” (العالم الصغير).<sup>26</sup> Domethënien e kësaj urtësie, Bagdadiu, sikur e ka shpjeguar akoma më mirë: Ai thotë: Mbase, çdo gjë në gjithësinë e madhe, e ka një shembull tipik në trupin e njeriut, si në vijim: Shqisat e njeriut, janë më brilante se sa yjet e shndritshëm; dëgjimi dhe shikimi janë ekuivalent me pozitën e Diellit e Hënës, në kontekst të perceptimit dhe përfshirjes. Trupi i tij, pas vdekjes shkrihet në llojin e tokës. Po ashtu, trupi njeriut përmban prej llojit të ujit siç janë djersët dhe lëngjet e tjera. Ndërsa, prej llojit të atmosferës, njeriu përmban frymën dhe shpirtin. Prej zjarrit trupi i njeriut e ka vlerin e tij. Damarët e trupit, ngjasojnë me lumenjtë e tokës, kurse mëlçia e tij është si burimet e lumenjve, sepse djersët varën prej saj. Urina e trupit, u ngjason deteve, pasi që është një lloj rezervuari, në të cilën derdhen ujërat e trupit, ashtu sikurse lumenjtë që derdhen në dete. Eshtrat e trupit, janë sikurse kodrat, që cilësohen si përforcim i tokës. Gjymtyrët e tij, janë sikurse pemët, që japin fruta, ngjashëm edhe secila gjymtyrë ka një funksion dhe efekt. Qimet në trupin e njeriut janë sikurse bari mbi tokë. Njeriu, me zërin e tij pasqyron zërin e të gjitha kafshëve, ndërsa me trupin e tij rrëfen krijimin e të gjitha kafshëve. Për këtë arsye, njeriu është si bota e vogël në raport me botën e madhe, është i krijuar, i ngjarë nga Krijuesi i vetëm, nuk ka zot tjetër përveç Atij.<sup>27</sup>

Poeti, sikur e paraqet këtë domethënie, kur ka përpiluar vargjet, përfërsisht:

*“Ti, pretendon se je një trup i vogël, por, vetvetja jote përmban gjithësinë e madhe”.*

<sup>26</sup> El-Maturidij, *Kitabu-t-Tevhid*, f.5.

<sup>27</sup> El-Bagdadij, *Usuli-din*, f.34-35.



Me të vërtetë, njeriu si qenie, është argumenti më madhështor për të vërtetuar ekzistencën e Allahut, sepse përmban një trup me funksione të shumëfishta, me një përsosmëri precize, por edhe i dobët përballë faktorëve shkatërrues.

Maturidiu citon se vetë analizimi i nyjave të njeriut, përfshirë mënyrën e formësimit, fleksibilitetin, gjersa njeriu përmes tyre “e mbledh grushtin dhe shtrinë atë, pastaj kalimi i tij nëpër gjendje të ndryshme, aftësitë për veprime të llojllojshme<sup>28</sup>, i mundësojnë njeriut, që ta kuptojë se ai nuk është vepër nga një i verbër. Pastaj, soditja e këtyre nyjave, përfshirë efektin kapërcor, që i mbron eshtrat nga fërkimi, si dhe lëndën specifike në mes tyre, që e lehtëson lëvizjen, pastaj tipologjia e nyjave, ashtu që, disa prej nyjave mund të shtrihen në drejtimin përpara, sikurse janë nyjat e krahëve, disa shtrihen në drejtimin përmbapa, sikurse janë nyjat e këmbëve, apo disa nyja që lëvizin në të gjitha drejtimet, sikurse është kyçi i dorës<sup>29</sup>. Kjo tregon se ai që e ka planifikuar këtë trup, posedon fuqi dhe urtësi të madhe, e ai, pa dyshim, është Allahu i Lartësuar.

Por, argumenti njeri nuk kufizohet vetëm në këto karakteristika. Përkundrazi, ai konsiston edhe në dallimet njerëzore, përfshirë ngjyrat, zërin dhe veçoritë, sepse secili njeri i ka veçoritë e veta individuale dhe nuk mund të gjesh dy njerëz me veti të përbashkëta apo që ngjasojnë hollësisht, si nga aspekti i jashtëm ashtu edhe i brendshëm. Kjo tregon për fuqinë madhështore të Allahut të Madhërishëm, e cila shfaqet në diversitetin e krijesave të Tij dhe njëkohësisht dëshmon për Njëshmërinë e Tij.

Definitivisht, ky konstruksion i njeriut nuk është tjetër veçse shpikje prej Krijuesit, për të cilën ka dëftuar Maturidiu me një dëftim konciz, i cili dëshmon për qëndrimin e tij. Sidoqoftë në lidhje me këtë tematikë, një kontribut të mirë e kanë dhënë edhe autorët e vjetër dhe hadithologët<sup>30</sup>, gjithnjë duke iu referuar argumenteve të qarta kuranore.

<sup>28</sup> El-Maturidij, *Kitabu-t-Tevhid*, f.181.

<sup>29</sup> Vehbi Sulejman, *Erkanu-l iman*, f.83.

<sup>30</sup> Periudha bashkëkohore është e mbushur me zbulime shkencore, prandaj, disa prej studiuesve bëjnë argumentimin e ekzistencës së Allahut, duke u mbështetur në atë që Allahu ka krijuar në këtë gjithësi prej atyre mrekullive sekrete që gjinden te njeriu, kafshët, insektet, në tokë e qiell. Secili prej këtyre studiuesve ka lënë gjurmë në fushën e specializimit të tyre, në lidhje me njohjen e njeriut, si një çështje e veçantë. Të tilla janë edhe këta në vijim:

Prandaj, në këto argumente, që i parashtruam deri tani, ka shumë dëftime dhe indikacione përmbajtjesore me të cilat është preokupuar periudha e kohës sonë. Do të ishte shumë mirë që ato të shfrytëzohen si bazë për hulumtimin e këtyre argumenteve, me të cilat në fakt periudha bashkëkohore është e stërmbushur. Në këtë mënyrë, ky kontribut, do të shërbejë edhe si një mburojë për imanin - akiden (kredon) e qëndrueshme, dhe nuk do të linte hapësirë për ndikimin e cytjeve dhe sulmeve të ateistëve materialistë.

*Nga gjuha arabe:*  
**Orhan Bislimaj**

- 
- Dr. Vehidu'd-din Han, *El\_islamu jetehad-da*;
  - Dr. Ahmed Zekij, *Meall-Llahi fis-semai*, si dhe një libër tjetër: *Mea'll-Llahi fil erdi*;
  - Dr. Ahmed El-Gumeravi, *El-islamu fi asril ilmi*;
  - Muhamed Avd Ibrahim, *Ehake ilah*;
  - Përkthimi nga dr. Ed-Demertash Abdul Kerim Serhan, *Allahu jetexhel-la fi asril ilmi*.
  - Prof. Cressy Morrison, *El-insan la jekumu vahdehu*, përktheu Mahmud Salih El-Felekij me titull: *El-Ilmu jedu lil iman*.



Ramadan SHKODRA

## **PAVARËSIMI I BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS - (IV)**

Fillimi i viteve 90 shënon një etapë të re për Kosovën dhe popullatën e saj. Këto vite ishin vitet e kthesave të mëdha. Ndonëse nga pushtuesi serb, Kosovës në kuadër të ish-Federatës Jugosllave i qe marrë me dhunë edhe ajo pak autonomi që e kishte më herët, shqiptarët në mënyrë të prerë dhe unike u organizuan dhe vendosën që të vazhdonin drejt pavarësimit përfundimtar të tyre nga Serbia dhe Jugosllavia<sup>1</sup>.

Në këtë drejtim, pas përgatitjeve të duhura, institucionet e Bashkësisë Islame të Kosovës, respektivisht Kuvendi i saj, më 11 dhjetor 1993<sup>2</sup>, vendosën të shkëputen nga RIJASET-i i deriatëhershëm dhe të shpallnin Bashkësinë Islame të Kosovës të pavarur dhe të mëvetësishme.

Më 11 dhjetor 1993, delegatët e Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës, pas një diskutimi të gjatë e gjithëpërfshirës, me shumicë absolute votash, miratuan mëvetësimin e Bashkësisë Islame të Kosovës<sup>3</sup>.

Për të realizuar mëvetësinë e Bashkësisë Islame, megjithëse në kushte e rrethana të vështira, Kuvendi i BI u thirr sërish në një mbledhje të jash-

---

<sup>1</sup> *Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës*, përgatitën Ramadan Shkodra - Sadik Mehmeti, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë 2013, fq. 15.

<sup>2</sup> Elez Osmani, *Delegatët nuk u hamenden për mëvetësi*, në: "Dituria Islame", nr. 54, Prishtinë, 1994, f. 32-33.

<sup>3</sup> Po aty, fq.33.

tëzakonshme më 5 shkurt të vitit 1994, ku i aprovoi konkluzionet që i jepnin formë e rrugë mëvetësisë së BIK-ut.

Konkluzionet e Kuvendit të BIK-ut në mbledhjen e jashtëzakonshme, më 5 shkurt 1994, ishin:

1. *“Në bazë të propozimit të Këshillave të B. Islame u verifikohet pjesëmarrja anëtarëve të rinj të Kuvendit: Mustafë Dervisholli, Fatmir Jëlliqi dhe Sadri Rrahimi.*
2. *Kuvendi i Bashkësisë Islame nuk e njeh më Rijasetin, që ishte Organ Suprem i Bashkësisë Islame në ish-Jugosllavi, i cili praktikisht, me shpërbërjen e Jugosllavisë, nuk funksionon më, ndaj Bashkësia jonë është e pavarur në punën e saj.*
3. *Kuvendi në pajtim me përcaktimet e veta vendosi të iniciojë nismën për hartimin e Kushtetutës së Bashkësisë Islame, në kuadër të territorit të vet. Për këtë formoi komisionin që do të punojë për përgatitjen e saj.*
4. *Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës, përkohësisht, deri në shpalljen e Kushtetutës së Bashkësisë Islame të Kosovës e autorizon Komisionin e vet për parashtrësia dhe ankesa që të shqyrtojnë dhe të vendosë lidhur me vendimet e Meshihatit që ishin në kompetencë të Rijasetit. I sugjerohet komisionit që në mbledhjet e tyre të marrë pjesë edhe përfaqësuesi i Meshihatit për ndihmë.*
5. *Kuvendi aprovoi Llogarinë përfundimtare për vitin 1992 dhe projekt-buxhetin për vitin 1993.*
6. *Kuvendi, edhe pas largimit të delegatëve të Sanxhakut, të cilët kanë formuar Kuvendin dhe Meshihatit të tyre, vazhdoi punën e vet dhe konkludoi se në mbledhjet e ardhshme nuk do të llogariten anëtarët e territorit të Sanxhakut, kjo do të vlejë edhe për anëtarët e komisioneve të Kuvendit, për anëtarët e Meshihatit si dhe organeve tjera.*
7. *Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës aprovon propozimin e Meshihatit që shqyrtimi i projektkushtetutës së Ballkanit të ndërpritet. Ne jemi duke hartuar kushtetutën e Bashkësisë Islame të Kosovës.*

8. Kuvendi konkludon që statuti i Medresesë së Mesme “Alauddin” në Prishtinë të shqyrtohet në Meshihatit e BI, ta analizojë dhe pastaj ta miratojë Kuvendi i BI.
9. Kuvendi aprovoi propozimin e grupit punues që Shoqata humanitare bamirëse Islame “Sami Frashëri” të transformohet<sup>4</sup>.

Në bazë të vendimit të Kuvendit të BIK-ut, nisi edhe puna për hartimin e Kushtetutës së BIK-ut. Për këtë, Kuvendi formoi Komisionin Kushtetues, i cili kishte për detyrë përgatitjen e aktit më të lartë juridik për Bashkësinë Islame të Pavarur - Kushtetutën e Bashkësisë Islame të Kosovës. Në krye të Komisionit kushtues ishte kryetari i Kuvendit të BI, Miftar Ajdini.

Komisioni Kushtues përgatiti projektin e kushtetutës dhe të njëjtin ia paraqiti Kuvendit të BIK-ut, i cili u thirr në mbledhje të jashtëzakonshëm më 24 qershor 1994<sup>5</sup> dhe shpalli Projekt-Kushtetutën në diskutim publik<sup>6</sup>.

Pas diskutimit publik të Projekt-Kushtetutës, më 15 tetor 1994, Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës, miratoi Kushtetutën e Bashkësisë Islame.<sup>7</sup> Për ecurinë punën dhe nevojën e miratimit të Kushtetutës raportoi Mr. Qemajl Morina, anëtar i komisionit kushtetues, i cili, përveç tjerash, tha:

*“Kaluan dhjetë muaj prej marrjes së vendimit nga ana e këtij Kuvendi për mëvetësimin e Bashkësisë Islame për territorin e Kosovës, duke përfshirë në gjirin e saj edhe pjesët e Kosovës Lindore, Preshevën, Bujanocin e Medvegjën. Për këtë, 11 dhjetori i vitit 1993, në analet e historisë së Bashkësisë Islame të Kosovës do të hyjë si një datë me rëndësi të madhe, sepse iu vu themeli i mëvetësimit të BI, ndërsa këtij Kuvendi me këtë përbërje, gjeneratat e ardhshme do t’ia kenë lakmi që pati guxim të marrë mbi vete një përgjegjësi aq të madhe.*

<sup>4</sup> E.O.: *Mbi të gjitha mbretëroi arsyeja*, Dituria Islame nr. 55 shkurt 1994, Prishtinë, f. 34.

<sup>5</sup> *Kushtetuta e Bashkësisë Islame imperativ i kohës*, “Dituria islame”, nr. 59 qershor 1994, f.4.

<sup>6</sup> *Projekti i Kushtetutës së Bashkësisë Islame të Kosovës*, version për diskutim publik (separatë) e botoi Revista “Dituria Islame” nr. 59/1994.

<sup>7</sup> Elez Osmani, *U miratua Kushtetuta e Bashkësisë Islame të Kosovës*, në: “Dituria islame”, nr. 62, Prishtinë 1994, f. 2 dhe 63.

*Po ashtu edhe kjo datë e sotme, e 15 tetorit të vitit 1994, do të mbetet datë e shënuar jo vetëm në analet e Bashkësisë Islame, por edhe në historinë e re të popullit shqiptar si dhe në historinë e të gjithë vëllezërve tanë të përkatësisë islame në Kosovë dhe më gjerë”<sup>8</sup>.*

Kushtetuta kishte 6 kapituj dhe 73 nene<sup>9</sup>, me të cilët rregullohej funksionimi dhe administrimi i BIK-ut. Nga kjo kohë filloi një periudhë e re e Bashkësisë Islame të Kosovës.

Neni i parë i kësaj Kushtetute thotë:

*“Bashkësia Islame e Kosovës është e vetmja bashkësi e pavarur fetare, të cilën e përbëjnë të gjithë besimtarët e besimit islam të regjionit të Ferizajt, të Gjilanit, të Mitrovicës, të Prishtinës, të Prizrenit, të Pejës dhe të Preshevës, si dhe besimtarët, që gjenden me punë dhe me qëndrim të përkohshëm në botën e jashtme.*

*Regjionin e Ferizajt e përbëjnë Këshilli i Bashkësisë Islame i Ferizajt, i Kaçanikut dhe i Lipjanit. Regjionin e Gjilanit e përbëjnë Këshilli i Bashkësisë Islame i Gjilanit, i Kamenicës dhe i Vitisë. Regjionin e Mitrovicës e përbëjnë Këshilli i Bashkësisë Islame i Mitrovicës, i Vushtrrisë dhe i Skenderajt. Regjionin e Prishtinës e përbëjnë Këshilli i Bashkësisë Islame i Prishtinës, i Podujevës dhe i Glllogocit. Regjionin e Prizrenit e përbëjnë Këshilli i Bashkësisë Islame i Prizrenit, i Dragashit, i Rahovecit dhe i Suharekës. Regjionin e Pejës e përbëjnë Këshilli i Bashkësisë Islame i Pejës, i Gjakovës dhe i Istogut. Regjionin e Preshevës e përbëjnë Këshilli i Bashkësisë Islame i Preshevës, i Bujanocit dhe i Medvegjës.*

*Bashkësia Islame vepron në bazë të mësimëve të Kuranit, të Sunetit, të rregullave të nxjerra nga ato në bazë të shkollës juridike hanefite dhe në bazë të kësaj Kushtetute, si dhe në bazë të dispozitave ligjore.*

*Bashkësia Islame predikon dhe zbaton Islamin lirisht dhe publikisht.”<sup>10</sup>*

<sup>8</sup> Po aty, f. 2.

<sup>9</sup> Shih: *Kushtetuta e Bashkësisë Islame të Kosovës*, Prishtinë 1994.

<sup>10</sup> Shih: *Kushtetutën e Bashkësisë Islame të Kosovës*, Prishtinë, 1994, f. 5, neni 1.

Sipas Kushtetutës, qëllimi i Bashkësisë Islame të Kosovës është organizimi, planifikimi, mbikëqyrja dhe zbatimi i jetës fetare në territorin e Bashkësisë Islame të Kosovës.

Përmes organeve dhe institucioneve të saj, ajo angazhohet që të gjithë pjesëtarët e vet të jetojnë në përputhje me normat islame, të ruajë dhe të zhvillojë vetëdijen islame, jetën fetare të myslimanëve dhe të punojë në ngritjen shpirtërore, kulturore, shkencore dhe social - ekonomike të myslimanëve.

Ajo gjithashtu kujdeset për të drejtat e myslimanëve.

Në kuadër të mundësive të veta atyre u siguron kushte për realizimin e detyrave islame.

Për organizimin e jetës fetare në vend, kjo bashkësi është e organizuar bazuar në Kushtetutën e Bashkësisë Islame të Kosovës, e cila mbështetje kryesore ka Kuranin, Synetin e Pejgamberit Muhamed a.s. dhe rregullat e shkollës juridike hanefite, si dhe rregulloret e miratuara nga organet e Bashkësisë Islame të Kosovës.

Bashkësia Islame e Kosovës, duke iu përgjigjur kërkesave të besimtarëve për përmbushjen e jetës fetare, që prej kohësh ka krijuar institucione edukativo-arsimore nga niveli parashkollor e deri tek arsimi i lartë<sup>11</sup>.

Bashkësia Islame detyrat e veta i kryen nëpërmjet organeve, institucioneve dhe kuadrove të saj, në organet e Bashkësisë Islame janë:

- Këshillat e Bashkësisë Islame,
- Kryesia e Bashkësisë Islame dhe
- Kuvendi i Bashkësisë Islame<sup>12</sup>.

Organet e Bashkësisë Islame punojnë në seanca dhe mund të vendosin për çështjet e ndryshme në qoftë se në seanca janë prezent së paku 2/3 e anëtarëve, kurse vendimet i marrin me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve<sup>13</sup>.

---

<sup>11</sup> Po aty, neni 32.

<sup>12</sup> Po aty, neni 29.

<sup>13</sup> Po aty, neni 29.



## **5.1. Struktura organizative e Bashkësisë Islame të Kosovës**

Sipas Kushtetutës së BIK-ut, organizimi i Bashkësisë Islame të Kosovës fillon përmes xhemeve, të cilët përbëjnë këshillin e xhemitit të një xhamie të caktuar.

Këshillat e xhemitit janë në vartësi të Këshillave të Bashkësisë Islame. Këshilli ndërkaq, është institucion bazë dhe kompetent për organizimin e jetës fetare në nivel lokal. Në terren Bashkësia Islame e Kosovës është e ndarë në 8 regjione, 7 në territorin administrativ të Kosovës: Regjioni i Prishtinës, Gjilanit, Mitrovicës, Prizrenit, Pejës, Ferizajt, Gjakovës; dhe 1 që përfshin komunat shqiptare në Luginën e Preshevës: Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

## **5.2. Organet e Bashkësisë Islame të Kosovës**

Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) aktivitetin e vet e organizon përmes organeve, institucioneve dhe kuadrit të saj.

Bashkësia Islame e Kosovës është e pavarur në punën e saj, e organizuar nëpërmjet organeve që zgjidhen nga baza (anëtarësia e saj), duke filluar nga:

### **5.2.1. Këshilli i Xhemitit në nivel të xhamive**

Xhemati është grup myslimanësh në një territor të ngushtë, në kuadër të të cilit kryhen detyrat e përbashkëta fetare, mirëmbahen xhamitë, pronat, varrezat, grumbullohen anëtarësia, të ardhura dhe kontribute për nevoja të Bashkësisë Islame.

Xhematët kanë Këshillin e Xhemitit që është trup ndihmës i Këshillit të Bashkësisë Islame.

### **5.2.2. Këshilli i Bashkësisë Islame në nivel lokal**

Këshilli i Bashkësisë Islame është organ themelor i Bashkësisë Islame në territorin e vet.

Këshilli është përgjegjës për të gjitha çështjet e jetës fetare dhe për të gjitha nevojat e tjera të Bashkësisë Islame dhe të xhemitit<sup>14</sup>.

---

<sup>14</sup> Po aty, neni 32.

### **5.2.3. Kuvendi i Bashkësisë Islame**

Kuvendi i Bashkësisë Islame është organi më i lartë përfaqësues dhe ligjdhënës i Bashkësisë Islame të Kosovës.

Kuvendi i BIK ka aq anëtarë, sa është numri i këshillave të Bashkësisë Islame në territorin e tij. Në kuvendin e BIK-ut përfaqësohen me nga një anëtar të zgjedhur edhe Fakulteti i Studimeve Islame dhe Medresetë<sup>15</sup>.

### **5.2.4. Kryesia e Bashkësisë Islame**

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës është organ ekzekutiv i dalë nga Kuvendi i Bashkësisë Islame dhe, si i tillë, është institucioni më i lartë për çështje fetare, arsimore, administrative dhe pronësore në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Kryesia e Bashkësisë Islame udhëheq dhe orienton punën në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës, zbaton vendimet e Kuvendit, mbikëqyr punën e organeve dhe institucioneve në territorin e vet, mbikëqyr punën e institucioneve në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës mbikëqyr krijimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e pronës së Bashkësisë Islame<sup>16</sup>.

Kryesia e Bashkësisë Islame udhëhiqet nga kryetari i Kryesisë, i cili njëherësh është edhe myfti i Bashkësisë Islame të Kosovës.

## **5.3. Hierarkia e Bashkësisë Islame të Kosovës**

### **5.3.1. Kryetari**

Kryetari i Kryesisë është autoriteti më i lartë për çështje fetare islame në Kosovë.

Kryetari përfaqëson Bashkësinë Islame, interesat e besimtarëve brenda dhe jashtë vendit. Organizon dhe mbikëqyr punën e shërbimeve profesionale në kuadër të Kryesisë dhe u lëshon murasele (autorizime) imamëve, hatibëve dhe mualimëve për xhuma dhe Bajrame.

---

<sup>15</sup> Po aty, neni 52

<sup>16</sup> Po aty, neni 39.

Kryetari thërret dhe kryeson mbledhjet e Kryesisë dhe kujdeset për zbatimin e vendimeve të Kryesisë dhe nënshkruan të gjitha aktet dhe vendimet e Kryesisë.

Kryetari mbron interesat e Bashkësisë Islame dhe të myslimanëve tek organet dhe institucionet shtetërore<sup>17</sup>.

### 5.3.2. Institucioni i vakëfit

Vakëfet çdoherë kanë luajtur një rol të rëndësishëm dhe domethënës në jetën e myslimanëve, pra edhe të atyre shqiptarë, si në aspektin fetar, po ashtu edhe në aspektin kulturor, social dhe human. Roli i vakëfit është shumë i madh edhe në formimin dhe ndërtimin e zhvillimin e shumë lagjeve dhe kasabave/qyteteve shqiptare. Të rralla janë vendbanimet tona ku jetojnë ose ku kanë jetuar myslimanët e të mos kenë një e më shumë vakëfe dhe hajrate. Në vendbanimet urbane numri i vakëfeve është ku e ku më i madh, për të arritur në dhjetëra sosh.

Institucioni i vakëfit ka luajtur një rol jashtëzakonisht të madh dhe të pakrahasueshëm për përhapjen e fesë islame në vendin tonë dhe për përhapjen e kulturës islame në këto anë, rrjedhimisht edhe për mbajtjen, stimulimin e institucioneve arsimore islame, si medreseve, mektebeve e xhamive dhe për pasurimin e fondeve të bibliotekave të këtyre institucioneve.

Shumica e institucioneve islame në Kosovë gjatë historisë kanë qenë të ngritura dhe të themeluara falë vakëflënësve, shumica bij të këtyre hapësirave, të cilët jo vetëm se kanë lënë vakëfe e hajrate në vendlindjen e tyre, por edhe gjithandej Perandorisë Osmane, madje edhe deri në Jemen, Mekë e Medinë, si p.sh. Koxha Sinan pasha, Mehmet Kuklibegu, Jemish-xhi Hasan Pasha, familja fisnike e Rrotllajve të Prizrenit, Kryezinjët e Gjakovës, Mahmutbegollët e Pejës, Gjinollët e Prishtinës etj.<sup>18</sup>

Por, shumë nga këto vakëfe e hajrate që kanë lënë këta bamirës, fatkeqësisht janë shkatërruar, janë uzurpuar, janë tjetërsuar dhe janë bërë pre e njerëzve lakmitarë dhe e pushteteve nëpër të cilat kaloi Kosova.

<sup>17</sup> Po aty, neni 44-46.

<sup>18</sup> *Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës*, përgatitën Ramadan Shkodra - Sadik Mehmeti, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë 2013, fq. 47-48.

Edhe sot Bashkësia Islame e Kosovës kryesisht funksionon dhe vepron falë vakëfeve dhe hajrateve që kanë lënë dhe vazhdojnë të lënë bamirësit e ndryshëm.

Prona e Bashkësisë Islame është dhe realizohet prej:

- vakëfeve dhe pasurisë tjetër të luajjtshme e të paluajjtshme, që u takojnë organeve dhe institucioneve të BI, si dhe të ardhurave nga kjo pasuri;
- zekatit, sadekul-fitrit dhe kurbaneve;
- anëtarësisë dhe donacioneve tjera të pjesëtarëve të Bashkësisë Islame;
- dhuratave dhe vasijeteve;
- aksioneve, fondeve dhe të ardhurave prej tyre;
- të ardhurave prej shërbimeve dhe taksave fetare për kryerjen e shërbimeve administrative e të tjera;
- të ardhurave dhe ndihmave të tjera të ndryshme<sup>19</sup>.

### 5.3.3. Tjetërsimi dhe uzurpimi i vakëfeve

Bashkësia Islame në Kosovë në shekullin e fundit në vazhdimësi është atakuar nga regjimet të cilat kanë kaluar nëpër Kosovë.

Përveç presionit, ndjekjes, burgimit, dënimit dhe persekutimit të kuadrut (ulemave) të saj, ajo u përball edhe me konfiskimin, reformën agrare, shkatërrimin, dëmtimin, uzurpimin dhe tjetërsimin e pasurisë dhe pronës së saj, të lënë vakëf dhe hajrat nga vakëflënës dhe bamirës tanë për gjatë shekujve. Institucioni i vakëfit është institucioni që më së shumti ka pësuar dhe është dëmtuar gjatë kësaj periudhe<sup>20</sup>. Me shkatërrimin e vakëfeve synohej ndërprerja dhe mosfunksionimi normal i Bashkësisë Islame. Kjo fushatë ndaj pronës së Bashkësisë Islame filloi që nga viti 1912 kur Kosova u okupua nga Serbia, për të vazhduar me Mbretërinë SKS (1918-1929), pastaj gjatë Mbretërisë Jugosllave (1929-1941) dhe gjatë sistemit komunist (1945-1989)<sup>21</sup>.

<sup>19</sup> Kushtetuta e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë 1994, neni 12.

<sup>20</sup> *Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës*, përgatitën Ramadan Shkodra - Sadik Mehmeti, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë 2013, fq. 49

<sup>21</sup> Po aty fq. 49.

#### 5.4. Dëmet nga lufta e fundit

Dhjetë vjetët e fundit të pushtimit serb (1989-1999) qenë më të vështirë për popullin shqiptar të Kosovës, ngase regjimi serb mbylli të gjitha vatrat arsimore, që nga niveli parashkollor e deri tek ai universitar, dëboi nga puna pothuajse të gjithë shqiptarët, si dhe mijëra të tjerë i detyroi të migronin jashtë vendit, me qëllim të spastrimit etnik të Kosovës. Mirëpo, me gjithë represionin dhe zullumin, popullata shqiptare nuk u dorëzua, fillimisht u organizua në Lëvizjen Paqësore e më vonë edhe në rezistencën e armatosur - luftën çlirimtare të prirë nga UÇK-ja, kundër forcave serbe, që përfundoi me lirinë e vendit në qershor të vitit 1999. Gjatë luftës (1998-1999) Kosova pësoi dëme të mëdha nga soldateska serbe, me ç'rast u vranë mbi 12.000 civilë, fëmijë, gra e pleq, kurse konsiderohen të zhdukur mbi 1.800 vetë (ndonëse u zbuluan afro 600 varreza masive) dhe u dogjën mbi 250.000 shtëpi.

Njëri ndër institucionet që pësoi më së shumti gjatë kësaj dekade nga pushteti serb, pa dyshim është edhe Bashkësia Islame e Kosovës, të cilës iu dëmtua dhe iu shkatërrua mbi 40% të infrastrukturës së saj.

Kur Kosova u përball me agresionin e egër serb, në shënjestër ishin edhe objektet fetare islame, xhamitë, mesxhidet, mejtepet, bibliotekat, arkivat, teqetë, hamamet, varrezat etj. Gjatë kësaj periudhe forcat serbe dogjën, rrënuan dhe granatuan mbi 218 xhami në Kosovë, në mesin e tyre edhe xhamitë monumentale, siç ishin: "Xhamia e Hadumit" në Gjakovë, e ndërtuar më 1594/95, Çarshia e Vjetër dhe Biblioteka e xhamisë, në të cilën gjendeshin me qindra dorëshkrime të vjetra orientale; "Xhamia e Llapit" apo "Xhamia "Ramadanije" në Prishtinë, e ndërtuar më 1569 etj.<sup>22</sup>

Në qytetin e Pejës me rrethinë pothuajse u dogjën të gjitha xhamitë, si xhamia e Çarshisë (1470), xhamia Kurshumli (1577), xhamia e Defterdarit (1570), xhamia e Hamamit (1587), xhamia e Kuqe (1755), Hamami i Pejës si dhe Çarshia e Vjetër<sup>23</sup>.

Shkatërrimi i objekteve islame në Gjakovë, Pejë, Prishtinë, Vushtrri, Mitrovicë e në qytetet tjera të Kosovës ka qenë i planifikuar mirë nga ana

<sup>22</sup> Shih: Sabri Bajgora, *Barbaria serbe ndaj monumenteve islame në Kosovë (shkurt '98-qershor '99)* Botoi "Dituria Islame", Prishtinë 2000.

<sup>23</sup> Po aty.

e agresorit, sa që në disa raste gërmadhat e xhamive të shkatërruara janë pastruar me buldozerë, në mënyrë që të pamundësohet rindërtimi i tyre, siç ndodhi f.v. me xhaminë “Ikramije” (Xhamia e Çarshisë) 1878 në Vushtrri, Xhaminë e Ibrit 1878 në Mitrovicë etj.

Në ditën e hyrjes së forcave të NATO-s në Prishtinë, forcat serbe i dhanë flakën edhe selisë së Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, duke e djegur arkivin dhe bibliotekën e saj shumë të pasur me dorëshkrime islame<sup>24</sup>.

#### **5.4.1. Dëshmorët nga radhët e Bashkësisë Islame të Kosovës**

Gjatë luftës së fundit në Kosovë (1998-1999) nga radhët e Bashkësisë Islame të Kosovës ranë dëshmorë edhe 37 kuadro të saj, disa prej tyre ranë në vijat e para të frontit në luftimet me armikun pushtues, nga ata:

- 12 nxënës të medresesë,
- 2 studentë të Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë
- 22 imamë dhe
- 1 nëpunës i Kryesisë së BIK-ut<sup>25</sup>.

## **PËRFUNDIME**

- Në punimit tonë kemi trajtuar organizimin, rritjen dhe funksionim e Bashkisë Islame në Kosovës gjatë viteve 1945-1999 të shekullit të shkuar, por për të pasur një pasqyrë sa më të qartë për organizimin e Bashkësisë Islame në vendin tonë, gjatë historisë, e kemi parë të udhës që të marrim në shqyrtim edhe të kaluarën duke u nisur nga fillimet e para të pranisë së fesë islame te ne, për të vazhduar me organizimin dhe funksionimin e BI pas tërheqjes së Perandorisë osmane, me theks të veçantë gjatë viteve 1944-1999 kur prania e fesë islame te ne fillon me depërtimin e Perandorisë Osmane në trojet tona, dhe që nga kjo, kemi edhe shtrirjen, përhapjen dhe organizmin e fesë islame e rrjedhimit edhe organizmin e institucioneve bartëse e përfaqësuese të besimit islam. Siç

<sup>24</sup> Po aty.

<sup>25</sup> Grup autorësh, *Imamët dëshmorë-shehidë në luftën e fundit në Kosovë 1989/1999*, Prishtinë 2010.

dihet gjatë sundimit e qeverisjes së Perandorisë Osmane organizimi i jetës fetare dhe i asaj politike ka qenë i njësuar, pra organizimi fetar islam dhe organizimi shtetëror kanë qenë strukturë unike e quajtur “*Din ve Devlet*”, ndërsa bashkësitë e tjera fetare kanë pas organizimet e veta dhe kanë gëzuar autonominë substanciale në funksionimin e tyre.

- Në kuadër të Perandorisë Osmane të gjithë myslimanët e Ballkanit kanë qenë pjesë përbërëse e Bashkësisë Unike Myslimane në krye të së cilës ka qëndruar vet sulltani që njëkohësisht ishte edhe kalif.
- Në kohën e Sulltan Muratit të II (1421-1451) kompetencat e kalifit janë bartur në myftiun kryesor - *Shejhul Islam*, i cili ishte autoriteti më i lartë fetar islam. Ndërsa në nivele lokale autoritetet më të larta fetare kanë qenë myftinjtë e elajeteve, vilajeteve dhe kazave, të cilët i janë përgjigjur Shejhul Islamit.
- Pas tërheqjes së Perandorisë Osmane ndryshimet e mëdha që pasuan pas luftërave dhe lëvizjeve të dekadave të para të shekullit XX, për pjesën dërmuese të shqiptarëve patën pasoja të rënda të cilat jo vetëm që nuk e fituan lirinë kombëtare, por ranë edhe në robëri më të thellë. Pas vitit 1912 pushtuesit serbo-malazez filluan fushatën e përgjithshme diskriminuese të ndjekjes së popullatës shqiptare, që përbënte shumicën e popullsisë së viseve etnike shqiptare që mbetën jashtë Shqipërisë londineze.
- Në rrethanat e krijuara gjendja dhe pozita e institucioneve të BI-së ishte tejet e rëndë. Pos vështirësive të tjera në këtë kohë ishin shkëputur të gjitha lidhjet me selinë e kryeqendrës në Stamboll. Pra, jeta e organizuar fetare islame në viset shqiptare të pushtuara nga serbo-malazeztë mund të thuhet se ishte paralizuar fare.
- Gjendja vazhdoi të jetë e rëndë edhe pas marrëveshjes së Stambollit të marsit të vitit 1914 të lidhur ndërmjet Mbretërisë së Serbisë dhe Turqisë. Me këtë marrëveshje i garantoheshin të drejtat popullatës myslimane të viseve të pushtuara, ku institucionet fetare islame thuhej se gëzonin të drejtat e tyre për aftësimin e kuadrit fetar dhe organizimin e lirë të jetës fetare, se pasuria e tyre do t’u njëhej dhe respektohej. Sipas kësaj marrëveshjeje, kurrfarë pengesash nuk do t’u parashtrohen bashkësive fetare islame dhe individëve në lidhje me kryesuesin e tyre të

- shenjtë, qoftë edhe jashtë kufijve të shtetit, siç ishte rasti me Kryesinë e BI-së në Stamboll (Shejhul-Islamin).
- Më 1914 në Kosovë vepronin këto myftini të qarkut (në Prishtinë, Prizren dhe në Mitrovicë) dhe disa të tjera të rretheve.
  - Përpjekjet për konsolidim të organeve administrative fetare të BI-së përjetuan goditje të rëndë në vitin 1929. Më vendosjen e diktaturës së 6 janarit u godit edhe BI-ja. Ajo në fakt humbi atë autonomi formale që e kishte. U bënë shumë ndryshime në strukturën udhëheqëse e profesionale fetare.
  - Me ndryshimet që pasuan pas vitit 1929 u formua Ulema Mexhlisi i Shkupit, i cili zëvendësoi Myftininë Supreme të Beogradit.
  - Gjatë vitit 1931 në Shkup u themelua Drejtoria e Vakëfeve mearife, që përfshinte 42 njësi administrative fetare, gjegjësisht komisione të vakëfeve mearife të rretheve. Në Kosovë ekzistonin 11 komisione të vakëfeve mearife të rretheve.
  - Me konsolidimin dhe forcimin e institucioneve dhe organeve të ndryshme fetare të BI-së, gjendja dhe pozita e mjerë e besimtarëve shqiptarë mysliman bëhej më e lehtë. Duhet theksuar se organet administrative fetare islame (imamatet e xhematit, komisionet e vakëfeve mearife dhe me vonë ulema mexhlisi i Shkupit) ishin të vetmet institucione dhe do t'i quanim organe popullore legale për shqiptarët myslimanë të viseve të pushtuara, ku ata mund të komunikonin në gjuhën amtare. Për rolin pozitiv të tyre në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe të krijimit të mundësisë së rezistencës të organizuar shqiptare kundër pushtuesit deri sot nuk është shkruar. Është i njohur aktiviteti dhe lufta politike e Ferat Dragës në Ulema Mexhllisin e Shkupit kundër tendencave dhe veprimeve shoviniste serbe, në mënyrë të veçantë, ai u angazhua kundër shpërnguljes së shqiptarëve dhe arsimimit të tyre.
  - Pas pushtimit nga shtetet e Bllokut fashist (prill 1941), Jugosllavia e Vjetër u shpërbë dhe u copëtua, po ashtu edhe trevat shqiptare që ishin nën sundimin e saj.
  - Gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore pati lëvizje të shumta përbrenda bashkësisë islame. Qëllimi kryesor i udhëheqësve të kësaj bashkësie fetare në të gjitha viset e pushtuara shqiptare ishte krijimi i një



kryeqendre unike fetare në kuadër të një shteti etnik shqiptar. Kjo ide u realizua pjesërisht pas lidhjes me Kryesinë e Këshillit të Ulemave të Komunitetit Mysliman me qendër në Tiranë. Në viset e çliruara shqiptare vepronin kryemyftinjtë, myftinjtë, nënmyftinitë dhe imametet e xhemateve.

- Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Kosova edhe njëherë padrejtësisht ndahet nga trugu i saj - Shqipëria dhe futet dhunshëm nën administrimin e sajësës së quajtur Jugosllavi. Në këto rrethana, në viset shqiptare, sidomos ato që u aneksuan nga Jugosllavia, u bënë ndryshime të mëdha shoqërore dhe politike të cilat ushtruan ndikim edhe në veprimtarinë e bashkësive fetare. Në këtë kontekst edhe Bashkësisë Islame i pamundësohet veprimi i mëtutjeshëm në kuadër të KMSH, andaj, aktiviteti i BI bëhej kryesish në nivel të Zyrave të Vakëfeve dhe nëpër xhemate ku vazhdonin aktivitetin dhe kryheshin ceremonitë e ritet fetare. Ndërsa, struktura organizative e Bashkësisë Islame (BI-së) e ndërtuar gjatë luftës pushoi së vepruari dhe kështu praktikisht Bashkësia Islame ngeli pa organizim dhe udhëheqje qendrore.
- Të vetëdijshëm për rrethanat e reja, që u krijuan pas aneksimit të Kosovës nga Jugosllavia respektivisht Serbia, paria islame u vetorganizua dhe ndërmori nismën për organizimin e mëvetësishëm e të pavarur të Bashkësisë Islame në Kosovë.
- Organizimi i Bashkësisë së Fesë Islame në RFP të Jugosllavisë bazohej në Kushtetutën e Bashkësisë së Fesë Islame të miratuar nga Kuvendi Suprem Vakufor i BFI-ve nga territori i Bosnjës dhe Hercegovinës, RP të Serbisë, RP të Maqedonisë dhe RP të Malit të Zi, në mbledhjen e parë të mbajtur në Sarajevë më 26-27.8.1947.
- Bashkësia Fetare Islame në Kosovë pas miratimit të Kushtetutës së vitit 1947 të Bashkësisë Fetare Islame për RPFJ, me të cilin rregullohej funksionimi i BI, bëhet pjesë përbërëse - njësi e BFI-së në Jugosllavi.
- Bazuar në këtë Kushtetutë, bëhej edhe organizimi i paraparë i Bashkësive Islame në nivel republikash. Kuvendi i Vakëfnor për RPS, ku përfshihej edhe territori i Kosovës e rrjedhimisht edhe Bashkësia Islame në Kosovë, ishte konstituuar-themeluar në Beograd më 20 gusht 1947.

- Ndërsa, Kryesia Islame në Prishtinë ka nisur funksionimin më 1 janar 1948. Në këtë strukturë organizative Bashkësia Islame në Kosovë ve-proi deri në fillim të viteve 90 të shekullit të shkuar. Gjatë kësaj periudhe me gjithë vështirësitë e sfidat me të cilat u përball, duke nisur që nga atakimi që iu bë përmes Reformës Agrare, Bashkësia Islame arriti që të konsolidohet, të shtrihej në terren përmes këshillave e nga këshillat në xheme, si dhe të themelojë institucionet e saja: Bibliotekën e Vakëfit (1951), Medresenë (1951), Fakultetin e Studimeve Islame (1992), Shtëpinë Botuese “Dituria Islame” (1993) etj., të cilat do të jenë bartëse të zhvillimit, rritës dhe avancimit së jetës fetare te ne.
- Një rëndësi të veçantë Bashkësia Islame i kushtoi edhe botimit të literaturës në gjuhën shqipe.
- Në këtë kohë nis edhe periodiku islam, më saktësisht në vitet 60, me “Buletini Informativ” (1962), “Takvimi” (1970), “Edukata Islame” (1971), “Dituria Islame” (1986).
- Fillimi i viteve të 90 shënon një etapë të re për Kosovën dhe popullatën e saj. Këto vite ishin vitet e kthesave të mëdha. Dhe, ndonëse nga push-tuesi serb i qe marrë me dhunë edhe ajo pak autonomi që e kishte më herët Kosova në kuadër të ish-Federatës Jugosllave, shqiptarët në mënyrë të prerë dhe unike u organizuan dhe vendosen që të vazhdonin drejt pavarësisht përfundimtar të tyre nga Serbia dhe Jugosllavia.
- Në këtë drejtim, institucionet e Bashkësisë Islame të Kosovës, respekti-visht Kuvendi i saj, më 11 dhjetor 1993, vendosën të shkëputeshin nga RIJASET-i i deriatëhershëm dhe të shpallin Bashkësinë Islame të Ko-sovës të pavarur dhe të mëvetësishme. Nga kjo kohë filloi një periudhë e re e Bashkësisë Islame të Kosovës.



Dr. Nehat KRASNIQI - Dr. Sadik MEHMETI

## VËSHTRIM KOMENTIMIT TË SURES “JÂSÎN” NGA SELIM “SAMI” EF. DREJTA

### **Abstrakt**

Në këtë punim është marrë në shqyrtim vepra në dorëshkrim “*Tefsîr sûretu Jâsîn*” e autorit Selim Sami ef. Drejta (1883-1951) nga Vushtrria.

Megjithëse për autorin është ditur deri në njëfarë mase, për veprën e tij në gjuhën arabe “*Tefsîr sûretu Jâsîn*”, e cila ruhet në bibliotekën e Gazi Husrev-begut në Sarajevë, deri tani nuk ka pasur ndonjë vështrim a studim.

Përveç vlerës historike dhe përmbajtjesore që ka, vepra “*Tefsîr sûretu Jâsîn*” është edhe një dëshmi më shumë se në bibliotekat e ndryshme të vendit dhe jashtë tij, ruhen vepra të panjohura të autorëve shqiptarë, të shkruara në gjuhët orientale islame, që i presin studiuesit t’i hulumtojnë, t’i studiojnë dhe t’ua bëjnë të qasshme masës së gjerë të lexuesve.

**Fjalët çelës:** *Selim “Sami ef. Drejta, Vushtrri, dorëshkrim, Kuran, tefsir, sure “Jâsîn”.*

## Hyrje

Kur në “*Takvimin*” e vitit 2016 patëm botuar një shkrim, të parin për hafëzin, hoxhën, pedagogun, myderrizin, mistikun, shkencëtarin, publicistin, poetin dhe mendimtarin vushtrrias, Selim “Sami” ef. Drejta (1883-1951), patëm konstatuar se Selim “Sami” efendiu, - duke qenë shkrimtar, myderriz i aftë, si dhe njeri mjaft i ngritur dhe njohës i mrekullueshëm i tesavufit, i cili përveç gjuhës shqipe dhe tri gjuhëve orientale islame: arabishte, osmanishte dhe persishte, ka njohur edhe boshnjakishten dhe deri diku frëngjishten, - ka lënë pas edhe disa vepra në dorëshkrim, në mesin e tyre edhe dy vepra nga fusha e komentimit të Kuranit - “*Tefsîr sûretu er-Rrahmân*” dhe “*Tefsîr sûretu Jâsîn*”.<sup>1</sup>

Përderisa për veprën e parë nuk kishim të dhëna, - dhe as sot nuk kemi, - se ku ruhet, për këtë të dytën, pra veprën “*Tefsîr sûretu Jâsîn*” e dinim se ruhej në Bibliotekën e Gazi Husrev-begut në Sarajevë<sup>2</sup>, por edhe këtë nuk e kishim në dorë dhe, përveç titullit, për të nuk dinim më shumë. Interesimet tona për ta pasur një kopje në dorëshkrim të kësaj vepre të Selim efendiut u përmbushën ditë më parë dhe kështu një kopje e saj në mënyrë elektronike u vu në dispozicionin tonë, prandaj edhe vendosëm që t’i bëjmë një vështrim të përgjithshëm, për aq sa mund të vështrohet nga autorë, vokacioni dhe profesioni i të cilëve nuk është ai i tefsirologut (punë kjo që gjithsesi duhet bërë nga këta), por i gjurmuesve dhe studiuesve të dorëshkrimeve arabike-islame.

## Autori

Para se të bëjmë fjalë për Selim ef. Drejtën dhe veprën e tij në dorëshkrim “*Tefsîr sûretu Jâsîn*”, ia lejojmë vetes të theksojmë faktin se shkrimi i sipërpërmendur, i botuar në “*Takvim*”, u prit mirë nga lexuesit dhe zgjoi kureshtjen e të interesuarve për këtë fushë. Gjithashtu, patëm nderin dhe kënaqësinë që për Selim ef. Drejtën të shkruajmë një zë, i cili

<sup>1</sup> Nehat Krasniqi - Sadik Mehmeti, *Selim ef. Drejta dhe “Himni i Mevlydit”*, “Kalendari/Takvimi”, 2016, Prishtinë, 2016, f. 251-275.

<sup>2</sup> Samir Beglerović, *Bibliografija Fejzulah efendija Hadžibajrić*, në: “Znakovi Vremena”, nr. 25, Sarajevë 2005, f. 2-13; Zejnil Fajić, *Katalog arapski, turskih, perzijskih i bosanskih rukopisa*, vëll. XI, London-Sarajevo, 2003, f. 246.

zuri vend të meritueshëm në “*Fjalorin Enciklopedik të Kosovës*”, të botuar tash së voni nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.<sup>3</sup>

Selim “Sami” ef. Drejta u lind më 15.8.1883 në Vushtri.<sup>4</sup> Rrjedh nga një familje e ngritur dhe me ndikim në Vushtri dhe më gjerë. Stërgjyshi i tij, *Haxhi Mahmud efendiu*, ka punuar imam në xhaminë e Gazi Ali beut në Vushtri<sup>5</sup>, ndërkaq në vitin 1822, ka punuar kadi në Kadillëkun e Vushtrrisë. Ai së bashku me kadilerët e kadillëqeve të Prishtinës, ishte një nga organizatorët e marshit protestues të organizuar në vitin 1822, që ishte drejtuar kundër sjelljeve të ashpra të Maliq pashë Gjinollit<sup>6</sup>.

Gjyshi i Selim efendiut, *Jashar efendiu*, ka qenë myteveli i vakëfeve në Vushtri<sup>7</sup>. Ndërsa i ati i Selim efendiut, *Mulla Hasan-Tahsin efendiu*, ka qenë punonjës arsimit në Vushtri: mësues në iptidâije (fillore), profesor në rushdije (shkollën e mesme), e më pastaj edhe myderriz në medresenë e Gazi Ali Begut dhe drejtor i shkollës së parë shqipe në Vushtri gjatë viteve 1915-1918.

Selim efendiu e ka kryer shkollimin fillor (iptidâije) në vendlindje, sikurse edhe të mesmen (rushdijen), të cilën e ka mbaruar në vitin 1890-1891. Më pastaj, për 12 vjet ka studiuar në medresenë e Vushtrrisë, te myderrizi dhe dijetari i njohur *haxhi Abdylkadër efendiu*<sup>8</sup>, tek i cili ka marrë ixhazetnamenë dhe lejen për myderriz. Myderriz Abdylkadër efendiu shquhej si pedagog dhe njohës i thellë i shkencave islame dhe i tesavufit, ide këto të cilat do t’i kultivonte tek Selim efendiu dhe nxënësit e

<sup>3</sup> Nehat Krasniqi - Sadik Mehmeti, DREJTA Selim (1883-1951): *Fjalori Enciklopedik i Kosovës, I*, Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2018, f. 352.

<sup>4</sup> Arkivi i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, kutia nr. 19, dosja nr. 19.

<sup>5</sup> Omer Nakićević, *Revolt i protestni marš stanovnika Kosova 1822*, Prishtinë 1965, f. 34-35; 69.

<sup>6</sup> Omer Nakićević, *Revolt i protestni...*, po aty.

<sup>7</sup> Selim Sami Jašar, “*Tuhfa*” (“*Dar*”), bejtovi o mekamima, Sarajevo 1984, izdanju Tekijskog odbora Hadži-Sinanove Tekije u Sarajevu, preveo s turskog hadži Fejzullah Hadžibajric, Sarajevë 1984.

<sup>8</sup> *Haxhi Abdylkadër efendiu ose “Baba Hoxhë”* ka qenë mjaft i çmuar, i ditur dhe me autoritet. Rrjedh nga një familje e njohur, prej babait Haxhi Muhedinit. Mësimet i ka marrë prej sheh Mehmet Eminut, i cili edhe e ka futur ne rendin kaderi, kurse hilafetnamen e ka marrë në Bagdad. Ka pasur shumë nxënës dhe pjesëtarë të tarikatit të tij. Ka vdekur në vitin 1935. Jashar Rexhepagiqi, *Dervishët dhe teqetë në Kosovë, në Sanxhak dhe në rajonet tjera përreth*, botoi: “Dukagjini”, 2003, f. 185.

tjerë. Nën ndikimin e mësimeve të mësuesit të tij, Selim efendiu do të bëhet jo vetëm njohës i mrekullueshëm i tesavufit, por edhe autor i disa veprave në këtë lëmë.

Pas kryerjes së medresesë, Selim efendiu studimet i vazhdoi në *Shkollën e Lartë Pedagogjike (Dâru'l-muallimîn) në Shkup* (e themeluar më 1882), të cilën e përfundon me sukses të shkëlqyeshëm më 11 prill 1904.<sup>9</sup>

Periodha kur Selim efendiu ishte student në Dâru'l-muallimîn të Shkupit, ishte koha kur patriotët shqiptarë bënë përpjekje të mëdha për futjen e gjuhës shqipe në shkollat osmane, jo vetëm kryeqendrën e vilajetit të Kosovës - në Shkup, po gjithandej vilajetit, dhe jo vetëm si lëndë, por edhe si gjuhë mësimi. Kështu, Idâdija dhe Dâru'l-muallimîn të Shkupit, luajtën rolin e vatrave të përhapjes së shkrimit dhe gjuhës shqipe. Një luftë e tillë u zhvillua edhe brenda vetë Dâru'l-muallimînit, midis pedagogëve që ishin konservatorë, proqeveritarë e kundër gjuhës shqipe (siç ishte drejtori i kësaj shkolle Ejup Sabri Xhemili) dhe pedagogëve atdhetarë, si *Salih Gjuka (1876-1925)*, *Bedri Pejani* etj.

Këta pedagogë atdhetarë patën ndikim te studentët e tyre (edhe tek Selim efendiu) jo vetëm në formimin e tyre arsimor, por edhe kombëtar, që më vonë do të jepte frytet e veta dhe rezultatet e jashtëzakonshme, sepse shumica prej këtyre studentëve do të bëhen personalitete të shquara të dijes, arsimit e edukimit kombëtar, jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë.

Pas kryerjes së studimeve, Selim efendiu fillimisht ka punuar mësues në sibjân mekteb, e më pas edhe në mektebin iptidâi të Vushtrrisë nga viti 1904-1912. Kurse pjesën më të madhe të punës së tij si pedagog e ka kaluar në medresenë Gazi Ali Begu në Vushtri, ku ishte njëkohësisht edhe drejtor (nga viti 1913-1941). Selim efendiu ka qenë edhe anëtar i Kuvendit të Ulema Mexhllisit me seli në Shkup në kohën kur në këtë institucion përkrahësit e vijës së Ferat bej Dragës diskutonin dhe mbronin të drejtat e shqiptarëve në kuadër të Mbretërisë Jugosllave. Në vitin 1932 Selim efendiu kishte shkuar në haxhillëk dhe kjo i kishte mundësuar që të njëjtojë më për së afërmi me shumë vende, popuj dhe kultura.<sup>10</sup>

<sup>9</sup> *Arkivi i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës*, kutia nr. 19, dosja nr. 19.

<sup>10</sup> Jashar Rexhepagiqi, *Dervishët...*, po aty, f. 188-189.



*Selim "Sami" efendi*

Selim efendi ka qenë njeri me autoritet të madh në masë. Ai në të gjitha fazat kritike të zhvillimit tonë historik të periudhës së tij, si Revolucioni Xhonturk (1908), lufta për arsim dhe kulturë kombëtare (1898-1912), lufta për çlirim nga robëria serbe pas vitit 1913 dhe sidomos gjatë Luftës së Parë Botërore, ka qenë në anën e forcave të ndërgjegjshme kombëtarisht. Ai ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me *Hasan Prishtinën*. Ky i fundit, si duket ka qenë anëtar i rendit kaderi, sepse ia merrte dorën Selim efendiut, mbase edhe nxënës prej të parëve të Selim efendiut në mejtep dhe në rushdije. Kontaktet e tyre kanë rezultuar në ndikime të ndërsjella të këtyre dy viganëve të Vushtrisë. Bashkëpunëtor i ngushtë i Selim efendiut nga radhët e ulemasë ishte myftiu i Prishtinës dhe përkra-



hësi e aktivitetit i madh i çështjes kombëtare, arsimdashësi e poeti Mehmet ef. Sezai.<sup>11</sup>

Ka pasur një bashkëbisedim poetik edhe me poetët dhe intelektualët Hilmi ef. Maliqin (1865-1928) dhe Haxhi Ymer Lutfi ef. Paçarizin (1870-1929). Kurse ndër nxënësit e tij duhen veçuar: Hafiz Sabit ef. Zajmin nga Vushtrria (1893-1975), Hafiz Fahri ef. Iljazin nga Gjakova, Mulla Ibrahim Maxhunin nga Vushtrria dhe Haxhi Fejzullah ef. Haxhibajriçin nga Sarajeva.

Ishte anëtar i organizatës politike e kulturore-arsimore “*Bashkimi*”, që u formua nga Hasan Prishtina në Mitrovicë më 1915. Në vitin 1918 pushteti okupator serb e ka burgosur për shkak të aktivitetit të tij politik në kohën e pushtetit austro-hungarez në Kosovë, si njërin ndër luftëtarët për të drejta të popullit shqiptar. Në burg ka vuajtur dënimin gjatë 18 muajve, prej nga doli me pasoja shëndetësore. Selim efendiu ndërroi jetë në vitin 1951.<sup>12</sup>

Ka lënë këta trashëgimtarë: Masarin, Myzaferin dhe Mensurin. Myzaferi ka mësuar në medresenë e reformuar të “Gazi Isa Beut “ në Shkup. Ka qenë anëtar aktiv i Organizatës së Rinisë Përparimtare Shqiptare me emrin “Hasan Prishtina”. Për shkak të aktiviteteve dhe bindjeve të tij, në vitin 1945 është pushkatuar nga pushteti sllavo-komunist. Kurse Mensuri, i cili jeton në Turqi, ka kryer Shkollën Normale dhe para se të shpërngulej në Turqi, ka punuar (1958) arsimtar i fizikës në shkollën fillore të Vushtrrisë.

<sup>11</sup> Mehmet ef. Sezai (vd. 1947). Pas mbarimit të shkollës fillore dhe medresesë në Prishtinë, studimet i vazhdon në Stamboll. Ka qenë myderriz dhe myfti i Prishtinës. Aktivist dhe përkrahës i arsimit shqip në Vilajetin e Kosovës. Luftoi me ngulm kundër shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi. Ka lënë disa krijime letrare dhe një “Divan”. (Shih: J. Rexhepagiqi, Dervishët dhe teqetë në Kosovë..., po aty, f. 186-187).

<sup>12</sup> Arkivi i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, kutia nr. 19, dosja nr. 19.

## Veprat

Selim “Sami” efendiu, sikurse u tha, ka qenë shkrimtar dhe myderriz i aftë dhe njeri mjaft i ngritur. Ka shkruar kryesisht në gjuhët orientale islame, por ka lënë edhe dy-tri poezi në gjuhën shqipe me alfabet arabo-islam. Në shkrimet e tij Selim efendiu nënshkruhej me pseudonimin poetik (mahllasin) “*Sâmi*” (“i vlerësuar”, “i ngritur”).

Selim efendiu ka lënë në dorëshkrim këto vepra:

1. “*Tuhfa*” - “Dhuratë”;
2. “*Sânihât*” - “Mendime”;
3. “*Menâkib-i Abdulkâdir Gejlânî*” - “Biografia dhe përjetimet e Abdyklkadër Gjejlaniut”;
4. “*Saksağan*” - “Laraska”;
5. “*İki cevap*” - “Dy përgjigje”;
6. “*Tefsîr sûretu Jâsîn*” - “Komentimi i sures “Jâsîn”;
7. “*Tefsîru sûreti err-Rrahmân*” - “Komentimi i sures “err-Rrahman”;
8. “*Tefsîr-i Evrâdi-i şerîf*” - “Komentimi i “Evradi sherifit” të kade-rinjve” dhe
9. “*İlâhi*” - “Përmbledhje poezish”.

Veprat, përveç “*Tuhfa*”-së, që të gjitha kanë mbetur në dorëshkrim. “*Tuhfa*” është botuar në përkthim në boshnjakisht nga Fejzullah Haxhibajriçi, në Sarajevë më 1984. Është nga fusha e moralit dhe e filozofisë islame, e veshur me petkun e tesavvufit (misticizmit islam).

Veprat e tjera nuk janë ruajtur në një vend. Ato janë shpërndarë, së bashku me bibliotekën e madhe të Selim efendiut, në disa drejtime. Tri prej tyre (“*Tuhfa*”, “*Tefsîr-i Evrâdi-i şerîf*” dhe “*Tefsîr sûretu Jâsîn*”) ruhen në Bibliotekën e Gazi Husrev-begut në Sarajevë.<sup>13</sup>

<sup>13</sup> Këto vepra në Bibliotekën e Gazi Husrev-begut në Sarajevë mbajnë singanturat: R. 9349, përkatësisht R. 8713. Për këto dorëshkrime, shih më gjerësisht: Zejnil Fajić, *Katalog arapski, turskih, perzijskih i bosanskih rukopisa*, vëll. XI, London-Sarajevo, 2003, f. 246; Haso Popara, *Katalog arapski, turskih, perzijskih i bosanskih rukopisa*, vëll. XIII, London-Sarajevo, 2004, f. 502-503.

Shumë nga ilahitë që ka shkruar Selim efendiu këndoheshin nëpër teqe, sidomos të kaderinjve. Numri i poezive në gjuhët orientale islame sillet rreth 100, ndërsa nga poezitë shqipe që ka shkruar Selim efendiu, sipas djalit të tij, është poezia “*Perëndia ka urdhnuë*”.

Ka të ngjarë që edhe poezia e njohur “*Eni vllazni tubohem*”, të mos jetë e Hafiz Mustafës, por e Selim efendiut. Për këtë ka shfaqur dyshimin edhe studiuesi M. Pirraku.<sup>14</sup>

Edhe disa nga poezitë e tij në gjuhët orientale janë të motivuara nga bukuritë e vendlindjes dhe nga dashuria për të, siç është edhe poezia kushtuar qytetit të Mitrovicës, që fillon me vargjet:

*“Mitroviça beldesi,  
Kosova'nın goncesi  
Gümüş gibi akıyor  
O mübarek İbresi”*

*“Qyteti Mitrovicës  
Gonxhe e Kosovës  
Si argjendi rrjedh  
Ai Ibër i bekuar”*

Selim efendiu është autor i disa artikujve të ndryshëm në gazetata e kohës, si në “*Işık*” që dilte në Shkup 1928 (nr. 97, 98 etj.), “*Sadâ-i Millet*” dhe “*Hakk*” të Shkupit.

---

<sup>14</sup> Muhamet Pirraku, *Gjurmë të veprimtarisë letrare shqipe me alfabet arab në Kosovë (III)*, “Gjurmime albanologjike”, SSHF, X, Prishtinë 1980, f. 207.

## 2. DORËSHKRIMI

### 2.1. Përshkrimi analitik

Dorëshkrimi “*Tefsîr sûretu Jâsîn*” i Selim efendi Drejtës, që e kemi marrë në shqyrtim, është i shkruar në gjuhën arabe. Ka formatin 20,5x14 cm, kurse teksti 16x12,5 cm dhe ka 19 rreshta. Ka gjithsej 48 fletë (98 faqe). Është i shkruar me shkrimin arab *Nas’h*, i shkruar më ngjyrë të kaltër. Letra është e bardhë, me vija të gjëra (fletore e rëndomtë). Mbulohet me kopertina të kartonit.

Fillimi i dorëshkrimit është:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ  
تفسير سورة يس مكيه لشيخ سليم سامي  
وهي ٨٣ آية و ٧٢٩ كلمة و ٣٠٠٠ حرف

“*Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!*

*Komentimi i sures “Jâsîn” nga Selim Samiu, e shpallur në Mekë, dhe ka 83 ajete, 729 fjalë dhe 3000 shkronja...*”

Është komentim i sures “*Jâsîn*”, e cila renditet e 36-a në Kuranin fisnik, ndërsa në radhitjen e zbritjes është e 41-ta. Kjo sure, për shkak të tematikave të saj, në jetën e myslimanit ka domethënie dhe rëndësi të veçantë. Surja “*Jâsîn*”, përveç tjerash, quhet “*Zemra e Kuranit*”. Për rëndësinë dhe vlerën e saj janë transmetuar shumë hadithe (një pjesë e tyre edhe në dorëshkrimin tonë), prandaj edhe leximi i kësaj sureje është popullarizuar edhe ndër myslimanët tanë, kurse leximi i saj praktikohet në raste dhe manifestime të ndryshme. Është emërtuar “*Jâsîn*”, sipas ajetit të parë të saj, në të cilin Allahu xh.sh. betohet me fjalët: “*Ja Sin*”, dhe ka 83 ajete, 729 fjalë dhe 3000 shkronja, siç konstaton edhe Selim efendi Drejta, në ballë të komentimit të tij. Kjo sure ka njohur shumë komentime dhe në gjuhë të ndryshme të botës.

Komentimi i kësaj sureje nga Selim efendiu i takon komentimeve sufiste të Kuranit, gjë e kuptueshme kur dihet profili i autorit Selim ef. dhe përgatitja e tij. Gjatë komentimit të saj, autori ka komentuar dhe ka shpjeg-

guar sipas metodave “ajet me ajet”, pastaj “ajet me hadith”, dhe po ashtu ka sjellë edhe thënie të sahabëve, të dijetarëve të shquar dhe shpeshherë edhe pjesë nga “Mesnevia” e mistikut të shquar Xhelaludin Rumiut dhe të poetëve të njohur persian Xhamiut, Saadiut etj., të cilat këtu janë dhënë në gjuhën perse, që tregon për nivelin e njohjes së kësaj gjuhe nga autori. Të gjitha këto jemi të sigurt se paraqesin material të dorës së parë për studiuesit e shkencës së tefsirit, islamologët dhe njohësit e gjuhëve të sipërpërmendura.

## 2.2. Kopjuesi dhe pronarët

Në faqen 89 të dorëshkrimit shkruan se kopjimin e tij e ka bërë Fejzi Haxhibajriqi nga Sarajeva *تحرير فيضى حاجى بايريج من سراى بوسنه*.

Fejzi Haxhibajriqi, në të vërtetë, është myderrizi, hoxha, bibliotekisti, shejhu dhe nëpunësi në administratën e Bashkësisë Islame të Bosnjë-Hercegovinës - *Fejzullah Haxhibajriqi* (1912-1990). Ai e ka njohur mirë gjuhën arabe, turke dhe persiane. Është autor i shumë shkrimeve të botuara në revistat profesionale nga islamologjia dhe nga trashëgimia islame në Bosnje dhe më gjerë. Ka qenë sheh i tarikatit kaderij nga viti 1936, kur edhe mori hilâfetnâmenë nga shejhi i tij, myderrizi i Vushtrisë, Selim ef. “Sami” Drejta. Fejzullah efendiu ka botuar në gjuhën boshnjake shumë ilahi, sikundër edhe përkthimin e veprës “*Tuhfa*” të shejhut të tij, Selim efendiut.<sup>15</sup>

Kopjimin e komentimit të sures “Jâsîn”, F. Haxhibajriqi e ka bërë në vitin 1986, dhe e ka pajisur atë me disa shënime marginale në gjuhën boshnjake me shkronja latine. Gjithashtu, në faqen 95 ka edhe një shënim në gjuhën osmane, ku na jepen disa të dhëna me rëndësi e të cilat na mundësojnë një njohje më të mirë të dorëshkrimit. Aty shkruan:

مؤلف إتمام سورة يس من آية و ما علمناه إلى نهاية يس شيخ الحاج حافظ  
فخرى افندى الياس المدرس فى بلده ياقووه مرید و خلیفة شيخ سليم سامی

<sup>15</sup> Më gjerësisht për këtë, shih: M. Trajlić, *Prof. Hadži Fejzulah Hadžibajrić (in memoriam)*, në: “Anali” Gazi Husrev-begove Biblioteke, nr. XV-XVI, Sarajevë 1990, f. 287-291. Në vitin 1963 F. Haxhibajriqi ka botuar “*Ilmihalin*”, i cili në vitin 1968 është përkthyer në gjuhën shqipe nga H. Sherif Ahmeti dhe deri sot ka pasur disa ribotime.

افندی شیخ الطریقة القادرية من قصبه ولجترین من قصووا شیخی ومعمدی

سرای بوسنه ۲۶ رجب ۱۴۰۷ الموافق ۶ ابریل ۱۹۸۶

فیضی

*“Autori i plotësimit të (komentit) të sures “Jâsîn” nga ajeti “...ve mâ ‘al-lemnâhu...” e deri në fund të “Jâsîn-it” është shejh haxhi hafiz Fahri efendi Iljasi, myderriz në qytetin e Gjakovës dhe murid e halife (nxënës dhe zëvendës) i shejh Selim “Sami” efendiut – shejhut të tarikatit kaderij nga kasabaja e Vushtrrisë së Kosovës, përndryshe (ky i fundit është edhe) shejhi dhe prijësi im. Sarajevë, më 26 rrexheb 1407, përkatësisht 6 prill 1986.*

*Fejziu”.*

Sikurse kuptohet nga ky shënim, Selim efendi, ka komentuar suren “Jâsîn” nga ajeti i parë e deri tek ajeti 68 “...ve mâ ‘al-lemnâhu...”, kurse nga këtu e deri në ajetin e fundit të sures, komentimin e ka bërë Fahri ef. Iljasi nga Gjakova.<sup>16</sup>


Në të vërtetë, emrin e Fahri efendiut me shkronja arabe e hasim të shkruar edhe në disa faqe të tjera të këtij dorëshkrimi, që lë të kuptohet se ky përveçse e ka plotësuar fundin e tij, ai edhe e ka shfrytëzuar dhe ka qenë në pronë të bibliotekës së tij.

Ka mundësi që përfundimin e kësaj vepre Fahri efendi ta ketë bërë pas vitit 1951, kur autori Selim efendi tanimë kishte kaluar në botën tjetër.

Sidoqoftë, edhe kaq sa ka bërë Fahri efendi duhet vlerësuar masa e kontributit të tij në plotësimin e kësaj vepre, por edhe në komentimin e saj, pavarësisht se sikurse shkruan aty, ai është mbështetur kryesisht në


<sup>16</sup> *Hafiz Fahri ef. Iljazi* (1903-1985). Lindi në Gjakovë në vitin 1903 dhe mësimet e para i ndoqi pranë t'et, Iljaz efendiut. Në moshën 11 vjeç kreu hifzin. Pas vdekjes së t'et, në moshën 17 vjeç vijoi mësimet në Medresenë “Mehmet Pasha” në Prizren, te myderrizi i shquar, Hfz. Nysret ef. Galibi, të cilën e kryen me sukses të shkëlqyeshëm. Kurse hilâfetnâmenë (diplomën për shejh) e mori nga shejh Selim ef. Drejta. Nga janari i vitit 1930 e deri në vitin 1948, ka qenë myderriz, udhëheqësi kryesor, në Medresenë e Madhe të Gjakovës. Vdiq në vitin 1985 në Gjakovë.

tefsirin “Rûhu ‘l-me‘ânî” të autorit Shihâbuddîn Mahmûd el-Alûsî (1802-1854).<sup>17</sup>



Faksimile e faqes së parë të dorëshkrimit

<sup>17</sup> Tefsiri i Mahmûd el-Alûsî mbanë titullin “Ar-Rûh al-Ma‘ânî fî Tafsîri ‘l-Kur‘ânî ‘l-‘Adhîm êa Sab‘u-l-Mathânî” (روح المعاني في تفسير القرآن العظيم والسبع المثاني). Kritikon rrëfimet e pasakta dhe vlerësohet si tefsiri më i mirë i “tefsir bil-re‘jî” (“tefsirit më gjykim të shëndosh - racional”). (Shih: Ahmed fon Denfer, *Historia e Kuranit*, Tiranë, 2006, f. 155.



*Faksimile e faqes së fundit të dorëshkrimit*

### 3. Veçoritë dhe rëndësia e dorëshkrimit

Janë disa arsye me të cilat e konsiderojmë këtë dorëshkrim të rëndësishëm për qëllime kërkimore shkencore:

*E para*, sikurse e kemi thënë edhe herë të tjera, ky dorëshkrim edhe një herë e përligj konstatimin se shqiptarët që nga koha kur e njohën Kur'anin dhe e pranuan atë, nuk mbetën, si të thuash, në kontakte dhe njohje pasive ose si vështrues statikë, por u bënë me plot kuptimin e fjalës “*Ehli Kurân*”, u bënë zbatues të mësimave të tij, u vunë në shërbim të tij dhe u bënë bartës dhe kultivues të tij, qoftë duke e lexuar, mësuar e studiuar, qoftë duke e kopjuar, komentuar, e më vonë



edhe duke e përkthyer atë. Me një fjalë, shqiptarët, me vetëbindje dhe me dëshirë u përfshinë në dinamikën studimeve kuranore.<sup>18</sup>

*E dyta*, autori i këtij komenti është një nga ulematë tanë të shquar nga Vushtrria, kurse vepra e tij e shkruar para vitit 1951, përveç se e rëndit atë në mesin e mufesirëve (komentuesve) shqiptarë të Kuranit, ajo e pasuron listën e dorëshkrimeve nga fusha e tefsirit, në veçanti, dhe e dorëshkrimeve arabe-islame origjinale, në përgjithësi.

*E treta*, kopjimin e këtij dorëshkrimi e ka bërë një personalitet i shquar nga Bosnja - Haxhi Fejzullah Haxhibajriqi, që tregon se Selim efendi Drejta dhe vepra e tij kanë kaluar kufijtë e vendit ku ka jetuar autori dhe ku është shkruar vepra. Ky fakt i jep vlerë dorëshkrimit.

*E katërta*, ky dorëshkrim sot mbush shtatë dekada, nëse kemi parasysh kohën kur autori nuk ka qenë ndër të gjallët, por vepra sigurisht që do të jetë shkruar më herët.

*E pesta*, ky dorëshkrim, përveçse për islamologët, tefsirologët, është shumë me rëndësi të studiohet edhe nga aspekti gjuhësor, për të njohur nivelin e përdorimit të gjuhëve orientale nga autori dhe nxënësit, përkatësisht kolegët të tij, në një kohë të vonshme të përdorimit të këtyre gjuhëve ndër ne.

### Përfundim

Në përmbyllje të këtij vështrimi mendojmë se para studiuesve që merren me Kuranin dhe trashëgiminë e tij ndër shqiptarët, dy çështje dalin si obliguese:

*E para*, duhet të bëhen hulumtime të vazhdueshme për të ndriçuar kontributin e shqiptarëve për Kuranin dhe disiplinat e tij. Puna e bërë në këtë drejtim, me gjithë përpjekjet, lë shumë për të dëshiruar. Kjo punë nuk mund të bëhet pa tubimin, hulumtimin dhe studimin e dorëshkrimeve islame-orientale që ruhen në bibliotekat tona dhe të atyre dorëshkrimeve të autorëve e kopjuesve shqiptarë, që për arsyet që tashmë dihen, ruhen

---

<sup>18</sup> Sadik Mehmeti, *Një dorëshkrim i çmuëshëm i Tefsirit të Bejdâviut në Arkivin e Kosovës*, në përmbledhjen e kumtesave nga sesioni shkencor "Kurani te shqiptarët", Prishtinë, 24-25 dhjetor 2015, f. 35-50.

nëpër biblioteka të huaja. E vetëm pasi të jetë bërë kjo, mund të njohim, deri në njëfarë mase, kontributin e shqiptarëve ndër shekuj për Kuranin. Themi deri në njëfarë mase, sepse, fatkeqësisht, një pjesë e kontributit të tyre, tashmë ka shkuar për të mos u njohur kurrë.

Obligimi *i dytë* mbetet ndriçimi i jetës dhe veprës së Selim efendi Drejtës nga Vushtrria, i cili më shumë është i njohur ndër studiuesit boshnjakë se sa ndër ata vendës, e aq më pak është i njohur kontributi i tij në fushën e komentimit të Kuranit fisnik.

*Dr. Nehat KRASNIQI - Dr. Sadik MEHMETI*

## **OVERVIEW ON THE COMMENTARY OF THE YA-SIN SURAH TAFSIR BY SELIM SAMI EF. DREJTA**

### **(Summary)**

In this paper we will analyze the *Ya-Sin Surah Tafsir*, whose author was Selim Sami ef. Drejta (1883-1951) from Vushtri. Despite the fact that the author is known to some extent, so far there have been no studies on his work, the *Ya-Sin Surah Tafsir*, which was written in Arabic and is kept in the Gazi Husrev Beg Library in Sarajevo.

Apart from its historical value this tafsir is proof that many other works by Albanian authors written in Oriental languages still lie hidden in libraries in Kosova and abroad, and await to be examined by researchers and to be made available to the masses.

د. نحات كراسنيشي - د. صادق مهمتي

### **النظرة العامة لتفسير سورة "يس" من الشيخ سليم سامي دريتا**

#### **(خلاصة البحث)**

في هذه الورقة ، تمت مراجعة العمل في المخطوطة "تفسير سورة (يس)" للمؤلف سليم سامي دريتا (١٨٨٣-١٩٥١) من فوشتري.

على الرغم من أن المؤلف معروف إلى حد ما ، إلا أن عمله باللغة العربية "Tefsîr sùretu Jâsîn"، المحفوظ في مكتبة Gazi Husrev-Begu في سرايفو ، لم تتم دراسته حتى الآن.

بالإضافة إلى قيمته التاريخية والموضوعية ، يُعد عمل "Tefsîr sùretu Jâsîn" دليلاً آخر على أنه في مختلف المكتبات في البلاد مجاورة، لا تزال أعمال المؤلفين الألبان غير معروفة. هذه المخطوطات المكتوبة باللغات الإسلامية الشرقية، في انتظار العلماء للبحث والدراسة وجعلها في متناول مجموعة واسعة من القراء.

Dr. Ajni SINANI

**RREGULLIMI I GJYQEVE TË SHERIATIT  
DHE E DREJTA E SHERIATIT  
(Roli dhe rëndësia e Bashkësisë Islame në Kosovë:  
sfidat dhe perspektiva)**

**Abstrakt**

Është fakt historik se Sheriati, në një masë më të madhe apo më të vogël, ka qenë pjesë e ligjit pozitiv në Kosovë që nga vendosja e sundimit osman, deri pas Luftës së Dytë Botërore.

Pas largimit të shtetit osman, në vitin 1912, deri në vitin 1929 zbatimi i ligjit të Sheriatit ka qenë nën juridiksionin e Myftinive, ndërsa nga viti 1929 deri 1946 për zbatimin e tij janë formuar organe të veçanta shtetërore - gjykatat e Sheriatit (gjyqet e Sheriatit).

Ndërsa sistemi aktual politik dhe shtetëror në Kosovë është në frymën e sistemit laik dhe përjashton praninë e ndonjë ligji fetar, qoftë në martesë, qoftë në trashëgimi apo në marrëdhëniet familjare.

*Fjalët çelës: Sheriati, Gjyqet, Islami, tradita sheriatike etj.*

## Rëndësia e Gjyqeve të Sheriatit

Ardhja e osmanëve në Ballkan shkaktoi ndryshime të thella për të gjithë popujt e Ballkanit, veçanërisht për popullin shqiptar. Kjo kryesisht ka të bëjë me kulturën islame të shqiptarëve, edhe pse kontakti i parë i shqiptarëve me Islamin datonte shumë kohë para ardhjes së osmanëve.<sup>1</sup>

Me ardhjen e shtetit osman, Islami u bë një faktor i rëndësishëm politik dhe social në rajon. Ai solli një sistem dhe administrim tërësisht të ri të shqiptarët dhe territoret e tjera në Ballkan.<sup>2</sup>

Ligji islam ka qenë i pranishëm te ne për një kohë të gjatë. Përfundimi i sundimit osman në Ballkan ka qenë një proces shumë tragjik për popullatën myslimane. Pas rënies së shtetit osman u formuan bashkësi të veçanta islame në shumë vende të Ballkanit. Bashkësia Islame në Kosovë, padrejtësisht, për arsye që dihen, ka qenë pjesë e Bashkësisë Islame në Serbi.<sup>3</sup> Populli shqiptar jashtë Shqipërisë ka jetuar në një shtet të pnatyrshëm në këtë pjesë të Evropës Lindore.

Roli dhe rëndësia e Myftinive në Kosovë, ndërmjet dy luftërave botërore, për shqiptarët dhe gjithë myslimanët e Kosovës, ishin të jashtëzakonshme. Puna dhe veprimtaria e institucionit të Myftinive, që ishin në kuadër të Mbretërisë së Serbisë dhe më vonë të Mbretërisë së Jugosllavisë, ishte e vështirë.<sup>4</sup>

Traditat islame, institucionet fisnore dhe e drejta zakonore të shqiptarët, në një periudhë të gjatë të administratës osmane, ishin shumë të pranishme dhe në disa zona qëndruan krejtësisht të paprekura për një kohë të gjatë.<sup>5</sup>

Është fakt historik se Sheriati, në një masë më të madhe apo më të vogël, ka qenë pjesë e ligjit pozitiv në Kosovë që nga vendosja e sundimit

<sup>1</sup> Duka, dr. Ferit, *Historia e Shqipërisë*, Kreu III, *Ndryshimet në strukturën fetare të popullit shqiptar, Përhapja e fesë islame* (shek. XV-XIX), Tiranë 1983.

<sup>2</sup> Novaković, Dragan, *Organizacija i položaj Islamske vjerske zajednice u Kraljevini Jugoslaviji*, vidi: <http://teme.junis.ni.ac.rs/teme3-2003/teme3-2003-04.pdf>

<sup>3</sup> Dr. Sinani, Ajni, *Muftijstva i šeriatski sudovi na Kosovu, između dva svjetska rata (1918-1941)*, disertacion i doktoratës, f. 10.

<sup>4</sup> Ibid, f. 10

<sup>5</sup> Popovci, Surja, *Građanskopravni odnosi u zakoniku Leke Dukađina*, Priština, 1968.

osman, madje deri pas Luftës së Dytë Botërore. Pra, edhe pas Luftërave Ballkanike 1912-1913 dhe deri në vitin 1946 e drejta islame kishte sanksionim shtetëror. Gjatë kësaj periudhe, e drejta islame ishte pjesë e së drejtës pozitive.<sup>6</sup>

Pas largimit të shtetit osman, në vitin 1912, deri në vitin 1929 zbatimi i ligjit të Sheriatit ka qenë nën juridiksionin e Myftinive, ndërsa nga viti 1929 deri 1946 për zbatimin e tij janë formuar organe të veçanta shtetërore - gjykatat e Sheriatit (gjyqet e Sheriatit).

Gjatë disa shekujve, Islami ishte feja zyrtare e shtetit osman, por shteti osman toleroi edhe ekzistencën e feve të tjera.<sup>7</sup> Me përfundimin e dominimit osman në trojet tona, pas vitit 1912, popullsia jonë ra në kontakt me kulturën dhe besimet evropiane. Me ndryshimin e situatave politike, që çuan në rënien graduale të pushtetit osman në Ballkan deri në rrënimin e tij të plotë, myslimanët e Ballkanit nisën organizimin e institucioneve të tyre fetare për të vazhduar jetën dhe veprimtarinë e tyre fetare islame.<sup>8</sup>

Në periudhën e viteve 1918-1946 janë bërë ndryshime në zbatimin dhe vlefshmërinë e së drejtës së sheriatit në shtetin jugosllav. Këto ndryshime janë zbatuar përmes praktikës dhe përmes myftinive, kurse më vonë përmes institucioneve të gjyqeve të sheriatit. Korniza institucionale për praktikën e të drejtës së sheriatit dhe gjyqësinë e sheriatit është siguruar me sjelljen e Ligjit për rregullimin e gjyqeve të sheriatit dhe gjykatësve të sheriatit më 21.3.1929, i cili ishte bazë për vendosjen e gjyqeve të sheriatit edhe në Kosovë, sipas modelit të gjyqeve të sheriatit, të cilat kanë ekzistuar më parë në Bosnjë-Hercegovinë. Një nga objektivat e institucioneve të arsimit islam në Ballkan ka qenë nxjerrja e gjyqtarëve të Sheriatit.<sup>9</sup>

Në këtë mënyrë, myslimanët e Kosovës midis dy luftërave botërore, me të drejtën e sheriatit, nëpërmjet gjyqeve të posaçme të sheriatit,

---

<sup>6</sup> Shih: dr. Sinani, Ajni, *Muftijstva i šeriatski sudovi na Kosovu, između dva svjetska rata (1918-1941)*, disertacion i doktorates Doktoratura, f.10

<sup>7</sup> Ibid, f.11

<sup>8</sup> Shih: Karčić, Fikret, *Istorija šerijatskog prava*, Sarajevo, 1987, str. 132.

<sup>9</sup> Mandak, Rejhan, *Zbatimi i së drejtës së sheriatit në gjyqësinë e Maqedonisë dhe të Kosovës (1913-1941)*, shih: *Historia e së drejtës së sheriatit*, Ali, Muhamed & Shaban Sulejmani, Shkup, 2016, f. 257.

i kanë zgjidhur çështjet familjare, bashkëshortore dhe ato të vakëfit. Gjykatat/gjyqet e Sheriatit kanë vepruar në Kosovë nga viti 1929 deri në vitin 1946<sup>10</sup>.

Situata socio-politike dhe situata fetare në Kosovë, pas aneksimit të padrejtë të saj nga Serbia dhe më pas nga Mbretëria Jugosllave, ishin shumë të rënda. Aneksimi nga ana e Serbisë dhe krijimi i Mbretërisë Jugosllave, pas Luftës së Dytë Botërore, shkaktoi valën e ndryshimeve në jetën social-politike, fetare, arsimore dhe kulturore të shqiptarëve në Kosovë, në kuadër të Mbretërisë.<sup>11</sup>

Edhe institucionet arsimore islame pësuan vazhdimisht ndryshime në varësi të situatave. Objekti bazë i këtyre institucioneve arsimore islamike ishte dhe vazhdon të jetë përcjellja e diturisë, e besimit dhe e moralit islam.

Më pas, me zvogëlimin e rolit të Islamit në jetën publike të vendeve të Ballkanit, edhe objektivat e shkollave fetare islame u kufizuan në nxjerrjen e predikuesve fetarë, të imamëve dhe të intelektualëve që mund të bartin mesazhin kulturor të Islamit në realitetet e reja kulturore të formuara që nga rënia e Perandorisë Osmane.

Periodha ndërmjet dy luftërave botërore, komunizmi, post-komunizmi dhe tashmë periodha e globalizmit dhe e pas ngjarjeve të shtatorit të vitit 2001 kanë ndikuar thellësisht në zhvillimet islame anekënd globit.

Të shkruhet sot për këtë aspekt është shumë e vështirë dhe kjo është një përgjegjësi dhe sfidë e madhe. Natyrisht, kjo detyrë në kultura të tjera dhe në vendet islamike nuk është aq e ngarkuar si në rrethanat tona të tanishme.

Megjithatë, mendojmë se ulemaja islame ia ka dalë që ta realizojë misionin e saj dhe interesat që variojnë ndërmjet predikimit të saj dhe kompetencave që shteti ia kishte përcaktuar me ligjet e tij.

Rëndësia e Islamit dhe e të drejtës islame ka qenë, është dhe do të jetë e madhe, jo vetëm për ne myslimanët, por për të gjithë botën.<sup>12</sup> Për shkak

<sup>10</sup> Karčić, Fikret, *Šerijatski sudovi u Jugoslaviji 1918-1941*, Sarajevo, 1986.

<sup>11</sup> Dr. Sinani, Ajni, *Muftijstva i šerijatski sudovi na Kosovu, između dva svjetska rata (1918-1941)*, disertacion i doktoratës, f.12

<sup>12</sup> Shih: Karčić, Fikret, *Šerijatski sudovi u Jugoslaviji 1918-1941*, Sarajevo, 1986.

të kësaj rëndësie të madhe, ne duhet të merremi dhe ta studiojmë objektivisht trashëgiminë tonë islame, në përputhje me përkatësinë tonë të qytetërit, të kulturës, të traditës, të identitetit dhe të interesave tona aktuale dhe të ardhshme.

Është e nevojshme të marrim në konsideratë historinë tonë nga këndvështrimi islam, duke theksuar faktet dhe duke korigjuar parregullsitë e shkaktuara nga interpretimet e historisë nga këndvështrimi i nacionalistëve dhe armiqve të Islamit.

Islami nuk është teologji, sepse, krahas besimit, Islami është një mënyrë jetese që duhet të zbatohet në praktikë dhe nuk mund të reduktohet në një fushë të tillë të ngushtë.

Shqiptarët me shumicë myslimane, që jetojnë në kontinentin evropian, ballafaqohen me shumë dilema dhe vështirësi në përpjekjen e tyre për ta ruajtur identitetin e tyre islamik. Socializmi dhe ateizimi i arsimit në periudhën e Jugosllavisë kanë formuar tek inteligjencia shqiptare ndjenjën që ta ruajnë Islamit në intimitetin e tyre, kurse për një shqiptar të deislamizuar Islami është vetëm një fenomen marginal.

Sheriati është një mënyrë dinamike dhe praktike e jetës. Ai është shpallur me qëllim që të rregullojë jetën në formën e saj praktike dhe realitetin konkret t'ia nënshtrojë vlerave të tij.<sup>13</sup>

Vetëm përmendja e konceptit të ligjit të Sheriatit në vendin tonë shkakton konotacion negativ. Kjo temë është devaluuar përmes konsumit ditor politik dhe është bërë objekt i mediave të shumta.

Bashkësia Islame ka të drejtë dhe e ka për obligim që të angazhohet dhe ta adresojë jetën e myslimanëve. Për disa, kjo është një kufizim i lirisë civile, kurse për bashkësinë islame kjo është normale. Disa konsiderojnë se feja nuk duhet të ndërhyjë në mënyrën e jetës së njerëzve, sepse kjo është çështje e tyre personale. Ndërkaq, sipas mësimave islame, Sheriati duhet të jetë i pranishëm në jetën shoqërore, sepse Islami nuk është vetëm besim, por edhe praktikë.

Publiku shqiptar në Kosovë ka njohuri vetëm sipërfaqësore rreth Sheriatit. Për shkak të fushatave mediale, Sheriati është bërë një lloj tabuje e

---

<sup>13</sup> Shih: El Kardavi, Jusuf, *Islamsko pravo*, Sarajevo, 1989.



pashprehur, ashtu që sot të gjithë “njohuritë” për Sheriatin shtrihen dhe përkufizohen në dispozitat e tij për poligaminë dhe disa ndëshkime dhe sanksione të tij, si për shembull prerja e duarve për vjedhje, gurëzimi deri në vdekje për njerëzit e martuar që kryejnë prostitucion etj.

Shumë herë Sheriatit i jepet kuptim i ngushtë, prandaj ky term është përdorur për ato dispozita që rregullojnë marrëdhëniet në komunitetin islamik dhe që ngërthejnë aktet dhe veprimet e njerëzve, por jo edhe anën e tyre shpirtërore dhe të besuarit. Për këtë arsye, e drejta islame në Kosovë është fokus i një sulmi të përgjithshëm.<sup>14</sup>

Sheriati, krahas të drejtës romake dhe anglo-saksone, është e drejta më e njohur në botë.

Në qasjen teorike në këtë temë mund të konstatohet se, nga ardhja e Islamit në vendin tonë, ka pasur ndryshime në kontekst të shtetit ligjor, kulturor dhe civilizues.

Është mjaft e dukshme se ka një inferioritet të caktuar të popullit shqiptar (sidomos të pjesës myslimane) ndaj besimit të tyre, traditës, kulturës dhe identitetit.

Kurse ekzistenca biologjike dhe identiteti janë aq të lidhura, saqë në fakt, nuk mund të ekzistojnë pa njëra-tjetrën! Një popull i vogël mund të mbijetojë vetëm në qoftë se e mban fenë dhe kulturën e vet.

Kurani, në ata kapituj që flasin për “njerëzit e vjetër”, të cilët janë zhdukur (të ashtuquajtur *umemul-gabire*, kombe të mbuluara nga pluhuri), i bën jehonë mesazhit se si mushrikët (paganët), popujt, të cilët kanë mohuar dhe përgënjeshtuar Librin (Tevratin, Ungjillin dhe Kuranin), kanë dështuar, pa marrë parasysh se sa shumë ishin, apo se sa e madhe ishte fuqia e tyre ushtarake etj. Ndërkaq, popujt monoteistë (hebrenjtë, krishterët dhe myslimanët), edhe në qoftë se janë me numër të vogël, mbijetojnë dhe mbeten, për sa kohë iu qëndrojnë besnikë librave të tyre të shenjtë. Kurani thotë: **“Allahu kurrsesi nuk ju mundëson jobesimtarëve mbizotërim të plotë mbi besimtarët.”** (*En-Nisa: 141*).

**“...Obligim i Yni ishte që të ndihmojmë besimtarët.”** (*Er-Rum: 47*).

<sup>14</sup> Shih: El Kardavi, Jusuf, *Šerijat i život*, Zenica, 2003.

Rregullat e Sheriatit, gjatë disa shekujve, e kanë formësuar kulturën dhe civilizimin e shqiptarëve. Ato madje janë bërë trashëgimi e përbashkët e gjithë popullit. Edhe sot gjejmë dispozita në jetën e shqiptarëve të vendosura sipas Sheriatit, i cili kishte një ndikim të rëndësishëm në jetën e myslimanëve shqiptarë. Kjo është një fushë shumë interesante.<sup>15</sup>

Duke u marrë me çështjen e Sheriatit dhe ndikimin e tij, ne myslimanët duhet të marrin në konsideratë traditën tonë, që të gjejmë zgjidhje që do të mundësojnë ruajtjen e identitetit tonë fetar.

Sqarimi i rregullave islame për kërkesat e myslimanëve është një temë e rëndësishme, por edhe e ndjeshme, sepse si rezultat i interpretimit të gabuar dhe jo të saktë, shtrembërohet e vërteta e Sheriatit.

Ka disa parakushte për atë që dëshiron të merret me shpjegimin dhe interpretimin e Sheriatit, sepse jo të gjithë mund të merren me këtë degë themelore të studimeve islame.

Bota islame sot po kalon nëpër një fazë shumë të vështirë, sidomos pas zhvillimeve të fundit. Për fat të keq, shumë myslimanë e ndërtojnë vështrimin e tyre ndaj fesë së tyre në bazë të informacionit që ua servojnë mediat e huaja.

Në të vërtetë, Islami ofron një rrugëdalje nga çdo situatë dhe siguron përgjigje për pyetjet para të cilave shkenca moderne mbetet e pafuqishme.<sup>16</sup> Arsyeja për dobësinë aktuale të myslimanëve qëndron në largimin e tyre nga Islami dhe në injorancën e tyre për parimet që janë shpëtim i njerëzimit.

---

<sup>15</sup> Shih: Dr. Sinani, Ajni, *Muftijstva i šeriatski sudovi na Kosovu, između dva svjetska rata (1918-1941)*, disertacion i doktoratës.

<sup>16</sup> Shih: El Katan, Menna Halil, *Vuxhub tahkim esh-sheriatil islamijeh*, Kajro, (pa vit botimi).

## Institucionet fetare

Ekzistenca e institucioneve të rëndësishme fetare tregon se edhe myslimanët shqiptarë trashëgojnë dhe gëzojnë traditën e Islamit institucional dhe organizimin e jetës fetare pas largimit të shtetit osman. Ne duhet të merremi shumë seriozisht me këtë çështje dhe arsyet për këtë zgjedhje janë të shumta.

Ligji i Sheriatit është aplikuar dhe mund të zbatohet edhe sot për shkak se ai është aktual për të gjithë kohën.<sup>17</sup> Megjithatë, gjerësia e ligjit islamik nuk është hulumtuar sa duhet. Ne besojmë se studimi i tij në këtë situatë të vështirë është shumë i rëndësishëm, sepse është shkruar shumë pak në lidhje me të.

Ndikimi i të drejtës së Sheriatit vazhdon të ndihet edhe sot e kësaj dite në disa aspekte të jetës së shoqërisë shqiptare. Disa nga këto dispozita kanë ndikim në ngjarjet e përditshme dhe praktike të jetës.

Ne, gjithashtu, duhet të trajtojmë seriozisht edhe sfidat që parashtrojnë rrethanat aktuale rajonale dhe globale për përmirësimin dhe vazhdimësinë e arsimit islam në rajon, me qëllimin e avancimit kulturor, edukativ dhe intelektual të bashkësive islame në vendet tona, duke respektuar kontekstin evropian, të cilit i përkasim dhe për të ofruar një shpjegim dhe interpretim si myslimanë në këtë pjesë të Evropës.

Islami ka ndikuar në masë të madhe jo vetëm në jetën private dhe shoqërore të myslimanëve, por ai ka pasur një ndikim të madh në zakonet e popullsisë jomyslimane shqiptare.

Ligji i Sheriatit, në segmente të caktuara, ka qenë rregullatori i vërtetë i qëndrimeve të ndryshme në mesin e shqiptarëve, madje edhe në rastet kur nuk është kërkuar që të ndërhyjë gjykata.<sup>18</sup>

Në zbatimin e të drejtës islame merren në konsideratë specifikat e vendit dhe të rrethanave që ndikojnë në kuptimin e normave të caktuara në situata të ndryshme sociale. Në bazë të rregullave ligjore-sheriatike, disa fetva ndryshojnë me ndryshimin e kohës, të vendit dhe të rrethanave.

<sup>17</sup> Shih: El Katan, Menna Halil, *Vuxhub tahkim esh-sheriatil islamijeh*, Kajro, (pa vit botimi).

<sup>18</sup> Shih: Karčić, Fikret, *Šerijatski sudovi u Jugoslaviji 1918–1941*, Sarajevo, 1986.

Duke pranuar parimin e ndarjes së bashkësive fetare nga shteti (1946), nga ai moment, te ne mësimi fetar në shkollat publike është ndaluar.

Pas kësaj ka qenë e mundur të flitej vetëm për një prani të caktuar të normave të Sheriatit në jetën private dhe sjelljet e myslimanëve. Disa ligje të Sheriatit kanë vazhduar të praktikohen si norma dhe zakone fetare të pasuesve të Islamit (sikurse ishin rregullimi i martesës, mehri, formimi i vakëfeve etj.).

Në kohën e shtetit socialist është vlerësuar se, me kalimin e kohës, myslimanët do të largoheshin nga besimi. Por tani perspektiva duket krejt ndryshe nga ajo çfarë e kishin imagjinuar më parë parashikuesit socialistë. Islami tashmë është në fokus dhe ai ka fituar rishtas intensitet të interesimit, si reflektim i ndryshimit të përgjithshëm shoqëror.

Autoritetet e Bashkësisë Islame, në kushtet e shoqërisë laike, në bazë të akteve të Bashkësisë Islame janë të lidhur në punën e tyre me rregullat e Sheriatit.

Rregullat e ibadetit (adhurimeve), që hyjnë në korpusin e ligjit të Sheriatit janë të detyrueshme për pasuesit e Islamit në vendin tonë, jo si të sanksionuara me ligj, por si një normë fetare.

Për shkak të rrethanave të vështira të luftës, si dhe të trazirave sociale e politike, myslimanët shqiptarë kanë shumë vështirësi në arsimin fetar në historinë e tyre moderne. Ashtu sikurse jeta e tyre politike dhe kulturore në përgjithësi, edhe edukimi i tyre fetar e institucional ballafaqohen me shumë pengesa dhe sfida.

Me shpjegimin e fesë merren edhe individë, në mënyrë josistematike, individuale, private dhe sporadike. Kërkesa për aktualitetin e mendimit islam është pamundësim i interpretimeve ekstreme, anarkiste dhe anakronike. Kjo arrihet vetëm duke forcuar më tej interpretimet institucionale të dispozitave dhe mësimëve islame.

Rregullat e përgjithshme të së drejtës islame janë jetike për t'i ndihmuar myslimanët që të marrin pjesë në shoqërinë e tyre, ndërsa, në të njëjtën kohë, të mosshkëputen nga besimi dhe tradita e tyre.<sup>19</sup>

---

<sup>19</sup> Shih: Huršid, Ahmed, *Porodični život u islamu*, Sarajevo, 1987.

Duhet të kihen parasysh modalitetet për studimin e fikhut, me kushtet, fazat dhe prioritetet e tij, në përputhje me mjedisin dhe interesin e shoqërisë.

Fikhu ofron zgjidhje alternative për situata të caktuara, ndaj myslimanët, në varësi të rrethanave në të cilat jetojnë në një vend, duhet të zgjedhin shpjegimin që më së miri korrespondon me frymën e mësimëve islame dhe interesat specifike të bashkësisë islame.

Aktualiteti ynë na detyron që të japin përgjigje të qarta, sipas modaliteteve që janë të përshtatshme për vendin tonë.

E drejta islame nuk është e mbyllur dhe e dhënë në formë të prerë për të gjithë, pavarësisht zhvillimit të shoqërive dhe dinamikës së tyre. Përkundrazi, kjo e drejtë, edhe pse gjithnjë besnike ndaj parimeve të saj, karakterizohet nga nevoja e vazhdueshme që të marrë pjesë me kontekstin e saj, me qëllim që të mundësojë zgjidhje të kënaqshme.

E ardhmja do të varet nga interpretimi i së drejtës së Sheriatit dhe niveli i të kuptuarit të saj. Ulemaja islame duhet të marrë përgjegjësinë e vet në mënyrë që të kapërcehet gjendja e dyshimit dhe refuzimit. Institucionet islame duhet të shpjegojnë të drejtën islamike dhe të japin fetva konstruktive, larg nga pretendimet që prezantojnë disa medie.

Marrëdhëniet njerëzore, në çështje të ndryshme, kushtëzojnë angazhimin e juristëve myslimanë për të siguruar përgjigje të përshtatshme. Normat ligjore kuranore-sunetike janë të përgjithësuara dhe nuk janë të konkretizuara, prandaj është e nevojshme që të angazhohen juristët për t'i shpjeguar ato, për t'i përcaktuar dhe për të lehtësuar zbatimin e tyre praktik.<sup>20</sup> E gjithë kjo ka ndikuar që të ofrohen zgjidhje të ndryshme për raste të veçanta.

Sipas mendimit tonë, duhet të ndiqet kjo metodologji në mënyrë që të lidhet kuadri teorik i jurisprudencës që kemi paraqitur me zbatimin praktik.

Përgjegjësia e myslimanëve është që të përpiqen të jetojnë sipas parimeve të sheriatit, sepse ligji i sheriatit mund të zgjidhë problemet e myslimanëve në çdo kohë. Sheriati i ka të gjitha institucionet, rregullat dhe

<sup>20</sup> Karčić, Fikret, *Studije o šerijatskom pravu i institucijama*, El Kalem, Sarajevo, 1432/2011. god, str. 117.

normat për të gjitha nevojat e reja që dalin nga tendencat e reja shoqërore që na rrethojnë.

Sistemi aktual politik dhe shtetëror në Kosovë është në frymën e sistemit laik dhe përjashton praninë e ndonjë ligji fetar, qoftë në martesë, qoftë në trashëgimi apo në marrëdhëniet familjare.

Bashkësia islame ka provuar të jetë shumë e përgjegjshme ndaj detyrave dhe misionit të saj. Institucioni i Bashkësisë Islame, myftinjët, juristët dhe ulemaja islame kanë operuar në kushte shumë të vështira, por megjithatë ia kanë dalë të jenë në mbrojtjen e të drejtave të subjekteve të tyre. Institucionet arsimore islame në Kosovë (Medreseja dhe Fakulteti i Studimeve Islame) kanë punuar që rinia myslimane të trashëgojë medh'hebin dhe kulturën fetare, etikën dhe traditën.

*Dr. Ajni SINANI*

## **THE REGULATION OF SHARIA COURTS IN KOSOVA**

### **(Summary)**

It is a well-known historical fact that the Sharia was part of the positive laws in Kosova since the establishment of Ottoman rule in Kosova until the end of WWII. After the collapse of the Ottoman state in the Balkans, in 1912, the implementation of the Sharia Law until 1929 was in the jurisdiction of the muftis. Between 1929 and 1946, Sharia Courts were established for the implementation of the Sharia Law.

The current political and state system in Kosova is in the spirit of secularism and it excludes the use of religious laws, be it in cases having to do with marriage, heritage or family relations.

د. عيني سيناني

## **تنظيم المحاكم الشرعية في كوسوفا**

### **(خلاصة البحث)**

إنها حقيقة تاريخية أن الشريعة ، إلى حد كبير أو أقل ، كانت جزءًا من القانون الإيجابي في كوسوفا منذ إنشاء الحكم العثماني حتى بعد الحرب العالمية الثانية. بعد انسحاب الدولة العثمانية ، في عام ١٩١٢ من اراضى البلقانية ، حتى عام ١٩٢٩ ، كان تنفيذ الشريعة يخضع للاختصاص القضائي للمفتين ، في حين تم تشكيل هيئات حكومية خاصة في الفترة من ١٩٢٩ إلى ١٩٤٦ - المحاكم الشرعية (المحاكم الشرعية). اما عن النظام السياسي الحالي في كوسوفا هو النظام العلماني الذي يمنع وجود أي قانون ديني سواء في احكام الزواج أو الميراث أو العلاقات الأسرية.

Mr. Driton ARIFI

## **FETVATË LAJTHITËSE NË OPTIKËN E KRITEREVE JURIDIKE ISLAME**

### **Abstrakt**

Çdo gjë, për të cilën shoqëria ka nevojë, llogaritet prej misioneve më madhore në konceptin e kulluar islam. I tillë konsiderohet edhe misioni i marrjes me nxjerrje së fetvave-opinioneve juridike islame nga ana e elitës së dijetarëve myslimanë. Ky është një mision shumë fisnik dhe me peshë, por fatkeqësisht, përgjatë shekujve, pati edhe “dijetarë” të pandërgjegjshëm, të cilët nga lakmia, që të jenë referenca të kohës për çështjet juridike islame, shpeshherë me qëndrimet dhe fetvatë e tyre e vunë në lajthitje një pjesë të shoqërisë islame. Ky veprim i tyre i ka hutuar një pjesë të popullatës islame duke ngjallur tek ata dilema dhe dyshime për çështje të caktuara.

Ky punim, mëton të hedhë dritë mbi shkaqet dhe arsyet pse disa pseudodijetarë, nëpër kohë të ndryshme të Islamit, nuk nguruan ta çorientojnë dhe ta vënë në lajthitje popullatën islame me fetvatë e tyre të paqëndrueshme.

**Fjalët kyçe:** *fetva, lajthitje, ixhtihad, Usuli Fikh, Fikh*



### Çfarë janë fetvatë lajthitëse!?

Në përpjekje për të qenë më të qartë se çfarë synojmë në aspektin semantik me nocionin “**fetva lajthitëse apo të lajthitura**”, fillimisht do të japim një sqarim të thukët të këtij nocioni.

Për të qenë sa më objektiv, duhet theksuar faktin se shprehja “lajthitje”, në aspektin gjuhësor më tepër ka kuptimin e ndonjë gabimi apo lëshimi që është bërë pa qëllim e pavetëdije. Pikërisht për këtë arsye ne po i cilësojmë këto fetva me këtë emërtim, duke ruajtur mendim të mirë për të gjithë ata që shfaqen ose dalin në opinion me mendime lajthitëse, e të cilat ndonjëherë japin indikacione se mund të jenë edhe tendencioze.

Në literaturën e *Usuli Fikhut* te dijetarët e kësaj shkence, e madje edhe te juristët në literaturën e *Fikhut*, gjejmë se ata kanë përdorur shprehjen “**فَتَاوَى شَادَّةٌ** – *fetava shadh-dhe*”, për të emërtuar këto lloj fetvashë të cilat i kemi për objekt studimi në këtë trajtesë.

Në kontekst të sqarimit më domethënies të shprehjes “*shadh-dh ose shudhudh*” - **شَادَّةٌ - شُدُوْدٌ** tek fetvatë, gjejmë se Imam Gazali thoshte: “*Kjo shprehje ka kuptimin e daljes së ndonjërit me një mendim jashtë unanimitetit-ixhmailt të dijetarëve islamë, pasi që i njëjti dijetar më herët ka qenë brenda atij unanimiteti dhe nuk e ka thyer atë*”<sup>1</sup>.

Edhe më interesant është përshkrimi i Ibn Hazmit, i cili e determinon nocionin “*shadh-dh ose shudhudh* - **شَادَّةٌ - شُدُوْدٌ**” si shmangie ose kundërshtim i së vërtetës apo të saktës, pavarësisht se a kundërshtohet ajo e vërtetë nga një njeri, dy, nga një pakicë apo një shumicë dërrmuese”<sup>2</sup>. Pra, kriter për t’u llogaritur se si një mendim i caktuar qenka i lajthitur, sipas Ibn Hazmit, është vetëm mospërputhja e tij më të vërtetën apo me të saktën dhe jo se kush është ai që e ka bërë diferencën në mendim, apo se sa të shumtë janë ata që ai person i paska kundërshtuar. E, meqë e vërteta dhe e sakta shpesh shfaqen si dilematike në hulumtimet e dijetarëve islamë, atëherë mund të themi se ky kriter, i vendosur nga Ibn Hazmi, në fakt, i hap rrugën vetë atij që të sjellë mendime nga më të çuditshmet e

<sup>1</sup> El Gazali, *El Mustesfa* (1/147). Bot. I parë, 1993. Daru El Kutub El Ilmijje. Bejrut.

<sup>2</sup> Ibn Hazm El Endelusij, *El Ihkam Fi Usul el Ahkam* (5/86). Bot. I parë. Daru-l Afak el Xhedeidh. Bejrut. Pa vit botimi.

më të padëgjuarat, të cilat shpeshherë janë gjykuar nga dijetarët e tjerë si tejet të lajthitura, për shkak të pikëpamjeve të tij literaliste ndaj teksteve tradicionale apo burimeve shariatike islame.

Në një analogji më të thellë të kësaj shprehjeje, që përdoret në shkencën e *Usulit* ose *Fikhut*, vërejmë se e njëjta është përdorur edhe në shkencat kuranore dhe si e tillë del të jetë pothuajse ekuivalente edhe në domethënie. Në shkencat kuranore e hasim shprehjen “*Kiraetun Shadh-dheh* – الْقِرَاءَةُ الشَّاذَّةُ - Kiraet i vetmuar - që ka për qëllim atë version specifik të leximit të disa ajeteve të Kuranit që bien ndesh me ato shtatë apo dhjetë kiraetet-dialektet e njohura të Kuranit Fisnik.

Madje, e njëjta shprehje është përdorur edhe në shkencat e hadithit, për të emërtuar një kategori të caktuar të transmetimeve ose haditheve, si “*Ehadithu shadh-dheh* - أَحَادِيثُ أَوْ رَوَايَاتُ شَاذَّةٌ - hadithe ose transmetime të vetmuara”, me të cilat nënkuptohen ato transmetime të haditheve që bien ndesh me transmetimet e transmetuesve të tjerë, të cilët janë shumë më të përpiktë në transmetime, por edhe më të besueshëm në fe.

Ky trajtim analitik ka synim që të hedhë pak dritë rreth fenomenit të fetvave të lajthitura e të çuditshme, si dhe të kristalizojë arsyet dhe shkaqet e nxjerrjes së tyre.

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. tërhoqi vërejtjen dhe paralajmëroi një simptomë të kësaj sëmundjeje serioze në vetëdijen e ymetit islam. Ai, në hadithin e transmetuar nga Abdullah ibn Amër ibn Asi, tha: “*Vërtet Allahu nuk e shkul prej ymetit islam diturinë* (siç shkulet druri me rrënjë nga dheu, sh.p.), *por ai e zhduk (largon) diturinë me vdekjen e dijetarëve, saqë kur nuk mbetet asnjë dijetar (gjallë), njerëzit marrin për prijes të tyre injorantët. Njerëzit do t’i pyesin ata, ndërsa ata (inJORANTËT) do të japin përgjigje pa dituri, kështu që ata e humbin vetveten, por edhe i devijojnë të tjerët*”<sup>3</sup>. Nga ky hadith sinjalizohet se fenomeni i dhënies së fetvave nga persona joadekuatë është i paralajmëruar (natyrisht në kontekst negativ) si diçka që do të ndodhë. Edhe më i keq se kjo është paralajmërimi se në shoqëritë myslimane, njerëz të tillë, fatkeqësisht, do të marrin referenca kredibile, aq sa prej tyre do të pranohet marrja e fetvave.

<sup>3</sup> *Muttefakun Alejhi*. (Buhariu evidenton hadithin, me numër: 100), ndërsa (Muslimi, me numër: 6873).

Rezultati i pashmangshëm i theksuar edhe në fund të hadithit është se “*ata e humbin vetveten, por edhe i devijojnë të tjerët*”.

### **Dhënia e fetvave mision i dëlirë, por kërkohet kujdes maksimal në të**

Pa dyshim, angazhimi individual i dijetarëve dhe hulumtimet e tyre të thelluara në shkencat islame kishin si pikënisje aspiratën e tyre të natyrshe që të arrijnë pozita të larta tek Allahu në këtë dhe në botën tjetër. Citate të kësaj natyre që provokuan aspiratat e dijetarëve islamë ka shumë në burimet bazike islame. Mirëpo, në anën tjetër, nëse ky mision nuk merret seriozisht dhe nëse nuk krijohet ndjeshmëria e lartë e përgjegjësisë për peshën që ka dhënia e fetvave, kjo dukuri ka tendencë që t’i kthehet si bumerang vetë dhënësit të fetvave lajthitëse, sepse ai, përveçse vetë do t’i bartë pasojat e vënies në lajthitje, do të ngarkohet edhe me përgjegjësinë shtesë para Zotit, për të gjithë ata njerëz që janë vënë në lajthitje, duke marrë si referenca mendimet dhe fetvatë e tij.

Është mjaft domethënës fakti se, pos librave të shkruar enkas rreth fetvasë dhe dimensioneve të saja juridike e fetare, pothuajse nuk gjejmë asnjë libër të *Usuli Fikhut*-Bazave të Jurisprudencës Islame, që të mos e ketë trajtuar tematikën e fetvasë deri në detajet më të imëta të saj. Për më tepër, kjo tematikë rëndom është vendosur në fund të të gjithë kapitujve të literaturës së *Usulit*, si për të na dhënë një indikacion se ulja në “kolltuk” për dhënie të fetvave, mund të bëhet vetëm pasi të jenë shoshitur e kuptuar mirë e mirë të gjithë kapitujt paraprakë.

Parimisht, ai që merret me nxjerrje të ndonjë fetvave, duhet të dijë dhe të jetë i vetëdijshëm se nga ai kërkohet kujdes i shtuar, sepse nuk është e domosdoshme, madje as nuk do të duhej që për çdo pyetje që i shtrohet, të japë përgjigje. Dijetari i njohur El Axhurrij, përkritazi me këtë, thotë: “*Nëse dikush pyetet për një çështje të caktuar, dhe ai (dijetari) e di që një gjë e tillë, do të trazonte opinionin e përgjithshëm, duke shkaktuar përçarje në mesin e myslimanëve, atëherë ai duhet të kursehet e të mos japë fare përgjigje në të, por duhet ta orientojë pyetësin në diç tjetër, që për të*

*është më e rëndësishme. Këtë veprim duhet ta bëjë në formën më të butë të mundshme*"<sup>4</sup>.

Në fakt, guximi i tepruar dhe ngazëllimi i pamatur për dhënie të fetvave nuk ka qenë asnjëherë prej natyrës së dijetarëve të brezave të artë të myslimanëve. Ata nuk e mendonin veten si më fatlumët, me faktin se kishin arritur aftësinë për t'iu dhënë njerëzve verdikte fetare rreth atyre çështjeve të cilat i preokuponin ata. Shumë prej tyre këtë punë e bënë në shtyrë dhe të shtrënguar nga nevoja evidente që dikush të merrej me këtë detyrë, përndryshe dëshira e tyre ishte që dikush tjetër, e jo vetë ata, të merrej me të. Abdurrahman Ibn Ebi Lejla e thotë: *"I kam takuar këtu në xhami të Muhamedit s.a.v.s., 120 prej sahabëve të tij, që ishin prej dijetarëve të mëdhenj (që jepnin mësimë islame) dhe secili prej tyre dëshironte që dikush tjetër të merrej me transmetim të haditheve dhe dikush tjetër të merrej me dhënie të fetvave"*.<sup>5</sup> Këtë qëndrim në fakt ata e kishin marrë pasi që e ndienin thellë në shpirt peshën e asaj barre që nuk ishte edhe aq e lehtë për ta bartur. Edhe më i drejtpërdrejtë ishte kolosi i dijes islame, Sufjan Ibn Ujejne, kur tha: *"Ai që më së shumti ka njohuri për të dhënë fetva, ai më së paku flet -jep fetva, ndërsa ai që është më injoranti në dhënie të fetvave, ai është më i zëshmi në dhënie të tyre"*.<sup>6</sup> Këto fjalë kaq rigorozë i kanë thënë dijetarët e brezave të hershëm, me të vetmin qëllim - parandalimin dhe mbylljen e rrugëve për të gjithë ata që këtij misioni ia mësyjnë me injorancë. Ata e konsideronin se nxitimi, gara dhe lakmia për dhënie të fetvave, i privon të njëjtit nga begatia dhe kujdesi i Allahut gjatë kryerjes së kësaj detyre aq fisnike.

<sup>4</sup> El Axhurrij, *Ahlakul Ulema*, f. 53, Bot. iI parë. 2001. Darul Kalem. Damask.

<sup>5</sup> Hamud Et Tuvejxhrij, *Taglidhul melam alel muteserri'ine alel futja ve tag'jiril ahkam* (fq.10). Bot. I parë. Daru Es Sami'ij. Rrijad.

<sup>6</sup> El Bagdadij, *El Fekihu vel Mutefekkihu* (2/350). Bot. i tretë, 1426, h. Daru ibn El Xhevzi. Demmam, Arabi Saudite.

## Shkaqet e nxjerrjes së fetvave lajthitëse

Është e domosdoshme të theksohet se gjeneratat e para kanë qenë shumë të kujdesshme në nxjerrjen e fetvave. Ky veprim i tyre natyrshëm lë të kuptohet se duhet eliminuar të gjitha shkaqet që shpijnë te fetvatë e lajthitura e intriguese në mesin e myslimanëve.

Ndër shkaqet më kryesore, që mund ta nxisin një person të lajthisë e të japë fetva të çuditshme e tunduese, mund t'i përmendim edhe këto:

### 1. Padituria - injoranca

Injoranca nënkupton mosnjohjen, cektësinë dhe paqartësinë e atij që merret me dhënie të fetvave. Kjo injorancë, kryekëput, ka të bëjë me moskuptimin e mirëfilltë të burimeve të shëndosha juridike islame, ose anashkalimin e rregullave dhe principeve që janë vendosur nga dijetarët eminentë islamë për të shmangur nxjerrjen e verdikteve të gabuara, të cilat në një formë ose tjetër ia veshin Islamit një “petk” që nuk i takon. Allahu i Madhëruar e ka tërhequr vërejtjen për këtë fenomen duke thënë: *“Mos theksoni me gjuhët tuaja rrejshëm: “Kjo është e lejuar, e kjo e ndaluar”, e të trilloni gënjeshtër për Zotin. Me të vërtetë, ata që trillojnë gënjeshtër ndaj Zotit, nuk do të shpëtojnë”*. - (En Nahl), 117.

Njeriu që më së shumti është i prire të thurë gënjeshtër rreth Zotit ose fesë së Tij është injoranti, i cili s’ka njohuri as rreth bazave e as rreth dispozitave të Islamit.

Injoranca që i përshkruhet atij që merret me dhënie të fetvave, zakonisht, ka të bëjë me njërin prej dy aspekteve:

a) Kur ai nuk e ka perceptuar drejt çështjen e shtruar nga pyetësi dhe nuk ka njohuri për detajet e shumta që kanë efekt të drejtpërdrejtë në kategorinë e normës juridike islame që duhet të nxirret përkitazi me atë çështje. Këtu duhet theksuar se ekziston një praktikë e shkëlqyeshme tek akademitë juridike islame të kohës sonë bashkëkohore, nën ombrellën e të cilave veprojnë një elitë e mirëfilltë e dijetarëve myslimanë. Ata, sa herë që diskutojnë rreth një çështjeje në një fushë të caktuar, ftojnë ekspertët e asaj fushe për të marrë pjesë në seancat e tyre diskutuese e konsultative. Sa herë që problematika e shtruar ka të bëjë

me çështjet ekonomike, p.sh. në seancat e diskutimit në akademi, ftohen ekonomistë myslimanë me renome botërore. Sa herë që çështja ndërlidhet me ndonjë aspekt mjekësor, ata ftojnë ndonjë specialist të asaj fushe mjekësore, e kështu me radhë. Kjo mënyrë e funksionimit të këtyre akademive ka për qëllim që çështjet e shtruar të konceptohen drejt, para se të hulumtohet argumentimi i normës dhe trajtimi juridik i saj. Çështjet duhet të sqarohen mirëfilli nga njerëzit që i njohin ato në thelb me të gjitha detajet e tyre të hollësishme. E gjithë kjo është në funksion të aplikimit rigoroz të një rregulli të mirënjohur në shkencën e *Usuli Fikhut*, që njihet si: **“Gjykimi mbi ndonjë çështje, buron nga perceptimi i mirëfilltë i saj”**. Një gjë e tillë sigurisht se është e porositur edhe nga ajeti kuranor, ku Allahu i Lartmadhërishëm na thotë: **”... Ju, pyetni pra dijetarët, nëse ju nuk dini”** - (*En Nahl*, 43), dhe

- b) Kur studiuesi i Islamit nuk ka njohuri të mjaftueshme për burimet shariatike - argumentet dhe formën e nxjerrjes së normës prej tyre. Thënë shkurt, kur ai nuk i ka plotësuar kushtet apo kriteret, pas plotësimit të të cilave do të llogaritej autoritet kredibil, për nxjerrje të fetvave. Në literaturën e Bazave të Jurisprudencës, këto kushte i gjejmë të detajuar në kapitulli i kushteve të ixhtihadit-përpyjekjes. Këtu duhet theksuar se hulumtuesi ose personi që merret me nxjerrje të fetvave nuk obligohet, sipas mendimit më të saktë të usulistëve (siç është imam Ebu Hamid El Gazali e të tjerë), që t'i dijë apo t'i ketë të memorizuara të gjitha ajetet që flasin për norma juridike, apo t'i dijë përmendsh të gjitha hadithet e kësaj natyre, (ndonëse tek dijetarët e brezave të hershëm kjo as që diskutohej). E tërë ajo që kërkohet nga fetvadhënësi është që ai të jetë i ndërgjegjshëm se duhet të ketë aftësi apo afinitet që t'i gjejë argumentet adekuate (qoftë në Kuran, koleksione të haditheve apo burime të tjera shariatike) të një tematike të caktuar, sa herë që ajo shtrohet për diskutim para atij hulumtuesi.<sup>7</sup>

<sup>7</sup> Shih: Dr. Abdul Kerim en Nemletu, *El Xhami'u li Ahkami-l Usul ve tatbikatuha ale-l mdh'heb er-Rraxhih* (1/399). Bot. i parë. 2000. Mektebetu-r-Rrushd. Rijad.

Nëse ndonjëri prej këtyre dy komponentëve do t'i mungonte hulumtuesit, ai në këtë rast do të llogaritej si jokompetent për nxjerrje të normave sheriatike islame.

E nëse dikush flet pa kompetencë duke nxjerrë fetva nga hamendja e tij, ai, pos tjerash, tregon se ka përtaci për t'iu referuar literaturës islame, si dhe për të hulumtuar nëse e njëjta çështje është shtjelluar nga dikush që mund të ketë qenë më i ditur dhe më i devotshëm se ai. Ibn Abidin, njëri prej juristëve më të spikatur, të vonshëm të shkollës juridike hanefite, thotë: *“Rëndom kur dikush nuk gjen tekst adekuat për të dhënë ndonjë përgjigje të saktë, ajo vjen si rezultat i leximit të paktë të tij, ose për shkak se ai nuk e di fare as vendndodhjen e asaj çështjeje në literaturën islame. Ndodh kështu, ngase shumë të pakta janë dilemat apo çështjet për të cilat nuk do të gjejmë shtjellim të mjaftueshëm brenda literaturës së shkollës sonë juridike hanefite, qoftë si e theksuar në mënyrë specifike, qoftë si e theksuar brenda ndonjë rregulli përmbledhës, në kuadër të të cilit mund të jetë trajtuar edhe çështja konkrete e shtruar nga pyetësi”*<sup>8</sup>. Nga ky konstatim i juristit të mirënjohur hanefit, Ibn Abidinit, del se kategoria më e madhe e fetvave të lajthitura vijnë nga ata që kanë informacione të pakta dhe që kanë qasje tejet të cekët në literaturën e jurisprudencës islame. Të tillët, në shumicën e rrethanave, nuk dinë e as nuk konsultohen me askënd, madje as që kanë gatishmëri për t'u ndalur e për të analizuar pasojat e një fetvaje, të cilën ata e kanë nxjerrë, pa u menduar dy herë në lidhje me të. Është e habitshme, e madje edhe ironike, se si për shumë çështje që kërkojnë ndoshta edhe hulumtime kolektive dhe tejet të thella të juristëve bashkëkohorë, gjejmë të tillë që e japin opinionin e tyre individual me një nxitim të pashpjegueshëm. E thoshte bukur njëri prej dijetarëve të brezave të hershëm, Ebil Husejn el Esdijj, në kontekst të qortimit të atyre që nxisojnë për të dhënë fetva të pamatura: *“Ndodh që dikush të pyetet ndonjëherë për ndonjë çështje, por që e njëjta nëse do t'i shtrohej halifit Umer r.a., ai sigurisht se do t'i mblidhte të gjithë pjesëmarrësit e betejës së Bedrit-elitën e sahabëve (për të nxjerrë një fetva të*

<sup>8</sup> Muhammed Tekijj el Uthmanij, *Usulul Ifta ve adabuhu*. (f. 356). Bot. i parë. 2014. Daruu-l Kalem. Damask.

qëlluar)”. Nga këtu vihet në pah një element, se brezat e parë, sa herë që kishin para vetes ndonjë çështje të ndërlikuar, nëse gjenin dikë tjetër që të jepte përgjigje për të, ia referonin atij. E nëse nuk gjenin, atëherë tubonin rreth vetes kokat e dijes e të shkencave islame dhe konsultoheshin me ta, e pastaj nxirrnin një konstatim-fetva të përbashkët, e cila në çdo situatë do të ishte më e shëndoshë dhe më kredibile sesa të nxirrej në mënyrë individuale.

Kemi edhe raste kur dikush jep fetva të lajthitura dhe ai nuk e bën këtë për shkak se nuk ka dije të bollshme fetare në ndonjë fushë të caktuar, por për shkak se i ka dhënë vetvetes të drejtë që të flasë pa kompetencë në një fushë tjetër, në të cilën nuk ka njohuri të thella. Rrëfëhet se si dijetari i mirënjohur i hadithit - *Sulejman ibn Mehran* (i njohur me nofken - *El Aë'mesh*), i kishte kërkuar Imam Ebu Hanifes që t'ia përshkruante në një shkresë ritualet e haxhit<sup>9</sup>. Sigurisht që *El Aë'meshi* ishte kolos i dijes në hadith dhe i dinte hadithet që flasin për haxhin, por Imam Ebu Hanifen e konsideronte si njohës të detajeve të dispozitave të kësaj shtyllë të Islamit dhe njëherësh dëshironte që ta kursente veten nga ndonjë gabim apo mendim i ngatërruar rreth këtij obligimi me të cilin detyrohe mi vetëm një herë në jetë. Po ashtu, kolosi i madh i hadithit, Ibn Haxher el Askelani, duke dhënë instruksione prej një njohësi të thellë, ai në formë mjeshtërore theksonte se “*Kur njeriu flet jashtë fushës së tij, do të japë mendime të çuditshme*”<sup>11</sup>.

## 2. Dëshira për ekspozim dhe vetëpëlqimi

“I mjafton njeriut nga dituria, që të ketë frikë Allahun, ndërsa i mjafton njeriut nga injoranca, që të sprovohet me vetëpëlqim”<sup>12</sup>, do të na thoshte dijetari i mirënjohur Mesruku. Dijetarët e mirëfilltë nuk kanë vuajtur

<sup>9</sup> Ibn Salah, *Edebul Mufti vel musteftij* (fq.76). Bot. i parë. 1986. Daru A'lemu el Kutub. Rijad.

<sup>10</sup> Ibn Xheziri, *Ed Durerul feraid el munadh-dhame fi ahbaril Haxh* (2/423). Bot. i parë. 2002. Darul Kutub El Ilmijje. Bejrut.

<sup>11</sup> Ibn Haxher El Askalani, *Fet'hul Bari - Sherh Sahihul Buh'arij*. (3/584). Bot. i parë. 1998. Darul Hadith. Kajro.

<sup>12</sup> El Axhurrij, *Ahlakul Ulema*, f. 63, Bot. i parë. 2001. Darul Kalem. Damask.



asnjëherë e as nuk janë ankuar nëse nuk iu është dhënë pozita meritore në shoqëri. Ata pozitën e lartë kanë aspiruar ta kenë arritur vetëm te Zoti i tyre, sepse tek Ai është shpërblimi madhor. Të frikësuar nga mundësia që në shpirtin e tyre të fiksohet ndjenja e vetëpëlqimit, është transmetuar se disa prej tyre që jepnin mësim në ndonjë qoshe të xhamisë së Kufës, të Basrës apo gjetiu, kur vërenin se rreth tyre janë mbledhur një numër i madh nxënësish, ose ndjekësish, ata menjëherë dilnin nga ajo xhami dhe iknin larg, për të mos u kthyer më. Këtë e bënin vetëm nga frika e vetëpëlqimit apo krijimit të ndjesisë se qenkan bërë të famshëm dhe me nam. Ky është një asketizëm i kulluar, apo modesti shkencore, që për dikë në kohën tonë, ndoshta cilësohet si veprim i çuditshëm, i panevojshëm e madje edhe i tepruar. Megjithatë, veprimet e tilla ata nuk i ndërmorën nga injoranca, por nga dituria e thellë që kishin në fe. Ata, nga frika e ekspozimit, nuk bënin as polemika të panevojshme, sepse në polemika boshe te njeriu dëshira manifestohet dëshira për mposhtjen e tjetrit dhe dominim në fushën e dijes. Transmetohet nga Hasen el Basriu të ketë thënë: "Ne nuk kemi parë asnjë fekih-jurist islam duke polemizuar"<sup>13</sup>. Ata diskutonin në mes vete për çështje të Islamit, për të cilat ishin të bindur se shoqëria e tyre kishte nevojë, por thjesht nuk polemizonin në mënyrë që të mos shkaktonin plasaritje të panevojshme e as të ngjallnin dilema në shoqëri. Neve që jemi larguar bukur shumë prej etikës së atij brezi, rrëfimet e tyre na sjellin një imazh përlulësie e modestie, të cilin nuk po e shohim dot në epokën në të cilën po jetojmë. Sot, ndoshta si kurrë më parë, edhe përkundër atyre brezave që i kishim, ka shumë njerëz që fare nuk e fshehin dëshirën e tyre të flaktë për ekspozim dhe këmbëngulin që të jenë gjithmonë në ballë të ndejës dhe kërkojnë që objektivat e kamerave të jenë të drejtuar vetëm nga ata!

Është paradoksale se si brezat e kaluar me gjithë mundësitë e kufizuara dhe mjetet e pakta të ekspozimit, kishin frikë të madhe nga humbja e sinqeritetit në veprimtarinë e tyre. Ndërsa sot, me gjithë këto mundësi të mëdha të ekspozimit e të shpërfaqjes, për çudi mungon në një masë të madhe kriteri i sinqeritetit. E kundërta do të ishte më e logjikshme, por

---

<sup>13</sup> Po aty, f. 55.

ajo fatkeqësisht s'po ndodh. Mund të duket që s'ka kurrfarë lidhshmërie ndërmjet asaj pike dhe zhvillimit të fenomenit të fetvave lajthitëse, por faktet na dëshmojnë se secili që e dëshiron ekspozimin e tepërt, rrezikon privimin nga përkujdesja hyjnore dhe rrjedhimisht fetvatë lajthitëse të tij do të jenë të shpeshta.

### **3. Konformizmi - kompleksi i të qenit apo të folurit ashtu siç dëshirojnë të tjerët**

Dijetarët e mirëfilltë në të kaluarën nuk preokupoheshin me atë se çfarë mendojnë të tjerët, veçse brengoseshin nëse janë duke e thënë të vërtetën. Ata kishin frikë Allahun dhe e dinin se duhet të flisnin vetëm për kënaqësinë e tij. Allahu i Lartmadhëruar ia ndaloi edhe të Dërguarit të tij s.a.v.s. që t'i ndiqte dëshirat dhe pasionet e njerëzve, ndalesë kjo që doemos, duhet të vlejë edhe për të tjerët. Ai në një ajet thotë: *"... Gjyko në mes tyre me atë që ka zbritur Allahu dhe mos ndiq dëshirat-qejfet e tyre, e të mos devijosh nga ajo që të ka ardhur ty nga e Vërteta. Ne për të gjithë jua kemi bërë ligj një rrugë të qartë...."* - (El Maide, 48). Edhe më i drejt-përdrejtë ishte ajeti, i cili sërish i drejtohet Muhamedit s.a.v.s. e pastaj edhe të tjerëve pas tij, ku i Lartmadhërishti thotë: *"Pastaj, Ne të vumë ty në një rrugë të drejtë të fesë, pra ti ndiqe atë e mos ndiq dëshirat e atyre që nuk dinë. Ata nuk mund të mbrojnë ty për asgjë tek Allahu..."* - (El Xhathije, 18-19).

Këto ajete do të duhej të ishin moto dhe si të tilla ai që merret me nxjerrje të fetvave gjithnjë t'i ketë parasysh. Pasimi i dëshirave të njerëzve bën që feja e përkryer e Zotit, të ngjyroset me ngjyime njerëzore dhe si e tillë rrezikon ta zbehë tiparin e vet hyjnor. Ai që merret me nxjerrje të fetvave duhet të ketë shumë kujdes në këtë segment, sepse dhënia e një përgjigjeje sipas dëshirës së rrethit, shoqërisë, udhëheqësve, apo kujtdo tjetër, ndoshta mund t'i sigurojë atij një prestigj apo pozitë në këtë botë të përkohshme, por i tilli te Zoti ka humbur shumë, sepse tek Ai është kthimi i të gjithëve.

#### 4. Mosnjohja e së drejtës zakonore - “Urfit” të vendit ku vepron dijetari

Po e vëmë theksin mbi këtë shkak për të qenë në linjë dhe të ekuilibruar me atë që u tha në pikën paraprake, sepse mund të krijohet përshtypja e gabuar se ai që nxjerr fetva nuk duhet që patjetër të interesohet për realitetin, kohën dhe rrethanat ku ai jeton. Kjo është e pamundur, sepse nuk mund të dalin fetva të shëndosha nga ai që injoron realitetin dhe rrethanat ku jeton. Imam Shafi'u (Zoti e pastë mëshiruar) në shumë çështje me kalimin e kohës ndryshoi qëndrimin dhe fetvatë. Ai kësisoj formoi shkollën juridike të vjetër (sa ishte në Mekë e Irak), e më vonë themeloi edhe shkollën e tij të re juridike, kur shkoi në Egjipt. Nxënësit e tij dhe ata që e ndoqën me kujdes ndryshimin në qëndrime të Imam Shafiut, thanë se tek ai në Egjipt nuk kishte ndodhur ndonjë shtim i dijes apo i njohurive, por thjesht kishte ndodhur ndërrimi i vendit dhe i ambientit. Nisur nga kjo, gjejmë se një rregull juridike islame është pothuajse unanimitisht e pranuar nga të gjithë dijetarët se **“fetvaja ndryshon me ndryshimin e vendit dhe të kohës”**, ose për të respektuar mendimin e dijetarëve të mëhershëm, ky rregull përpilohej kështu: **“Nuk mohohet ndryshimi i dispozitave me ndryshimin e kohëve”**<sup>14</sup>. Të tilla fetva që kanë ndryshuar me ndryshim të vendit e të kohës ka mjaft, Ato janë shtjelluar dhe gjenden të shpërndara gjithandej në literaturën e fikhut islam, por askush nga dijetarët nuk u qortua për këtë, ngase si kriter të ndryshimit të fetvave, ata asnjëherë nuk e patën ndjekjen e tekeve apo dëshirave të shoqërive ku jetuan, por vepruan në bazë të një realiteti faktik, të pamohueshëm. Për më tepër, një prej burimeve të dispozitave juridike islame është edhe *urfi* - e drejta zakonore e një vendi, njohja e së cilës konsiderohet prej kushteve esenciale për çdo muxhtehid, në mënyrë që fetvatë e tij të mos jenë lajthitëse.

Këto shkaqe që i përmendëm janë ato që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në nxjerrjen e fetvave lajthitëse, të cilat në çdo kohë kanë pasur dhe do të kenë ndikim në trazimin e opinionit publik islam. Andaj, duke i eliminuar shkaqet që shpijnë deri te fetvatë lajthitëse, synohet edhe mënjanimi i

<sup>14</sup> Muhamed Uthman Shubejr, *El Kavaid el fikhijje ved-davabitul kul-lijje fi-sh-Sheriatil Islamiyye*, f. 259, Bot. i parë. 2000. Darul Furkan. Aman-Jordani.

pasojave të tyre, të cilat shpeshherë nuk parashikohen as nga vetë ata që kanë dhënë fetva të tilla.

### **Përfundim**

Polemikat e shumta që i gjejmë gjithandej në shoqërinë islame, dilemat e shumta që njerëzit i kanë fiksuar në kokat e tyre rreth një morie çështjesh dhe problematikash islame, s'ka dyshim se për burim kanë edhe disa prej këtyre fetvave lajthitëse e të devijuara, të cilat mjerisht kanë dalë nga shkollarë e fushave të ndryshme islame.

Në situata të caktuara gjejmë se mendimi, apo fetvaja e tillë çorientuese-lajthitëse, te shumë njerëz e ka zënë pozitën e mendimit të vetëm të saktë - të qëlluar pa kurrfarë diskutimi. Së këndejmi, nuk duhet përjashtuar mundësinë që disa prej këtyre fetvave, të cilat në një periudhë kohore, nga nxitimi apo ndoshta edhe nga zilia, janë cilësuar si të lajthitura nga disa njerëz që nuk kanë pasur dituri të mjaftueshme. Megjithatë, pas një periudhe kohore, fatmirësisht qëndrimi ndaj tyre është kristalizuar me argument dhe më nuk trajtohen si të tilla.

Edhe përkundër këtyre fetvave të dëmshme e lajthitëse, megjithatë feja e Zotit do të mbetet e pastër si loti, pavarësisht mendimeve dhe interpretimeve të ndryshme të gabuara që sillen rreth saj. Ndërsa mendimet, fetvatë dhe interpretimet e devijuara, që i tundojnë, i trazojnë e shpeshherë edhe i përçajnë radhët e myslimanëve, do të mbesin si njollë e keqe për emrin e atyre që i lëshuan dhe i publikuan ato. Opinionet e tilla lajthitëse do t'i takojnë të kaluarës dhe mbase do të studiohen vetëm sa për të ditur për efektin dhe ndikimin negativ që patën në mendësinë e myslimanëve përgjatë shekujve.

---

**Literatura e shfrytëzuar:**

1. El Gazali, *El Mustesfa*. Bot. i parë, 1993. Darul Kutub el Ilmijje. Bejrut.
2. Ibn Hazm el Endelusij, *El Ihkam fi Usulil Ahkam*. Bot. i parë. Daruul Afak el Xhedideh. Bejrut. Pa vit botimi.
3. *El Buhari*.
4. *Sahih Muslim*.
5. El Axhurrij, *Ah'laku-l Ulema*. Bot. i parë. 2001. Darul Kalem. Damask.
6. Hamud et Tuvejxhrij, *Taglidhul melam alel muteserri'ine alel futja ve tag'jiril ahkam*. Bot. i parë. Daru Es Sami'ij. Rijad.
7. El Bagdadij, *El Fekihu vel Mutefekkihu* . Bot. i tretë. Viti i botimit: 1426, lunar. Daru ibnul Xhevzij. Demmam, Arabi Saudite.
8. Dr. Abdul Kerim en Nemletu, *El Xhami'u li ahkamil Usul ve tatbikatuha alel medh'hebi-rr-rraxhih*. Bot. i parë. 2000. Mektebetu Err Rrushd. Rijad.
9. Muhammed Tekijj el Uthmanij, *Usulul Ifta ve adabuhu*. Bot. i parë. 2014. Darul Kalem, Damask.
10. Ibn Salah, *Edebul Mufti vel musteftij*. Bot. i parë. 1986. Daru A'lemu el Kutub. Rijad.
11. Ibn Xheziri, *Ed Durerul feraid el munadh-dhame fi ah'baril Haxh* . Bot. i parë. 2002. Darul Kutub el Ilmijje. Bejrut.
12. Ibn Haxher el Askalani, *Fet'hul Bari - Sherh Sahih el Buh'arij*. Bot. i parë. 1998. Darul Hadith. Kajro.
13. Muhamed Uthman Shubejr, *El Kavaidul fikhijje ved-davabitul kul-lijje fi esh Sheriatil Islamijje*. Bot. i parë. 2000. Darul Furkan. Aman-Jordani.

*Driton ARIFI*

## **MISLEADING FATWAS – IN THE OPTICS OF ISLAMIC LEGAL CRITERIA**

### **(Summary)**

The issuing of fatwas (Islamic legal opinions) on specific issues is one of their most important missions assigned to the elite of Muslim scholars. This is a very noble mission of great importance, yet, unfortunately, throughout centuries, there were also irresponsible scholars, who misled part of the Islamic society through their views and the fatwas they issued.

This paper aims at shedding light on the reasons why some pseudo-scholars in different periods of time did not hesitate to mislead the Islamic population with the fatwa they issued.

دريتون عريفى

## **الفتاوى الضالة و المزيفة في بصريات المعايير الشرعية الإسلامية**

### **(خلاصة البحث)**

كل ما يحتاجه المجتمع يعد من المهام الرئيسية لمفهوم الإسلام النقي. ومن ضمن هذا المهمات تعتبر مهمة استنباط الفتاوى الإسلامية من قبل نخبة العلماء المسلمين انبلها. هذه مهمة نبيلة وثقيلة للغاية، و لكن لسوء الحظ، كان هناك "علماء" غير واعين ممن أرادوا وصمموا أن يكونوا مرجعًا لبعض القضايا الإسلامية. لقد تسببت هذه الفتاوى الضالة في إرتباك جزء من المجتمع الإسلامي من خلال إثارة الشكوك حول بعض القضايا.

تسعى هذا البحث القاء الضوء على الأسباب وراء عدم تردد بعض العلماء الزائفين طوال العصور، في تضليل المسلمين بفتاواهم المتقلبة و الضالة.



Dr. Hatixhe AHMEDI

**“ARNAUT HOXHA” - HYSREV EF. NUMANI  
(AYDINLAR) (1883-1953)**

**Abstrakt**

Ky punim bën fjalë për *hoxhën, myderrizin, hatibin, pedagogun, mufesirin dhe dijetarin shqiptar* nga Labunishta e Strugës, që studioi e veproi në Ohër, Tiranë e Stamboll, duke nderuar veten, origjinën, atdheun, institucionin dhe vendin ku jetoi e veproi. Pra, është fjala për Hysrev ef. Numanin, i njohur dhe i popullarizuar me emrin që tregon origjinën e tij - Arnaut Hoxha (1883-1953).

Për këtë personalitet të shquar, ka disa shkrime në gjuhën turke, përfshirë edhe zërin në “Enciklopedinë Islame”, kurse në literaturën në gjuhën shqipe është tërësisht i panjohur dhe nuk përmendet askund.

**Fjalët kyçe:** *Hysrev ef., Arnaut Hoxha, myderriz, ligjërues, Strugë, Tiranë, Stamboll*



## Hyrje

Shqiptarët ngado që shkuan e vepruan, e gjallëruan dhe e nderuan vendin ku u vendosën. Nuk është e rastit kur shohim që shumë prej tyre të kenë dhënë mund më shumë jashtë sesa në vendlindjen e tyre, kjo sepse rrethanat shoqërore e politike ishin të tilla. Gjersa po hulumtoja të dhënat për punimin tim rreth Ali Jakup ef. Shkodrës, me të cilin kishte kohë që po merresha, në “Enciklopedinë Islame Turke”, hasa edhe në një emër tjetër me nofkën “Arnauti”, për të cilin m’u shtuan kureshtja dhe interesi mi që ta njihja edhe më mirë këtë vatanli, i cili e ruajti ofiqin origjinal edhe në tokat e Perandorisë Osmane. E lexova me kërshtëri të madhe shkrimin e studiuesit të njohur turk, prof.



*“ARNAUT Hoxha” Hysrev ef.  
Numani (Aydinlar)  
(1883-1953)*

dr. Bekir Topaloglu, kushtuar Hysrev efendiut - Arnaut Hoxhës, dhe mbeta e habitur nga historia e bujshme e këtij hoxhe, sa veprues po aq edhe i mbushur me devotshmëri. U rreka të kërkoja edhe të dhëna të tjera në literaturën e botuar në gjuhën turke për jetën dhe veprën e këtij arnauti. Për fatin tim të mirë, gjeta disa kujtime dhe të dhëna të shkruara e të botuara nga ish-studentët e tij, të cilët e kujtonin me mall hoxhën e tyre. Në literaturën në gjuhën shqipe, për këtë personalitet nuk ka ndonjë të dhënë të botuar dhe është fare i panjohur, paçka se ai veproi dhe kontriboi në Strugë, Ohër, Tiranë, Stamboll dhe kudo që shkoi. Për këtë arsye, mbi bazën e literaturës në gjuhën turke, të cilën e kemi shfrytëzuar, do t’i japim disa të dhëna kryesore jetëshkrimore, apo, si të thuash, një skicë për biografinë e Hysrev efendiut, apo siç njihej ai dhe siç kishte dëshirë ta thërrisnin - për Arnaut Hoxhën, me shpresë se për të do të shkruhet edhe më shumë në të ardhmen. Kjo për ligj edhe një konstatim tjetër të

thënë sa e sa herë, se në raftet e bibliotekave dhe arkivave turke, ruhen dosje dhe vepra të autorëve dhe personaliteteve shqiptare, të cilat presin dorën e studiuesve për t'i nxjerrë nga heshtja dhe për t'i bërë pjesë të literaturës sonë. Ndriçimi i figurave dhe personaliteteve tona të çfarëdo fushë qofshin ato, është borxh dhe detyrim yni, aq më tepër për ata që vepruan jashtë atdheut për të cilin vuajtën shumë.

### **Arsimimi**

Hysrev Arnaut Hoxha u lind në vitin 1883 në fshatin Labunishtë të Kazasë së Strugës, që asokohe administrohej nga Vilajeti i Manastirit me Ohrin kryeqendër, nga prindërit shqiptarë Numan beu dhe e ëma Habibe Hanëmja. Mësimet e para i mori në mejtepin e fshatit, ku u dallua për zgjuarsinë dhe inteligjencën, prandaj prindërit e tij e dërguan që të vazhdonte shkollimin në qytetin e Ohrit, respektivisht në Medresenë e famshme të asaj kohe, e cila mbante të njëjtin emër, sikur të tij, - Medreseja "Hysrev Beg". Në këtë medrese për një vit e gjysmë i ndoqi mësimet tek alimi dhe myderrizi i famshëm i këtyre anëve Mustafa efendiu. Sigurisht, për shkaqe të ndryshme të cilat ishin aktuale në ato kohë, Hysrev Arnaut Hoxha studimet i vazhdoi për një kohë edhe në Medresenë e Tiranës. Krahas studimit në këtë medrese, njëkohësisht mbante ligjërata edhe nëpër xhami të ndryshme të Tiranës.

### **Ligjërues në Tiranë**

Meqenëse shquhej për zgjuarsinë, mendjemprehtësinë, zotërimin e pastër të gjuhës shqipe dhe gjuhëve orientale, por edhe për karakterin e rreptë të tij, ai shumë shpejt u bë i njohur, i kërkuar dhe i admiruar nga xhemati. Ajo që ia rriti namin dhe e bëri të njohur ndër shqiptarët e Tiranës dhe jo vetëm, ishte mënyra e drejtpërdrejtë e shpjegimit të çështjeve.

Kohën sa qëndroi në Tiranë, Arnaut Hoxha nuk do ta harronte asnjëherë dhe gjithmonë do t'ua përmendte studentëve dhe nxënësve të tij. Studentët e tij prore e përmendin ngjarjen që i kishte ndodhur hoxhës së tyre në kohën kur në Tiranë Esat Pashë Toptani kishte goxha pushtet. Në një nga ligjëratat e ditës së Bajramit, Hysrev Arnaut efendiu, përveç tje-

rash, kishte ngritur zërin dhe kishte kritikuar shumë ashpër popullatën, por sidomos qeveritarët. Kjo nuk kishte se si të mos i binte në vesh Esat Pashës, i cili në rezidencën e tij e kishte ftuar myftiun dhe myderrizin kryesor të Medresesë së Tiranës dhe i kishte pyetur: “*Ligjërata e Hysrev efendiut, a ka mbështetje dhe bazë diku nëpër libra?!*” - “*Po, ligjëratat e efendiut në fjalë kanë bazë nëpër këto e këto vepra!*” - ishin përgjigjur ata dhe kur të nesërmen e kishin takuar Hysrev efendiun dhe e kishin porositur që, nëse të thërret Pashai dhe të pyet, të lutemi ia jep këtë përgjigje të cilën ia kemi dhënë edhe ne, dhe ia kishin treguar titujt e librave të cilët ia kishin thënë Pashait.

Kur Esat Pasha e ftoi hoxhën, ai iu përgjigj ashtu siç e kishin këshilluar myftiu dhe myderrizi i Tiranës. Pashai mbeti “i kënaqur” nga korrektësia e hoxhës dhe si shpërblim ia dha 5 lira të arit.

Kur morën vesh për këtë myftiu dhe myderrizi dhe duke e njohur mirë karakterin e Esat Pashës, e porosisin Hysrev efendiun, që urgjentisht të largohej nga Tirana, sepse Pashai kështu vepronte me ata të cilët vendoste t’i dënonte apo t’i ekzekutonte.

Hysrev efendiut nuk i mbeti tjetër, veçse të kthehej në vendlindje, në Labunishtë të Strugës, për të shpëtuar kokën.

### **Vajtja në Stamboll**

Ngjarja e Tiranës e kishte lënduar shumë Hysrev Arnaut Hoxhën, sepse iu desh të ndërpriste shkollimin. Në Tiranë nuk mund të kthehej për të vazhduar, ndaj e vetmja zgjidhje ishte Stambolli. Kështu, në vitin 1910, Hysrev efendiun e gjejmë në “*Medresenë Üçbaşlar*” në lagjen Karagümrük të Stambollit, ku ndoqi studimet te myderrizët e njohur Ahmed ef. Kastamonliu, Hasan ef. Tavasliu, Atif ef. Kërklareliu dhe Ismailhaki Izmirliu, por me këtë të fundit më vonë pati mospajtime dhe zhvilloi shumë polemika e debate. Po ashtu, gjatë kësaj kohe mësoi edhe te një hoxhë i cili në ato kohë vepronte në gjysmë ilegalitet, sepse ishte i ndjekur, por që ishte shumë i shquar, i nderuar dhe i urtë - Mulla Rebi efendi.

Hysrev efendiun, pasi qëndroi për një kohë në Medresenë e Karagümrükut, kaloi në Medresenë Sylejmanie, në të cilën, në vitin 1919, u diplo-

mua në degën e tefisirit dhe hadithit. Pas përfundimit të Medresesë Sylejmanie, ai iu nënshtrua edhe provimit të jashtëm kryesor, i cili në atë kohë quhej “*Ru’us-imtihani*”, me çka e fitoi të drejtën që t’i vazhdonte studimet e përgjithshme “*Dersiâm*” si dhe u emërua profesor i gjuhës arabe në medresetë “*İbtidâiyye-i Hâriç*” - “*Shkollat fillore të veçanta*”. Abdullah Naim Şener, ish-student i hoxhës, citohet të ketë thënë se myderrizi i tij, Arnaut Hoxha, për njëfarë kohe ka ndjekur studimet edhe në “*Shkollën e Mjekësisë*” “*Mekteb-i Tibbiyye*” .

Në periudhën që njihet përgjithësisht si koha e Cumhuriyyetit - e shpalljes së Republikës së Turqisë, pas ndryshimeve që ndodhën, u mbyllën disa nga medresetë e kohës, kurse shumë profesorë mbetën pa punë, prandaj u gjetën ashtu siç edhe mundën, madje shumica prej tyre edhe duke bërë punë jashtë profesionit sa për të mbajtur familjen. Por Hysrev Arnaut Hoxha ndryshonte nga të tjerët, sepse ai edhe gjatë kësaj kohe të vështirë, vazhdoi të kryente, në formë vullnetare dhe pa kurrfarë kompensimi, detyrën e profesorit në medrese.

### Ligjërues në xhamitë e Stambollit

Krahas detyrës së myderrizit, Hysrev Arnaut Hoxha ligjëronte edhe në xhami të ndryshme të Stambollit, duke filluar nga xhamia e famshme “Fatih”. Djali i tij, Ahmet Rebiu, të cilit ia kishte vënë emrin e myderrizit të tij, kujton: “Babai im, në ditët e xhuma shpesh mbante ligjëratë nëpër xhami të ndryshme, sidomos në xhaminë “Hoxhapasha” ku pas ligjëratës përfundonte “si i ftuar” në qendrën ushtarake, e cila ishte poshtë xhamisë. Gjatë ditëve të xhuma, unë e shoqëroja babanë tim duke shkuar së bashku me të për t’ia mbajtur xhyben dhe librat që merrte me vete. Shpeshherë, kur zbriste nga shkallët e hytbes dhe nga qyrsia, ishte i djer-situr dhe i bërë qull nga ashpërsia dhe nga sikleti që e kaplonte, meqë gjërat nuk shkonin ashtu siç donte ai!”

Me gjithë presionet e shpeshta, hoxha asnjëherë nuk ndaloi së ligjëruari në këto dy xhami, në atë të “Hoxhapashës” dhe atë të “Xhamiallti”, madje edhe nuk reshti të thoshte të vërtetën në asnjë çast. Pas përfundimit të këtyre ligjëratave, ndodhte të përfundonte në stacionin policor, por megjithatë kurrë nuk hoqi dorë dhe nuk u zbraps nga fjalët e tij.

### **Vajtja në Medinetul Munevvere (Medinën e Ndrirtshme)**

Hysrev Arnaut Hoxha, kur e pa se në Stamboll gjithnjë e më shumë po i ngushtohet rrethi i veprimtarisë, vendosi të ndërmerre një sfidë të re, të shpërngulej në Medinën e Ndrirtshme. Kështu, pas 26 vjetësh qëndrimi në Stamboll, ai vendosi që në vitin 1936 të shpërngulej afër atij të cilin e donte me shpirt, pra afër Pejgamberit a.s. Por edhe këtë herë ishte nën presion dhe nuk arriti të merrte leje për shpërngulje, andaj organeve shtetërore të Turqisë që detyruar t'iu thoshte se po kthehej sërish në vendlindjen e tij në Strugë, dhe në këtë formë mori leje për t'u larguar nga Turqia. Së bashku me familjen e tij e lëshoi Turqinë dhe u vendos në Medinë, por edhe këtu nuk mundi të qëndronte gjatë, sepse njëra nga vajzat e tij nuk arriti ta përballonte klimën e atjeshme dhe u sëmur. Kështu, pas një viti qëndrim, ai kthehet sërish në Turqi dhe vendoset në Stamboll në lagjen Çengelkoy.

### **Rikthimi në Stamboll**

Pas kthimit nga Medina, Arnaut Hoxha filloi shpjegimin dhe komentimin e veprave të ndryshme në xhaminë "Fatih", në të cilën shërbeu afër 40 vjet, derisa e dha frymën e fundit të tij. Aty studentëve dhe të interesuarve të tjerë ua shpjegonte lëndët: gjuhë arabe, tefsir, hadith, fikh, filozofi dhe logjikë. Në xhaminë "Fatih" ai ulej në anën e djathtë të minberit të xhamisë. Pas namazit të drekës dhe të ikindisë nga një hoxhë shqiptar, jepeshin mësimet për çështjet më delikate në fushat e përmendura, sidomos shpjegohej vepra "*El-Hidaje*" nga fusha e fikhut, tefsiri i Kadi Bejdaviut, koleksioni i haditheve të Buhariut dhe Tirmidhiut, nga filozofia dhe logjika mësohej "*Thjau Ulumiddini*" i Imam Gazaliut, librat "*Shifa-i Sherif*" dhe "*Risale-i Kudsiye*" etj.

Asokohe, në Stamboll kishte edhe hoxhallarë dhe profesorë të tjerë të shquar që ligjëronin në këtë mënyrë, siç ishin Hazim efendiu, i cili studentëve u ligjëronte "*Mesnevinë*" e Xhelaledin Rumiut, Mekki efendiu, që ligjëronte Tefsirin e Kadi Bejdaviut, Emin efendi Kulalli u ligjëronte lëndë të ndryshme, por Hysrev efendi Aranut Hoxha dallohej nga këta, sepse ligjëronte më shumë vepra dhe kishte më shumë studentë.

Ish-studenti i tij, Abdulhalim Akkul, thotë për Arnaut Hoxhën se: “Vite me radhë i mësoi studentët sa në xhami po aq dhe në shtëpinë e tij. Këtë mision të tij e vazhdoi deri në vitin 1953, kur edhe vdiq në moshën 70-vjeçare. Sa e sa herë na ka zënë mëngjesi së bashku nëpër stacione të ndryshme të policisë.” Kurse ish-studenti tjetër, Mahmut Bajrami, në lidhje me këtë thotë: “Hoxha, shumë herë ka përfunduar nëpër gjykata, por vetëbesimi dhe guximi i tij prej intelektualit dhe qytetari për shprehjen e lirë ishte tejet i lartë, por edhe goxha i kushtueshëm!”

Përveç në xhami, Arnaut Hoxha jepte mësim edhe në shtëpinë e tij, madje edhe deri në orët e vona të natës, sidomos gjatë stinës së dimrit, kurse gjatë stinës së verës fillonte menjëherë pas namazit të sabahut e vazhdonte gjer në kohën e drekës, pra deri në mesditë, iu jepte mësim kategorive të ndryshme të studentëve.

Hysrev Arnaut Hoxha ia dinte shumë vlerën diturisë, si për ta mësuar vetë, ashtu edhe për ta përhapur atë te të tjerët. Shpesh e përsëriste fjalën e tij që studentët nuk ia harruan asnjëherë, kur thoshte: *“Teksa mësoj vetë dhe i mësoj studentët e mi, mësimin e secilës nga këto lëndë e llogaris ibadet. Ndiej kënaqësi dhe lumturi të pafundme me përvetësimin dhe përhapjen e diturisë. Asnjëherë as që më shkon në mendje bile të lodhem e të mërzitem nga kjo detyrë!”*

Atij kurrë nuk i kishte ndodhur që t’i thoshte ndonjë student: *“Shko sot, e eja nesër të mësosh! Ai vazhdonte t’i mësonte studentët madje edhe gjatë kohës sa ishte shumë i sëmurë. Ata shpesh i thoshin: “Hoxhë efendi, sot je pakëz pa qejf, ta marrim këtë ditë, ditë pushimi?!” Arnaut Hoxha do t’ju përgjigjej: “Jo, t’i mësosh të tjerët, ka shifa (shërim) dhe bereqet (bekim). Unë gjersa ju mësoj juve, nuk më ngelet asnjë dhimbje, më kalon e tërë sëmundja!”*

Edhe në ditën e fundit të jetës së tij, atëherë kur e kishte lënë forca, ai sërish kishte vazhduar shprehinë e tij të pashmangshme - mësimdhënien. Tri ditë para se të vdiste njëri nga studentët e tij e kishte lutur: *“Hoxhë efendi po ju shoh pak pa qejf dhe të lodhur shumë! Pushoni disa ditë, inshaallah do të mëkëmbeni së shpejti dhe do të vazhdojmë së bashku mësimin!”* Edhe kësaj radhe nuk ndërmori vendim i vetëm pa i pyetur studentët e tjerë: *“A e pranoni edhe ju idenë e shokut tuaj?!”* Studentët njëzëri

i thanë: *“Po e pranojmë hoxha ynë, vetëm ty të shohim të qetë dhe të shëruar!”* Atëherë Arnaut Hoxha tha: *“Ja Rabbi, bëhu Dëshmitar, se nuk e lashë mësimdhënien me dëshirën time, por me këmbënguljen e studentëve!”* Kjo ishte ngjarja dhe kujtimi i fundit për të dhe për studentët e tij, sepse pas disa ditësh, ai kaloi në botën tjetër.

Hoxha i shquar i Turqisë, Esad Cosan, për Arnaut Hoxhën do të shprehet kështu: *“Ishte një hoxhë që xhamisë “Fatih” i jepte madhështi, e lartësonte me diturinë e tij, por edhe e ruante me trimërinë dhe guximin e tij që se kishte njeri sikur ai! Allahu e mëshiroftë dhe e pushoftë në nur, ishte hoxhë i ashpër por frytdhënës. Kur Arnaut Hoxha ishte prezent në xhaminë “Fatih”, nuk thoshin se është imami apo hatibi i xhamisë, por në këtë rast i referoheshin me emrin e tij të veçantë duke thënë se është Hysrev Arnaut Hoxha duke mbajtur mësim me studentët!, pra me të identifikojë xhamia “Fatih” asokohe!”*

Ishte dijetar tek i cili nuk ekzistonte censura dhe frika, ose kthimi prapa, por vetëm marshimi drejt dhe fitimi në atë që synonte. Ishte kundër besëtytnive dhe njerëzve që merreshin me to, për të cilët thoshte: *“Le të digjen vetë nga e pavërteta e tyre!”*

Shokët dhe kolegët e tij e çmonin shumë diturinë dhe diapazonin e Arnaut Hoxhës, aq sa tek ai dërgonin studentët e tyre për të kryer një lloj specializimi, duke iu thënë: *“Biri im, qenke ngritur shumë, paske marrë mjaft dituri, por shko mëso pak edhe tek Arnaut Hoxha, ai nuk është sikur ne tjerët...”*

Në popullatë për Hysrev Arnaut Hoxhën qarkullonte thënia: *“Është i ditur, është i madh, është trim dhe bujar, prandaj dhe e duam pafund Hysrev Arnaut Hoxhën!”*

Hysrev Arnaut Hoxha, sipas tregimit të Hafëz Enver Galip Ceylan, Hysrev efendiu, e kishte marrë nofkën *“Arnaut - shqiptar”* sepse vinte nga trojet shqiptare, por edhe për shkak se ishte i vetmi shqiptar i gjeneratës së vet që arriti të përfundonte shkallën *“ders-i am” - mësim të përgjithshme*, të medreseve të ndryshme të Stambollit e në veçanti gradës më të lartë të Medresesë së Madhe të Fatihut.

Studentët e tij e përshkruajnë hoxhën si një profesor që sakrifikonte shumë për ta. Me një fjalë Arnaut Hoxha që bërë kurban i tyre, duke i

mësuar natë e ditë. Ai nuk e shikonte kohën se kur i përshtatej atij, por gjithmonë e shikonte kohën e cila u përshtatej studentëve, vetëm e vetëm që ata të mos e linin mësimin. Studentët kujtojnë se sa herë që lidhej ndonjë ngjarje apo përshkrim në libër me popujt e ndryshëm, hoxha sillte shembuj duke thënë: *“Shqiptarët e mi veprojnë kështu, boshnjakët kështu, çerkezët kështu, e me radhë!”* dhe ne shpesh qeshnim me diçka, e cila për neve ishte e çuditshme, ndërsa te disa popuj ajo ishte një realitet që kishte hyrë në traditën e tyre.

Emin Saraç Hoxha kohën kur mësonte në xhaminë “Fatih” pranë Arnaut Hoxhës, e kujton me mall, dhe thotë se këshillat e tij dhe mësimi i gjuhës së pastër arabe që kishte mësuar tek ai, do t’i ndihmonin shumë gjatë studimeve në Universitetin “Al-Az’har” të Kajros, për të vazhduar me një ngjarje interesante, ku thotë: *“Patëm filluar ta mësonim Sunenin e Tirmidhiut. Në atë kohë erdhi një shok i hoxhës nga Izmiri. Hoxha kishte të veshur një xhybe me vija, por që në anën e pasme e kishte një arnë (harrën-leckë) të madh. Hoxha nga Izmiri i tha: “Hysrev efendi, nëse ke nevojë për ndihmë, dua të të ndihmoj!” Hysrev Hoxha iu përgjigj: “Po është shumë e mirëseardhur ndihma jote, por unë nuk dua të më ndihmosh vetëm mua. Nëse vërtet ke vendosur të na ndihmosh, atëherë shko dhe na blej nja 15-20 kopje të veprës “Sunen-i Tirmidhi!” Shoku i tij shkoi dhe ia bleu, ia solli hoxhës, ndërsa ai menjëherë na i shpërndau studentëve. Më dha edhe mua një kopje të cilën e ruaj sot e kësaj dite si kujtim nga hoxha im i dashur Arnaut Hysrev Hoxha”.*

### **Puna në shkollat e quajtura “Imam Hatip”**

Arnaut Hysrev Hoxha radhitet në grupin e atyre hoxhallarëve të parë të cilët bënë shumë përpjekje dhe këmbëngulje në rihapjen e shkollave të mesme fetare të njohura si *“Imam Hatip”* në Turqi. Arnaut Hoxha radhitet ndër të parët e atyre që morën bajrakun dhe iniciativën për t’i rihapur sërish këto shkolla. Në fakt, kjo edhe ishte ëndrra e tij, të cilën arriti ta shihte në realitet. Studenti dhe kolegu i tij dhe një ndër profesorët e parë në këto shkolla, Mahmut Bajrami, thotë: *“Arnaut Hoxha u shërbeu shumë shkollave “Imam Hatip”, jo vetëm pse ishte profesor në to, por edhe për përkujdesjen që tregoi që ato shkolla të mos e ulnin nivelin e të de-*



*gradoheshin. Ngatërrohej me të gjithë profesorët e këtyre shkollave vetëm e vetëm që nxënësve të mos u cenohej krenaria. Ai këmbëngulte që asnjë nga nxënësit nuk guxonte ta përsëriste vitin!”*

Profesor Mahmuti, teksa evokon kujtimet e atyre kohëve, e kujton shumë mirë se në vitin e parë të hapjes së këtyre shkollave, Arnaut Hoxha erdhi në kabinetin e tij dhe ia kërkoi fletoren e vlerësimit të nxënësve e shkoi në klasë. Të gjithë nxënësit që ishin vlerësuar me nota të dobëta i thërriste dhe u thoshte: *“Fëmijët e mi, ma thoni Kelime-i Shehadetin”*. Kur nxënësit e thoshin shehadetin, Hoxha i vlerësonte me nota pozitive, kurse mua më drejtohej duke me thënë: *“Djali im, të metat dhe pamjaftu-eshmërinë që kanë në mësim, do ta plotësojnë në vitet në vijim. Nja dy vite nxënësit menaxhoni në këtë formë! Mos t’ju thyhet atyre dinjiteti dhe krenaria! Të gjithë këta janë nxënës që vijnë nga viset e largëta, me një fjalë konsiderohen kurbetçinj. Le të shkojnë në vendlindjen e tyre krenarë dhe gjithashtu krenarë le të kthehen në shkollë!”*



Kolegët dhe ish-studentët e Arnaut Hoxhës kujtojnë shumë ngjarje nga kjo kohë sa ishin me të, në ambientet e shkollave, të cilat përshkruajnë karakterin, vizionin, largpamësinë dhe këshillat prindërore të Arnaut Hoxhës. Si pedagog në këto shkolla, ai ligjëroi lëndët kryesore: Gjuhë arabe, Tefsir, Hadith dhe Akaid. Në njohjen e gjuhës arabe nuk kishte shoq.

### **Vepra e papërfunduar dhe dorëshkrimi i djegur**

Arnaut Hysrev Hoxha nuk punonte për nam dhe reputacion. Ai, gjithë kohës sa jetoi, bënte punë vullnetare, pa kurrfarë kompensimi. Në ditët më të vështira të jetës së tij kishte filluar të shkruante një vepër autoriale nga fusha e tefsirit, por të cilën kurrë nuk e përfundoi. Për më keq, edhe dorëshkrimi autograf u dogj së bashku me shtëpinë e tij. Në “Enciklopedinë Islame Turke”, autor i zërit për Hysrev Arnaut Hoxhën, prof. dr. Be-

kir Topaloglu, thotë: “*Arnaut Hoxha në parathënien e librit të tij të vetëm me titull “Risaletu’l mevahibi’l ilahiyje”, shënon se këtë vepër kishte filluar ta shkruante në një kohë të vështirë*”. Ndërsa ish-studenti i Arnaut Hoxhës dhe njëkohësisht edhe kopjuesi i kësaj vepre, Mustafa Nexhati efendiu, thekson: “*Kur Arnaut Hoxha filloi ta shkruante këtë vepër, për hoxhën filluan ditë shumë të vështira. Gjatë kësaj kohe, atij i vdes bashkëshortja dhe i digjet shtëpia, e së bashku me librat e tjerë, iu dogj edhe dorëshkrimi i veprës. Në rreshtat e këtij libri ai përshkruan edhe kohën e fillimit të luftës, atëherë kur filluan të gjëmonin topat dhe krismat e armëve*”.

Në bibliotekën e Bekir Topaloglut, në indeksin me numër 86, thuhet se kjo vepër është në gjuhën arabe dhe titullohet “*Risâletu ’l-mevâhibi ’l-Ilâhiyye*”. Kjo vepër është edhe tezë diplome për dhënien e provimit të quajtur “*Ru’ûs imtihâni*”, të cilin e jepnin myderrizët e asaj kohe në “*Medresetu’l Mutehassissinë*” - “*Medresenë e të dalluarve*”. Ai që e mbronte me sukses disertacionin e tij, emërohej si myderriz nëpër medresetë e Perandorisë Osmane. Këtu Arnaut Hoxha kishte marrë përsipër analizën e ajetit të 21-të të kaptinës “*El- Bekare*”, duke e analizuar në hollësi dhe duke e sqaruar me hadithe të shumta. Vepra, përveç hyrjes, në të cilën bëhet fjalë për shkencën e tefsirit (komentimin e Kuranit) dhe *te’vilin* (interpretimin e leximit të Kuranit), ndahet në dy kapituj kryesorë me nënçështjet e tyre.

Meqë bëhet fjalë për një vepër autoriale nga kjo fushë dhe e cila për autor ka një shqiptar, që ka qenë njohës i mirë i gjuhës arabe dhe i shkencave islame, në vazhdim po paraqesim edhe përmbajtjen e shkurtër të kësaj vepre, e bindur se do t’iu shërbejë të gjithë atyre që merren me autorët shqiptarë të cilët kanë shkruar vepra në gjuhët orientale, e me shpresë se një ditë kjo vepër do të jetë objekt i analizës së studiuesve tanë të fushës së tefsirit.

*Kapitulli i parë* i kësaj vepre në dorëshkrim ndahet në tre nënkapituj.

*Në nënkapitullin e parë* flitet për rëndësinë dhe epërsinë e Kuranit në fenë islame, vlerën e leximit të tij dhe të mësuarit e tij individual, si dhe përcjelljen e interpretimin e mësimit të tij te të tjerët. Të gjitha këto rë-

ndësi dhe vlera shpjegohen dhe lidhen me anë të haditheve që e qartësojnë edhe njëherë dhe e bëjnë më të përafërt kuptimin e kësaj tematike.

*Në nënkapitullin e dytë* autori bën fjalë për injorancën e grupit të njerëzve, të cilët pa e ditur Kuranin, japin shpjegime dhe komente për të, si dhe për grupin e dytë të njerëzve të cilët pasi ta kenë mësuar Kuranin përmendsh e harrojnë atë. Këtë e përshkruan mirë dhe qartë gjithashtu duke e argumentuar edhe me hadithe dhe transmetime të tjera të ndryshe.

*Në nënkapitullin e tretë* bëhet fjalë për përmbledhjen dhe kompletimin e Kurani Kerimit, radhitjen e tij dhe veçorinë e tij në zbritjen dhe leximin e tij në shtatë kiraete.

*Kapitulli i dytë* fillon me *rëndësinë e të njohurit dhe të dalluarit e ajeteve mekase dhe medinase*. Në këtë kapitull ai e jep një sqarim të gjatë rreth asaj se si duhet të orientohemi në njohjen e tyre, dhe sa është e rëndësishme njohja dhe të dalluarit e ajeteve në shkencën e tefsirit. Pastaj vazhdon me tefsirin dhe shpjegimin e ajetit 21 të kaptinës “*El-Bekare*”. Në fillim e shkruan ajetin origjinal:

يَتَأْتِيهَا النَّاسُ أَعْبُدُوا رَبُّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿٢١﴾

**“O njerëz, adhurojeni Zotin tuaj, i Cili ju krijoi juve edhe ata që ishin para jush, ashtu që të jeni të devotshëm (të shpëtuar).”** (*El-Bekare, 21*)

Këtij ajeti, Arnaut Hoxha i bën një tefsir dhe komentim të gjatë, më shumë se 150 faqe dorëshkrim. Së pari fillon shpjegimin e këtij ajeti me një mendjemprehtësi, duke u kujdesur që të japë shpjegime të kapshme e logjike, ndërsa më vonë fillon shpjegimin e ajetit, duke i vënë në pah dhe duke i analizuar shpjegimet dhe komentimet e transmetuesve të ndryshëm. Dhe në fund e fillon edhe një kapitull të veçantë të tefsirit ose të komentimit dhe transmetimit të ajeteve nga as’habët dhe tabiinët, duke u mbështetur në interpretimet e koleksionuesve të mëdhenj të shkencës së tefsirit. Gjatë tefsirit të këtij ajeti, Hysrev Arnaut Hoxha gjithashtu ka bërë edhe interpretimin mistik (sufist) të tij, por gjithnjë duke u kujdesur që të qëndrojë në kufijtë e lejuar të Islamit.

*Kapitulli në vijim* flet për rëndësinë e tefsirit dhe dijetarët që merren me këtë shkencë, duke pretenduar dhe këshilluar se ata duhet të posedojnë një bagazh më të gjerë dhe të kenë një përvojë më të gjatë. Gjithashtu

ai shpjegon edhe *tevhidin - Njëshmërinë absolute* të Zotit që na e mëson ky ajet, ndërsa kur e shpjegon tevhidin, e ndërlihdh me hadithe të ndryshme që flasin rreth kësaj çështjeje. Gjithashtu thekson se burimi i këtij ajeti ka të bëjë me fushat dhe termet “*xherh ve ‘t-ta’dil*”, fushë e cila është shumë e rëndësishme në shkencën e tefsirit, por sidomos në atë të hadithit.

Në fund të veprës, respektivisht në f. 152, është dhënë edhe data se kur e ka përfunduar këtë vepër: 8 Xhemaziye’l evvel 1337, që korrespondon me datën 9 shkurt 1919. Ndërsa aty gjithashtu figuron edhe data kur kjo vepër është marrë sërish në dorë për t’u redaktuar për herë të dytë: viti 1359/1940.

Vepra “*Risâletu ‘l-mevâhibi ‘l-Ilâhiyye*” na bën të qartë edhe njëherë zotërimin e lartë të gjuhës arabe dhe shkencave islame nga Arnaut Hoxha.

Sikur që shihet, Arnaut Hoxha është marrë edhe me shkrime dhe kishte prirje në këtë drejtim, por rrethanat e vështira në të cilat jetoi dhe sidomos angazhimi i tij i madh në mësimdhënie, nuk ia lejuan që të vazhdonte tutje në këtë drejtim që të na linte si trashëgimi kulturore edhe ndonjë vepër tjetër.

### **Kalimi në ahiret**

Ashtu si shumë hoxhallarë të tjerë, të cilët përjetuan vështirësi materiale dhe morale, edhe Arnaut Hoxha ishte njëri nga ata që, përpos presionit shpirtëror, pati vuajtje edhe në aspektin material. Mund të imagjinohet dhe të kuptohet se çfarë sigurimi jetësor dhe çfarë jete mund të zhvillonte një njeri, i cili të gjitha punët e tij i bëri vullnetarisht, ndërsa e mbante shpirtin gjallë me kultivimin e disa perimeve në një bahçe të vogël, e cila ishte pjesë e oborrit të shtëpisë së tij.

Arnaut Hoxha vdiq më 23 prill të vitit 1953, në moshën 70-vjeçare, në shtëpinë e tij, në lagjen Çenglekoy në Stamboll. Shpenzimet e varrimit të tij, në pamundësi sigurimi nga familja apo nxënësit e tij, i siguroi një polic që e dinte vlerën e veprës së Arnaut Hoxhës. Më vonë studentët e tij i mblodhën të hollat për t’ia kthyer, por polici nuk i pranoi këto të duke ia kthyer sërish familjes së hoxhës.

Biblioteka e hoxhës u dogj së bashku me veprën autoriale dhe autografe “Risâletu’l-mevâhibi’l-Ilâhiyye”.

Namazi i xhenazes së Hysrev Arnaut Hoxhës iu fal në xhaminë “Fatih” dhe u varros në varrezat e Edirnekapi Sakizgaci, afër lagjes Fatih në Stamboll.

Pas vetes ka lënë shtatë fëmijë, tre djem dhe katër vajza dhe shumë nxënës e studentë, të cilët edhe sot e kësaj dite e përmendin me pietet dhe me nderim të lartë mësuesin e tyre Arnaut Hoxhën.

### **Përfundim**

Nga sa u tha më sipër, mund të përfundojmë se, me kaq sa kemi thënë, shpresojmë të kemi ndriçuar sadopak një personalitet të panjohur gjertani në literaturën shqipe. Aktiviteti dhe mudi i Arnaut Hoxhës le të na shërbejë si motivim dhe frymëzim për të ardhmen, respektivisht për ngritjen dhe edukimin e brezave të rinj. Do të kishte qenë shumë me interes sikur të kishim në dorë ndonjë kopje të veprës së Arnaut Hoxhës, por kjo deri në këtë fazë të hulumtimeve nuk qe e mundur. Kjo mbetet një punë për t’u bërë në të ardhmen, në radhë të parë nga studiuesit e fushës së tefsirit dhe autorëve që kanë shkruar në këtë drejtim.

Për Arnaut Hoxhën, më shumë janë shkruar kujtime nga ish-studentët e tij, të cilat në mungesë të të dhënave dokumentare, mbesin burime të rëndësishme dhe sikurse do të thoshte me shumë të drejtë studiuesi dhe autori i veprës “*Son Devrin İslam Uleması*”, dr. Sadik Albayrak: “*Ndoshta përshkrimi i jetës dhe i aktivitetit të këtyre ulemave vetëm me anë të kujtimeve është jo shumë shkencor, por megjithatë, nëse nuk veprojmë kështu, atëherë do t’i brejë në tërësi dhëmbi i kohës dhe do të harrohen fare...*”

Arnaut Hoxha e donte vatanin e tij, prandaj dhe kudo që shkoi e barti me krenari ofiqin që tregonte prejardhjen e tij “Arnaut Hoxha” dhe po të shkruante poezi, sigurisht që do të shprehej siç u shpreh një tjetër personalitet me prejardhje shqiptare që jetoi e veproi jashtë atdheut të tij - Mehmet Akifi, i biri i Tahir efendiut nga Peja, i cili thërriste më sa zë që kishte: “*Po unë me të vërtetë jam shqiptar, kjo është origjina ime dhe nuk kam çfarë të heq a të shtoj!*”

---

**Literatura e shfrytëzuar:**

- Bekir Topaloğlu, "Hüsrev Hoca", İslam Ansiklopedisi-Cilt:19-botim: - İFAV Yayınları-Stamboll.1999
- Revista "Altınoluk",nr: 19, 26, 27, 136, 157
- dervisan.com/yazi2/c931202.html - 38k
- mail.zikrullah.com/yazilar/arsiv/z010602.htm - 43k
- Mustafa Özdamar, Celal Hoca, Botim: Marifet Yayınları- Stamboll-1995
- Sadık Albayrak, Son Devrin İslam Uleması, Botim: Milli Gazete Yayınları- Stamboll-1980
- [http://www.cevaplar.org/index.php?khide=visible&sec=16&sec1=59&yazi\\_id=5387](http://www.cevaplar.org/index.php?khide=visible&sec=16&sec1=59&yazi_id=5387)
- SadıkAlbayrak- Son Devrin İslam Akademisi- Botim:İzYayıncılık- Stamboll.
- Birecik'li Abdullah Naim Şener, Kıyamet Alametleri, Stamboll. 1977
- Muzaffer Özak, Ziyetü'l Kulûb, Botim: Salah Bilici Yayınları, Stamboll.

*Dr. Hatixhe AHMETI*

**ARNAUT HODJA HYSREV EF. NUMANI (AYDINLAR)  
(1883-1953)**

**(Summary)**

This paper is about Hysrev ef. Numani, who is also known as Arnaut Hoxha (1883-1953), a hodja, muderris, khatib, pedagogue, mufassir and Albanian scholar from the village of Labunishta near Struga, who brought honor to himself, his place of birth, country, and the institution where he worked. Arnaut hodja studied and worked in Ohër, Tirana and Istanbul.

There are a number of writings about him in the Turkish language including an entry in the Islamic Encyclopedia. There is no mention of him in literature in the Albanian language. The aim of this paper is to shed some light on his figure, which is little known in the Albanian lands.

د. خديجة أحمدی

**أرناؤوط خوجا خسرف أفندي نعماني ١٨٨٣-١٩٥٣**

**(خلاصة البحث)**

يدور هذا البحث حول الشيخ الجليل والمدرس، والخطيب، والمربي، والمفسر العلامة الألباني من لابونيشتا في ستروغا، الذي تعلم وعمل في مدينة أوهر، تيرانا، وإسطنبول، والذي كرم نفسه و أصله ووطنه والمؤسسة والمكان الذي عاش وعمل فيه الشيخ العلامة خسرف نعماني المعروف والمشهور باسم أرناؤوط خوجا (1883-1953) . Hoxha . حول هذه الشخصية البارزة، هناك العديد من المقالات باللغة التركية، بما في ذلك مقال في "الموسوعة الإسلامية"، في حين أنه في المؤلفات باللغة الألبانية غير معروف تمامًا ولم يرد ذكره في أي مكان .

كان هذا الأمر هو السبب في كتابة هذه الدراسة ، لذلك يمكننا إلقاء بعض الضوء على هذه الشخصية ، التي لم تكن معروفة في أراضينا الألبانية.

Sezai SULEJMANI

## **VËSHTRIM HISTORIK RRETH KALIFATIT ISLAM**

### **Abstrakt**

Kalifati në aspektin terminologjik, nënkupton mënyrën e udhëheqjes së myslimanëve në aspektin fetar dhe politik.

Kalifi i parë ishte Ebu Bekri r.a., e pas tij erdhën Omeri, Othmani dhe Aliu r.a. Zaten ky edhe ishte fundi i kalifatit të drejtë, sepse pas Aliut, u themeluan dinasti mbretërore, të cilat po ashtu bartnin edhe titullin e kalifit të myslimanëve.

Në këtë punim, janë sjellë disa të dhëna historike, rreth funksionimit të kalifatit ndër shekuj, derisa ai u abrogua me ligj shtetëror nga Kemal Atataturku, me se morri fund edhe epoka e kalifatit islam në botë.

*Fjalët çelës: Kalifi, Kalifati, Perandoria Osmane, Atataturku, etj.*



## Kalifatit Islam nëpër shekuj

Kalifati paraqet formën e udhëheqjes politike dhe fetare pas vdekjes së Muhamedit a.s. Me kohë, kalifati është zgjeruar në tokat myslimane të banuara prej popujve të ndryshëm dhe gjatë tërë historisë së tij ka zgjuar interesimin e botës islame dhe të shteteve të mëdha të Perëndimit, deri në shuarjen e tij në vitin 1924. Kalif është transformuar nga fjala “khalef”, që gjendet në fjalor dhe e ka marrë kuptimin e kalifit të pejgamberit që, pas tij, e zëvendëson dhe e merr kuptimin e titullit të udhëheqësit të komunitetit mysliman, domethënë titullin e imamit. Lidhur me titullin “kalif” në kuptimin e udhëheqësit të myslimanëve nuk ekziston ndonjë dispozitë në Kuran e as ndonjë porosi apo amanet nga Muhamedi a.s. dhe prandaj mënyra e zgjedhjes së tij, lojaliteti i besimtarëve ndaj tij, uniteti, pajtimi dhe shtrirja e autoritetit kanë paraqitur problemin më serioz, të dhembshëm dhe të pazgjidhshëm përgjatë tërë historisë së fesë islame. Kalifi përfaqëson udhëheqësin e myslimanëve, i cili ishte i autorizuar ta ruante dhe zgjeronte tërësinë territoriale të shtetit, të urdhëronte për punë të mira, të bënte thirrje që në emër të fesë të shkohet në xhihad, të siguronte zbatimin e shariatit, faljen e namazit të xhumasë në atë vend ku ishte i pranishëm etj.. Me autorizimet e përmendura, kalifi shihej si lider i vetëm i botës islame, mirëpo ai nuk kishte autorizim fetar si papa në krishterizëm, prandaj vënia në praktikë e këtyre autorizimeve nuk u zhvillua si në krishterizëm. Pa këtë funksionalitet fetar pozicioni i kalifit nuk mundi që të parandalonte përçarjet, ngatërresat dhe konfliktet e përgjakshme që zunë vend në botën islame gjatë tërë periudhës sa ishte në fuqi kalifati. Pa pasur autorizimin fetar, në periudha të ndryshme historike, posaçërisht në shtetin osman, për aspektin e pajtueshmërisë apo jo të çështjeve botërore me shariat, fetvanë e jepte shejhul islami, e jo kalifi. Mungesa e dispozitës kuranore për ekzistimin e kalifit, autorizimeve të tij, mënyrës së zgjedhjes së tij dhe besnikërisë, obligimeve dhe përgjegjësisë së umetit ndaj tij, shkaktuan huti elementare, duke filluar prej vetë titullit të kalifit. Termi “halifetullah” (kalif i Allahut), që mund të haset aty-këtu në fillim të historisë së kalifatit, nuk zuri vend në përdorim; vetë Ebu Bekri e kundërshtoi këtë emërtim kur dikush iu drejtua me këtë titull dhe e përmendi titullin “halifetu Resulullah (İbn Sa‘d, III, 183; Musned, I, 11).

Ndërkaq, Muhamedi a.s. u përcillte njerëzve mesazhin hyjnor, i rregullonte çështjet jetësore të komunitetit, i zgjidhte problemet e drejtësisë, i udhëzonte në çështjet morale dhe edukative dhe si lider i organizimit shtetëror udhëhiqte politikën dhe komandonte ushtrinë. Kalimi i tërë këtyre autorizimeve për kalifin - ai që vjen, zë vend pas profetit - dukej një mision shumë i vështirë.

Akoma pa u bërë varrimi i Muhamedit a.s. disa njerëz nga ensarët, u tubuan për t'i shpallur besnikërinë prijësit të fisit Hazrexh - Sa'd b. Ubadës, si lider të myslimanëve. Nuk do të hyjmë në historinë e Hulefai Rashidinëve - katër kalifëve të drejtë, tre prej të cilëve kanë përfunduar jetën në mënyrë të dhunshme si pasojë e atentateve. Në kuptimin e vërtetë, kalifati (hilafetu'n-nubuvve) do të zgjasë tridhjetë vjet dhe pastaj do të kthehet në mbretëri trashëgimtare - dinasti. Në disa raste emërtimi kalif zëvendësohet me emir'ul muminun dhe imam.

Pas katër kalifëve pasoi sundimi i Emevive (Omejadëve) në Damask në periudhën prej v. 661 deri në v. 750.

Pastaj kalifati vazhdon me Abbasidët në Bagdad në periudhën v. 750-1258

Në Kajro janë kalifët Fatimi gjatë periudhës v.910-1171

Në Kordobë (Spanjë) janë kalifët prej vitit 929 deri 1031 me pushtet në Spanjë dhe pjesë të Marokut.

Almohadët në Spanjë dhe Marok në vitit 1145 deri 1269.

Abasidët në Kajro nën patronatin e Mamelukëve prej vitit 1261-1517.

Prej vitit 1517-1924 sulltanët osmanlinj.

Vendet myslimane shtriheshin nga Andaluzia dhe Maroku në perëndim deri te sulltanatet në Lindjen e largët. Në disa vende, në periudha të ndryshme kohore, disa udhëheqës e përdornin titullin e kalifit. Kështu kalifi identifikohet si udhëheqës i shtetit duke filluar që nga Murati I, e quanin veten kalifë.

Në kohën e sulltan Selimit I, Egjipti dhe siujdhesa arabike bijnë në sundimin osman. Padishahu-sulltani e mori titullin "*Hadimu'l Haremejni'sh-sherifejn*". Burimet joautoktone shkruajnë se kalifi i fundit Abbasi - Mutevekkil-Alellah III e ka pranuar sulltan Selimin I në Haleb (Alep) dhe ia ka dorëzuar titullin e kalifit. Sipas burimit të njëjtë ai ia ka dorëzuar

shpatën e kalifit në mënyrë ceremoniale sulltan Selimit I në xhaminë e Ejub Ensarit, apo në xhaminë Aja Sofía. Edhe pse historiografia moderne këtë ngjarje nuk e sheh të bazuar në faktografi reale, në një letër që i dërgon sulltan Selimi I Meliku'r-Rahim Shirvan Shah Shejh Ibrahim, i kërkon që t'ua bëjë me dije prijësve myslimanë që duhet t'ia pranojnë titullin "kalif" dhe të lutën në hytbe për të, pasi që ky, si kujdestar i vendeve të shenjta, siguron rrugët e haxhit për myslimanët. Sidoqoftë, autoriteti i osmanëve u rrit në botën islame pas përhapjes së tyre në Hixhaz dhe Egjipt. Pas kësaj, nganjëherë ndodhte që në letrat e autoriteteve që i vinin sulltanit nga Azia e Mesme dhe e Lartë të përdorej titulli "kalif" për të.

Në kohën e sulltan Sylejmanit-Kanunit, është me rëndësi një letër që ky ia ka dërguar mbretit të Portugalisë, kur e quan veten kalif, pasi që myslimanët e Indisë kishin kërkuar ndihmë prej tij: "me mirësinë e Zotit të Plotfuqishëm në gjendjen e tanishme si Kalif..."

Sulltan Murati III, në letrën dërguar Sa'di sulltanëve të Afrikës Veriore, kërkon që ta njohin kalifatin e osmanëve.

Sidoqoftë, në periudhën osmane është një fakt i pamohuar që titulli sulltan dominon te sundimtarët e shtetit. Edhe pse në kohën e sulltan Sulejmanit I, sadriazem Lutfi Pashë-Halasi në veprën "Umme fi marifeti'l-eimme", argumenton se nuk ekziston ndonjë provë që vërteton se kalifi duhet të jetë nga fisi Kurejsh, titulli "kalif". Asokohe, paratë shtypeshin me emrin e sulltanit dhe jo të kalifit.

Që nga koha e selxhukëve, turqit e kanë parë veten si mbrojtës të Islamit kundër kryqëzatave të hershme dhe atyre të mëvonshme që janë zhvilluar kundër shtetit osman. Në Evropë, emri turk bëhet sinonim për mysliman dhe kur është thënë "el Turko" ose "ala Turka" është menduar për myslimanët dhe Lindjen në përgjithësi. Megjithatë, sundimi osman përfshinte vetëm një pjesë të botës islame. Aty ishte rivali i saj i përherëshëm, Irani, me të cilin zhvilluan luftë njëqindvjeçare, prej së cilës dolën që të dyja aq të rraskapitura saqë kurrë nuk e arritën më fuqinë që e kishin pasur. Aty ishin shtetet e Azisë së Mesme, Afganistani, India, vendet e Malajeve. Kështu emri "kalif", që e mbanin sulltanët osmanë, ishte një

formalitet që nuk kishte ndonjë domethënie të madhe dhe që nuk kishte ndonjë funksion të madh politik e as shpirtëror.

Si shkas për bartjen e Kalifatit jashtë kufijve të tij shërbeu marrëveshja në Kyçyk Kajnarxha, e nënshkruar pas luftës osmano-ruse më 1774. Kjo marrëveshje ka rëndësi sepse për të parën herë një shtet i Perëndimit e njehe me dokument zyrtar sulltanin osman si kalif të të gjithë myslimanëve. Ky konstatim është korrigjuar me faktografi më të re, sipas të cilës, qysh në vitin 1727, në një marrëveshje të nënshkruar ndërmjet sulltan Ahmetit III dhe sunduesit Afgan Eshref Han, qëndron nënshkrimi i sulltanit dhe titulli “Kalif i të gjithë myslimanëve”. Megjithatë, kjo tregon për një kontinuitet të shtetit osman, që nëpërmes të titullit “kalif i myslimanëve” ta shtrijë ndikimin në vendet e populluara me myslimanë. Me humbjen e Krimesë ndodhi që vendet e banuara me myslimanë të gjinden nën pushtimin jomysliman dhe prandaj titulli sulltan më nuk mjaftonte, por duhej shfrytëzuar edhe autoriteti i kalifit. Raste tjera të fillimit të politizimit të titullit kemi edhe në një shembull tjetër kur gjatë nënshkrimit të një marrëveshjeje, Spanja insistonte të përfshihej një klauzolë ku shteti osman do të garantonte se nuk do t’i ndihmonte myslimanët e Afrikës Veriore. Shteti osman rezistoi në përfshirjen e kësaj klauzole me arsyetimin se si “*xhihet-i xhamia-i hilafet*” e ka për farz t’u ndihmojë atyre.

Shembuj të tillë, me rëndësi praktike jo aq të përfillshme, kemi edhe në kohën e Tanzimatit dhe në përgjithësi kur filluan vendet me popullsi myslimane të dalin jashtë administrimit osman dhe t’i nënshtrohen repressionsit të vendeve jomyslimane. Në përgjithësi, mund të konkludohet që titulli kalif për sundimtarët osmanë ka qenë më tepër simbolik, me rëndësi të vogël praktike dhe me domethënie kryesisht si kujdestar i vendeve të shenjta si Mekë, Medinë dhe Jerusalem. Ashtu si edhe kalifët para tyre, ingerenca e sundimtarëve osmanë ka qenë kryesisht brenda kufijve të perandorisë, pa pasur përfshirje në tërësinë e botës islame.

Lufta kundër islamit ishte një synim konstant i Evropës, i filluar me kryqëzatat dhe i vazhduar më vonë me politikat imperiale dhe ekspansioniste të shteteve evropiane. Në Mesjetë, lufta kundër islamit zhvillohej nën petkun ideologjik dhe fetar dhe personifikimi i El-Sidit frymëzonte brezat e tërë të Perëndimit në luftë kundër arabëve në Andaluzi, në Li-

ndjen e Mesme dhe kundër osmanëve në Ballkan, Mesdhe dhe në Evropë. Filluar nga shekulli XIII, sulmet kundër vendeve myslimane fituan edhe një motiv tjetër - imperialist, kolonialist dhe ekspansionist. Rusia cariste, e forcuar pas reformave të Petrit I, filloi ekspansionin në drejtim të tokave osmane, e pushtoi Krimenë, fitoi dalje në Detin e Zi. Në dekadat e ardhshme i pushtoi hapësirat e gjera të Azisë Qendrore me popullsi myslimane, pastaj u zgjerua në jug dhe pushtoi vendet e Kaukazit. Kështu një numër i madh i popujve myslimanë u gjend nën sundimin rus.

Nga ana tjetër, Perandoria Britanike e pushtoi Indinë duk e bërë koloni të sajën, vendet me popullsi myslimane të Afrikës po ashtu u gjendën nën pushtimin anglez, e nxiti kryengritjen në Greqi kundër shtetit osman, ndërsa kah mesi i shek. XIX e mori Egjiptin nën administrimin e saj.

Holanda i bëri koloni të saj të gjithë ishujt e banuar me myslimanë e që sot përbëjnë Indonezinë.

Franca e pushtoi Algjerinë dhe e bëri koloni të saj, sikurse edhe shtetet tjera afrikane të banuara me myslimanë. Shumë popuj myslimanë u gjendën në robëri të shteteve të Perëndimit. Ndërkaq në administrim të shtetit mysliman ndodheshin vetëm popujt e krishterë të besimit ortodoks, popujt e Ballkanit dhe armenët. Jashtë sundimit të saj Rusia, nën vëllon e mbrojtjes së popullatës ortodokse në shtetin osman vazhdimisht i nxiste bullgarët, grekët, armenët, serbët, rumunët, kundër Portës, i frymëzonte, organizonte dhe i armatoste. Shteti osman ishte i zhytur në borxhe ndaj shteteve evropiane, dhe i kërcënuar vazhdimisht prej Rusisë, emërtohej si i “e sëmura e Bosforit”. Në këtë kohë kritike në krye të shtetit osman erdhi sulltan Abdyl Hamidi II. I traumatizuar nga vdekja e prindërve të tij nga tuberkulozi, Abdyl Hamidi II bëri kujdes në ushqim dhe iu përkushtua stërvitjeve trupore, banjave të ftohta, notimit, gjërave të cilat nuk ishin të zakonshme në shoqërinë osmane, por që kishin filluar të praktikoheshin edhe në oborrin mbretëror të Vjenës. Sulltani çoi një jetë të thjeshtë e pa veshje ekstravagante, flinte në një krevat të thjeshtë. Duke iu nënshtruar zakonisht të dinastisë osmane, sikur të gjithë princërit para tij, e mësoi një zanat. U bë një marangoz shumë kreativ, të cilit i kishin lakmi mjeshtrit më të mirë të kohës. Dollapët që i bënte vetë mund të shihen edhe sot në arkivat e Stambollit. Ishte i devotshëm në praktikimin e be-

simit - i falte pesë vaktet e namazit. Në oborrin mbretëror në Jëlldëz Saraj dëgjohej rregullisht zëri i myezinit.

Por karriera e tij e sundimitarit filloi në kohën më të errët që erdhi për Perandorinë. Shumë probleme të grumbulluara shpërthyen pikërisht në vitin e parë të sundimit të tij. Duke parë dobësimin e shtetit osman, Rusia nxiste popujt sllavë të rebeloheshin, i armatoste dhe u dërgonte oficerë rusë për përgatitje luftarake. Kështu, në vitin e parë të sundimit të tij, serbët u ngritën në Hercegovinë dhe me këtë shkas Serbia dhe Mali i Zi i shpallën luftë shtetit osman. Ushtrinë serbe e komandonte gjenerali Chernajev. Po ashtu edhe bullgarët, të nxitur prej Rusisë, filluan kryengritjen. Më 1877 Rusia i shpalli luftë shtetit osman. Opinioni evropian, posaçërisht ai anglez, ishte antiosman dhe me atë rast vazhdonte kampanja antiosmane e Gladstonit, i cili siguronte opinionin britanik se Rusia kishte premtuar se nuk do të rrezikonte interesat britanike, sepse nuk do ta okuponte Stambollin dhe Bosforin. Lufta përfundoi në mënyrë katastrofale për Perandorinë Osmane. Nga Perandoria u shkëputën Rumania, Serbia, Bullgaria fitoi autonomi, Bosnja dhe Hercegovina u vunë nën administrimin e Austro – Hungarisë. Serbia u njoh zyrtarisht si shtet i pavarur, zgjeroi territorin dhe filloi pastrimin etnik të popullatës myslimane, kryesisht shqiptare. Rusia fitoi territor në Kaukaz dhe e mori Karsin dhe Ardahanin në lindje dhe Besarabinë në perëndim. Por, fituesi kryesor, pa derdhur asnjë pikë gjak, ishte Britania; ajo fitoi Qipron, si vend strategjik në Mesdhe dhe, kryesorja - Egjiptin, më 1882. Bile okupimin e Egjiptit e bëri me pretendimin se këtë po e bën në emër të kalifit dhe të mbrojtjes së rregullit dhe ligjit. Nuk kishin kaluar as 20 vjet nga Lufta e Krimesë dhe situata gjeostrategjike kishte ndërruar në disfavor të shtetit osman. Dalja e Gjermanisë në skenë si fuqi botërore e kishte afruar Francën me Rusinë. Tashti shteti osman kishte mbetur në një izolim të frikshëm. Në tokat e saj pretendonte Britania, Franca, Rusia, Italia.

Pas këtyre ngjarjeve shteti osman kishte humbur një të tretën e territorit me pesë milionë banorë, gjysma prej të cilëve ishin myslimanë. Së shpejti pasoi dëbimi i popullatës myslimane nga vendet e pushtuara nga shtetet e reja ballkanike dhe arritja e refugjatëve nga vendet e ndryshme. Si rezultat i këtyre lëvizjeve të popullsisë, situata demografike brenda Pe-

randorisë pësoi ndryshim dramatik. Në fund të viteve 1870 popullsia në Perandori ishte më shumë se 70% e besimit mysliman. Si pasojë kjo ndikonte edhe në krijimin e politikës së re në shtetin osman.

Si vazhdim i politikës antiosmane të shteteve evropiane, Porta u detyrua t'i bënte koncesione territoriale Greqisë. Ndërkohë, Franca e okupoi më 1881 Tunizinë, ndërsa Algjeria ishte e okupuar qysh nga viti 1830.

Në këtë situatë të agresionit të pandërprerë të fuqive botërore, sulltan Abdylhamidit II nuk i mbetej tjetër opsion përveçse të kthehej kah vendet myslimane dhe uniteti islamik.

Që në Konstitucionin e parë, menjëherë pas ardhjes në fron, nenet 3 dhe 4, përveçse e definonin Perandorinë si shtet islam, kishin edhe këtë përmbajtje:

*“Sulltanët osmanë, si kalifë sublimë të Islamit, i përkasin derës së vjetër të Osmanit... Ekselenca e tij, Padishahu si kalif, është mbrojtës i religjionit islam...”*

Abdylhamidit nuk i mbetej tjetër përveç mobilizimit të myslimanëve në mbështetje të kalifatit dhe integritetit të Perandorisë. Kjo ide u përkrah fuqishëm me gjeste simbolike dhe entuziazëm pro-osman në botën myslimane, posaçërisht në Indi, në kohën sa ishte duke u zhvilluar lufta e fundit.

Duke parë rreziqet jashtë dhe brenda Perandorisë, Abdylhamidi e suspendoi Kushtetutën dhe e shfuqizoi Parlamentin duke i marrë të gjitha çështjet në Perandori në kompetencë personale. Nacionalizmin e shihte si rrezikun më të madh të brendshëm në Perandori. Për këtë arsye angazhoi rrjet të organizuar të inteligjencës me të cilin i zbulonte dhe i mbushte burgjet me nacionalistë. Kur një orientalist i njohur hungarez i kërkoi që t'i jepte një ligjëratë për racën turke, ai refuzoi dhe tha: “Ne nuk duhet ta prekim çështjen e nacionalizmit; myslimanët janë vëllezër mes tyre dhe çdo ndarje në nacionalitete do të shkaktonte dëmtim serioz.”

Sulltani e mbante qëndrimin se Perandoria e kishte mbështetjen në Islam:

Islami ishte ai që i ka mbajtur grupet e ndryshme si anëtarë të një familjeje. Prandaj theksi nuk duhet të jetë në otomanizëm, por në Islam...

meqenëse struktura sociale dhe politika e Perandorisë është e bazuar në religjion.

Duke iu përmbajtur idesë së unitetit islam, Abdylhamidi e inkurajoi edukimin islam, i ngriti pagat dhe pensionet e ulemave dhe zyrtarëve tjerë, u ngritën dhe u krijuan fonde për ngritjen e cilësisë së diturisë së klerikëve në mënyrë që të konkurronin në dijeni me kolegët e tyre të krishterë. Prej anëve të ndryshme të Perandorisë i ftonte dijetarët e shquar islamë, rrugët dhe sheshet i emërtoi me emra dijetarësh, personalitete të shquara nga vendet arabe i solli në kryeqytet dhe u dha pozita të larta në qeveri si: ministra dhe sekretarë, me idenë se krejt këta mund të angazhohen në ruajtjen dhe lojalitetin e popujve të tyre ndaj shtetit dhe kalifit. Titulli “kalif” ose *Emiru'l Muminin* përdorej tani më me ëndje se sa titulli sulltan ose padishah. Arabishtja si gjuhë u favorizua, bile flitej se sulltani një kohë mendonte që arabishtja të bëhej gjuhë zyrtare në perandori.

“Ai (Abdylhamidi) është posaçërisht i ndjeshëm ndaj subjektit të pozitës dhe autoritetit të tij si Kalif”, shkruante Henry Layard, ambasadori britanik në Stamboll (1877-80).

Arsyeja për këtë ishte politikisht e kuptueshme: Kalifati ishte çelës për implementimin e shumë politikave të jashtme e të brendshme dhe për këtë, ky aksion inspirohej nga ambicia e tij për të shtrirë ndikimin dhe influencën ndaj myslimanëve në pjesë të ndryshme të botës. Po ashtu linte të kuptohej se ai e konsideron si më të shenjtë pozitën e kalifit se sa të sovranit në vendin e tij. Posaçërisht ishte i ndjeshëm ndaj çdo kontestimi të pozitës së tij si kalif. Ndaj vërejtjes së sulltanit të Marokut se pozita e kalifit i takon pjesëtarit të fisit Kurejsh, Abdylhamidi u përgjigj se ai është i vetmi kalif i cili e ka trashëguar kalifatin nga paraardhësit e tij. Ai e shtriu propagandën e organizuar ndaj vërejtjeve të disa arabëve dhe evropianëve se sulltanët osmanë nuk janë pasardhës të fisit Kurejsh. Si akt të kundërt me qëllim të propagandimit dhe popullarizimit të pozitës së tij si kalif i vërtetë, u shkruan shumë libra dhe pamflete me përmbajtje të ajeteve të Kuranit dhe thënieve të Profetit. E njëjta gjë u bë edhe me gazeta, njësoj si në vend ashtu edhe jashtë vendit nga ana e disa turkofilëve në mbrojtje të Perandorisë, sigurisht me inkurajimin e Portës.



Abdylhamidi e dinte që prapa përpjekjeve për kontestimin e Kalifatit të tij janë duke qëndruar anglezët, me qëllim që ta kontestojnë legjitimitetin e titullit të tij e në shërbim të trimërimin të arabëve për të kërkuar pavarësi. Ai konsideronte se prestigji i tij e kishte marrë goditjen më të rëndë me rastin e humbjes së Egjiptit. Ai po ashtu dinte për planet e anglezëve që Kalifatin ta zhvendosin në Xhide dhe ta zgjidhnin një kalif me të cilin mund të dirigjonin në mënyrë që të realizonin interesat politike të tyre. Në fakt, kjo frikë e shtyri Abdylhamidin që t'i tubonte njerëzit me influencë në Stamboll dhe nëpërmjet tyre të siguronte lojalitetin e arabëve ndaj Perandorisë. Dhe vërtet deri në fillimin e Luftës së Parë Botërore nuk pati ndonjë pakënaqësi serioze të arabëve ndaj integritetit të Perandorisë e as ndonjë kontestim të Kalifatit, duke dëshmuar me këtë se Abdylhamidi është i suksesshëm dhe që meriton respektin e tyre. Shumica e myslimanëve jetonte jashtë Perandorisë Osmane dhe Abdylhamidi ishte koshient se shumica e tyre jetonte nën administrimin e huaj, por ai nuk e merrte këtë si pengesë për unitet dhe as që nuk mund të jenë të lidhur shpirtërisht me Kalifat. Duke u nisur nga kjo logjikë ai shpresonte se opinioni i fuqishëm publik mysliman në favor të tij anë e kënd botës, do t'ia forconte pozitën në raportet me fuqitë evropiane. Ai shkruante:

“Ne duhet t'i forcojmë lidhjet tona me myslimanët e vendeve tjera dhe të jemi më të afërt me njëri tjetrin. Shpresa e vetme për të ardhmen tonë qëndron te kjo ide”.

Një vend tjetër përsëri pohonte:

Përderisa të vazhdojë unioni Islam, Anglia, Franca, Rusia dhe Holanda varen prej majës së gishtave të mi, sepse një fjalë e vetme e kalifit mund të jetë e mjaftueshme që në vendet myslimane nën dominimin e tyre të startojë xihadi kundër tyre, gjë që do të ishte një katastrofë për të krishterët.

Në rend të parë ai kishte parasysh mbështetjen dhe përkushtimin e myslimanëve të Indisë ndaj çështjes së Kalifit. Ai shkruan, “Nënmbreti (viceroy) ka bërë presion në Qeverinë Britanike që të jetë miqësore me ne. Kjo qartazi i lehtëson punët tona”.

Ky botëkuptim i Abdylhamidit bënte që ai të ishte sinqerisht i brengosur për problemet e myslimanëve jashtë shtetit të tij. Kjo është e evidente

nga fakti që Porta protestonte haptazi dhe zyrtarisht çdoherë kur kishte lajme për ndonjë maltretim apo shtypje të myslimanëve. Ai konsideronte se Perandoria Osmane ishte shpresa e vetme për botën myslimane.

“Milionë myslimanë, nën pushtetin e evropianëve, pohonte ai, i luten Zotit për çlirimin e tyre dhe e mbështesin shpresën e tyre te pasuesi i Profetit, te Kalifi”.

Lidhur me myslimanët e Indisë ai pyeste:

A ekziston ndonjë guvernator, komisioner apo zyrtar i lartë mysliman në Indi? A posedojnë myslimanët ende ndonjë pasuri apo pushtet? A kanë ata ndonjë armë në duart e tyre për rastin kur duhet të mbrojnë veten e tyre? A është në Parlament bile edhe një anëtar i vetëm indian që të mbrojë qoftë me fjalë të drejtat e miliona indianëve. Britanikët nuk janë duke bërë asgjë tjetër përveçse eksploatojnë pasuritë dhe potencialet e Indisë duke i trajtuar njerëzit e saj si kafshë.

Në një rast tjetër ai parasheh:

Një ditë do të vijë koha e revanshit për indianët të cilët do të çlirohen nga zgjedha britanike. India me milionat e popullit të saj mundet, në qoftë se dëshiron me të vërtetë, lehtësisht t'i përzë britanikët, të cilët i shtypin dhe i plaçkitin.

Megjithatë, këto shprehje të fuqishme emocionale shihen të jenë të natyrës personale dhe private. Në praktikën reale nuk kishte shumë mundësi për të bërë diçka me të cilën do të manifestohej kjo brengë. Nuk ekziston ndonjë evidencë për sugjerim të çfarëdo lloji për formim të frontit të përbashkët ushtarak të myslimanëve kundër dominimit të krishterë dhe as inkurajim të myslimanëve kundër pushtuesve të tyre të krishterë. Në realitet, ai ishte mjaft mendjemprehtë që t'q kuptonte tërë superioritetin e Perëndimit që e kishte në çdo fushë dhe që idetë e tij ishin të pamundshme të realizohen. Ai e ekzagjeronte rolin e xhihadit në publik, por ishte koshient se nuk kishte fuqi për t'u rezistuar fuqive të Perëndimit.

Përkundër pohimeve të perëndimorëve, nuk ka ndonjë evidencë në kuptimin që Abdylhamidi ndonjëherë e ka dënuar sovranitetin politik ndaj myslimanëve jashtë vendit të tij. Por, ai ishte këmbëngulës në insistimin që të njihen të drejtat e tij si kalif për emërimin e zyrtarëve fetarë në ish tokat osmane, që tani ndodheshin nën pushtet tjetër, në kuptimin që ta

mbajë gjallë ndikimin e tij te myslimanët në ato territore dhe t'i përmbushte nevojat e tyre fetare. Kështu, ai personalisht i zgjidhte myftinjët, kadijët dhe mësuesit të cilët dërgoheshin në Egjipt, Qipro, Bulgari, Krime dhe Bosnjë e Hercegovinë. Gjatë luftës ruso-turke, ishte një shpërthim i ndjenjave pro osmane në botën myslimane dhe ai konstatoi se ka të drejtë të kërkojë, si kalif që ishte, shërbim nga të gjithë myslimanët, kurdoherë që nderi dhe dinjiteti islam të jetë i rrezikuar. Që nga koha kur ai ishte kalif i të gjithë myslimanëve, pretendonte se t'i shërbesh atij do të thotë t'u shërbesh të gjithë myslimanëve. Krahas rritjes së ndikimit dhe prestigjit të tij si kalif te myslimanët jashtë shtetit, Abdylhamidi personalisht ftonte në pallatin e tij figura me ndikim dhe ulema nga vende të ndryshme myslimane. Ata trajtoheshin jashtëzakonisht mirë në Stamboll, në mënyrë që të popullarizonin imazhin e kalifit në vendet e tyre. Por, njëri nga rolet më të rëndësishme dhe efektive ishte ai që e luante me sufinjtë. Ai ishte posaçërisht entuziast që të mbante relacione të mira me shehlerë dhe dervishë. Për shkak të popullaritetit dhe ndikimit të tyre, ata ishin ftuar në pallat dhe ishin trajtuar shumë mirë. Ndërmjet tyre, si më me ndikim të gjerë gjithandej botës myslimane, ishin Sheh Muhammed Zafir nga rendi Shazeli, Ebul Huda as Sajadi dhe Ahmed Esad nga rendi Rufai. Këta shehlerë, jo vetëm që kontribuuan në letërsinë osmane, por po ashtu dërguan muridët e tyre në vende të ndryshme myslimane për të inkurajuar ndjenjat pro kalifit.

Një shans tjetër për popullarizimin, rritjen e ndikimit dhe forcimin e legjitimitetit të kalifit ishte haxhi në Mekë. Në këtë drejtim punohej si me haxhilerët e thjeshtë, nëpërmes pamfleteve dhe formave verbale të propagandës, ashtu edhe me autoritetet e larta të vendeve të ndryshme, të cilët kishin ardhur në haxhillëk. Cilido udhëheqës apo personalitet me prestigj të lartë që vinte në haxhillëk, trajtohej me kujdes dhe përkushtim të veçantë. Pamflete që shpërndaheshin, e që shumë prej tyre mund të gjenden në arkivat e Stambollit, e afirmojnë solidaritetin dhe unitetin islamik nën mbrojtjen e kalifit.

Mënyrë tjetër për krijimin e ndjenjave pro-osmane ishte prania e konsujve osmanë në vendet myslimane, të cilët Abdylhamidi dinte t'i shfrytëzonte mirë. Ai personalisht i përzgjidhte dhe emëronte shumicën e

ambasadorëve dhe konsujve. Një raport i konsullit gjeneral në kolonitë Indiano-Lindore të Holandës, Ali Galib, ilustron rolin i cili është luajtur nga këta konsuj në përhapjen e ndjenjave pro-osmane dhe pro-kalifit. I akredituar më 1886, ai në fillim të raportit e përfshin historinë e ardhjes së holandezëve në regjion, ndërsa, më tej jep pasqyrën demografike, gjeografike, ekonomike dhe fetare të ishujve, përfshirë aty edhe historinë e përhapjes së islamit në ishujt e Indonezisë së sotme. Ali Galib njofton se përkundër asaj që pothuaj tetë mijë pelegrinë shkojnë në Haxh për çdo vit, aty ishte i vështirësuar çdo komunikim me myslimanët e vendeve tjera, posaçërisht me ulematë, për shkakun e restriksioneve nga autoritetet holandeze, të cilat kishin frikë nga ndikimi i “fanatizmit mysliman”. Si pasojë e kësaj, njerëzit ishin analfabetë dhe të prapambetur. Ali Galib pastaj raporton se që nga arritja e tij në Batava, më 1883, nuk kishte ishull ku praktikoheshin lutja për kalifin osman në faljen e xhumasë. Prandaj, në ligjëratën e parë që e mbajti ai, në hytben e xhumasë e përmendi emrin e Abdylhamidit si kalif të epokës. Xhemati u trazua dhe shpërtheu në lot dhe i shprehu falënderimin e tij. Pas kësaj, kjo praktikë u përhap me shpejtësi në ishuj dhe u bë zakon në faljen e xhumasë. 1. Galib Beu pohon se para akreditimit të tij nuk ishte bërë asnjë përpjekje për lidhjen e këtyre myslimanëve me kalifin. Gjatë mandatit të tij zyrtar shumë myslimanë aplikuan që të bëhen subjekte të Kalifit, por ishte e pamundur që të pranohen kërkesat e tyre për shkak se e drejta ndërkombëtare nuk lejonte një praktikë të tillë.

Raportet konsullore që janë në dispozicion te arkivat osmane, zbulojnë qartë atë se konsujt osmanë në tokat myslimane ishin shumë aktivë në kultivimin e ndjenjave pro-osmane. Ata po ashtu e prezantonin veten si mbrojtës të interesave të myslimanëve, si përfaqësues të kalifit.

Krahas motivit politik që qëndronte si esencë e përpjekjes për popullarizimin e pozitës së kalifit në vendet myslimane, Abdylhamidi e kuptonte tërë seriozitetin e përgjegjësisë së tij për mbrojtjen e interesave të myslimanëve gjithandej në botë, e posaçërisht në Perandori. Në v. 1897 në Bazel u mbajt Kongresi Cionist, në të cilin, në njërin prej vendimeve qëndronte kërkesa për gjetjen e një vendi i cili do të mirëpriste hebrenjtë e Evropës. Lideri cionist Theodor Herzl me bashkëmendimtarët e tij e ki-

shin idenë e qartë që duhet të formohet shteti hebraik dhe për territor e synonin Palestinën, e cila ishte pjesë e Perandorisë Osmane. Për ta negociuar këtë çështje me sulltanin e zgjodhën një ndërmjetësues. Ndërmjetësuesi ishte konti Philippe Newliniski. Ky kont në të njëjtën kohë ishte edhe një spiun i Abdylhamidit në Evropë. Para se të dilte Herzl në skenë, kont Newliniski e kishte informuar sulltanin për lëvizjen cioniste dhe Abdylhamidi e njihte çështjen. Mirëpo, konti hebre që ishte në anën e cionistëve, i cili më parë kishte kryer analizat për gjendjen financiare të Perandorisë dhe kalkulimet, se sa i duhet ofruar Perandorisë për të dalë nga kriza në këmbim të tokës Palestineze për vendosjen e hebrenjve, u kishte dorëzuar cionistëve në formë të një raporti. Cionistët i ofruan 20 milionë sterlina të atëhershme me të cilat shlyhej borxhi publik i perandorisë e për kundërvlerë t'u jepej një vend në Palestinë ku do të arrinin kolonët hebrenj nga Evropa. Abdylhamidi këtë propozim e refuzoi. Sulltani, i cili nuk ishte edhe ashtu i popullarizuar në qarqet evropiane dhe quhej “Sulltani i Kuq” e bëri një hap vendimtar me të cilin cionistët dhe qarqet antiosmane u orientuan të bashkëpunonin me qarqet që ishin kundër sulltanit, e ndër ta edhe me xhonturqit.

Pas viteve të kërcënimit të territorit të Perandorisë, nxitjes së popujve të krishterë kundër shtetit, humbjes së territoreve dhe një kohe relativisht të qetë gjatë sundimit të Abdylhamidit, pasuan ngjarjet dramatike që i rrënuan themelet e Perandorisë. Më 1908 Abdylhamidin e hoqën nga fronti dhe pushtetin e morën xhonturqit me triumviratin e ashtuquajtur “tre pashallarë të pafe”. Pastaj pasoi invazioni i italianëve në Libi dhe humbja e saj. Pastaj pasuan Luftërat Ballkanike si episodi më katastrofal dhe më poshtërues në tërë historinë e Perandorisë. Perandoria, e dërrmuar nga krizat dhe disfatat nga më të ndryshmet, rreshtohet në anën e Gjermanisë dhe Austro-Hungarisë duke hyrë në Luftën e Parë Botërore e lodhur dhe e demoralizuar. Angazhohet në pesë fronte: Fronti i Kaukazit kundër Rusëve, Fronti i Galicisë si ndihmë Austrisë kundër Rusëve, Fronti i Çanakkalasë kundër anglezëve e francezëve, fronti i Suezit kundër anglezëve dhe fronti i Mesopotamisë kundër anglezëve. Humbës në luftën e Parë Botërore ishin Gjermania, Austro-Hungaria dhe natyrisht Perandoria Osmane, por gjatë këtyre viteve të përgjakshme plot vuajtje, ndodhi një

ngjarje e cila me heroizmin, vetëmohimin dhe idealizmin e saj e tejkaloi traumën, turpin dhe qyqarllëkun e Luftërave Ballkanike dhe e solli dinjitetin e krenarinë në shpirtin e lënduar të Perandorisë. Ky episod nga Lufta e Parë Botërore do të bëjë të harrohet disfata e përgjithshme, miliona të vrarë e të plagosur që nga shkretëtirat e Irakut e Sinajit e deri te ushtarët e ngrirë me veshje verore në dimrin e Kaukazit. Ishte kjo beteja e Çanakalasë, betejë që zgjati dhjetë muaj e që angazhoi qindra mijëra ushtarë me treqind mijë të vrarë e të plagosur në të dyja anët. Osmanët kishin para vetes përqendrimin e flotës më të madhe detare që ishte parë ndonjëherë. Kundër vetes kishin ushtarët nga Britania, Franca, Australia, Zelanda e Re, India. Por Çanakalanë nuk e lëshuan dhe nuk lejuan hapjen e rrugës për Stamboll. Ky heroizëm do të jetë simbol i lavdisë për brezat e ardhshëm dhe do të jetë inspirim për Luftën për Pavarësi, e cila do të fillojë katër vjet më vonë se kjo ngjarje. Fundi i Luftës së Parë Botërore shënon fundin e shtetit 600-vjeçar osman. Me armëpushimin e nënshkruar ndërmjet aleatëve fitues të luftës dhe shtetit osman në Mudros, garnizonet osmane jashtë Anadollit do t'u dorëzoheshin aleatëve, grykat detare Bosfori dhe Dardanelet vëheshin nën kontrollin e aleatëve, ushtria osmane duhej të demobilizohej në tërësi dhe çdo pjesë e territorit të mbetur osman mund të okupohej nëse ai territor paraqiste rrezik për sigurinë e aleatëve. Ky armëpushim u pasua me okupimin e Stambollit (Kostandinopojës) e më vonë edhe me copëtimin e territorit. Grekët invaduan në Anadollinë Perëndimore, zbarkuan në Izmir dhe vazhduan të përparonin në brendi të Anadollit. Pjesa Juglindore e Anadollit, Hataji, Siria e sotme u okupua nga francezët. Territori i sotëm i Irakut, Palestina, Sinaji u okupuan nga Britania e Madhe, Anadollit Jugor me pjesën e Antalisë u vu nën kontrollin italian. Të gjitha rrugët hekurudhore, portet dhe pikat tjera strategjike u vunë në dispozicion të shteteve aleate. Parlamenti në Stamboll u shpërnda, ndërsa formalisht në fron mbeti sulltan Vahdedini që nominalisht ishte edhe kalif - lider i myslimanëve. Aleatëve u konvenonte të mbahej një pozicion formal i sulltanit dhe i kalifit të cilin e kishin nën kontroll dhe me anë të të cilit do të manipulonin me masat e popullit i cili ishte lojal ndaj sulltanit të tij. Statistika demografike e Stambollit të atyre ditëve tregon se pjesëmarrja e popullsisë myslimane dhe jomyslimane ishte e

barabartë. Kjo është pasqyra e tolerancës fetare të shtetit osman, i cili për pothuajse 500 vjet sa e kishte marrë Stambollin nuk e persekutoi, nuk e dëboi dhe e ruajti popullatën jomyslimane. Lehtë mund të parashikohet se si për një kohë të shkurtër Stambolli – Kostandinopoja do të shndërrohej në metropolin më të rëndësishëm krishterë në Evropë duke bartur tërë rëndësinë e krishterimit lindor me të cilin Vatikani si territor prej disa kilometrash katrorë gjeografikisht dhe strategjikisht as që do të mund t'i afrohej. Territori i Perandorisë u copëtua, ushtria u demobilizua, Parlamenti u shpërnda, pjesët më vitale u okupuan, por historia, tradita e lavdishme, ndjenjat fetare, kuadri ushtarak dhe shpirti luftarak i popullit, nuk u harrua e as u mposht dhe nuk u pajtua me pushtimin, zhdukjen e shtetit dhe me robërinë. Filloi Lufta për Pavarësi, për krijimin e shtetit nacional, me nacionalistët turq, të udhëhequr prej gjeneralëve me përvojë të gjatë luftarake, të cilët përveç aftësive ushtarake, vetëmohimit të luftëtarëve, mobilizimit shpirtëror dhe material të tërë popullit, nuk posedonin armatim adekuat që mund të matej me armatimin që e posedonte ushtria greke si pushtuesi i territorit të madh në Anadoll. Së pari filloi organizimi politik, i cili paralajmëronte formimin e një shteti nacional me rregullim republikan. U formua Kuvendi i Madh Popullor, i cili e mori në dorë udhëheqjen e çështjeve politike dhe luftarake. U vendos mobilizimi total i të mirave materiale me të cilat dispononte populli. Në ofiçinat e improvizuara në qytete e fshatra, burra, gra, të mëdhenj e të vegjël filluan prodhimin e armëve. U vu në dispozicion të ushtrisë çdo gjë që e kishte populli: prej ushqimit deri te batanijet, postiqet, bagëtia, qerret. U grumbullua ari dhe argjendi. Në vendet e largëta myslimane filluan të mblidhen para për t'iu dërguar ndihmë luftëtarëve në Anadoll. Arritën ndihma financiare prej Indonezisë dhe Indisë. Edhe shteti i ri Sovjetik dërgoi ndihmë në armatim, sepse nuk dëshironte që shtetet imperialiste t'i kishte në kufijtë e tij dhe në kontroll të grykave strategjike. Lufta për Pavarësi zgjati pothuaj katër vjet dhe si rezultat i saj doli në skenën botërore një shtet i ri – Turqia. Nga gërmadhat e Perandorisë Osmane do të lindin me dhjetëra shtete të reja prej të cilave disa në Lindjen e Afërt dhe të Mesme do të paraqesin burimin e destabilizimit dhe të luftërave të gjata që do të vazhdojnë edhe në ditët tona.

Ndërkaq në Stambollin e okupuar sulltani – kalif Vahdedini nuk u njoh nga Qeveria e Ankarasë, e cila ishte zgjedhur nga Kuvendi i Madh Popullor. Në Stambollin e okupuar nga britanikët, Vahdedini si kalif e kishte nënshkruar dënimin me vdekje për krerët e Luftës për Pavarësi dhe nën presionin e britanikëve i kishte nisur forcat e kalifit që të luftonin me ushtrinë e Kuvendit të Madh Popullor që po luftonte për pavarësi. Pas fitoreve të nacionalistëve, pas Ofensivës së Madhe, kur u bë e ditur se forcat okupuese në Anadoll do të duhej të tërhiqeshin, sulltani Vahdedin, më 17 nëntor 1922, u largua nga Stambolli dhe më 18 nëntor, me vendimin e Kuvendit të Madh Popullor, u hoq nga pozita e kalifit. Po në atë seancë me 148 prej 162 votash u zgjodh kalifi i ri – Abdylmexhidi. Lideri i shtetit të ri i cili po krijohet, Mustafa Kemali, nëpërmjet Refet Beut ia përcolli rregullat e nevojshme për kalifin. Abdylmexhidi do të përdorte tashmë vetëm titullin kalif. Po ashtu në një njoftim iu caktuan detyrat dhe autorizimet që do t'i kishte. Kalifi i ri nuk u pajtua me këto kufizime dhe kërkoi që titulli të tij t'i shtohet edhe Hadimul Haremejn dhe që të bartte një saruk të ngjashëm si sulltan Fatihu. Mustafa Kemali i tha që mund të vishte një redengotë, por as që vinte në shprehje të vishte uniformë ushtarake.

Perioda prej zgjedhjes së kalifit të ri e deri te heqja e tij është kalimi kah laicizmi i plotë i shtetit të ri që e mori emrin Republika e Turqisë. Me rregullim republikan, laik, nuk mbetej vend për ushtrimin e autoritetit fetar. Kalifit nuk iu nda buxhet e as që kishte arkë financiare për nevoja të domosdoshme. Gjatë vizitave në Stamboll, zyrtarët e anashkalonin. Megjithatë në popull, e bile edhe në mesin e qeveritarëve, kishte simpatizues të pozitës së kalifit. Filluan edhe lëvizje për rimëkëmbjen e plotë të kalifit. Shteti i ri i gjykonte këto aksione dhe shumë prej tyre i gjykoi, i futi prapa grilave dhe shumë kundërshtarë të regjimit e autoritete fetare i ekzekutoi. Dalëngadalë, në kontinuitet, zhvillohej plani për heqjen e plotë të kalifit dhe kalifatit. Sipas liderit të shtetit të ri, Mustafa Kemal Atatürkut, faktor vendimtar për rrëzimin e kalifatit ishte pengesa që kalifi do paraqiste në rrugën e paraparë të revolucionit shoqëror dhe laicist që e priste vendin. Çështja e kalifatit në esencë ishte një çështje e regjimit. Atatürku në çështjen e heqjes së Kalifatit bëri një sërë përgatitjesh. Ai e mësoi



opinionin e shtypit, të intelektualëve, të liderëve të Luftës Çlirimtare, të shokëve të afërt dhe komandantëve.

Për marrjen e një vendimi të prerë ai e shfrytëzoi kohën prej 15-20 shkurt të vitit 1924, kur i ftoi në Izmir komandantët e armatave dhe divizioneve me rastin e Lojërave Luftarake.

Më 1 mars e hapi sezonin e ri të sesioneve të Parlamentit. Më 3 mars të vitit 1924, me propozimin e deputetit të Sirtit dhe 53 shokëve të tij, u aprovua ligji sipas të cilit hiqej abrrigohej kalifi dhe të gjithë anëtarët e Dinastisë Osmane nxirreshin jashtë shtetit. Të gjithë meshkujt, femrat, dhëndurët dhe fëmijët e lindur nga ato gra, e humbin nënshtetësinë dhe nxirreshin jashtë tokës së Turqisë. Kalifi dhe anëtarët e dinastisë, në afatin prej 10 ditësh, duhet ta braktisnin vendin dhe nuk kishin të drejtë të ktheheshin kurrë më. Kështu kalifati, i cili në epokën e republikës u konsiderua si faktor i rrezikshëm, u zhyt në histori.

Heqja e kalifatit u prit në mënyra të ndryshme në Perëndim dhe në botën myslimane.

Ambasadori i Britanisë së Madhe, Ronald Lindsey, më raportin e 8 shkurtit të vitit 1926 shkruante:

Myslimanët e Turqisë laike tashmë nuk paraqesin ndonjë rrezik për Perandorinë Britanike. Marrëdhëniet e ngushta me Turqinë laike do të jenë në interes të Britanisë.

Historiani i njohur anglez Arnold J. Toynbeen e jep këtë konstatim:

“Me heqjen e kalifatit, Turqia nuk është më qendër e botës islame. Me braktisjen e udhëheqjes shpirtërore të Islamit, me të kthyer kokën kah punët e kësaj bote dhe duke e përzënë kalifin jashtë vendit, Turqia e humbi mbështetjen e Islamit për të mirat e Vesternizimit. Sido që të ketë qenë, kalifati ishte lidhja më e fortë e unitetit islam. Heqja e këtij institucioni ndoshta më së shumti ngjason me “shokun” që e pati përjetuar Evropa Perëndimore kur mori fund Perandoria e Shenjtë Romake për shkak të luftërave të Napoleonit.”

Shkrimtari anglez Philips Gravesis shkruante:

“Turqit e hoqën një institucion që ka mundur t’i sillte kokëçarje çdo shteti që ka shtetas myslimanë. Nga ky aspekt, edhe nëse nuk e kanë pa-

sur atë qëllim, ata ia kanë bërë një shërbim të jashtëzakonshëm Perandorisë Britanike.

Këtë situatë François Georgeon e përshkruan në këtë mënyrë:

“Heqja e kalifatit paraqet një mjet me të cilin Turqia i shkëput lidhjet me të kaluarën myslimane dhe me botën myslimane”.

Ndërkaq, heqja e kalifatit zgjoi huti, demoralizim dhe reagime në botën myslimane. Në fillim nuk iu besua lajmit, por me t’u konfirmuar lajmi lindën reagimet e para dhe kërkesat që shteti të bënte hap prapa dhe të mos merrte një vendim i cili nuk ishte kompetencë ekskluzive e tij, por është çështje që u përkiste të gjithë myslimanëve. Reagimet erdhën nga India, Egjipti dhe Lindja e Largët. Për të shpëtuar pozitën e kalifatit, pati edhe propozime të tilla që Mustafa Kemal Atatürk të merrte personalisht pozitën e kalifit. Mirëpo as ky propozim nuk u pranua. Më vonë kjo huti dhe kjo letargji hapi rrugë për daljen në skenë të shumë kandidatëve për kalif. Përveç Abdylmexhidit, i cili ndodhej në Zvicër, ishte edhe mbreti i Marokut, Jusuf, imam Jahja nga Jemeni, Sherif Huseini i Mekës, mbreti Afgan Emanullah etj.

Me kalimin e kohës çështja e kalifatit e humbi vendin e rëndësisë që kishte në botën myslimane dhe mbeti aktual vetëm te personat idealistë dhe shtresat konservatore të popullit. Mbetet të bëhet një analizë e thellë, shkencore dhe e paanshme, e dijetarëve të kualifikuar se sa ka ndikim mungesa e kalifatit në situatën e përçarjes së përgjithshme në botën islame, ku pikëpamjet fetare, politike dhe ideologjike jo vetëm që nuk janë unike për botën islame, por nuk janë unike as për një vend të caktuar, shtet, apo krahinë.

**Literatura:**

- Azim Ozcan: Pan-Islamism : Indian Muslims, the Ottomans and Britain (1877-1924)
- Ilber Ortayli: Defterimden Portreler (Istanbul 2011)
- Halil Inalcik: Devleti Aliye (İş Bankası Kültür Yayınları İstanbul 2009.
- Ismail Colak: Halifeligin Kaldirilmasinin Yankilari (www islami yontem.net)
- Prof. Dr. Mehmet Celik: Şimdi anladınız mı Hilafet neden kaldırıldı? (mehmetcelik@gunes.com. 2017.)
- Seçil Karal Akgün: Halifelik nedir? Neden kaldırıldı (aydinlik.com.tr 2017)
- Islam Ansiklopedisi: Hilafet
- Essad Bey: Allah je Veliki (Beograd 1940)

Sezai SULEJMANI

## HISTORICAL OVERVIEW ON THE ISLAMIC CALIPHATE

### (Summary)

Terminologically, the caliphate is the way in which Muslims are governed religiously and politically.

The first Caliph was Abu Baqr. Abu Baqr was succeeded by Umar, Uthman and Ali. The death of Ali marked the end of the Rashidun Caliphate (rightly guided Caliphate). Following the death of Ali a number of royal dynasties were established, whose leaders continued to hold the title of Caliph.

In this paper we will present historical data about the functioning of the Caliphate through centuries until its abolition by Kemal Ataturk. This marked the end of the era of the Islamic Caliphate.

سيزائى سليمانى

## لمحة تاريخية عن الخلافة الإسلامية

### (خلاصة البحث)

الخلافة الإسلامية تعني رعاية شؤون المسلمين و تنظيم امورهم دينياً وسياسياً. الخليفة الأول كان أبو بكر الصديق ، ثم عمر ، ثم عثمان ، و اخر خلفاء الراشدين كان علي ابن أبي طالب رضى الله عنه. ثم تولى هذا المنصب معاوية و استمرت الخلافة عبر العصورحتى الغيت قانونيا من مؤسس الدولة التركية الحديثة كمال آتاتورك فى عام ١٩٢٤. بهذا القرار قضى نهائيا على الخلافة الإسلامية.



Mr. Vedat SHABANI

## **NAMAZI DHE FSHEHTËSITË E TIJ**

### **Abstrakt**

Namazi është një ndër pesë shtyllat bazike të Islamit. Këtë adhurim, i Madhërishmi e ka bërë obligim ditor, pesë herë brenda njëzetekatër orëve. Besimtari gjatë kryerjes së këtij ibadeti, arrin një lumturi të papërshkrueshme, në përpjekje për t'u ngritur në lartësitë shpirtërore. Si një prej ibadeteve më madhështore, namazi luan një rol të veçantë në edukimin dhe kalitjen e besimtarit mysliman në frymën e mirëfilltë fetare.

Namazi, si adhurim, ka rregullat dhe dispozita të veçanta, të cilat juristët myslimanë i kanë shtjelluar në përpikëri. Por, përveç këtyre rregullave të jashtme, namazin e karakterizojnë edhe veçori të brendshme shpirtërore, të cilat mund të përjetojnë vetëm me ndjenja dhe me zemër. Prandaj, duhet të jemi të kujdesshëm dhe të përkushtuar, gjatë kryerjes së këtij obligimi shumë të rëndësishëm të fesë Islame, në mënyrë që të përfitojmë mirësitë e tij si fizike, ashtu edhe shpirtërore.

***Fjalët kyçe:** namaz, ezan, përkushtim, përvulje, prezenca e zemrës.*

## Hyrje

Namazi është lumturia e çdo besimtari të sinqertë, është kënaqësia e shpirtit të namaz falësit, është kopsht i myslimanit të përkushtuar dhe mëshirë e dhuruar e Zotit për robërit e Tij. Këtë dhuratë, Krijuesi i gjithësisë, ia dhuroi ymetit përmes të Dërguarit të Tij, Muhamedit a.s., si mëshirë, afrim dhe nderim, në mënyrë që përmes këtij adhurimi të arrijnë kënaqësinë e Tij. Ky adhurim është i veçantë dhe dallon nga adhurimet e tjera, sepse është prej adhurimeve të para me të cilin, Krijuesi i gjithësisë, i ngarkoi robërit e Tij. Namazi luan një rol të veçantë në edukimin dhe kalitjen e besimtarit mysliman, në frymën e mirëfilltë fetare, sepse besimtari mysliman paraqitet para madhërisë së Zotit pesë herë gjatë ditës, dhe nuk ka dyshim se kjo paraqitje lë mbresa të pashlyera në zemrën e çdo myslimani.

Namazi ka rregullat dhe dispozitat e tij, të cilat juristët myslimanë i kanë shtjelluar në përpikëri, duke u bazuar në ajetet kuranore dhe në hadithet e Pejgamberit a.s. Mirëpo, përveç rregullave juridike të cilat juristët islamë i kanë shpjeguar në librat e tyre të jurisprudencës, namazi ka edhe disa fshehtësi të brendshme të cilat nuk mund t'i ndjejë e as shijojë askush, përveç atij, i cili namazin e kryen me përpikëri dhe përkushtim maksimal, prandaj, për t'i dhënë namazit vendin e merituar dhe për ta arritur efektin për çka edhe Allahu xh.sh. e ka bërë obligim për myslimanët, atëherë, patjetër duhet të jemi shumë të përkushtuar gjatë kryerjes së tij.

## Vlera e namazeve farz

Sa i përket kategorizimit të namazit, nuk ka dyshim se namazi farz<sup>1</sup> është kulmi i të gjitha namazeve. Për vlerën e namazit farz flasin ajete të shumta të Kuranit dhe hadithe të Pejgamberit a.s.. Prej tyre do të përmendim ajetin ku Allahu xh.sh. thotë:

<sup>1</sup> Namazet farze, të detyrueshme janë: 2 rekatet të sabahut, 4 rekatet të drekës, 4 rekatet të ikindisë, 3 rekatet të akshamit dhe 4 rekatet të jacisë.

إِنَّ الصَّلَاةَ كَانَتْ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ كِتَابًا مَّوْقُوتًا

**“Namazi është obligim (në kohë) i caktuar për besimtarët”<sup>2</sup>.**

Ndërsa Pejgamberi a.s. në një prej haditheve të shumta që flasin për vlerën dhe rëndësinë e namazit farz thotë: *“Pesë namazet gjatë ditës, xhumaja deri në xhumanë tjetër, janë falëse të mëkateve në mes tyre, nëse braktisen mëkatet e mëdha”<sup>3</sup>.*

Me një rast, kur Pejgamberi a.s. është pyetur se cila është puna më me vlerë?, ka thënë: *“Namazi në kohën e tij”<sup>4</sup>.*

### Vlera e xhamisë dhe vendfaljes

Xhamia është njëra ndër institucionet më të rëndësishme në jetën shoqërore të çdo myslimani. Këtë e vërteton edhe veprimi i Pejgamberit a.s. me rastin e shpërnguljes së tij prej Mekës në Medinë, ku ndër veprimet e para që ndërmoi, ishte përcaktimi i vendit për ndërtimin e xhamisë.

Lidhur me rëndësinë e xhamisë Allahu xh.sh. në Kuran thotë:

إِنَّمَا يَعْمُرُ مَسَاجِدَ اللَّهِ مَنِ آمَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ

**“E drejtë e përkujdesjes së xhamive të Allahut është vetëm e atij që i ka besuar Allahut dhe ditës së fundit”<sup>5</sup>,**

Ndërsa Pejgamberi a.s. ka thënë shumë hadithe për vlerën e xhamisë, prej tyre janë edhe këto: *“Ai person i cili për hir të Allahut e ndërton një xhami, edhe nëse ajo është sa strofulli i thëllëzës, Allahu do t’ia ndërtoj atij një shtëpi në xhenet”<sup>6</sup>,*

*“Fqinji i xhamisë nuk e ka namazin (e plotë) përveçse në xhami.”*

Ndërsa në një hadith tjetër, i cili për kohën që po jetojmë, për fat të keq, është mjaft aktual, ai thotë:

<sup>2</sup> En-Nisa’ë, 103.

<sup>3</sup> E transmeton Imam Muslimi, Libri i Pastërtisë, nr: (232). Gjithashtu e transmeton edhe Imam Ahmedi në Musnedin e tij (2/229).

<sup>4</sup> E transmetojnë Imam Buhariu dhe Muslimi.

<sup>5</sup> Et-Tevbe, 18

<sup>6</sup> E transmeton Ibën Maxhe dhe Imam Ahmedi.



*“Do të vijë një kohë kur njerëzit do të tubohen nëpër xhamitë e tyre dhe i tërë përkushtimi i tyre do të jetë rreth kësaj bote, Allahu xh.sh. nuk ka nevojë për njerëz të tillë, prandaj mos i shoqëroni ata.”<sup>7</sup>*

### **Vlera e plotësimit të kushteve (shtyllave) të namazit**

Mësimet e fesë islame çdoherë porosisin besimtarin që me rastin e veprimt të ndonjë vepre, atëherë atë duhet ta bëjë në mënyrën më të mirë të mundshme. Kështu edhe gjatë faljes së namazit, është esenciale që ai të kryhet në formën dhe mënyrën më të përkryer. Pejgamberi a.s. ka thënë:

*“Ai person i cili e fal namazin në kohën e tij, duke marrë abdes në formën e duhur, duke e plotësuar rukunë, sexhden dhe përkushtimin ndaj namazit, namazi i tij do të ngrihet në formë të bardhë e ndriçuese duke thënë: Zoti u përkujdestë për ty ashtu siç u përkujdeste për mua, ndërsa ai i cili e fal namazin pas kohës së tij, duke mos marrë abdes në formën e duhur, duke mos e plotësuar rukunë, sexhden dhe përkushtimin ndaj tij, namazi do t’i ngrihet në formë të zezë e të errtë duke thënë: Zoti të humbtë ashtu siç më humbe mua, derisa të arrij deri aty ku dëshiron Zoti dhe në një moment do t’i lidhet ashtu siç lidhet rroba e vjetër dhe do t’i përplaset në fytyrën e tij”<sup>8</sup>.*

### **Vlera e namazit me xhematë**

Sa i përket vlerës së namazit me xhematë, kemi shumë hadithe të Pejgamberit a.s. të cilat flasin rreth kësaj. Ndër të tjera, Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Namazi me xhematë, është më i vlefshëm se namazi vetëm, për njëzeteshtatë shkallë”<sup>9</sup>.*

Othmani r.a., duke përshkruar vlerën e namazit me xhematë, bazuar në atë çfarë kishte dëgjuar nga Pejgamberi a.s., ka thënë: *“Kush e falë namazin e jaxisë me xhematë, e ka vlerën sikur të atij që falet sa gjysmën e*

<sup>7</sup> E transmeton Ibën Hibbani dhe Hakimi.

<sup>8</sup> E transmeton Imam Msulimi, nr. (226).

<sup>9</sup> E transmetojnë Imam Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi, Tirmidhiu, Nesaiu dhe Ibën Maxhe.

natës, ndërsa ai që e falë namazin e sabahut me xhematë, e ka vlerën sikur të atij që falet tërë natën”.

Ndërsa, Muhamed bin Vasiu<sup>10</sup> lidhur me këtë çështje ka thënë: “Nuk kam ndonjë dëshirë nga kjo botë përveç tri gjërave: një mik-vëlla, që të më këshillojë kur gaboj, furnizim të hallallit dhe namazin me xhematë”.

### Vlera e sexhdes

Sexhdeja, është një prej pjesëve përbërëse të namazit, si shenjë e përlësisë ndaj Krijuesit fuqiptotë. Gjatë sexhdes sonë, ne e vendosim fytyrën-ballin në tokë, duke e lartësuar Allahun e gjithëmëshirshëm me fjalët: **“Subhane Rebbijel A’ëla - I lartësuar dhe i zhveshur nga çdo e metë, është Zoti im më i Larti”**.

Allahu xh.sh. në Kuran, na ka urdhëruar që të biem në sexhde përlësie, si f.v. në këtë ajet: **“O besimtarë! Bëni ruku, bëni sexhde, adhuroni Zotin tuaj, dhe punoni vepra të mira nëse doni të arrini shpëtimin.”** – (El-Haxh-xh, 77)

Pastaj: **“Pra, bini në sexhde për Allahun dhe Adhurojeni Atë!”**

Ndërsa i Dërguari a.s. në lidhje me vlerën e sexhdes thotë: **“Nuk ka mysliman i cili bën një sexhde për hir të Allahut, përveç se Zoti do ta ngritë atë një gradë dhe do t’ia shlyej një të metë”**<sup>11</sup>.

dhe:

**“Njeriu, gjatë namazit, më së afërmi është me Zotin, kur është në sexhde, prandaj shtoni lutjet”**<sup>12</sup>.

<sup>10</sup> Jurist, asket dhe një njeri i devotshëm, banor i Basrës i cili ka vdekur në vitin 123 h.

<sup>11</sup> E transmeton Imam Tirmidhiu dhe Imam Ahmedi.

<sup>12</sup> E transmeton Imam Muslimi dhe Imam Ahmedi.

### Përkushtimi në namaz

Lidhur me këtë pikë mjaft të rëndësishme, që për fat të keq, në kohën tonë, i ka humbur rëndësia te shumë namaz falës, Allahu xh.sh. në Kuran thotë:

وَأَقِمِ الصَّلَاةَ لِذِكْرِي

*“dhe fal namaz për të më kujtuar Mua”<sup>13</sup>,*

Kuptimi i këtij ajeti nënkupton pikërisht urdhrin për të kujtuar Zotin gjatë namazit, me përkushtimin më të plotë, duke qenë i vëmendshëm se ke dalë para Madhërisë së Allahut. Ndërsa, ai që e fal namazin, duke qenë i pavëmendshëm dhe i shkujdesur, namazi i tij është “i lëndueshëm, për të mos thënë, “i papranueshëm”.

Allahu xh.sh. thotë:

وَلَا تَكُن مِّنَ الْغَافِلِينَ

*“dhe mos u bëjë prej atyre që janë të shkujdesur”<sup>14</sup>,*

dhe:

قَدْ أَفْلَحَ الْمُؤْمِنُونَ الَّذِينَ هُمْ فِي صَلَاتِهِمْ خَاشِعُونَ

*“Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët, ata të cilët janë të përlur dhe janë të kujdesshëm gjatë faljes së namazit”<sup>15</sup>.*

Në këtë ajet, Allahu xh.sh. shkallën e parë të shpëtimit e ka vendosur në kujdesin gjatë namazit, me qëllim të njoftimit se ai që nuk e ka këtë veti, është shumë larg shpëtimit, që në këtë rast nënkupton kujdesin. Ndërsa lidhur me këtë çështje, ka folur edhe i Dërguari i Allahut a.s. në shumë thënie të tij, ndër të cilat do të përmendim: *“Në të vërtetë namazi është përlulsi, modesti dhe përgjërimit, të ngresh duart dhe të thuash: O Zoti im, o Zoti im, e ai që nuk vepron në këtë mënyrë atëherë namazi i tij është i mangët”<sup>16</sup>.* Si dhe:

<sup>13</sup> Ta-Ha: 14

<sup>14</sup> El-A'raf: 205

<sup>15</sup> El-Mu'minun: 1,2.

<sup>16</sup> Transmeton Imam Ahmed i në Musnedin e tij, gjithashtu edhe Imam Tirmidhiu.

“Atë person të cilin namazi i tij nuk e ndalon nga imoraliteti dhe e neveritura, ai në realitet veç sa është duke u larguar nga Zoti”<sup>17</sup>.

Pejgamberi a.s. ka qenë shumë i përkushtuar gjatë faljes së namazit. Këtë traditë e kanë vazhduar shokët e tij dhe gjeneratat e mëpasshme. Si mos të jenë të përkushtuar kur ata kanë qenë të vetëdijshëm se gjatë namazit të tyre, ata në realitet janë duke biseduar me Krijuesin e tokës dhe të qiellit - Zotin e të gjitha botëve.

Lidhur me çështjen e përkushtimit gjatë namazit, Abdullah ibn Abasi ka thënë: “Dy rekate namaz duke qenë i përkushtuar plotësisht, janë më të vlefshme sesa namazi i tërë natës duke qenë i shkujdesur.”

### **Veprimet gjatë namazit që ndërlidhen me përkushtimin dhe përlësinë**

Kur një person dëshiron të falë namaz, ai fillimisht eliminon papastërtinë nga trupi, nga rrobat dhe vendi i faljes, më pastaj e mbulon pjesën e turpshme (avretin) të trupit, e që për mashkullin kërkohet prej kërthizës e deri në gjunjë, dhe merr abdes duke respektuar dispozitat fetare.

Pas kësaj, ai duke u përqendruar me mendje dhe me zemër, e bën nijet dhe drejtohet nga kibla, dhe lidhet në namaz, qoftë individual, qoftë me xhemat. Në këtë rast, është e rëndësishme që përkushtimi dhe lidhja e zemrës së tij me Allahun fuqiplotë, të jetë në nivelin e kërkuar shpirtëror. *Tekbiri*, leximi i Kuranit, *rukuja*, *sexhdeja*, qëndrimi në këmbë-*kijam* dhe ulja në *ete hijat*, janë pjesë përbërëse të një namazi që kryhet me përlësi, devocion dhe dashuri ndaj Allahut të Gjithëpushtetshëm.<sup>18</sup>

<sup>17</sup> E transmeton Taberaniu nga Abdullah bin Mesudi.

<sup>18</sup> Abdulvehab El-Mesh’hedani, *Sifetu salati-n-Nebij*, f. 15, botimi i Darul-Kalem, Damask-1990.

## **Ndjenjat dhe përjetimet e brendshme shpirtërore përmes së cilave veçohet namazi**

Këto ndjenja a përjetime, apo nëse mund t'i quajmë edhe përsiatje shpirtërore, mund t'i përmbledhim shkurtimisht në gjashtë:

- Prezenca e zemrës (حضور القلب)
- Të kuptuarit (التفهم)
- Ekzaltimi (التعظيم)
- Madhështia-autoriteti (الهيبة)
- Shpresa-pritja (الرجاء) dhe
- Turpi (الحياء).

Me termin *prezenca e zemrës*, nënkuptojmë braktisjen dhe largimin e zemrës nga gjërat që nuk përkojnë me përqendrimin në namaz.

*Të kuptuarit* e fjalëve dhe veprimeve gjatë namazit, është çështje e cila vjen si rezultat i prezencës së zemrës. Kur njeriu është me mendje dhe shpirt i pranishëm në namazin e tij para Krijuesit, atëherë do të jetë në gjendje t'i kuptojë dhe përjetojë të gjitha ndjenjat, me anë të cilave kupton se duhet të jetë i kujdesur që të largohet nga imoraliteti dhe e neveritura.

Gjatë leximit të disa ajeteve kuranore, njeriu s'ka si të mos *ekzaltohet*, sepse nga vetë ky term, kuptojmë se ekzaltimi është një gjendje e zemrës që buron përmes njohjes së Zotit xh.sh. dhe madhësisë së Tij, që konsiderohet bazë esenciale e besimit, si dhe përmes njohjes së vetvetes së tij.

Sa i përket *madhësisë*, ajo është një gjendje e cila lind si rezultat i njohjes së fuqisë së Zotit xh.sh., pushtetit të Tij dhe ndikimit të vullnetit të Tij. Sikur të shkatërroheshin të gjithë njerëzit, që nga njeriu i parë e deri në atë të fundit, asgjë nuk do t'i mungonte pushtetit të Tij. Aq sa përforcohet dhe shtohet dija rreth Allahut xh.sh. aq edhe shtohet frikë respekti ndaj Tij.

Dhe fare në fund, fare kemi të bëjmë me *shpresën*, të cilën namaz falesi e ushqen vazhdimisht, sepse Allahu na ka porositur neve si besimtarë që për asnjë çast, të mos e humbim shpresën nga mëshira e Tij. Dihet se *shpresa*, vjen si shkak i njohjes së butësisë së Allahut xh.sh., bujarisë dhe mirësive të Tij, e gjithashtu edhe nga njohja e premtimit të Tij me xhenet për atë që fal namazin

Pas tërë këtyre ndjenjave shpirtërore, në fund fare vjen edhe *ndjenja e turpit*, që nënkupton se ai njeri që ende ka moral dhe besim, ai sigurisht që ndjen një dozë ngushtimi a turpi, që të mëkatojë ndaj Allahut, pas faljes së namazit, i cili na thërret të distancohemi nga çdo gjë e shëmtuar.

### **Sqarimi i detajuar se si duhet të jetë zemra prezent në çdo veprim gjatë namazit**

Në momentin kur një mysliman dëgjon ezanin, atëherë ai duhet të llogarisë se është duke dëgjuar thirrjen e Zotit ndaj tij në Ditën e Gjykimit, për t'u përgatitur që të jap llogari para madhërisë së Allahut xh.sh.

Sa i përket pastërtisë, përderisa njeriu e pastron vendin ku dëshiron të falet, si dhe rrobat me të cilat do të falet, atëherë gjithsesi duhet të kujdeset edhe për pastrimin e tij të brendshëm shpirtëror, duke filluar nga zemra. Pastrimi i zemrës arrihet përmes pendimit, qortimit të vetvetes për veprimet e kaluara dhe përkushtimit, që në të ardhmen të mos veprojë ndonjë vepër të papërshtatshme.

Sa i përket mbulimit të avretit, kjo nënkupton se njeriu duhet t'i mbulojë pjesët e turpshme të trupit të tij përpara syve të njerëzve. Nëse ne i kushtojmë kaq kujdes pamjes së jashtme trupore dhe mbulimit të avretit, atëherë si qëndron puna me të metat dhe dobësitë tona të brendshme, të cilat nuk i di askush përveç Zotit Fuqplotë? Pikërisht për këtë arsye, ne duhet ta pastrojmë ndërgjegjen, zemrën dhe shpirtin tonë nga mendimet negative dhe nga ,uke u penduar sinqerisht për mëkatet e kaluara.

Sa i përket orientimit tona kah kibra, kjo nënkupton largimin nga të gjitha orientimet e tjera përveç orientimit në drejtim të shtëpisë së Zotit (Qabesë). Prandaj nëse gjatë namazit tonë orientohe mi me fytyrë kah kibra, atëherë duhet pasur kujdes që edhe zemra t'i përkushtohet plotësisht Krijuesit të saj, duke braktisur të gjitha preokupimet tjera të kësaj bote.

Me qëndrimin në këmbë nënkuptohet paraqitja e njeriut me fizikun dhe zemrën e tij përpara madhërisë së Zotit Fuqplotë, si shenjë që edhe zemra të jetë e stolisur me modesti e nënshtrim duke u larguar nga mendjemadhësia. Kur njeriu qëndron në këmbë gjatë namazit duhet ta imagjinojë veten se është në Ditën e Gjykimit duke dhënë llogari para Allahut të Lartmadhëreshëm.

Sa i përket nijetit-vendosjes, ky veprim nënkupton vendosmërinë e njeriut që t'i përgjigjet Krijuesit ndaj obligimeve dhe urdhrave të Tij, siç është namazi, duke e kryer këtë obligim me shpresën për të arritur shpërblimin e Tij.

Gjatë tekbirit fillestar, kur gjuha jote e thotë këtë madhërim, të jesh i kujdesshëm që zemra jote të mos e përgënjeshtrojë atë. Nëse në zemrën tënde gjendet diçka që është më e madhe se Allahu, ose egoja jote ka përparësi ndaj urdhrave të Tij, atëherë dije se me këtë rast ti i ke shoqëruar Zotit shok, duke e madhëruar dikë tjetër pos Tij. Në këtë rast, tekbiri i shprehur pa ndjesi shpirtërore, llogaritet vetëm thënie e gojës dhe gjendje shumë e rrezikshme për Imanin-besimin e njeriut.

Duaja e hapjes së namazit, përfshin fjalët përmes së cilave besimtari fillimisht e madhëron Allahun Fuqplotë, i Cili është i vetmi i denjë për t'u madhëruar.

Kur besimtari e lexon Fatihanë-Elhamdulillahin, në tërësi, duhet ta ketë në konsideratë se i tërë falënderimi është për Zotin, sepse të gjitha dhuntitë janë prej Tij. Gjatë namazit jemi të rrethuar më mëshirën, ngrohësinë dhe butësinë e Tij, dhe arrijmë në atë gjendje, sa të kuptojmë se tërë madhështia dhe pushteti i takon vetëm Allahut, sunduesit të Ditës së Gjykimit.

Ne po ashtu jemi të bindur se sa të pafuqishëm jemi pa ndihmën dhe përkrahjen e Allahut, andaj edhe lutjet tona drejtuar Atij që të ma udhëzojë në rrugën e drejtë, janë lutje që burojnë nga zemra dhe shpirti ynë i pastër. E vetmja rrugë shpëtimi është ajo në të cilën është i kënaqur Allahu i madhërishëm, rruga e atyre të cilët Ai i begatoi me mirësitë e Tij, e kurrësi rruga e atyre nga të cilët Allahu është i hidhëruar, për shkak të mosbesimit dhe ligësive të tyre.

Gjatë namazit, zemra duhet të jetë e përkushtuar sepse ruajtja e saj, që mos të preokupohet me çështje të tjera gjatë namazit, është rezultat i përkushtimit. Nëse brendësia e namazliut është e përkushtuar, atëherë edhe gjymtyrët e jashtme të tij, padyshim do të përkushtohen.

Edhe gjatë rukusë dhe sexhdesë, falësi i namazit, duhet ta ripërtërijë besatimin e tij me Allahun xh.sh., me nënshtrim të plotë ndaj Tij. Ai përmes rukusë dhe sexhdesë konfirmon se nënshtrimi dhe përkushtimi bëhet

vetëm ndaj Krijuesit Fuqiptotë, i Cili njeriut i dha shumë mirësi dhe begati, prandaj vetëm Ai, meriton që t'i nënshtrohemi dhe t'i përulemi vazhdimisht.

Me rastin e qëndrimit ulur gjatë namazit, në etehijat, namazliu duhet të ulet me edukatë dhe terbiye, duke konfirmuar të gjitha përshëndetjet dhe falënderimet për Zotin xh.sh., gjithashtu duke përcjellë përshëndetje ndaj Pejgamberit a.s., dhe duke bërë lutje për vete, për prindërit e tij dhe për të gjithë besimtarët myslimanë. Lutja duhet të bëhet me modesti, nënshttrim dhe përlësi si dhe me bindje të thellë se Allahu xh.sh. do t'i përgjigjet lutjes tënde. Ndërsa me rastin e dhënies së selamit, për të dalë nga namazi, duhet ta kesh parasysh përshëndetjen ndaj melaqeve, xhematit dhe gjithë të myslimanëve, që janë duke u falur me ty.

Ky pra është namazi i përlësve dhe i të përkushtuarve, të cilin e përshkruajnë edhe shumë ajete kuranore si këto në vazhdim:

الَّذِينَ هُمْ فِي صَلَاتِهِمْ خَاشِعُونَ

*“Ata të cilët janë të përlur dhe janë të kujdesshëm gjatë faljes së namazit”<sup>19</sup>.*

وَالَّذِينَ هُمْ عَلَى صَلَاتِهِمْ يُحَافِظُونَ

*“Edhe ata që janë të kujdesshëm ndaj rregullave të namazit të tyre”<sup>20</sup>.*

الَّذِينَ هُمْ عَلَى صَلَاتِهِمْ دَائِمُونَ

*“Të cilët janë të rregullt në faljen e namazit.”<sup>21</sup>*

<sup>19</sup> El-Muminun, 2

<sup>20</sup> El-Mearixh, 34

<sup>21</sup> El-Mearixh, 23



*Mr. Vedat SHABANI*

## NAMAZ AND ITS SECRETS

### (Summary)

Namaz is the joy of every true believer, it is pleasure of soul for those who perform it, it is the garden of devote Muslims, and the mercy of God to his servants. This kind of worship is specific and it differs from others by the fact that it was the first one to be ordained by the Creator.

Namaz as a mandatory form of worship for every grown-up Muslim has its rules and principles, which have been elaborated in great detail by Muslim scholars, based on ayats of the Qur'an of the hadiths of the Prophet. Apart from the legal rules, which have been defined by Islamic jurists in books on Fiqh, namaz has some inner secrets which can be enjoyed only by those who perform namaz with full devotion. Thus, in order for namaz to be fully effective we must be fully committed while performing this very important obligation of the Islamic faith.

فبيانات شاباني

## الصلاة و أسرارها

### (خلاصة البحث)

الصلاة هي سعادة كل مؤمن مخلص ، إنها متعة نفس المصلي ، وحديقة المسلم المكرس ورحمة الرب كنعمة لعباده. هذه العبادة متميزة ومميزة عن العبادات الأخرى ، لأنها من العبادات الأولى التي كلف بها خالق الكون عبده.

الصلاة، العبادة المفروضة على كل مسلم بالغ، لها قواعدها وأحكامها التي تناولها الفقهاء بدقة، استنادا إلى الآيات القرآنية والأحاديث النبوية. ومع ذلك، بالإضافة إلى القواعد القانونية التي أوضحها العلماء في كتب الفقه الإسلامي، فإن للصلاة أسرار داخلية لا يمكن تذوقها إلا من قبل أولئك الذين يؤدونها بدقة، وبالتالي، فلاعطاء الصلاة حقها، و لتحقيق التأثير الذي من أجله فرض الله سبحانه وتعالى الصلاة على المسلمين، يجب علينا أن نكون حريصين للغاية وملتزمين بأدائها على الوجه المطلوب لهذه العبادة المهمة في الدين الإسلامي.

Dr. Islam ISLAMI

## **IMAM GAZALIU: SHKOLLAR DHE URTAK TEJKOHOR**

### **Abstrakt**

Ky punim mëton të ndriçojë pjesë nga biografia e ndritshme e njërës prej kolosëve më të mëdhenj të Islamit Imam Gazalit. Ai u quajt me titullin “*Huxh-xhetul Islam*” - Argument i Islamit, për shkak të dijes dhe aftësisë së tij në komunikim dhe sjellje të argumenteve gjatë bisedave apo debateve.

Ima Ebu Hamid El Gazali është autor i shumë veprave, por njëra prej tyre zë vend të posaçëm në bibliotekat islame. Kjo vepër madhështore, “*Ihjau Ulumi-d-din*”, sot e kësaj dite vazhdon të jetë bazë dhe referencë studimore nëpër shumë katedra të universiteteve dhe fakulteteve të studimeve islame nëpër botë.

***Fjalët çelës:*** *Imam Gazali, Nidhamije, Ihjau Ulumi-d-din, Huxh-xhetul Islam, etj.*

## Biografi e shkurtër e tij

Ky është Muhammed bin Muhammed bin Muhammed bin Ahmed, me pseudonimin Ebu Hamid, sipas emrit të djalit të tij, i cili i vdiq i vogël. Mbiemri i tij është El-Gazali<sup>1</sup>.

Sipas profesor El-Azizij, shtimi i “z-së” në mbiemrin e El-Gazalit është një gabim i priftit Luis Sheh.<sup>2</sup> Ka mundësi që ky mbiemër të vijë nga emri i fshatit Gazala një prej fshatrave të Tusit, siç ka treguar Ibn Es-Salah. El-Gazali ka thënë: “Njerëzit më quajnë mua El-Gazzali (me dy “zë-ja”), ndonëse nuk jam El-Gazzali, por unë vij nga katundi i quajtur “Gazala”<sup>3</sup>.

Mund të hamendësohet se dyfishimi “z-së” mund të ketë ardhur nga fjala “Gazzālun”,<sup>4</sup> që do të thotë *tjerrës leshi*, që ishte edhe profesioni i të et,<sup>5</sup> siç e ka përcaktuar Ibn Halekani.<sup>6</sup> Shtojmë këtu se Ibn El-Hamevij na kujton se ai nuk ka dëgjuar për ndonjë fshat me emrin “Gazala” kur ka vizituar Tusin.<sup>7</sup> Kështu që thënia e Ebu Es-Salahit që na përmend Edh-Dhehebiu për El-Gazalin, i cili ka thënë se ai vjen nga katundi Gazala, është një tregim i dyshimtë, thjesht i trilluar.

Emri i El-Gazalit në Evropë, pas epokës së përkthimit, kur diskutimi i ri rreth fesë dhe filozofisë ishte rreth modës, ishte gjerësisht i njohur.

Vlen të theksohet se polemika e madhe që ka shpërthyer rreth dyfishimit në shqiptimin e shkronjës “z” apo mosdyfishimit të saj në emrin e

<sup>1</sup> Shih: El-Gazali: *Tabekatu esh-Shafi’ijeti el-Kubra*, vol. i 6-të, f. 191.

<sup>2</sup> Shih: El-Azizij: *Ruqs Bin Zejid* (Huxh-xhetu-l-Islam), Revista e Veprimtarisë kulturore irakiane, nr. 1, viti i parë - 1957, f. 34. E vërteta tregon të kundërtën. Emri i El-Gazalit është ngatërruar midis dyfishimit të shqiptimit të shkronjës (“z”) dhe mosdyfishimit të saj për kohë të gjatë. Sipas Uat-it, i cili këmbëngul në mosdyfishimin e shkronjës “z”, gabimi ka ndodhur si pasojë e profesionit të të atit, që turrte lesh, pra ishte *tjerrës leshi*.

<sup>3</sup> Edh-Dhehebi: *Sijeru Aëlamî en-Nubela’i* (Biografia e dijetarëve fisnikë), vol. 19, f. 343.

<sup>4</sup> Ibn Khalekan: *Vefejatu-l-Aëjani* (Vdekja e Ajkës së Shoqërisë), vol. i parë, f. 98.

<sup>5</sup> *Tabekatu esh-Shafi’ijeti el-Kubra*, vëllimi i 6, f. 193.

<sup>6</sup> *Vefejatu-l-Aëjani*, vëll. i parë, f. 98.

<sup>7</sup> Jakut El-Hamevij, *Mu’ëxhemu-l-Buldani* (Enciklopedia e vendeve), volumni i 4-t, f. 201. Botues: Dar “Sader” - Bejrut. Shih: Di Bur: *Tarikh El-Felsefati fi El-Islam* (Historia e filozofëve të Islamit), përkthyer nga Abu Rida, f. 317-319, Biblioteka “En-Nahda el-Misrije”.

El-Gazalit, u ka marrë shumë kohë studiuesve, në kuptimin e përcaktimit të emrit të tij për shkak të kontradiktave ndërmjet historianëve.

Ai njihet edhe si Et-Tusij<sup>8</sup>, sipas emrit të qytetit Tus<sup>9</sup> në Horasan, e po kështu me emrin El-Fekih esh-Shafij,<sup>10</sup> nisur nga fakti se konsiderohej ndër fekihët më të mëdhenj të shkollës juridike të Imam Shafiut në shekullin e pestë të hixhrit dhe si njëri nga ata që e pasuan Imam Shafiun në novacion.

Gjatë bisedave rreth tij, si njëri ndër pionierët e shkencës së kelamit (apologjetikës), ai njihet edhe me emrin El-Esh'arij, sepse ishte ndër themeluesit e shkollës Esh'arite,<sup>11</sup> pas Esh'ariut (i vdekur në vitin 324 të hixhrit), El-Bakilaniut (i vdekur në vitin 403 të hixhrit) dhe pas El-Xhuvajnit (i vdekur në vitin 478 të hixhrit) vjen Imam El-Gazali.

El-Gazali në jetën e tij pati shumë emërtime nderi, por më i njohuri ndër ta ishte Huxh-xhetu-l Islam. Ai u njoh edhe me emërtimin *Zejnu-d-Diin* (Zbukurim i Fesë),<sup>12</sup> *Huxh-xhetu-d-din* (Autoritet i Fesë)<sup>13</sup>, *El-Alimu el-Evhed* (i dituri i vetëm), *Xhemël El-Fireki* (Bukuria e grupeve) dhe *Mufti el-Ummeti* (Myftiu i Umetit).<sup>14</sup>

Ai ishte filozof, fekih (ekspert i së drejtës islame) dijetar i lartë me orientim sufist. Ai ndoqi rrugën e Imam Shafiut në fikh dhe e plotësoi atë që e pati filluar Esh'ariu në kelam (apologjetikë). Ishte personalitet i dalluar midis filozofëve, fekihëve dhe dijetarëve të rregullave sufiste e skolastike, gjë që ia mundësoi të mbetej në kujtesën e çdo dashamiri të filozofisë apo të së drejtës islame dhe të teologjisë për shekuj me radhë.

<sup>8</sup> Shih: Muhammed Ferid Vexhdij, *Dairetu El-Mearif el-Karn el-Ishrin* (Enciklopedia e Shekullit të Njëzetë), volumni i 7, f. 65,66. Botues: "Dar El-Fikër" (Shtëpia e Mendimit) – Bejrut dhe Haxhi Khalifa, "Keshf Edh-dhununi an Eseemi El-Kutub El-Fununi" (Zbulimi i Mendimeve në lidhje me librat më të lartë artistikë), volumni i dytë, f. 509-513. botim i Stambollit, viti 1941.

<sup>9</sup> *Mu'ëxhemu-l-Buldan*, volumni i 4-t, f. 49.

<sup>10</sup> *Dairetu El-Maarif El-Karn el-Ishrin*, volumni i 7, f. 65-68.

<sup>11</sup> Shih: Dr. Muhammed El-Behij, *El-Xhenib el-Ilahij mine-t-tefkir el-Islamij* (Ana hyjnore e mendimit Islam), f. 13. Botues: Dar Ihjau-l Kutub el-Arabijeti, botimi i parë, viti 1945.

<sup>12</sup> Muhammed Ferid Vexhdij, *Dairetu El-Mearif el-Karn el-Ishrin*, volumni i 7, f. 65-66.

<sup>13</sup> *Tabekatu esh-Shafi'ijeti el-Kubra*, volumni i 6, f. 191.

<sup>14</sup> El-Imam Ebu Hamid El-Gazali, *Ed-Durretu-l Fahiretu fi Keshf el-Ulumi-l Ahire*, f. 3, El-Xheziretu li-n-neshri ve-t-tevzië - Kajro, botimi i parë, viti 2006.

## Lindja dhe familja e tij

Lindja e El-Gazalit shoqërohet me një paqartësi të thjeshtë e tij, që shfaqet në dy forma:

1. Lindi në vitin 450 të hixhrit<sup>15</sup>, që i përket vitit 1058 të erës sonë<sup>16</sup> në Et-Taberan të qytetit të Tусit,<sup>17</sup> njëra nga dy pjesët e qytetit të Tусit<sup>18</sup>.

2. Lindi në vitin 451 të hixhrit,<sup>19</sup> që i bie në vitin 1059 të erës sonë.<sup>20</sup>

Familja e tij ishte në një gjendje të varfër, sepse i ati i tij punonte si tјerrës leshi, që pastaj e shiste në Tabaran të Tусit. Ai la pas vetëm atë dhe vëllain e tij Ahmedin,<sup>21</sup> i cili ishte një vit më i vogël se ai. Me sa duket, i ati anonte nga sufizmi, aq sa edhe prodhimet e tij mbanin simbole sufiste, shtu kësaj, varfërinë e tij që përbënte një nga shkaqet e ushtrimit të sufizmit.<sup>22</sup> I ati ishte njeri asket dhe i pëlqente të qëndronte në kuvendet e predikimit (va'dh), siç na ka informuar Es-Subkij.<sup>23</sup> Kur iu afrua vdekja, i kërkoi një shokut të vet sufist që të kujdesej për El-Gazalin dhe vëllain.<sup>24</sup> I kërkoi atij që të kujdesej për ta, t'i arsimonte dhe t'u kompensonte atyre atë që ai ua privoi, siç ishte pajisja me dije, në dy degët e fesë: ke-lam dhe fikh.

Kështu, sufisti (shoku i të atit) punoi me ngulm për kujdesin ndaj dy vëllezërve, domethënë El-Gazalit dhe të vëllait dhe kur iu bë e pamundur të vazhdonte menaxhimin e punëve të tyre, ai u kërkoi t'i drejtoheshin një

<sup>15</sup> Shih: *Mu'xhemu-l Buldani*, volumni i 4-t, f. 49 dhe *Tabekatu esh-Shafi'ijeti el-Kubra*, volumni i 4-t, f. 102 dhe Ibn El-Xhevziј, *El-Muntedham*, volumni i 9, f. 168, botimi i parë, viti 1359 i hixhrit.

<sup>16</sup> El-Gazali, *El-Munkidhu mine-d-dalal*, (Shpëtuesi nga Humbja), f. 25, nën kujdesin e Xhemil Saliba dhe Kamil Ajjad.

<sup>17</sup> *Tabekatu esh-Shafi'ijeti el-Kubra*, volumni i 6, f. 193.

<sup>18</sup> *Mu'xhemu-l Buldani*, volumni i 4-t, f. 49.a

<sup>19</sup> *Vefejatu-l A'ejani*, volumni i 4-t, f. 218.

<sup>20</sup> *El-Munkidhu mine-d-dalali*, f. 25.

<sup>21</sup> *Dairatu Mearif el-Karn el-Ishrin*, volumni i 7, f. 68-69.

<sup>22</sup> Ibn El-Xhuzij: Ebu-l-Ferexh: *Telbis Iblis*-(Mashttrimet e Shejtanit), f. 146. Botues: "Daru-l-Fikr li-t-tiba'ati ve-n-neshr" - Bejrut-Liban, botimi i parë, viti 2001.

<sup>23</sup> *Tabekatu esh-Shafi'ijeti el-Kubra*, volumni i 6, f. 192.

<sup>24</sup> Ibid.

shtëpie (shkolle) të diturive fetare, ku mund të gjenin qetësinë dhe sigurinë, të siguronin bukën dhe lartësoheshin me dije <sup>25</sup>.

### Studimet e El-Gazalit (465-478 të hixhrit)

Në vitin 465 të hixhrit El-Gazali filloi të mësonte fikhun (të drejtën islame) tek Shejh Ahmed Er-Radhikani në Tus.<sup>26</sup>

Këtu nuk qëndroi gjatë dhe pas një kohe, në kërkim të dijes, shkoi në Xherxhan pranë Shejh El-Ismaïlij.<sup>27</sup> Me sa duket vetëm Es-Subkij-u, i ka përmendur mësimet e El-Gazalit pranë Shejh El-Ismaïlij<sup>28</sup>, sepse një shënim të tillë nuk e gjejmë në librat e tjerë që u shkruan për historinë e El-Gazalit.<sup>29</sup> Ata mendonin se studimet e El-Gazalit u bënë në dy etapa: e para tek Er-Radhikani në Tus dhe e dyta tek El-Xhujevni në Nisabur.

Por ajo që na intereson nga Es-Subkij është një shënim nga Shejh Ismaili për Gazaliun, ku thuhet se ai kishte një qese në të cilën mbante librat e tij dhe atë ia vodhën hajdutët, kur ai po kthehej nga Xherxhani në Tus. Pasi një lutjeje të gjatë, hajdutët ia kthyen librat, por filluan të talle-shin me të, për shkak të insistimit të tij. Kjo bëri që El-Gazaliu të merrej intensivisht për tre vjet me radhë (470-473 h.) me studimin e shkencave islame, derisa i mësoi përmendsh.<sup>30</sup> Në vitin 473 h., ai udhëtoi për në Nisabur<sup>31</sup> në kërkim të diturisë pranë Ebu El-Mealij Abdulmelik El-Xhujevni, kryetar i fekihëve të medh-hebit Shafii në Nisabur dhe njëri prej teoricienëve të Esh'arizmit, drejtor i shkollës normale të tij. Ai studioi shkenca të ndryshme që njiheshin atëkohë, lidhur me fikhun, fikhun kra-

<sup>25</sup> Ibid. Ndoshta këtu do ishte më me interes të vinim në dukje se ky sufist, me siguri ka lënë ndikimin e vet të sjelljeve në mendimin e El-Gazalit që nga vitet e para të shkollimit prej tij e derisa u poq dhe filloi studimin e shkencave të ndryshme.

<sup>26</sup> *Dairatu Mearif El-Karn El-Ishrin*, volumni i 7, f. 65.

<sup>27</sup> *Tabekatu esh-Shafi'ijeti el-Kubra*, volumni i 6, f. 195.

<sup>28</sup> *Tabekatu esh-Shafi'ijeti el-Kubra*, volumni i 6, f. 195, kujton: "Pastaj shkoi në Xherxhan tek Imam Abu Naser El-Ismaïli dhe u lidh me të, pastaj u kthye në Tus.

<sup>29</sup> Shiko për shembull: Ibn El-Xhevzi, *El-Muntedham*, volumni i 9-të, f. 169 dhe Ibn Khalkan, *Vefajatu El-Aëjani*, volumni i parë, f. 102.

<sup>30</sup> *Tabekatu esh-Shafi'ijeti el-Kubra*, volumni i 6, f. 195.

<sup>31</sup> *Mu'ëxhemu-l-Buldani*, volumni i 5-të, f. 331, ku Nisaburin e kujton me fjalët: "Ai është minerali i fisnikëve dhe burim dijetarësh.

hasues, rregullat, skolastikën dhe parimet e filozofisë. Kur El-Xhujni vuri re përparimin e shpejtë tek El-Gazali, filloi të kujdesej në mënyrë të veçantë për të, aq sa pohonte për të se ai ishte një det me shumë ujë.<sup>32</sup>

Me sa duket El-Xhujni ishte krenar për El-Gazalin dhe tregonte hapur admirimin për të.<sup>33</sup>

Tregohej se ai u shpreh për talentin e tij të habitshëm<sup>34</sup> në krijimtari, pasi mbaroi librin e tij *El-Men'hul min ta'likat el Usul*,<sup>35</sup> ku i tha atij, d.m.th. El-Xhujni, Gazaliut, pasi e lexoi këtë libër: “*Më varrose të gjallë. Pse nuk prite derisa të vdes?*”<sup>36</sup>

Sapo El-Gazali mbaroi studimet e shkencave të Sheriatit pranë El-Xhujnit, filloi punën si ndihmës i tij në mësimdhënie, ndërkohë që vazhdoi kërkimet me zell të madh në shkenca të ndryshme. Ai mundi të fitonte dije në mënyrë objektive. Tek ai u shfaqën fillesat e procesit të lindjes së një dyshimi të përgjithshëm në vlerat e dijes<sup>37</sup> për efektin e njohjes. Ai nuk mundi të mos influencohej nga lufta në pikëpamje dhe artikuj që zhvillohej rreth tij...<sup>38</sup>

El-Gazali ishte i përkushtuar ndaj El-Xhujnit, i cili ishte nga fundi i ditëve të tij, ndaj nuk ia zbuloi atij synimet e veta për të zbuluar kontributin e secilit prej tarikateve në luftë me tarikatat e tjera. Kjo, sepse ai e kuptoi se duhej patjetër të ndërtohej një pengesë e fortë midis tij dhe formave të luftës, mosmarrëveshjeve dhe përçarjeve, në saje të kristalizimit të mendimeve sufiste tek ai si pasojë e ndikimit të asaj që pati mësuar për sufizmin dhe rregullat e tij pranë “Imamit asket Ebu Alij el-Fadël bin Ali

<sup>32</sup> *Tabekatu esh-Shafi'ijeti el-Kubra*, vol. i 6, f. 202.

<sup>33</sup> *Vefejatu-l-A'ejani*, vol. I 4-t, f. 217 dhe *Dairetu Mearif El-Karn El-Ishrin*, volumi i 7-të, f. 65.

<sup>34</sup> *Tabekatu esh-Shafi'ijeti el-Kubra*, volumi i 6, f. 202.

<sup>35</sup> *El-Muntedham*, volumi i 9, f. 169.

<sup>36</sup> *Ibid.* Në këtë tregim shohim krenarinë e El-Xhujnit për El-Gazalin dhe deri ku shkoi El-Xhujni kur vërejti talentin e El-Gazalit...Po të mos kishte ndodhur kështu, atëherë ai nuk do ta zgjidhte atë midis gjithë të tjerëve si bashkëpunëtor të vetin dhe ndihmës në mësimdhënie.

<sup>37</sup> *El-Munkidhu mine-d-dalali*, f. 26.

<sup>38</sup> Xhevad, dr. Mustafa: *El-Imam Abu Hamid El-Gazali*, Revista “El-Mearifetu El-Irakijatu” (Njohja Irakiane), volumi i 34-t, viti i dytë, f. 4.

el-Fermidhij et-Tusij”.<sup>39</sup> Këtu fillon një etapë e re në jetën e El-Gazalit, etapa e studimit të thellë dhe e kërkimeve personale për të vërtetën, të cilat El-Gazali i pati filluar në mënyrë të përgjithshme vetëm pas vdekjes se El-Xhujnit<sup>40</sup>.

### **El-Gazali dhe Nidhamu El-Mulki (478-484 hixhri)**

Në vitin 478 të hixhrit (që i bie në vitin 1085 të erës sonë) vdiq El-Xhujni. Vdekja e tij ishte një vijë ndarëse në jetën e El-Gazalit. Sipas historisë së qëndrimit të tij me profesorin e vet, siç e kanë shkruar historianët e tij, ai kishte për qëllim t’i qëndronte atij pranë deri në frymën e fundit. Kështu, nëse ai do t’ia kishte kushtuar El-Xhujnit edhe disa vjet, ndoshta atij nuk do t’i jepej mundësia ta takonte Nidham el-Mulkun e të bëhej njëri prej më të dalluarve që studiuuan në shkollën normale në Bagdad dhe Nisabur.

Që këtu fillon etapa e famës për El-Gazalin, kur ai vendosi të qëndronte në qytetin e ushtrive, domethënë të ushtarëve të Nisaburit,<sup>41</sup> ku ishte Nidhamu el-Mulki ministër i Selxhukëve,<sup>42</sup> i cili kishte afruar rreth vetes shumë personalitete të dalluara në fushat e ndryshme shkencore, duke pasur një ndikim të madh në jetën kulturore, nga njëra anë dhe, edhe në Fikhun Esh-Shafij e të ideologjisë el-Esh’arije, nga ana tjetër. Ai pati themeluar shkollat e njohura për përhapjen e këtij fikhu dhe për fitoren e asaj ideologjie. Kishte qenë bashkëkohës, bile bashkënxënës me El-Gazalin. Nidhamu el-Mulki Esh-Shafij El-Esh’arij pati qenë ministër i emirit

<sup>39</sup> Ai është Imami dijetar Ebu Ali El-Fadël Bin Muhammed bin Ali El-Fermidhij, pasi vinte prej Fermidh-it – një prej fshatrave të Tusit, gojëtar i Khorasanit dhe shejh i tij, autor i rrugës së mirë në edukimin e dashamirëve dhe shokëve. Ai kishte një kuvend predikimi (vazi). Vdiq në vitin 469 të hixhrit. Shih: *Sijeru Aëlamî en-Nubela*’i të Edh-Dhehebiut, volumni i 18, f. 565.

<sup>40</sup> Vdekja e El-Xhujnit ishte faktor kryesor për famën e El-Gazalit dhe të ngjitjes së tij në rangun ku arriti. Kjo sepse, nëse vdekja e El-Xhujnit do të vonohej disa vite, El-Gazali nuk do të takonte Nidham El-Mulkin, i cili konsiderohet me të drejtë shtytësi i shfaqjes së El-Gazalit në arenën politike dhe fetare, si dhe në betejat me fjalë që përputheshin me qëllimet e vetë Nidham El-Mulkut.

<sup>41</sup> *Mu’xhemu-l Buldan*, volumni i 4-t, f. 49.

<sup>42</sup> *Vefejatu-l-Aëjani*, volumni i 4-t, f. 217 dhe Uexhdij: “Deiratu El-Maarif”, volumni i 7, f. 65.



hanefij “Elb Arslan”, i biri i vëllait të “Tugrulbek” Selxhukut<sup>43</sup>. Ai, nëpërmjet themelimit të shkollave normale, synonte të forconte drejtimin Esh-Shafii dhe ideologjinë El-Esh’arije, për ta bërë atë të fitonte mbi medh-hebet e tjera, të cilat ishin në luftë midis tyre në atë kohë, sidomos rryma shiite Imamije<sup>44</sup> me rrymën Ismailije.<sup>45</sup> Kaq e ashpër qe kjo luftë saqë ky (Nidhamu el-Mulk) përfundoi i vrarë, kur lufta midis tij dhe atyre arriti në një fazë të ashpër.

Takimin i El-Gazalit me Nidham el-Mulk-un, sipas mendimit tim, do të thotë se Nidham El-Mulku, si politikan, gjeti tek El-Gazali, një personalitet të zgjuar, të ri dhe ambicioz, që njihte shkencat e kohës, me plot mendime novatore, armën e tij në luftën kundër sekteve të tjera për të cilët ushqente një armiqësi të madhe ideologjike.

Sipas Nidham El-Mulkut, El-Gazali ishte mjete me të cilin do ta realizonte qëllimin e tij dhe që medh-hebi Esh-Shafii ta zinte vendin e të gjitha medh-hebeve të tjera, sepse, sipas tij, nuk kishte vend për ideologji tjetër, përveç ideologjisë El-Esh’arije.

Pas kësaj do t’i merrte frerët e të gjitha punëve.<sup>46</sup> El-Gazali e pranoi ofertën e Nidham El-Mulkut për të dhënë mësim në Normalen e Bagdadit.<sup>47</sup> Kjo ndodhi në Xhumad El-Evvel (muaji i pestë i kalendarit hënor) të vitit 484 hixhri,<sup>48</sup> që i bie në vitin 1091 të erës sonë. Atëkohë ai nuk i kishte kapërcyer 34 vjet. “Shumë rrallë kishte ndodhur që këtë post të lartë ta merrte një dijetar në këtë moshë”.<sup>49</sup>

<sup>43</sup> Ali: Sejjid Emir: *Muhtesar Tarikh El-Arab* (Historia e Shkurtër Arabe), f. 274, përkthyer nga Afif El-Baalabekij, Shtëpia (botuese) “Dar El-Ilm Lilmelejini” –Bejrut, viti 1961.

<sup>44</sup> *Esh-Shiatu El-Imamijatu*. El-Imamija konsiderohet si tarikatit më i rëndësishëm dhe më i madh i Shiizmit. Ata mendojnë se trashëgimia e Profetit (a.s.) është detyrë e pjesëtarëve të familjes së tij, duke filluar nga Aliu, Zoti e nderoftë, e deri tek Imami i 12 i fshehur, që është Muhammed Bin El-Hasan El-Askerij.

<sup>45</sup> *Esh-Shiatu el-Ismailija*, që i përbahen Imamit Muhammed Bin Ismail. Tarikatit Ismailit është një tarikat batinij. Ndër mbiemrat e Ismailijas batinije janë Karamitat, ...Masdakijat dhe Taalimijat. Shih: Abdulkahir El-Bagdadij: *El-Ferku bejne-l fireki*, f. 46. Shtëpia botuese “Dar El-Efaki El-Xhedideti” – Bejrut, botimi i dytë, viti 1977.

<sup>46</sup> *El-Imam El-Gazali*, f. 55.

<sup>47</sup> Ibid.

<sup>48</sup> *Dairetu El-Mearif*, volumni i 7, f. 65.

<sup>49</sup> *Tabekatu esh-Shafi’ijeti el-Kubra*, volumni i 6, f. 205 dhe ato që vijnë pas kësaj f.je.

### El-Gazali në Bagdad (482-488 i hixhrit)

El-Gazali arriti në Bagdad në ditët e Kalifit El-Muktedij bi Emri El-Lahi El-Abbasij, i cili ishte shumë fetar, bamirës dhe i vendosur<sup>50</sup>. El-Gazali gjeti tek ai një mbështetës për medh-hebin dhe ideologjinë e tij.

El-Muktedij i krijoi El-Gazalit kushte të përshtatshme për veprimtarinë e tij misionare pranë Normalës së Bagdadit, pasi pati dëbuar nga kryeqyteti të gjithë elementët e këqij dhe kështu mori masa të tjera për përhapjen e moralit të lartë e për zhdukjen e korrupsionit<sup>51</sup>.

El-Gazali e meritoi titullin *Imam* falë pozitës së tij të lartë gjatë kohës që jepte mësim në Normalen e Bagdadit<sup>52</sup>, ku mësonin 300 studentë në fikh (të drejtën islame), teologji<sup>53</sup> dhe rregullat (usul)<sup>54</sup>. Kur El-Gazali arriti kulmin e suksesit hodhi vështrimin për rreth dhe pa se dijetarët ishin dhënë pas një jetese të këndshme dhe të qetë, me bindjen se librat kishin vdekur dhe se shprehjet ishin bosh<sup>55</sup>. Kështu që lëvizja e tij ideologjike ishte një punë e vështirë për rinovimin e rregullave dhe të fikhut, të shkençës së teologjisë, të filozofisë dhe së fundi të sufizmit.

El-Gazali iu dha tërësisht studimit dhe hulumtimit, pavarësisht se ishte i zënë deri në fyt me mësimin e nxënësve në Normalen e Bagdadit. Kjo ishte puna më madhështore që kishte bërë, sepse mësoi shkollat e ndryshme filozofike. Libri i tij "*Mekasidu El-Felasifeti*" (Synimi - qëllimi i filozofëve) arriti të përfshinte më të mirën e filozofisë peripatetike, të cilës iu kthye dhe e kritikoi në librin "*Tehafutu El-Felasifeti*" (Kontradiktat e Filozofëve), ku paraqitet në lartësinë e një burri që mbron fenë nga sëmundjet filozofike.

El-Gazali në Bagdad qëndronte i deziluzionuar midis famës dhe një thirrjeje të brendshme imediate që e grishte drejt shkallmimit të të gjitha

<sup>50</sup> Ali: Sejjid Emir: *Muhtesar Tarih el-Arabi*, f. 276.

<sup>51</sup> Ibid, f. 276.

<sup>52</sup> Emin: Husejn: *Et-Ta'limu fi Medreseti en-Nidhamijeti*, Revista irakiane "El-Mual'lim El-Xhedid" (Mësuesi i ri), volumni i 6, revista Nr. 18, viti 1955, f. 35.

<sup>53</sup> *Tabekatu esh-Shafi'ijeti el-Kubra*, volumni i 6, f. 200 dhe fqet që e pasojnë.

<sup>54</sup> *Et-Ta'limu fi Medreseti en-Nidhamijeti*, f. 35.

<sup>55</sup> Mazali: (Revista *El-Fikr Et-Tunisia* (Mendimi tunizian), numri 8, viti i katërt, viti (1959), f. 714-718.

shkaqeve dhe që ia nxinte jetën. Kështu filloi të shkallmojë çfarë kishin ndërtuar paraardhësit pikërisht në filozofi. Atij i erdhi në mendje t'i kritikonte bashkëkohësit e tij të fushës së arsimit apo të El-Batinijes, tek të cilët mori përmasa të mëdha implikimi i tyre politik dhe u forcua këmbëngulja e tyre deri aty sa të zgjasnin duart me thika të lyera me helm në drejtim të zemrës së gjithkujt që i mbështeste ata<sup>56</sup>.

Vrasja e Nidham El-Mulkut (viti 485 hixhri, ose 1091 i erës sonë) ndikoi thellë në shpirtin e El-Gazalit, sa që kur vdiq El-Muktedij, në vitin 487 të hixhrit, në rrethana të errëta, që mund të ishte një komplot i Batinijve gjithashtu dhe erdhi El-Mustedh-hiru Bil'lahi, ky i kërkoi El-Gazalit t'i luftonte El-Batinijët në ideologjinë e tyre, pasi midis El-Gazalit dhe El-Batinijve ekzistonte një histori e gjatë përplasjesh ideologjike në më shumë se një libër. Ai kundër tyre e shkroi posaçërisht librin "El-Mustedh-hiru, apo skandalet e El-Batinijve....."<sup>57</sup>

Pas këtij hapi, El-Gazali, pa dyshim, e pa veten të rrezikuar seriozisht nga të gjitha anët. Batinijët u vunë në përgjim dhe ndjekje të Gazalit, duke mos ia falur atij faktin se e kishte shkruar librin "El-Mustedh-hiru" dhe as për atë që fshihte brenda vetes në lidhje me luftën kundër batinijve, detyrë që ia pati ngarkuar atij El-Mustedh-hiri dhe që e pati një ndikim të qartë e të dukshëm në sjelljen e tij të pastajme.

Gazali gjithnjë u mundua të jetë një reformist (novator) fetar<sup>58</sup>, por përpjekjet e tij në disa raste nuk rezistuan përballë atyre rrymave dhe luftërave të ashpra që kishin përfshirë tarikatat dhe ideologjitë<sup>59</sup>, ashtu që tek ai ngjalli dyshimin për dijet dhe shqetësim në rritje si pasojë e frikës nga rreziqet që i kanoseshin. Kështu, ai vazhdoi të luftonte me ngulm me dyshimet e tij rreth dijes së vërtetë, si për nga vlera e tyre ashtu dhe për nga prova<sup>60</sup>, duke ndierë thellë rrezikun politik që i kërcënohej<sup>61</sup>.

<sup>56</sup> *Ebu Hamid El-Gazali*, f. 6.

<sup>57</sup> *El-Munkidhu mine-d-dalal* (Shpëtuesi nga humbja), f. 35.

<sup>58</sup> *Ibid*, f. 27, 147 – 148.

<sup>59</sup> *Ebu Hamid El-Gazali*, f. 4-6, 31-32.

<sup>60</sup> *El-Munkidhu mine-d-dalal*, f. 27, 125 – 127.

<sup>61</sup> *Tabekatu esh-Shafi'ijeti el-Kubra*, volumi i 4-t, f. 109.

E gjithë kjo e grishi atë të linte mënjanë komoditetin, paratë, lavdinë, pozitën shkencore që kishte arritur.<sup>62</sup> Parapëlqeu ndershmërinë dhe sinqeritetin, sakrifikoi të rëndësishmen në emër të më të rëndësishmes, duke bashkërenduar sjelljen e tij me pikëpamjet e tij për jetën, botën dhe ahiretin<sup>63</sup>. Atëherë vendosi të hiqte dorë nga jeta e tij plot me vështirësi, por edhe e bukur, në saje të famës së gjerë që kishte fituar<sup>64</sup>, e cila ia mundësoi, në mënyrë të vërtetë, të bëhej pikë e madhe reference për juristët Shafiij të kohës së tij.

Jakut El-Hamevij thotë: “Mori nga bota gjithçka synoi, pastaj iu përkushtua adhurimit, kreu haxhillëkun në Mekë, shkoi në Sham (Siri) dhe qëndroi një interval kohor në Palestinë (Kuds)”<sup>65</sup>.

### **Udhëtimi i El-Gazalit (488-498 i hixhrit)**

Largimi i El-Gazalit nga Bagdadi ndodhi në Dhul-ka'de (muaji i 11-të i kalendarit hënor) të vitit 488 të hixhrit<sup>66</sup>, duke u bërë asket. Ai la të vëllain Ahmedin në vend të tij, për të dhënë mësim në Normalen e Bagdadit.

Shohim se shpirti i befasishëm i sufizmit që e pushtoi jetën e El-Gazalit, ishte pasojë e pashmangshme e edukatës sufiste që pati marrë në të kaluarën e tij<sup>67</sup> dhe e cila luajti një rol vendimtar në jetën e tij më vonë, sepse ndikimi i Imam El-Fermdhij-ut ishte i dukshëm në sjelljet dhe mendimet e tij të përgjithshme, qysh kur ishte në Bagdad, gjë që i shkaktonte shqetësim.

El-Gazali na tregon: “... Pastaj u hodha një vështrim problemeve të mia dhe pashë se isha i kredhur në lidhje dashurie që më vështronte me vëmendje nga të gjitha anët. Vështrova punën time dhe më të mirën e saj - mësimin dhe mësimdhënien - dhe kuptova se isha marrë me shkenca të parëndësishme dhe të padobishme për rrugën e ahiretit... Për gati nëntë

<sup>62</sup> *El-Munkidhu mine-d-dalal*, f. 126 dhe të tjerat që e pasojnë.

<sup>63</sup> *Muhammed*, f. 714-718.

<sup>64</sup> *Tabekatu esh-Shafi'ijeti el-Kubra*, volumi i 4-të, f. 104.

<sup>65</sup> *Mu'xhemu-l Buldan*, volumi i 4-t, f. 49.

<sup>66</sup> *Vefejatu-l A'ëjan*, volumi i parë, f. 102.

<sup>67</sup> *El-Muntedham*, volumi i 9, f. 167.

muaj, duke filluar nga muaji Rexhep (muaji i shtatë i kalendarit hënor) i vitit 488 të hixhrit, vazhdova të lëkundesha midis tërheqjes që më bënte kjo botë dhe thirrjeve të botës tjetër (Ahiretit). Kur e mora veten, zgjedhja ime u bë përfundimtare, shfaqja vendosmërinë të dilja për në Mekë, ndërkohë që vetja më thoshte të shkoja në Sham... Kështu u ndava nga Bagdadi...<sup>68</sup>

Kriza ime shpirtërore përfundoi në Dhul-ka'de. Udhëtova nga Bagdadi për në Sham dhe arrita në Damask në të njëjtin vit, d.m.th. në vitin 489 të hixhrit.<sup>69</sup>

Me sa duket ekziston më tepër se një paqartësi në lidhje me jetën e El-Gazalit, pas lënies së Bagdadit për në Damask. Es-Subkij përmend se ai synonte haxhillëkun së pari dhe pastaj shkoi në Damask, ku qëndroi pak, pastaj shkoi në Kuds dhe u kthye në Damask, ku punoi pranë universitetit të tij<sup>70</sup>.

Ibn Halekani përmend diçka të ngjashme.<sup>71</sup> Por Jakut El-Hamevij thotë se ai shkoi në Haxh së pari e pastaj në Damask dhe qëndroi në Kuds për një kohë.<sup>72</sup> Ndërsa Ibn El-Xhevzi i shton diçka prononcimit të Jakutit, duke thënë se El-Gazali, pasi qëndroi në Kuds, u kthye në Damask<sup>73</sup>.

Në këtë mënyrë, tek historishkruesit ekzistojnë dy pikëpamje në lidhje me udhëtimin e El-Gazalit, plus një pikëpamje e tretë të cilës i përmbahen disa orientalistë.

Sa e rëndësishme është njohja e vendeve që përfshiu udhëtimi i El-Gazalit, po aq i rëndësishëm është edhe njohja e kohës kur ndodhi ky udhëtim.

Es-Subkij mendon se ai kaloi në udhëtim dhjetë vjet. Kjo mbi bazën e historikut që i bëri atij Abdulgafir El-Farisij - bashkëkohës i El-Gazalit<sup>74</sup>.

<sup>68</sup> *El-Munkidhu mine-d-dalal*, f. 126 dhe f.t që pasojnë.

<sup>69</sup> *Shedheratu-dh-dheheb* - (Kokrrizat e floririt), volumni i 3-të, f. 383, 384.

<sup>70</sup> *Tabekatu esh-Shafi'ijeti el-Kubra*, volumni i 6, f. 199.

<sup>71</sup> *Ibid.*

<sup>72</sup> *Vafejatu-l Aëjani*, volumni i 4-t, f. 217.

<sup>73</sup> *Mu'xhemu-l Buldan*, volumni i 4-t, f. 49.

<sup>74</sup> *Tabekatu esh-Shafi'ijeti el-Kubra*, volumni i 6, f. 19.

Ibn El-Arabiu mendon se El-Gazali u kthye në Bagdad në muajin Xhumade el-Ahire (muaji i pestë i kalendarit hënor) të vitit 490 të hixhrit dhe udhëtimi i tij zgjati plot dy vjet, të cilët i kaloi midis haxhillëkut, Damaskut, Kudsit dhe pastaj u kthye në Bagdad. Të njëjtën gjë e thotë edhe Ibn El-Imadi El-Hanbeli në *“Shedheratu-dh-dheheb”*.<sup>75</sup>

### A shkoi El-Gazali në Egjipt?

Mbështetur në pikëpamjen e dytë, El-Gazalit nuk ka e ka vizituar Egjiptin asnjëherë dhe kjo e dhënë është gabim i historianëve, ndoshta pa ndonjë qëllim. Ky konkluzion është dhënë mbi bazën e qasjes së historisë pa e kthyer kokën nga ajo që shkroi Abdulgafir El-Farisij-u dhe që na e transmeton Es-Subkij-u, i cili e pranon udhëtimin e tij në Egjipt dhe se, sipas tij, udhëtimi zgjati dhjetë vjet, që është më afër të vërtetës, sepse El-Gazali në këtë kohë ishte në kulm të krijimtarisë së tij, gjë që na bën të besojmë se ai i përpiloi gjithë këto vepra madhështore në vetëm dy vjet. Po ashtu, ne dimë se qëllimi i udhëtimit të tij në Egjipt ishte të takonte Ibn Teshifejnin. Fakt që e konfirmon këtë, janë tregimet e gojëdhënave popullore rreth ngjarjeve me të cilat u përplas në Aleksandri të Egjiptit që i tregojnë Es-Subkij dhe disa të tjerë.

Ky qe konstatimi që Es-Subkij-u ia bëri kohës së izolimit të El-Gazalit, d.m.th. udhëtimeve të tij. Kjo na ndihmon të kemi një pikëpamje të konsoliduar se udhëtimi i El-Gazalit në Egjipt dhe pikërisht në Aleksandri, për t’u njohur me fanarët e saj, është një gjë e mundur për dy shkaqe:

**E para**, refuzimi i El-Gazalit për të përfunduar udhëtimin e tij në Magreb (Maroko), d.m.th. tek Ibn Teshifejn pasi dëgjoi lajmin mbi vdekjen e tij, ndërkohë që kishte shkuar në Aleksandri <sup>76</sup>.

**E dyta**, ajo që përmendin historianët se El-Gazali kishte shfaqur kënaqësinë e tij nga Jusuf bin Teshifejn kur i lejoi vetes të mbiquhej me nofkën *“Imaratu El-Muminin”* (Principata e Besimtarëve)<sup>77</sup>. Kjo do të thotë

<sup>75</sup> *Shedheratu-dh-dhehebi*, volumni i 3-të, f. 383.

<sup>76</sup> *Tabekatu esh-Shafi’ijeti el-Kubra*, volumni i 6-të, f. 199 dhe *Vefejatu-l Aëjan*, volumni i parë, f. 102.

<sup>77</sup> Ibn Khaldun: *Kitabul-Iber* (Libri i eksperiencave), volumni i 3-të, f. 119, Shtëpia botuese: “Dar El-Kutub El-Ilmija”-Bejrut, viti 1991.

se ai ne fet'vanë (vendim i myftiut për probleme fetaro-juridike) e vet, që ia dërgoi atij, pohon vendimin e El-Gazalit për të udhëtuar në Egjipt, ku i lejoi Ibn Teshifejnit të merrte vendet muslimane të Andaluzisë (Spanjës), në kohën e mbretërve Et-Tavaa'if dhe t'ia aneksonte ato sulltanatit El-Adil.<sup>78</sup>

Nga krejt kjo mendoj se El-Gazali e bëri këtë rrugë: nga Bagdadi në haxhillëk, në Medinën e Ndritshme, në Damask, në Kuds, pastaj u kthye në Damask dhe pastaj shkoi në Egjipt.

Ndoshta këtu ekziston edhe një shkak tjetër që e bëri El-Gazalin të shkonte në Damask, duke e lënë Kuds, gjegjësisht rreziku që për të e përbënte prania e kryqtarëve në Palestinë<sup>79</sup>, si dhe për shkak se dëshironte të vizitonte Ibën Teshifejnin. Kështu që e la Damaskun dhe shkoi në Egjipt, ku Aleksandria ishte stacioni i fundit i udhëtimit të tij, ku qëndroi afërsisht deri në vitin 497 të hixhrit.

Sa i takon asaj që e thonë disa të tjerë se udhëtimi i tij në Egjipt<sup>80</sup> nuk është realizuar, pasi këtë gjë ai nuk e ka përmendur në librin e tij *El-Munkidhu mine-d-dalal*, kjo nuk qëndron sepse *El-Munkidhu mine-d-dalal* është një vepër autobiografike dhe nuk ka lidhje me regjistrimin e kushteve të jetesës së tij dhe të peripecive nëpër të cilat kaloi.

Pastaj, përpjekja për të lidhur mosvajtjen në Egjipt, sepse kryqtarët kishin zaptuar Palestinën në vitin 491 të hixhrit, nuk e mbështet fare thënien se ai ishte i rrezikuar prej tyre. Fakti që ai nuk përmend asgjë për këtë ngacmim shpirtëror në librin e tij, shpjegohet me atë se ai nuk shkruan gjithashtu asgjë për kryqtarët<sup>81</sup>.

Kjo na bën të thellohemi në analizën e qëndrimit të El-Gazalit, i cili vazhdoi të luftonte për çështjen e fesë<sup>82</sup>.

<sup>78</sup> Abdulkadir Es-Sahravij: *Xhevanibu min shahsijeti Ibn Tashifin* (Aspekte të personalitetit të Ibn Tashifin-it), Revista marokiane "Dav'atul-Hakki", numër 10, viti i tretë 1959, f. 54.

<sup>79</sup> Dr. Abdulkarim Othman: *Siretu El-Gazali ve akval el-Mutekaddimine fihi* (Biografia e El-Gazalit dhe mendimet e parardhësve për të), f. 24, Botues "Dar El-Fikër" - Damask.

<sup>80</sup> Abdurahman Bedevij: *Muel'lefat El-Gazali* (Veprat e El-Gazalit), f. 23, Botues "Dar El-Matbuati" në Kuvajt, botimi i dytë, viti 1977.

<sup>81</sup> Zekij Mubarek: *El-Ahlak inde El-Gazali* (Morali te El-Gazali), f. 18, Botuar nga "Matbaatu Dar El-Kutub" (Shtypshkronja e Shtëpisë së Librit) në Egjipt.

<sup>82</sup> Shiko parathënien e dr. Saliba dhe Kamil Ajjad-t, *El-Munkidhu*, f. 13.

### Vdekja e El-Gazalit (viti 505 i hixhrit)

El-Gazali u kthye në Bagdad nga Egjipti, por nuk qëndroi aty gjatë, pasi vazhdoi udhëtimin për në Tus<sup>83</sup>. Aty shpejt e pranoi, i imponuar, mendimin e ministrit Fahru El-Melik për të dhënë mësim në Normalen e Nisaburit<sup>84</sup>.

Koha ishte e shkurtër gjithashtu<sup>85</sup>, që nga Dhul-ka'de (muaji i 11 i kalendarit hënor) i vitit 499 të hixhrit e deri në vitin 503 të hixhrit, kur Fahr El-Meliku, i cili u vra nga Batinijtë. El-Gazali nxitoi për në Tus rishtazi dhe jetoi në Et-Tabaran, ku afër shtëpisë së tij ishte një shkollë e shkencave fetare<sup>86</sup>.

Es-Subkij njofton se kjo shkollë ishte vetëm për fakihët<sup>87</sup> me kontratë (lidhëse)<sup>88</sup> ose me Hanika<sup>89</sup> për sufizmin. Gazaliu kishte thënë: pasi veç duhet të ndahem nga kjo botë, përfundimisht do të merrem vetëm me shkencat e Ahiretit, që janë Kurani dhe Hadithi. Kjo ndodhi si pasojë e ndikimit që pati tek ai vrasja e mikut të tij, ministrit Fahru El-Melik, i cili i thoshte atij se dëshironte një jetë ku nuk do të kishte asnjë shqetësim, përveç adhurimit<sup>90</sup> dhe kuvendeve të njerëzve të zemrave<sup>91</sup>. Kështu iu plotësua dëshira.

Vdekja e tij ndodhi ditën e hënë, me 14 Xhumadel Ahir të vitit 505 të hixhrit<sup>92</sup>, që i bie janari i vitit 1111 të erës së re<sup>93</sup>. U varros në varrezat e Et-Tabaranit në Tus<sup>94</sup>. Varri i tij u bë vend vizitash dhe u vizitua edhe nga Ibn Es-Sem'ani<sup>95</sup>.

<sup>83</sup> *Vafejatu-l A'ëjan*, volumi i 4-t, f. 169.

<sup>84</sup> *El-Muntedham*, volumi i 9, f. 169.

<sup>85</sup> *Tabekatu esh-Shafi'ijeti el-Kubra*, volumi i 4-t, f. 106.

<sup>86</sup> *El-Muntedham*, volumi i 9, f. 169.

<sup>87</sup> *Tabekatu esh-Shafi'ijeti el-Kubra*, volumi i 4-t, f. 106.

<sup>88</sup> *El-Muntedham*, volumi i 9, f. 170.

<sup>89</sup> El-Khanika: Vend, ku falen sufistët dhe ku shképuten nga punët e kësaj bote, Ibn Hal-likan: *Vefejatu-l Aëjan*, volumi i parë, f. 102.

<sup>90</sup> *Mu'xhemu-l Buldan*, volumi i 4-t, f. 49.

<sup>91</sup> *El-Munkidhu mine-d-dalal*, volumi i katërt, f. 218.

<sup>92</sup> *Tabekat Esh-shafijje*, volumi i gjashtë, f. 201.

<sup>93</sup> *El-Munkidhu mine-d-dalal*, f. 28.

<sup>94</sup> *Mu'xhemu-l Buldan*, volumi i katërt, f. 49.

<sup>95</sup> *Siretu El-Gazali ve akvalu El-Mutekaddimine fihi*, f. 158.



*Dr. Islam ISLAMI*

## IMAM GHAZALI: A TRANSTEMPORAL SCHOLAR AND WISEMAN

### (Summary)

This paper aims to shed light on the biography of Imam Ghazali, one of the greatest personalities of Islam. He was awarded the title *Hujjat al-Islām (Proof of Islam)* due to his vast knowledge and communication and argumentation skills.

Imam Ghazali was the author of many books, yet one of them has a special place in Islamic libraries. His greatest work, *Ihya Ulum al-Din*, continues to be used as a reference in many Islamic universities and faculties throughout the world.

د. اسلام اسلامى

## حجة الاسلام - أبو حامد الغزالي

### (خلاصة البحث)

تسعى هذه البحث إلى إلقاء الضوء على مقتطفات من السيرة المشرفة لأحد أعظم العلماء المسلمين الإمام أبو حامد الغزالي. أطلق عليه لقب - حجة الإسلام - بسبب معرفته وقدرته على التواصل وجلب الحجج أثناء المحادثات أو المناقشات. أبو حامد الغزالي الف عديد من الكتب القيمة و لكن أحدها يحتل مكانة خاصة في المكتبات الإسلامية - "إحياء علوم الدين". هذا الكتاب الثمين حتى يومنا هذا هو المرجع الاساسى لعديد من الجامعات والكليات الإسلامية في جميع أنحاء العالم الإسلامي.

Enes KARIQ

**ME RASTIN E PETICIONIT PËR REVIZION DHE  
FSHIRJE TË AJETEVE KURANORE NË FRANCË<sup>1</sup>  
(Kë e qorton në të vërtetë Kurani?!)**

**Kurani si “leximi i antikës së mënuar”**

Nëse i kuptojmë mirë intencat kryesore të librit “Der Koran als Text-der Spätantike” (Kurani si teksti i antikës së mënuar), të shkruar nga profesoresha gjermane Angelika Neuwirth, në skenën botërore, Islami dhe Kurani vijnë në periudha të shënuar nga shumë si “dockën-kohëra” të mbetura nga antika. Kulturat dhe qytetërimet e Romës, Greqisë, Persisë..., veç kanë qenë të prekur me të madhe nga erozionet e përkohshmërisë së brendshme dhe të jashtme. Në këto erozione, antika e lashtë dhe e lavdishme kishte përjetuar goditje, shtresime dhe përfundime të shumëllojshme të veta. Historikisht e shikuar (edhe në gjurmë të pohimit të profesoreshës Angelika Neuwirth rreth Kuranit si tekst i antikës së mënuar), vetë mesazhi i Kuranit, i cili në Arabi shfaqet që nga vitet 610-632 pas Isait a.s. ose Jezu Krishtit, shënon një seri të tensioneve të fuqishme.

---

<sup>1</sup> Enes Karić, “Koga to Kur’an doista kudi?!”, **Preporod**, nr. 11/1117, 1 qershor 2018, Rijaseti i Bashkësisë Islame në Bosnje e Hercegovinë, Sarajevë, 2018, f. 6-8.

Së pari, Kurani paraqitet si libër i një besimi të qartë monoteist, si një lloj i projektit ripërtërirës, si një shfaqje e shpresës në një dhe të vetmin Zot. Kurani në politeizëm dhe paganizëm shikon si në një fragmentim të dëmshëm dhe grindës të njerëzimit. Nga ana tjetër, monoteizmi i Kuranit e nxjerr zërin për njerëzimin unitar të origjinës së përbashkët. Por, duket se vetë detyra parësore e Kuranit, nuk është nxitja e diskutimeve teologjike të komplikuar. Pikërisht për këto arsye, si libër i ri-shfaqjes së besimit në një Zot, Kurani e vë në kritikë të fortë ose qortim të formave të qeverisjes, dhe shumë prijësve paganë të kohërave të lashta dhe antike. Për shembull, surja 20, në mesin e shumë kaptinave të tjera të Kuranit, e qorton pushtetin mizor të Faraonit (kështu që, kjo sure, në mesin e shumë sureve të tjera, i merr hebrejntë në mbrojtje!). Për më tepër, surja 2: 258, aludon në sundimtarin babilonas Nemrud, kur flet për kryelartësinë dhe arrogancën e tij etj.

Në të gjitha këto pjesë të Kuranit insistohet në drejtësi ('*adl*). Kriteri i vlefshmërisë së ndonjë qeverie është e drejta dhe drejtësia, dhe jo fillimisht feja të cilën e pason sundimtari në këto vende. Kurani sikur na flet pikërisht duke na u drejtuar neve. Pra, se sundimtarët dhe qeveritë duhet të jenë të drejta, është një nga lajmërimet e fuqishme të Kuranit. Sundimtarët e mirë dhe të drejtë Kurani i lavdëron dhe i përmend si shëmbëlltyrë, p.sh. surja 2:102, e lavdëron Sulejmanin a.s. si sundimtar, (rreth tij flitet në më së paku dhjetë vende në Kuran), gjithashtu, Dhulkarnejni është përmendur (18:83 e tutje) si një sundimtar, i cili luftoi kundër pushuesve mizorë dhe i cili i mbronte të dobët etj.

Së dyti, duke u kthyer në kohëra antike, Kurani në disa vende dhe në mënyrë të përsëritur i qorton të gjitha format e marrëdhënieve shoqërore të padrejta. Këtë, Kurani e bën edhe karshi mjedisit ku është shfaqur fjala e tij për herë të parë (në një shoqëri të fragmentuar idhujtare arabe), gjithashtu edhe në tregimet e tij shqyrtuese, rreth popujve nga epokat e hershmërisë së paparashikueshme (ose brezat antikë). Kurani shpeshherë, me censurë të veçantë, ndonjëherë edhe me gjykime të mprehta, flet për popujt e vjetër dhe antikë të: Faraonit, Adit, Themudit Ejkes, Iremit, Tubbe'as etj., për shkak se i kanë përkrahur, para së gjithash, marrëdhëniet e padrejta dhe shfrytëzuese shoqërore. Ka mundësi që këtu qëndron arsyeja

se kapitujt e parë kuranorë (të së ashtuquajturës periudhës mekase), praktikisht *krahasojnë marrëdhëniet e barabarta shoqërore dhe vetëm besimin në Zot dhe Ditën e Gjykimit* (krah. p.sh.:107, 1-7).

Se me çfarë intensitet të madh Kurani qëndron në mbrojtje të drejtësisë, dëshmon një episod rreth “devesë së mbytur padrejtësisht” (krahaso: 7:77; 11:65; 91:14). Në fakt, populli i Themudit (themudianët) kishte një obligim të rëndësishëm “fetar” të sigurojnë që deveja e Salihut a.s., të ketë kohën e vetë kur të pijë ujë.

Por, themudianët asaj ia kishin ndaluar ‘*lugjenë*’ - “*kohën e pirjes së ujit*’, për më tepër, këtë deve me agresivitet dhe arrogancë edhe e kishin therur. Ndryshe nga shumë tekste antike, ku në skllavëri është shikuar si në “mënyrën normale të gjërave”, Kurani si “leximi nga antika e mënuar” nuk ka asnjë fjalë të vetme për lavdërim të skllavërisë, madje edhe as për lavdërimin e mbajtjes së njerëzve në çfarëdo kushte të skllavërisë. Përkundrajsaj, Kurani të paktën në njëzet vende e qorton skllavërinë dhe e ngre zërin fuqishëm kundër skllavërisë. Kur e afirmon Kurani konceptin e tij të ‘*abdullahut*’ (ose “Robit të Zotit”), kjo njëkohësisht do të thotë se ‘*abdullahut*’ rreptësisht i është ndaluar që të mbajë ose ta trajtojë dikë si rob (*‘abd*). Përkundrajsaj, para ‘*abdullahut*’ në Kuran vihen shumë ideale, e një nga këto është që ‘*abdullahu*’ në mesin e njerëzve të zbardh liri të dinjitetshme dhe mirësitë e saj. Nuk është e rastit se vetë Muhamedin a.s., në një vend në Kuran (72:19) e quan ‘*abdullah*’. Për fat të keq, vetë myslimanët nga gjeneratat e mëvonshme, i kanë keqkuptuar këto parime kuranore për marrëdhëniet e drejta shoqërore. Sigurisht, shumë prej perandorive dhe mbretërive myslimane kanë pasur tregti të trasuar dhe të zhvilluar me robër. Të kujtohem pak, për shembull, se Kurani e proklamoi (24:33) parimin: “*Dhe robëreshat tuaja mos i detyroni për amoralitet!*” Pikërisht, kjo aline e Kuranit, nëse faqet e Kuranit kuptohen brenda proceseve të llojllojshme të promovimit të lirisë së dinjitetshme, vetvetiu dëshmon se praktika e mbajtjes së robëreshave, haremeve, etj., një rrjedhojë antike të cilën Kurani e mbisundon dhe përfundimisht, sinjalizon rrugët e ndalimit të saj.

**Së treti**, si literaturë e antikës së mënuar, Kurani në shumë pjesë të tij qaset në skemën religjioze të mbetur nga epoka antike, skemën të cilën e

hasi, sikur një pjesë në Arabi, ashtu edhe në hapësirat aziatike, në kontinentin e Afrikës dhe të Evropës. Në këtë kontekst të referimit kritik, në të kaluarën duhet shikuar edhe qortimin kuranor, ose gjykimin e institucionit klerikal (“...shumë priftërinj dhe murgj pasurinë e botës e hanë në mënyrë të padrejtë” krah. 9:34). Kur janë në pyetje grupet fetare ose religjionet, Kurani, shkurt ose gjatë, flet për idhujtarët, hebrenjtë, krishterë, sabejtë, adhuruesit e zjarrit, adhuruesit e diellit, adhuruesit e yjeve, adhuruesit e Satanit. Natyrisht, Kurani flet edhe për komunitetin e ri i cili shfaqet, pasuesit e tij shpesh i quan “mu'mininun” (besimtarët) - fjala është për komunitetin islam e myslimanë në ngritje dhe formim. Fjala mysliman gjithashtu përmendet në Kuran. Me të përcaktohen pasuesit e Muhamedit a.s., në mënyrë gati të barabartë me të dërguarit e Zotit, të cilët ishin më herët si dhe pasuesit e tyre (p.sh. në suren 2:133, pasardhësit e Jakubit a.s., *pasardhësit hebrenjtë*, vetën e quanin *myslimanë*). Shikuar historikisht, pikërisht në dëshirën e përfshirjes së asaj që konsiderohet si përfitim pozitiv i kohërave antike, me faqet e veta, Kurani myslimanizmin e parashikon prapa, kështu që, në mënyrën e vetë, përfiton tradita monoteiste të hebrenjve, të krishterëve, etj. Me këtë veç vijnë te një pyetje me rëndësi, se si sillet në të vërtetë Kurani me trashëgiminë e hebrenjve dhe të krishterëve nga kohërat e antikës së vonshme?!

### **Njeriu si “subjekt” i qortimeve kuranore**

Por, para se të them disa fjalë për marrëdhënien e Kuranit ndaj trashëgimisë religjioze nga koha e “antikës së vonshme”, do të ishte mirë, që për shkak të marrëdhënies pranuese të drejtë, ndaj pengesave të shumta të tregimeve kuranore, të paraqiten si shembuj, kritikën kuranore ndaj Por, para se të them disa fjalë për marrëdhënien e Kuranit ndaj trashëgimisë religjioze nga koha e “antikës së vonshme”, do të ishte mirë, që për shkak të marrëdhënies pranuese të drejtë, ndaj pengesave të shumta të tregimeve kuranore, të paraqiten si shembuj, kritikën kuranore ndaj njeriut në përgjithësi. E shikuar në princip, kritikën e përgjithshme ndaj njeriut në Kuran i referohen myslimanëve, por edhe hebrenjve, të krishterëve, adhuruesve të zjarrit, sabejve, adhuruesve të yjeve etj.

Por, para se të them disa fjalë për marrëdhënien e Kuranit ndaj trashëgimisë religjioze nga koha e “antikës së vonshme”, do të ishte mirë, që për shkak të marrëdhënies pranuese të drejtë, ndaj pengesave të shumta të tregimeve kuranore, të paraqiten si shembuj, kritikata kuranore ndaj njeriut në përgjithësi. E shikuar në princip, kritikata e përgjithshme ndaj njeriut në Kuran, i referohen jo vetëm myslimanëve, por edhe hebrenjve, të krishterëve, adhuruesve të zjarrit, sabejve, adhuruesve të yjeve etj.

Në ato pjesë të tregimeve të veta, Kurani nuk bën kurrfarë përjashtimesh. Sipas shkronjës së Kuranit, njeriu është krijuar i dobët, ose si një ngordhalaq (4:28), kur është në fatkeqësi, ai nxiton kah Zoti, dhe kur të del nga fatkeqësia e harron Zotin (10:12), njeriu është përbuzës i madh (11: 9), ai është i shfrenuar (14:34), për këtë, njeriu është i ngutshëm (17: 11), ndaj Zotit është armik i hapur (16:4), si krijesë është i prirë për dëshpërim (17:83), flet se nuk do të ringjallet pas vdekjes (19:66), për më tepër, njeriu i pëlqen diskutimi në gjerësi (18:54), ai është për veten e tij, i padrejtë dhe injorant i madh (33:72), është i krijuar mendjelehtë (70:19) etj.

Shumë larg do të na çonte, nëse do të kishim shfletuar këtu gjithë atë që Kurani flet për njeriun në mënyrën e qortimit. Është me rëndësi të kihet parasysh se, Kurani nga faqet e veta, këto qortime i adreson ndaj individëve të të gjitha komuniteteve religjioze, të cilët i cilëson si myslimanë, hebrenj, krishterë, sabejë, adhurues të zjarrit. Këto qortime, thjesht janë universale dhe i referohen gjithë njerëzimit. Kjo është prova më e mirë se fjala kuranore e qorton në formë të butë edhe Muhamedin a.s., “sepse (me një rast) u kthye i mrrëshëm dhe me neglizhencë nga njeriu i verbër” (80: 110). E megjithatë, nga sa u tha rreth qortimeve kuranore për njeriun, nuk duhet të arrijmë në përfundim se Kurani njeriut i ofron një paraqitje të zezë, nihiliste dhe pesimiste. Përkundrazi, në përgjithësi është një ton i çiltër i Kuranit, kur janë në pyetje shumë njerëz të mirë të cilët i përmend ky libër. Gjithashtu, nga faqet e Kuranit spikat zëri hyjnor i cili e merr në mbrojtje njeriun dhe njerëzimin para ankesës së engjëjve, karshi krijimit të Ademit, paraardhësin e njerëzimit (2:30-37), etj.

## **A i largon Kurani hebrenjtë dhe të krishterët nga mëshira hyjnore?**

Në kërkimin shumëformësh për përgjigjet rreth pyetjes “Kë e qorton në të vërtetë Kurani?!”, është shumë e nevojshme të kemi kujdes. Kurani i ka etapat e veta të posaçme, pjesët ose anët e veta, por Kurani e ka edhe tërësinë e tij. Këto të dyja, njëra pa tjetrën nuk mund të shihen mirë. Kurse rregulli themelor i hermeneutikës së Kuranit është që teksti i Kuranit të kuptohet me bashkimin e pjesëve të tij me frymën e tërësisë së tij. Ky shënim është i rëndësishëm sa herë që dëshirojmë të kemi pamje me rëndësi të plotë se si Kurani i trajton me fakt, hebrenjtë dhe të krishterët. Tutje, nga pozicioni historik është shumë e rëndësishme të dihet edhe ajo se në cilat mësimë, çifute dhe krishtere (apo sektare) iu referohet Kurani. Paraprakisht mund të themi se Kurani ka në konsideratë ato komunitete hebraike dhe të krishtere që jetonin në shekullin e VII në gadishullin Arabik dhe në Palestinë, Siri, Egjipt etj. Sido që të jetë, rreth trajtimit kuranor të hebrenjve dhe të krishterëve këtu duhet, vetëm paraprakisht, të nxirren në pah disa gjëra të rëndësishme.

**Së pari**, nëse e përcjellim evidencën e Kuranit, ne shohim se me qortimet e veçanta flitet në lidhje me atë se hebrenjtë dhe të krishterët e kishin “marrë Zotin” vetëm si të tyrin, pra, vetës ia përshkruanin dashurinë e Zotit (krah. 9:30). Sigurisht, kjo disi aludon për debate bashkëkohore në mes të hebrenjve dhe të krishterëve në lidhje me atë se kush ka më shumë përparësi te Zoti. Por, në gjithë këtë, nuk duhet të harrojmë se Kurani me këto pjesë të veta, iu tërheq vëmendjen vetë myslimanëve se edhe ata nuk janë të dashurit me përparësi, te Zoti! (Surja 43:32), me vendosmëri mohon se vetë njerëzit janë ata që e shpërndajnë mëshirën hyjnore! Me këtë parim, Kurani, për të satën herë, njofton se Zoti - është Zot i të gjithë njerëzve, i të gjithë krijesave të Tij, i të gjitha botëve dhe universit.

**Së dyti**, komuniteti hebrenj qortohet në Kuran për shkak të qëndrimit tolerant ndaj marrjes së huasë-kamatës (4:161), dhe metodës së tillë të tregtimit me botën. Por, në mënyrë të barabartë huamarrjen dhe kamatën mizore ua ndalon edhe vetë myslimanëve (2:275),

për më tepër, myslimanëve këtu u paralajmërohet (2:279) lufta nga Zoti dhe i Dërguari i Tij, nëse merren me huanë dhe kamatën!

**Së treti**, Kurani hebrenjve ua njeh në një formë statusin e “popullit të privilegjuar” (krah. 45:16), sepse atyre u ka zbritur Libri, pastaj u është dhënë sundimi dhe peygamberllëku, etj. Prandaj, është e gabuar të konsiderohet se Kurani e mohon misionin e hebrenjve (dhe degës së tyre krishterimit) në skenën e njerëzimit. Atë që shohim në Kuran janë qortimet e disa formave të praktikës së hebrenjve, p.sh. (përveç tregtimit me hua dhe kamatë, të përmendura më sipër) përmendet edhe vrasja e të dërguarve të Zotit (2:61). Por, ky qortim në asnjë mënyrë nuk vlen vetëm për hebrenjtë, por edhe për bashkëkohësit e Muhamedit a.s., të cilët u përpoqën që ta vrisnin atë.

**Së katërti**, përkundër shumë qortimeve të traditës hebraike, Kurani prej të gjithë popujve të kohërave të lashta më së shumti flet rreth hebrenjve. Kurani në një mënyrë krejtësisht të qartë, sidomos kur bëhet fjalë vuajtjet e tyre nën sundimin e Faraonit, padyshim që është në anën e besimtarëve të singertë hebrenj, pothuajse në të gjitha tregimet që ndërlidhen me ta! Shikuar historikisht, Kurani në rrugën e vetë përfshiu të gjithë peygamberët, të dërguarit dhe profetët (Is'hakun, Jakubin, Jusufin, Musain, Harunin, Davudin, Sulejmanin). Përveç kësaj, në Kuran lavdërueshëm përmenden dijetarët (ulemaja) e bijve të Izraelit (*ulema'u bëni israil* (26: 197), të cilët e dinë shumë mirë se çka është në fakt Kurani.

Përfundimisht, siç është rasti edhe me të krishterët, përmes një numri të madh të faqeve të Kuranit, hebrenjtë përshkruhen me titullin e nderit - *Pasuesit e Librit* ose *pasuesit e shkrimit të shenjtë* (*Ehlu l-Kitab*). Të kërkohet që nga tërësia e Kuranit të hiqen pjesët që flasin rreth hebrenjve, do të thotë, që Islami të heqë dorë, ose të privohet prej një tradite, e cila në mënyrë integrale i takon.

**Së pesti**, duke lexuar tërësinë e Kuranit fitohet një përshtypje e përgjithshme se diskutimet me hebrenjtë nuk kanë të bëjnë aq shumë me pyetjet teologjike sesa për fajden/kamatën, viçin e artë, tregtinë/biznesin, mbylljen në vetvete, refuzimin në mënyrë të vrazhdë



dhe arrogante që të dëgjohet edhe ana e Muhamedit a.s. etj. Megjithatë, kur janë në pyetje të krishterët, me ta mosmarrëveshjet fillestare madje edhe të më vonshme, ndodhin kryesisht rreth pyetjeve teologjike dhe dogmatike. Sigurisht, ka pjesë nga Kurani të cilat në të vërtetë përlëvdojnë të krishterët. Për shembull, surja 5:82, njofton se besimtarëve d.m.th. myslimanëve, miqësisht u janë të afërt ata që thonë: “Ne jemi të krishterë!” Pastaj kur flitet për murgjit (5:82), tregohet se kjo dashuri e të krishterëve ndaj myslimanëve vjen nga fakti se në mesin e tyre, të krishterëve, ka edhe “murgj të cilët ndaj të vërtetës nuk janë kryeneçë!”

- Së gjashti**, mësimi rreth Trinitetit, të cilin Kurani e zbulon si dogmë krishtere (p.sh. në suren 5:73), është gjëja më e madhe e cila vendoset si linjë e diskutueshme në tërësinë kuranore, në mes të myslimanëve dhe të krishterëve. Edhe pse Kurani me fjalë të vruillshme dhe me formulimet e tradhëtisë e karakterizon besimin në Trinitet, prapë se prapë, myslimanëve u këshillohet që me të gjithë, kështu që edhe me ithtarët e librit, apo pasuesit e Biblës (përmes Kuranit të krishterët nderohen duke iu drejtuar kështu shumë herë), duhet të diskutojnë në mënyrën më të mirë (16:125).
- Së shtati**, pavarësisht kundërshtimeve, nganjëherë edhe gjykimeve të rrepta ndaj praktikave dhe dogmave hebraike dhe të krishtera, nga tërësia kuranore njihet shumë qartë dhe kuptohet se në mesin e hebrenjve, të krishterëve dhe myslimanëve, në besim, ka diçka të përbashkët, ka një fjalë të barasvlershme, ose fjalë e njëjtë “*edhe mes nesh edhe mes jush*” (3:64). Kjo fjalë e barasvlershme ose e njëjtë, natyrisht, është besimi në Zot. S’ka dyshim se me këto shpalosje, Kurani inkurajon një lloj marrëveshjeje, bashkëjetese, jetesë së bashku me hebrenjtë, të krishterët, etj.
- Së teti**, historikisht e shikuar, nuk është e panjohur se Kurani në universin e tij fetar kishte integruar edhe figurat kryesore të themelesve të krishterimit: Isa’in a.s. (Jezu Krishtit) dhe nënën e tij të respektuar Merjemen (Virgjëreshën Mari). Kur në burimin kuranor lexohen pjesët rreth Merjemes dhe djalit të saj, ne gjejmë himne të shpalljes së pakrahasueshme, me të cilat preken fshehtësitë

më të larta. Myslimanët këto pjesë i lexojnë me lot, emocionalitet dhe me devotshmëri. Siç është rasti edhe me pejgamberët e Zotit të hebrenjtë, gjithashtu edhe për tregimet rreth Merjemes dhe birit të saj, Kurani në mënyrë të qartë tregon se si e ekspozon dhe paraqet traditën e vetë themeluese të Islamit. Të kërkohet që nga Kurani të hiqen pjesët për të krishterë, pa marrë parasysh sa do të dukej absurde, kjo do të thotë se me këtë akt hiqet pjesa e një tërësie të Kuranit, e cila shikuar historikisht, kryesisht e arsyeton Islamit.

**Së nënti**, askund në Kuran nuk ka ndonjë fjali ose porosi, nga e cilat do të mund të lexohej fuqia e plotë hyjnore e dhënë myslimanëve, që të dëbojnë hebrenjtë dhe të krishterët, për shkak të dogmave dhe besimeve të tyre. Kalifatet e mëdha mund të ishin të mira apo më pak të mira, por gjithmonë kanë pasur numër të madh të banorëve jomuslimanë, hebrenj dhe të krishterë, si dhe pasues të besimeve të tjera.

Sipas Kuranit, kur të shteren të gjitha mundësitë e komunikimit dhe dialogut, mbetet në fund që të konstatohet paqësisht: *“Për ju është - besimi juaj, dhe për mua - besimi im!”* (109: 6). Zoti është - Zoti dhe Krijuesi i mirë i të gjithëve, Ai me të drejtë do të gjykojë të gjithë. Dhe në këtë botë, duhet të vazhdojmë të jetojmë së bashku, me të gjitha dallimet fetare dhe të tjera.

**Së dhjeti**, nëse Kurantin e lexojmë me gjurmë historike do të shohim se: Sa më shumë që të shkojmë kah viti 632 dhe përfundimit të shpalljes së Kuranit, shohim se hebrenjtë, të krishterët, adhuresit e zjarrit, sabejët etj..., janë komunitete veç të formuara dhe sisteme fetare tashmë të themeluara. Edhe pse Islami për të gjithë ata kishte hapur dyert e veta, pjesa më e madhe e tyre nuk është drejtuar kah ajo derë. Për këtë arsye, krejt në fund, pasoi shpallja e rëndësishme e Kuranit: *“Vërtet, ata që besuan, ata që ishin hebrenj, krishterët, sabejët (kishin lëshuar fenë e adhuronin engjëjt), kush besoi prej tyre (sinqerisht) Allahun, dhe botën tjetër dhe bëri vepra të mira, ata e kanë shpërblimin te Zoti i tyre. Për ta nuk ka frikë as*

*nuk kanë përse të pikëllohen (pasi që besuan Allahun, librat, të dërguarit në mesin e të cilëve edhe Muhamedin).” (2:62).*

Me këtë shpallje të Kuranit theksohet se në këtë botë, askush askujt nuk mund t’i jetë gardian i parajsës, por gjithashtu as edhe i ferrit.

### **A mund të jenë myslimanët të preferuarit e pakushtëzuar të Kuranit?**

Tashmë veç kemi thënë se qortimet të cilat i drejton Kurani kohë pas kohe, të referuara ndaj hebrenjve, të krishterëve dhe komuniteteve të tjera fetare (ose, pra, kohëve antike), iu referohen edhe vetë myslimanëve, në masën sa i përfshin perimetri i qortimit të tillë. Por, në qoftë se Kurani lexohet si një padi e parapërgatitur kundër hebrenjve dhe të krishterëve, atëherë në masë të madhe, do të injorohen vende të shumta në Kuran, ku ky libër i shpalljes hyjnore i qorton edhe shumë myslimanë, pra, procedurat e tyre, veprat, mirëkuptimet dhe animet. Andaj edhe këtu duhet munduar të kuptohet Kurani nga tërësia e tij.

Kurani shumë ashpër i qorton arabët (beduinët) dhe pranimin e tyre të Islamit me formalitet (49: 14-15), gjithashtu, ky libër për arabët (9:97) thotë se “janë jobesimtarë më të mëdhenj dhe hipokritët” (d.m.th., janë jobesimtarë më të mëdhenj edhe nga hebrenjtë dhe të krishterët). Në një insert nga Kurani (62:11) për disa myslimanë, bashkëkohësit e Muhamedita.s., thuhet: *“se kur të shohin ndonjë tregti ose argëtim, asaj i nxitojnë, kurse ty (o Muhamed), të lënë që të qëndrosh (në xhami)!”* Gjithashtu, surja 9:25., në mënyrë kritike flet për myslimanët, të cilët në luftën e Hunejnit, u larguan nga vendi i vatrës. *“Nuk ka dyshim se Allahu ju ka ndihmuar në shumë beteja, e edhe në ditën e Hunejnit, kur juve ju mahniti numri i madh, i cili nuk ju vlejti asgjë, dhe me gjerësinë e saj që e kishte toka u ngushtua për ju, pastaj ju u zbrapsët (ikët).”* (9:25).

Në vazhdim, Kurani i kushtëzon rreptë “një grup prej jush” myslimanët, të cilët kanë paraqitur gënjeshtër për amoralitet kundër Aishes, bashkëshortes së Muhamedit (24:11-20). Me këtë, tashmë veç kemi ardhur në të ashtuquajturit mynafikët ose dyfytërëshit dhe hipokritët, të cilët ishin shfaqur në mesin e vetë myslimanëve në Medinë, në dekadën e tretë të shekullit të shtatë pas 'Isa el-Mesihut. Në Kuran ka më shumë se njëqind

vende ku flitet për hipokritët myslimanë dhe hipokrizinë e tyre në mënyrë mjaft kritike dhe jashtëzakonisht qortuese.

Për më tepër, një kapitull apo sure e Kuranit (e 63-ta me radhë) mban emrin *El-Munafikun* ose dyfytyrëshit. Kurani askund nuk kërkon që kundër hipokritëve të nxirret shpata mizore, e as që fuqizon apo inkurajon komunitetin myslimanë për t'i vrarë ata. Përkundrazi, debati në Kuran me hipokritët. kryesisht përqendrohet në paraqitjen e provave morale kundër tyre.

Sipas asaj që kemi paraqitur, në raportin e vetë ndaj hebrenjve, të krishterëve, myslimanëve, sabijve etj., Kurani diçka pranon dhe diçka refuzon. Pikërisht kjo ishte arsyeja se gjatë shekullit të njëzetë, u zhvilluan diskutime në lidhje me atë nëse Kurani avokon, ose, në një farë mënyre, respekton pluralizmin fetar. Këto diskutime disa ende i kujtojnë. Përgjigjet ishin të ndryshme, nga fakti se pluralizmi fetar në nivel praktik, është një legjislativë e madhe e Kuranit, deri në atë se pluralizmi fetar buron nga konceptimi i Zotit në Kuran (Zoti i të gjitha botëve - *Rabbu l-alemin*). Sido që të jetë, mbetet fakti të cilin disa herë e kishte paraqitur historiani i ndjerë Bernard Lewis: “Ndryshe nga të tjerët, qytetërimi islam ishte i pari që do të mund të quhej universal, në kuptimin që ai përfshinte njerëzit e shumë racave dhe kulturave të ndryshme, në tre kontinente të ndryshëm.” (Islamic civilization, in contrast, was the first that can be called universal, in the sense that it comprised people of many different races and cultures, on three different continents).<sup>2</sup>

### Konstatime përfundimtare

Le të themi në fund të kësaj eseje, se para myslimanëve dhe njohësve të Kuranit në përgjithësi, sot qëndron detyra për t'u kthyer përsëri në leximin dhe interpretimin moral të Kuranit. Leximet ideologjike të Kuranit e shtrembërojnë mesazhin e Kuranit dhe nga ai bëjnë manifeste joshëse, por që zgjatin shkurt dhe shkaktojnë dëm të madh.

Shikuar në parim, qortimet e përgjithshme të njeriut në Kuran i referohen jo vetëm myslimanëve, por edhe hebrenjve, të krishterëve, adhuru-

<sup>2</sup> Bernard Lewis, *Cultures in Conflict*, Oxford, University Press, Oxford, 1995, f. 10.

esve të zjarrit, sabejve, adhuruesve të yjeve etj. Në ato pjesë të tregimeve të veta, Kurani nuk bën kurrfarë përjashtimesh.

Kurani në disa raste qorton të gjitha format e marrëdhënieve të padrejta shoqërore. Këtë Kurani e bën edhe karshi mjedisit ku u shfaq së pari (në një shoqëri të fragmentuar idhujtare arabe), dhe gjithashtu edhe në tregimet e tij rreth popujve nga kohët e lashta.

Askund në Kuran nuk ka ndonjë fjali ose aline nga e cila mund të lexohet “Fuqia e plotë hyjnore e dhënë myslimanëve”, për t’i dëbuar hebrenjtë dhe të krishterët, për shkak të dogmave dhe besimeve të tyre. Kalifatet e mëdha mund të ishin të mira apo më pak të mira, por gjithmonë në numër të madh kishin banorë të tyre hebrenj dhe të krishterë.

Kriteri i vlefshmërisë të ndonjë qeverisjeje është drejtësia dhe ndershmëria, dhe jo fillimisht feja në të cilën beson një sundimtar. Kurani na tregon pikërisht për këtë, gjegjësisht, sundimtarët dhe qeveritë duhet të jenë të drejtë, e që është një prej shfaqjeve të fuqishme të Kuranit.

*Nga gjuha boshnjake përktheu:*

**Azmir JUSUFI**

Ma. sc. Refik GËRBESHI

## **XHAMITË, MEJTEPET DHE SHKOLLAT E PARA NË GALLAP**

### **Abstrakt**

Pas tërheqjes së Perandorisë Osmane, në vitin 1912, Kosova ra nën sundimin serbo-malazez duke u privuar, përveç tjerash, edhe nga organizimi i mëtejshëm arsimor i besimit në gjuhën shqipe dhe institucionet arsimor kulturore të tij.

Por duke pasur figura të shumta intelektuale islame e familje me famë, organizimi dhe zhvillimi i fesë filloi të bëhej në mënyrat e mundshme. Ata lanë pas tyre hajrate, bamirësi e vakëfe, tokë e pasuri në shërbim të xhamive të cilat ndihmuan zhvillimin e kulturës islame pavarësisht pengesave që kishin nga pushtuesit.”

Megjithatë, edhe ato pak mejtepe, që i kishin mbijetuar katrahurës pas vitit 1912, u shndërruan në shkolla dhe vatra të arsimit, duke edukuar popullatën si në aspektin fetar, ashtu edhe në atë kombëtar. Në rol të tillë e luajtën edhe mejtepet e zonës së Gallapit, për të cilat do të flitet në këtë punim.

***Fjalët çelës:** Gallapi, xhami, mejtepe, shkolla, arsimi shqip etj.*

## Hyrje

Komponentë qenësorë të kulturës shpirtërore e materiale, si shprehje dhe rezultat i veprimtarisë njerëzore janë edhe objektet fetare të ngritura nga të parët tanë. Ata ngritën monumente të ndryshme e neve na mbetet ta studiojmë dhe hulumtojmë identitetin e tyre me vlerë, e më pas ta kultivojmë dhe transmetojmë atë te brezat që vijnë. Të shkruash për monumentet islame në Kosovë sa është e vështirë, por aq është edhe obligim e vullnet, sidomos kur kemi parasysh se prindërit e gjyshërit tanë ishin kontribuues për ngritjen dhe funksionimin e tyre. Gjatë periudhës disa shekulle osmane, në Kosovë u ndërtuan shumë vepra arkitektonike tipash të ndryshme, siç janë xhamitë monumentale, hamamet, urat, karvan-sarajet, hanet, kullat e sahatit medresetë, shtëpitë e banimit etj. Arkitektura islame-shqiptare ka kaluar nëpër fazat e tendencës për zhdukje dhe gjurmët e mbetura janë ende të padefinuara edhe pse mund të gjenden, sidomos te xhamitë apo objektet përcjellëse-mejtepjet, që sipas përbërjes së materialit mund të definoohen si të vjetra kulturo-historike. Vlen të ceket se, rindërtimet apo meremetimet duhet të jenë të kujdesshme që mos t'u priset konstrukti i vjetër. Pranë çdo xhamie në Gallap, kishte mejtepmësonjëtoje, të cilat ishin edhe shkollat e para shqipe në rajon.

## Monumentet e arkitekturës islame në Kosovë

Që nga shek. VII, arkitektura dhe arti islam u përhapën anekënd rruzullit tokësor. Arti islam ishte një art me vlerë në përmasa botërore. Me ardhjen e Islamit në trojet tona, së bashku me të, natyrshëm depërtuan edhe kultura e arti islam. Fillimet e ndërtimeve të veprave të artit në fjalë i hasim menjëherë pas Betejës së Kosovës, më 1389. Arkitektura islame në Kosovë, pavarësisht ndikimeve nga zhvillimet artistike të periudhës osmane, shquhet për elemente tradicionale dhe si e tillë është e dallueshme me karakteristikat autoktone shqiptare.<sup>1</sup> Shqiptarët, si banorë autokto-

<sup>1</sup> Dr. Fejaz Drançolli, "Trashëgimia Monumentale në Kosovë", Prishtinë, 2011, f. 51.

në të Kosovës, realizuan krijime me vlera dhe rëndësi historike-kulturore, një numër i të cilave lirisht mund të krahasohet me ato botërore.<sup>2</sup> Kosova përmban një thesar të pasur të monumenteve kulturo-historike në periudha të ndryshme, të cilat shquhen për lloj-llojshmërinë, cilësinë dhe rëndësinë e tyre.<sup>3</sup>

Në periudhën islame dihet se kryemjeshtrit ishin shqiptarët dhe disa arkitektë të njohur në atë kohë si arkitekt Sinani etj., që në ndërtimet e monumenteve të ndryshme, veçanërisht të xhamive, lanë emër dhe nam. Këto ndërtime të realizuara në provincat osmane duhet klasifikuar si vepër të grupit apo stilit islam-shqiptar, përkatësisht kosovar,<sup>4</sup> ngase kanë elemente të artit dhe të kulturës islame të shqiptarët në Kosovë, duke u sintetizuar dhe duke u modifikuar me motive etnike nga mjeshtrit shqiptarë. Vetë tradita e kulturës tradicionale shqiptare e gërshtuar me besimin dhe kulturën islame në shumicën e trojeve shqiptare, ndikoi pozitivisht në formimin e edukatës shqiptare.

Këto objekte monumentale i karakterizon stili islam-shqiptar i tyre, me skema dhe planimetri që kanë bazë katërkëndëshe, me hajat dhe minare. Xhamitë përbëhen prej hapësirës kryesore-sallës së lutjeve, e cila zakonisht është e mbuluar me një kube të realizuar në teknikën apo sistemin konstruktiv, punuar kryesisht me dru-dërrasa të holla. Në Gallap kemi kryesisht kulme të jashtme katër pikore, e në brendi një kupolë të improvizuar apo të ndërtuar nga dërrasa të holla, në formë disakëndëshe. Nëpër fshatra vazhdoi tradita e ngritjes së monumenteve islame që me plot të drejtë mund t'i quajmë islame-shqiptare, që është rast unik i veçantë i arkitekturës islame. Mejtepet e ngritura nga koha osmane vazhduan të funksiononin deri në kohën e pushtimit jugosllav, kur edhe u mbyllën e ndaluan. Këto shkolla fetare - mejtepet, kishin një traditë mjaft të gjatë të cilat më vonë shërbyen edhe si shkolla të para shqipe. Mejtepet kryesisht ishin në korridorin e xhamisë apo në aneks të ndarë në oborrin e saj.

---

<sup>2</sup> Dr. Fejaz Drançolli, "*Trashëgimia ...*" e cit. ,f. 14.

<sup>3</sup> Ramadan Shkodra-Sadik Mehmeti, "*Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës*" Prishtinë, 2013, f. 51.

<sup>4</sup> Dr. Fejaz Drançolli, "*Trashëgimia ...*", f. 100.



Mejtepet ishin hapur që moti dhe kanë funksionuar deri vonë, kurse ndër të parët ishte mejtepi i Brainës.<sup>5</sup>

### **Xhamia dhe mejtepi në Brainë**


Gojëdhënat tregojnë se Xhamia e Brainës është ndër të parat e ngritur në Kosovë. Supozime të ndryshme të përcjella gjeneratë pas gjenerate tregojnë se xhamia ka mbi 480 vjet. Hapësira e truallit të saj, ishte shumë e gjerë, derisa nuk filluan të ngritën edhe xhami të tjera në rajon. Xhema-të i kësaj xhamie konsiderohen shumë fshatra të Gallapit, si dhe ato të Kosovës Lindore, të banuara me shqiptarë, pjesëmarrës apo gravitues, pra kanë qenë gjithsejtë 85 fshatra.<sup>6</sup> Një gojëdhënë sqaron se me materialin e mbetur nga xhamia e Lluzhanit është ndërtuar kjo xhami me rëndësi të madhe historike për islamin te ne. Për minaren siç shihet ne foto vërehet një karakteristikë që nuk gjendet në Kosovë duke filluar që nga forma katrore e ngritjes së saj.



*Xhamia e Brainës, ndër më të vjetrat në Kosovë*

<sup>5</sup> Dr. Abdullah Vokrri, "Shkollat dhe arsimit në anën e Llapit brenda viteve 1878-1944" Pri-shtinë 1995, f. 74.

<sup>6</sup> Intervistë me imamin e xhamisë Mustafë Hajdini.



*Pllaka e ngritur në vitin 2007 që argumenton ekzistimin e mejtepit me te vjetër në rajon*

Kjo xhami konsiderohet një ndër xhamitë më vjetra në Gallup, e ndër-tuar në vitin 1766. Ndër imamët e parë, për të cilët dihet, është edhe mu-lla Bajrami nga Koliqi. Një prej imamëve të kësaj xhamie ishte edhe mulla Mustafë Braina, i cili e kishte hapur edhe mejtepin, në të cilin u jepte mësim talebeve (nxënësve) deri në vitin 1912.

Mulla Mustafë Braina e kishte kryer Medresenë në Sarajevë, shkollim-in e lartë në Stamboll, ku kishte marrë mësim edhe nga Hoxhë Tahsini. Nga dokumentet arkivore mësojmë se ai kishte pas kontakte edhe me shoqatën “DRITA” të Stambollit. Ishte hoxhë përparimtar, sepse u thosh-te masës së gjerë të popullit: “Mejtepi e ndërton xhaminë, e jo xhamia mejtepin.” Konsiderohej si njeri “i mbërrimë” apo një prej evliave të Zotit. Vdiq në vitin 1917.

Kjo xhami për rrethin ku gravitonte, kishte një rëndësi të veçantë në edukimin dhe arsimimin e popullit shqiptar, duke pasur parasysh se këtu ka ekzistuar mësonjëtorja dhe mejtepi i parë i këtij rajoni, i ngritur në vi-tin 1895 nga Hoxhë Braina, e cila njëherësh është edhe shkolla e parë fi-llore ne Brainë. Në vitin 2007 është vendosur një pllakë ku shënohet se kjo ishte shkolla e parë shqipe e këtij rajoni.


## Xhamia dhe Mejtepi në Prapashiticë

Xhamia gjendet afërsisht në mes fshatit që lidhet me rrugën e asfaltuar e cila shpie në Medvegjë. Pas luftës së vitit 1999, afër saj është ndërtuar xhamia e re. Xhamia e vjetër është jofunktionale, për shkak të dëmtimeve nga lufta, por edhe nga dhëmbi i kohës. Si



*Xhamia e vjetër e Prapashiticës*

vite të përafërta të ndërtimit të saj konsiderohen vitet 1770-1780. Sipas gojëdhënave, kjo xhami u ndërtua me kontributin e vendasve, kurse iniciator kryesor ishte Latif Ali Çarkani. Me kërkesën drejtuar Portës së Lartë në Stamboll, që xhamisë t'i lëshohej leja e të institucionalizohej xhamia dhe imami, ata kishin kërkuar që të plotësohej kushti që xhamia të kishte në pronësi një truall prej 30 dynmësh (3,351 hektarë). Pas plotësimit të këtij kushti, atyre u ishte lëshuar leja për ndërtimin e saj.<sup>7</sup> Në vitin 1879, imam ishte emëruar mulla Beqir Gajtani, muhaxhir nga rrethi (kazaja) i Nishit, i cili organizon edhe mejtepin. Pas tij ka shërbyer mulla Adem Hajrullahu. Në vitet 1912 dhe 1915,



*Minarja e veçantë*



*Shtylla e stilizuar*

<sup>7</sup> Historiku i shkurtër i xhamisë në fshatin Prapashiticë, dorëshkrim, më 2003, marrë nga imami i xhamisë Mulla Ismail Namani.

Latif Çarkani, Arif Haziri, Musë Jaha, etj., riparuan xhaminë. Punët mjeshtrërore si pullazi, shkallët e jashtme për në kat të hajatit dhe zbukurimet e gdhendura në dru i punoi Nezir Tahiri. Më 11 janar 1921, ushtria dhe xhandarmëria serbo-malazeze pas masakrës në Prapashticë e Keçekollë e dogji fshatin. Nga 1921 deri më 1941, pjesa më e madhe e kësaj prone u shfrytëzua nga kolonët serbo-malazez.

Në vitin 1941, xhamia u meremetua dhe njëkohësisht u ngrit minarja nga druri e punuar nga Shaban Rexhepi, Latif Çarkani dhe Tafë Rexhaku. Më 1944, ushtria bullgare në koalicion me partizanët serbë, sërish shkatërruan fshatin dhe demoluan xhaminë. Më 1983, Azem Sefë Fana rregulloi minaren duke ia vendosur kulmin konik nga llamarina, kurse Ramadan Namani e rrethoi sërish oborrin dhe më 1984 u vendosën dyert nga hekuri. Kjo xhami është e rrallë në tërë Ballkanin, është një shembull i rezultatit të kreativitetit të mjeshtrit kosovar, duke i përdorur materialet lokale. Materialet kryesore të ndërtesës së xhamisë janë gurët e palatuar dhe drunjtë e gdhendur. Minarja është e veçantë për trevat tona dhe e vetmja e këtij lloji në Kosovë, e ndërtuar në vitin 1941 edhe pse ato të llojit të saj janë shumë të hershme. Gjatë luftës së fundit i ishin prerë dy nga katër shtyllat nga të cilat njëra e këputur, por duke qenë e lidhur me hatullat dhe murin e xhamisë ajo nuk ishte rrëzuar. Te pjesët e ngjyrosura dominojnë ngjyra e gjelbër, e verdha dhe e kaltërta, si dhe nga pak e kuqja. Si element që duket të jetë më i vjetër është shtylla në mes të sallës së faljes, e cila është stilizuar me mjeshtri dhe paraqet një shembull të veçantë në trevat tona dhe dëshmon për origjinalitetin artistik të mjeshtrit kosovar. Mihrabi është tipik për xhamitë e periudhës së vjetër, një zgavër gjysmë cilindrike në murin e kibles që përfundon lart me hark, është i thjeshtë dhe me ngjyrë të njëjtë me murin. Një pjesë e dyshemesë pranë mihrabit, është pak më e ngritur. Minberi është i punuar nga druri me ca fleta llamarine në shkallë. Një sipërfaqe e vogël e murit e mbetur pas mimerit, është e pikturuar dhe jep të kuptosh se xhamia i kishte pasur muret e brendshme, apo pjesë e ilustruara me piktura murale. Por meqenëse muret janë zhveshur nga llaçi, kanë dalë në pah gurët. Në luftën e vitit 1999, paramilitarët serbë e demoluan xhaminë duke tentuar ta rrënojnë minaren. Sot kjo xhami, është gjysmë e shkatërruar.

### **Xhamia dhe mejtepi në Hajkobillë**

Në fshatin Gjembërishtë-Hajkobillë, në pjesën kufitare me Serbinë, ekziston mesxhidi i cili ka shërbyer edhe për fshatrat Glogovicë, Dabishec. Në kuadër të këtij mesxhidi ka funksionuar edhe mejtepi në të cilin kanë vijuar mësimet talebet (nxënësit) nga këto fshatra. Sipas Arkivit të BIK-ut, ky mesxhid u ndërtua në vitin 1830, nga banorët e fshatit me leje të pushtetit të kohës.



*Xhamia në Hajkobillë*

Është rindërtuar në vitin 1909 ndërsa në vitin 1987 ishte meremetuar salla e faljes dhe hajati, duke ia zëvendësuar këtij të fundit shtyllat e drurit me ato nga betonarmeja. Arkitektura i përket stilit të hershëm, e mbuluar me kulm të pjerrët dhe me hajat të hapur në dy etazhe sikurse ajo në Prapashticë. Ky lloj i xhamisë me hajat në kat, është i veçantë e i rrallë dhe përveç vendit tonë ai haset edhe në vende të tjera në Ballkan. Ka katin përdhes dhe katin e parë me mafil, i cili përbëhet nga ha-



*Pamja e brendshme*

jati drejtkëndësh, i hapur dhe salla katrore e faljes e mbuluar me kulm të pjerrët. Materialet kryesore janë gurët dhe llaçi nga balta, me të cilët janë ndërtuar muret. Gurët janë përdorur për themele dhe mure, ndërsa lëndët drusore për konstruktim të mureve-hatullat, hajatit, konstruksionit mes katesh, çatisë dhe elementeve të tjera në brendi, ndërsa betonarmeja për shtesat dhe dyshemënë në pjesën e poshtme të hajatit, llaç balte dhe gëlqeror për suvatim, tjegullat e vonshme mediterane për mbulesë të çatisë etj.



*Pamje e hajatit*

Tavani mbi sallën e faljes është i punuar me shikulla i cili është i vjetër dhe shumë i dëmtuar.

Kjo xhami nuk ka minare, por ka një lloj ballkoni nga një dritare me dimensione të një dere në anën e djathtë të mafilit, ku zakonisht gjendet hyrja për në minare, ngase ajo ishte e planifikuar të ndërtohet. Mafili është i punuar i tëri nga druri dhe i ngjyrosur me të gjelbër të mbylltë. Ai mbahet në tri mure dhe duke qenë mjaft i gjerë mbahet nga dy shtylla të stilizuara me heqjen e këndeve, me një nënra të përbashkët, kjo

përsëritet edhe lart. Trarët dhe shtyllat janë të formësuar me gdhendje me punë dore. Rrethoja e mafilit që sot është e dëmtuar dhe jo e plotë, kishte elemente vertikale me tipare formësuese tipike që përsëriten edhe te minberi dhe hasen në rrethoja mafilesh e çardakësh gjithandej në Kosovë. Të gjitha kornizat e dritareve kanë ngjyrë vishnje. Mihrabi është tipik për xhamitë më përmasa të vogla që janë në proporcion me ato të sallës. Ai përbën një zgavër gjysmë cilindri në murin e kibles që përfundon lart me hark. Ai ka një kornizë ngjyrë të verdhë dhe brendinë e ngjyrosur me ngjyrë pjeshke të fshirë. Minberi është i tipit të minberëve klasikë, i lartë dhe me shkallë të ngushta që përfundon me kulm, të vendosur në të djathtën e mihrabit. Është i punuar nga druri dhe i ngjyrosur me ngjyrë të

kaltër të çelë. Ai fillon me kornizën me shtylla të stilizuara e të zbukuruara, ka rrethojë të punuar me pllaka druri të formësuar dhe me parmakë. Faqet anësore përbëhen nga pllaka druri me hapje me përfundim harku. Lart gjendet kulla me kulm piramide katërfaqëshe të shkurtër me *alem* të gdhendur nga druri. Mjeshtëria popullore në ndërtimin e këtij hajati ende mund të shihet në punimin e shtyllave dhe nëntrarëve në të.

### Xhamia dhe mejtepi në Mramor

Është xhami e vjetër tradicionale shqiptaro-islame me oborr të gjerë e ndërtuar dhe rrethuar me mur nga gurët e pagdhendur, me një pus-bunar dhe ambiente të tjera përcjellëse. Ky monument i vjetër i ndërtimit sakral islam, i ndërtuar gjatë periudhës osmane (1797), konsiderohet objekt me rëndësi të lartë historike, ngase në të janë mbajtur disa tubime-pajtime me rëndësi kombëtare. Kjo xhami përmendet edhe në defte-



*Xhamia e vjetër e Mramorit*

rin kadastral të Vilajetit Vëllik, dhe është ndër xhamitë e trashëguara nga periudha osmane. Viti i ndërtimit sipas BIK-ut është 1797, ndërsa sipas gojëdhënave është e ndërtuar 300 vjet me parë.<sup>8</sup> Prej vitit 1933 deri në vitin 1939 ka punuar edhe mejtepi, i cili ka qenë i ndërtuar në oborrin e xhamisë së fshatit, ndërsa si imam kishte shërbyer mulla Zenel Tupalla, i cili kishte vazhduar punën edhe në mejtep si mësimsdhënës. Me talebet e

<sup>8</sup> Sipas imamit, Mulla Mehmet Gashi

këtushëm kanë punuar Sadik Xhemajli nga Mramori, i njohur më pseudonimin Duka i Mramorit, pas tij detyrën e imamit të xhamisë për 40 vjet e kishte kryer mulla Qamili nga Prishtina, mulla Nazifi, e pas këtij ka punuar mulla Meha i Busisë. Në këtë mejtep, mësimet i kanë ndjekur fëmijët nga Mramori e Busia, por edhe nga fshatrat e lagjet tjera si: Zllashi, Stullçakët, Veçirakët, nga Myrtajt, Byqmetet e Sylajt. Hajati është i ndër-tuar më vonë, ka qenë i tipit të hapur nga konstruksioni i drurit që nga viti 1948, kurse në vitin 1964 është mbyllur me dërrasa. Në përdhes ka hajatin, sallën e faljes të ndarë në dy pjesë me shtylla druri, kati i përbërë nga mafili, etazhi i dytë i hajatit. Streha është e hapur dhe e gjerë, strehë dyfishe nga lëndë të gdhendur druri.



*Brendësia e xhamisë*

Materialet kryesore janë gurët për themele dhe mure, lëndët e drurit për konstruktim të mureve, hatullave, shtyllave dhe konstruktonit të çatisë së piramidës së brendshme. Në vitin 2009, i është ndërtuar një objekt ndihmës-abdes’hane dhe një klasë mësimi mbi themelet e objektit të vjetër përcjellës, me një mbishkrim për ndërtimin e fundit. Kishte minaren e moçme nga druri e ngritur mbi bazamentin prizmatik të formës gjashtë këndore dhe më pas piramidës së ngushtuar deri tek unaza e parë ku fillon trupi i minares në formë cilindrike, deri tek sherefja ku trupi i minares është më i ngushtuar, deri tek çatia në formë konike dhe më mbulesë alumini për të përfunduar me simbolin e gjysmëhënës me yll. Minarja



është ndërtuar në vitin 1974, që e vërteton edhe përmbajtja e materialit, si betoni në themel dhe shkallët spirale, tullat industriale dhe llaçi për suvatim e lidhje, e cila është e mbështetur në murin e sallës nga ana jugperëndimore dhe me qasje nga mahfili. Mihrabi ka formën e gjysmërrethit, brenda i shkruar në gjerësi të murit të kibles dhe mbuluar me hark përballë derës hyrëse me një dysheme të ngritur nga niveli i dyshemesë së sallës. Minberi është nga druri me dhjetë shkallë, pa rrethojë, është i improvizuar apo mbetje nga koha e vjetër. Dy dollapë janë të punuar nga druri dhe kanë vlera të veçanta artistike së bashku me vjetërsinë. Çatia është e mbuluar me dru katër uJORë dhe tjegulla të vonshme industriale mediterane, e riparuar në vitin 1974. Tavani mbi sallën e faljes është i mbuluar me piramidën tetëfaqëshe që përfundon me një sferë dhe cilindër. Po në vitin 1974 janë veshur me llamarinë zinku piramida dhe i gjithë tavani. Piramida është e ngjyrosur më ngjyra të forta kontrast mes veti, kurse tavani i hajatit në përdhës dhe nën mafil është i veshur më llamperi në një fazë të vonshme.

### **Xhamia dhe mejtepi në Koliq**

Xhamia në fshatin Koliq është ndër xhamitë më të vjetra. Sipas Arkivit të BIK-ut, viti i ndërtimit është 1830. Xhamia e tanishme është ndërtim i vitit 1956/57, kur ishte rrënuar xhamia e vjetër dhe më poshtë saj është ndërtuar e sotmja.<sup>9</sup> Sipas gojëdhënave xhamia e vjetër ishte e ngjashme me të renë por nuk kishte minare. Nuk ka kurrfarë leje ndërtimi, edhe pse sipas gojëdhënave e kishte pëlqimin e autoriteteve osmane. Ndërtimi i



*Xhamia e vjetër e Koliqit*

<sup>9</sup> Intervistë me z. Beqir Hoxhaj, banor i Koliqit.

xhamisë së dytë apo të sotshmes sikurse edhe i minares më vonë, janë financuar dhe ndërtuar nga xhemati vendas.

Arkitektura, tavani, mafili, dyert, dritaret, minberi etj., janë të punuara nga druri. Sipërfaqja e mureve të brendshme dhe të jashtme është gëlqerosur. Në kuadër të parcelës nuk ka ndonjë objekt tjetër ndihmës. Materiali bazë i ndërtimi janë gurët për themele, tullat e plota për mure dhe minare, lëndët drunore për shtyllat e konstruksionit, llaçi gëlqeror për suvatim të jashtëm dhe të brendshëm, tjegullat mediterane, dritaret me dy rrrathë në katër faqet anësore, të parat kanë formë drejtkëndore dhe të mbuluara me arkitra druri. Hajati në përdhes shërben për abdes-hane, si dhe shkallët që shpijnë në sallën e faljes dhe mihrabin e brendashkruar në formë harku.

Çatia është e mbuluar më dru katër uJORë dhe tjegulla industriale mediterane. Për të zvogëluar hapësirën e dritës në kat, janë punuar dy shtylla druri mbi muri që mbanë hajatin dhe sallën e faljes së përdhesis. Tavani është i veshur me llamperi druri, ndërsa tavani i hajatit përdhes, ka të ekspozuar trarët e konstruksionit meqë nuk i është punuar kurrfarë veshje. Minarja është ndërtim edhe më i vonshëm, 9.5.1984, me mbishkrimin në të djathtë të saj, me çati të formës konike e të mbuluar me plumb. Sherefja ka ngjashmëri me ato të ndërtuara në Kosovë. Sherefes i prin unaza e dytë dhe fillon ndërtimi mbi katër rende tullash në kënd 45-shkallësh. Çatia përfundon me simbolin e gjysmëhënës me yll. Mihrabi ka formë të harkut, brenda i shkruar në gjerësi të murit të kibles dhe i mbuluar me hark të thepisur. Dyshemenë e ka të ngritur nga niveli i dyshemesë së xhematit dhe në të dy krahët e saj ka nga një basamak druri sa gjatësia e murit të kibles. Minberi është i punuar nga druri me rrethojë të plotë druri dhe disa dekorime druri në relief. Është i ngjyrosur me ngjyrë të gjelbër dhe me të bardhë, lart me shumë shkallë të ngushta dhe kulm konik me maje karakteristike të këtij stili.

### **Xhamia dhe mejtepi në Marec**

Xhamia e ndërtuar në vitin 1880, në lagjen Modripotok, gjendet në kufirin me Novobërdën dhe Prishtinën. Sipas matjeve kadastrale, për koincidence, kufiri i bie pikërisht në oborrin e xhamisë. Gojëdhënat sqarojnë se xhamia është ndërtuar herët dhe deri vonë ishte pa minare, pastaj është ndërtuar minarja e drurit. Në vitin 1955 është gëlqerosur, kurse në vitin 1971, është ndërtuar minarja me tulla. Në një dru në kulm është gjetur një datë që nuk është mjaft e dukshme që shënon 11 prill, por nuk shihet qartë nëse është viti 1863 apo 1963, që sipas gojëdhënave mund të jetë vetëm viti i ndërrimit të kulmit. Vërehet se rindërtimi është bërë në mënyrë profesionale për dallim nga shumë xhami të cilat janë rrënuar në anën tonë. Mejtepi ka ekzistuar herët, në të cilin ka dhënë mësim mulla Sefa nga Zllashi e hafëz Rizah Gërbeshi.



*Xhamia e vjetër e Marecit*



*Xhamia e re*

Xhamia dhe mejtepi kanë funksionuar edhe gjatë Mbretërisë SKS. Nga vitin 1900-1902, këtu nxënësit i kishin mësuar, mulla Xhafa dhe mulla Sefa i Zllashit, pas mulla Sefës, imam i kësaj xhamie ishte mulla Rama nga Janjeva, i cili përpos punës së imanit të xhamisë punoi edhe si mësime në mejtepe dhe bënte regjistrimin e fëmijëve të porsalindur, gjegjësisht e vazhdoi punën e mulla Sefës.

Në këtë mejtep, mësimit i kanë ndjekur shumë figura të njohura në Marec. Objekti i mejtepit kishte shërbyer si mejtep apo sibjan mektep, madje këtu edhe ishte hapur edhe shkolla e parë shqipe në Marec. Është ndërtim i tipit standard shqiptaro-islam me kaligrafi, piktura e murale, të cilat janë mbuluar në meremetimin e ri. Dimensionet e sallës së faljes janë ruajtur ashtu siç ishin, vetëm duke i gëlqerosur muret dhe minarja. Është hequr kupola shumëkëndëshe nga llamperitë dhe është vënë kupola me beton, kurse hajati është zgjeruar nga pjesa e minares si dhe në katin e dytë me shkallë moderne. Fatmirësisht nuk u rrëzua e vjetra që të ndërtohet e reja, por u ruajt origjinali. Mihrabi është po ai i vjetri por ka ndryshuar kaligrafia, është futur në murin e kibles me formë gjysmë rrethi nga sipër, si zakonisht përballë derës, ashtu siç ka qenë në xhaminë e vjetër, por tani është në skajin e majtë. Dyshemenë e ka të ngritur nga niveli i dyshemesë së sallës. I pikturuar me motive flore. Guri i mermerit është me kaligrafi ngjyrë të zezë në prapavijë. Minberi është i punuar nga druri masiv me rrethojë, çati konike me nëntë shkallë, sikurse mihrabi edhe kursija që janë punuar në vitin 2009, duke tentuar emetimin e të vjetrave që kanë ekzistuar. Xhamia e vjetër nuk kishte kursi, por vetëm një tavoli-

në të improvizuar afër dritares. Tavani dhe sipërfaqja e brendshme e mureve është suvatuar me gëlqere të ngjyrosur, e më pas janë pikturuar me murale kaligrafie. Përpara ka pasur piktura të rralla me relief, lule që me siguri janë mbuluar me ngjyrë. Sipërfaqja e jashtme është e suvatuar me llaç, strukturë të bardhë abrib. Oborri ka qenë i rrethuar me muri 2.5 m, me gjerësi afërsisht 0.60 cm, ndërsa tani është i rrethuar dhe ka një oborr të gjelbëruar. Me rindërtimin që iu bë nga fondacioni “Behgjet Pacolli”, në vitin 2009, është prishur hajati i vjetër dhe është rregulluar me material bashkëkohor, kurse muret e brendshme të xhamisë vetëm janë veshur me gëlqere e janë gëlqerosur.

### Mejtepi dhe xhamia në Hajvali

Sipas gojëdhënave, në Hajvali ka ekzistuar një shkollë e ulët fetare (mejtep), e cila në dokumentet e shkruara përmendet në sallnamen e Vilajetit të Kosovës të vitit 1885/6, se ky vendbanim kishte një sibijan mekteb (shkollë fillore). Iniciativa për ndërtimin e xhamisë u mor nga fshatarët në fillim të vitit 1984, kur iu drejtuan Këshillit të Bashkësisë Islame në Prishtinë e më pas edhe Bashkësisë Lokale për lejimin e ndërtimit të xhamisë. Aktvendimi me leje për ndërtimin iu dha investitorit, KBI-së në Prishtinë, pasi që i kishte plotësuar të gjitha kushtet, më 15.10.1985. Ndërtimi filloi në vitin 1985 dhe mbaroi në vitin 1987, duke u financuar kryesisht nga xhamati, mjeshtër kryesor ishte Haxhi Reshati nga Tetova.



*Xhamia e vjetër*

Në katin përdhes ka hajatin e shtuar më vonë (2005), nga i cili hyhet për në sallën e faljes e cila si zakonisht përbëhet nga dy ambiente, ai në mafil në të djathtën e së cilës gjenden shkallët për në mafil dhe hapësira me bazë katrore nën kupolën kryesore. Ka mafilin tek i cili arrihet me shkallë nga salla e faljes. Kati i aneksit ka hyrje direkte nga jashtë përmes shkallëve spirale me konstruktion çeliku. Ai përmban korridorin, zyrën e imamet, bibliotekën, si dhe një sallë për mësim dhe mbledhje për banorët e fshatit. Kjo xhami ka shumë elemente tradicionale në brendinë e sallës si, dyshemenë e ngritur në të dy krahët e hapësirës nën mafil. Përveç pikturave murale me motive flore e gjeometrike, janë trajtuar edhe elemente në tri dimensione si mihrabi, minberi e mafili.

Meremetimi dhe zgjerimi i fundit është shumë profesional me zbukurime moderne, por ka pësuar ndryshime strukturore. Minarja i përket stilit të formës cilindrike, me dy sherefë dhe çati të formës konike të mbuluar me plumb, është tipike për minaret e viteve 80. Tani ka dy minare.



*Xhamia e re*

Mihrabi përbëhet nga një drejtkëndësh prizmatik i nxjerrë nga muri i kibles me kornizë me pjesën e sipërme të valëzuar lehtë. Ai është i zgavruar në një kënd të drejtë, derisa në pjesën e sipërme të mihrabit ka një kurorëzim të plastifikuar me kaligrafi. Mihrabi është ngjyrosur me tone të së gjelbrës në të kaltër dhe me një kaligrafi ngjyrë ari. Pas meremetimit është zbukuruar mirë.

Minberi është mjaft i lartë dhe kulmi i tij arrin gati te plafoni, është i ngushtë dhe me dhjetë shkallë.

Kursija gjendet nga e majta e mihrabit në qoshe të mureve, përbëhet nga një hark i butë dhe katër shkallët paralel me murin e kibles, e veshur me dru e një qilim, ndërsa tani është nga druri me ngjyrë gështenjë. Në skajin lindor të oborrit qëndron një objekt i vogël me kulm të pjerrët i cili përmban gusulhanen, abdes'hanen dhe afër saj gjendet shatërvani i mbuluar me një kulm të pjerrët gjashtëkëndësh për marrjen e abdesit si dhe pusi-bunari pak më tutje. Muret e jashtme përbëheshin nga tulla industriale të kuqe e të bardha dhe nga sipërfaqe të suvatuara. Tullat e bardha veshin pjesën dërmuese të fasadës, përderisa e kuqja është përdorur për dekorim duke i theksuar harqet e dritareve. Ajo ka një kopsht të kultivuar mjaft mirë me shumë lule e selvi dhe në oborr gjenden gjithsej 19 pemë. Ka një sipërfaqe dhe disa shtigje të shtruara me prizma betoni që lidhin xhaminë me objektet ndihmëse dhe me hyrjet e oborrit në të cilat ka ulëse të shumta.

### **Mejtepe e xhami të tjera**

Mejtepe të tilla ka pasur edhe në Llukar, Grashticë, Makovc, Suteskë, Llabjan etj. Mejtepi në Grashticë është i ndërtuar në vitin 1946, kurse ai i Makocit është i ndërtuar shumë më herët. Sipas imamëve që kanë shërbyer këtu, mejtepi, ka filluar të punojë në vitin 1836 dhe ka vazhduar punën deri në fillimin e Luftës së Dytë Botërore. Që nga viti 1902, më mësim fetar, si hoxhë i parë ka shërbyer hafëz Qollaku, nga Prishtina. Po në këtë mejtep, mësimet i kanë vijuar edhe fëmijët nga Siçeva, Radasheci dhe Kolovica. Edhe në Suteskë ka pasur mejtep, ku mësimet fetare i kanë vijuar fëmijët e këtushëm, por edhe të fshatit Novosellë. Mësimdhënës kanë qenë mulla Smajli dhe mulla Hamdiu, nga Prishtina. Këtë mejtep e kanë kryer përveç tjerësh edhe Fehmi Gashi, Qerim Gashi e Tush Gashi. Ky mejtep e ka ndërprerë punën në fillim të Luftës së Dytë Botërore. Sipas gojëdhënave, mejtepi i Suteskës është ndërtuar para vitit 1870, më pas kishte përjetuar një vërshim diku rreth vitit 1900, dhe banorët kishin blerë një stallë ushqimi për kafshët dhe me materialin e saj e kanë rregulluar për herë të dytë. Dukë Gashi kishte qenë i pari që e ka hapur

shkollën dhe në atë kohë kanë mësuar nxënësit gjatë viteve 1941. Deri në vitin 1945 janë falur teravitë në atë mejtep, kurse në vitin 1970 ishte shkollë katërvjeçare ditën, ndërsa në mbrëmje faleshin teravitë. Prej hoxhallarëve që kanë shërbyer këtu janë mulla Hasani nga Makreshi, mulla Hamiti, mulla Smajli, Ramë Govori, një kohë të shkurtër mulla Ilaz Prapashica dhe Mustafë Gashi.

Mejtepi i Llabjanit ka funksionuar edhe pse këtu nuk ka pasur xhami. Mejtepi ka ekzistuar që nga herët, por nuk kemi shënime se kush ka qenë mësimitdhënësi i parë apo që ka vazhduar punën me talebet e këtushëm e të rrethinës.

### **Shqyrtime përfundimtare**

Nga të dhënat dhe hulumtimet e bëra rreth mejtepeve në rajonin e Gallapit, mund të vërehet qartë se arkitektura e tyre ka qenë tipike shqiptare, me interferime të vogla të kulturës osmane, kur bëhet fjalë për pikturat apo vizatimet në muret e brendshme të mesxhideve apo xhamive. Por ajo që vërehet më shumë, është fakti se shumica e këtyre xhamive, mesxhideve dhe mejtepeve, përveç mësimeve fetare islame, në rrethana të caktuara dhe në etapa të ndjeshme të popullit shqiptar, kanë shërbyer si mësonjëtoresh dhe shkolla shqipe, duke dhënë një kontribut të madh në arsimimin dhe emancipimin e popullatës së kësaj ane. Unë shpresoj, se studiuesit dhe historianët, do të hedhin edhe më shumë dritë, në këto hulumtime tona modeste rreth trashëgimisë islame-shqiptare në trevën e Gallapit.



**Literatura:**

- Dr. Fejaz Drançolli, “*Trashëgimia Monumentale në Kosovë*”, Prishtinë, 2011.
- Editore Rizzoli, “*Si ta njohim artin islam*”, Përktheu nga gjuha boshnjake Nexhat Ibrahim, Prishtinë, 2000
- Refik Gërbeshi, “*Familja e Gërbeshve*”, Prishtinë, 2012
- Izber Hoti, “*Prishtina dhe rrethina*”, Prishtinë, 2009
- Sami Isufi & Esat Ramadani, “*Xhamitë e Republikës së Kosovës*”, draft i përgatitur për botim
- R. Shkodra & S. Mehmeti, “*Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës*”, Prishtinë, 2013
- Dr. Abdullah Vokrri, “*Shkollat dhe arsimit në anën e Llapit, brenda viteve 1878-1944*”, Prishtinë, 1995

Refik GËRBESHI

## MAKTABS – THE FIRST SCHOOLS IN THE GALLAPI REGION

### (Summary)

After the decline of the Ottoman Empire in 1912, Kosova fell under the rule of Serbia and Montenegro. Consequently, Albanians were denied religious education in their language (educational and cultural institutions were banned). Yet, thanks to a vast number of Islamic intellectuals and distinguished families, the organization of religious education survived. The latter made donations, which contributed to the development of Islamic culture despite the obstacles placed in front of them by the oppressors.

Such developments were not seen favorably by the Serbs, who had occupied Kosova. According to Serb documents, the murder of Muslim scholars, the destruction of maktabs and Islamic holy sites was planned. Many religious books were burned and laws enforcing the agrarian reform were introduced seizing large surfaces of land belonging to Islamic waqfs.

The remaining maktabs were turned into schools providing religious as well as national education to the people. The role of the maktabs in the Gallapi region will be discussed in this paper.

رفيق غريشي

### الكتاتيب كانت المدارس الأولى في منطقة غالاب في بريشتينا

#### (خلاصة البحث)

بعد انسحاب الإمبراطورية العثمانية ، في عام ١٩١٢ ، سقطت كوسوفو تحت هيمنة الصرب والجبل الأسود ، وحرمت ، من بين أمور أخرى ، من تعليم الدين في ألبانيا ومؤسساتها التعليمية الثقافية.

ولكن بوجود العديد من الشخصيات الفكرية الإسلامية والعائلات الشهيرة ، بدأ تنظيم وتنمية التعليم الديني بالطرق المتوفرة. لقد تركوا وراءهم الخيرات والأوقاف، والأراضي والثروات لخدمة المساجد التي ساعدت على تطوير الثقافة الإسلامية رغم العقبات التي واجهوها من قبل المحتلين "



Bajram SHATRI

**KONTRIBUTI I BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS  
DHE INSTITUCIONEVE TË SAJ NË MBIJETESËN  
E ARSIMIT SHQIP NË KOSOVË NË PERIUdhËN  
E VITEVE 1990-1999**

**Abstrakt**

Pas ndryshimeve të dhunshme kushtetuese në Serbi në vitin 1989, filloi imponimi i ligjeve diskriminuese edhe në Kosovë, të cilës atëbotë iu suprimua autonomia substanciale, e garantuar me Kushtetutën e Jugosllavisë të vitit 1974.

Ndër segmentet e para që u goditën nga këto ndryshime kushtetuese ishte Arsimi. Duke parë këto ligje diskriminuese, në maj të vitit 1990, me propozimin e Entit Pedagogjik të Kosovës, iu kërkua organeve të Kosovës, Kuvendit dhe Këshillit Ekzekutiv si dhe Komisionit krahinor për Arsim që të mos pranohen këto ligje dhe planet të përgatitura nga Serbia dhe të ruhet sistemi i arsimit i Kosovës. Më 26 qershor të vitit 1990, Kuvendi i Kosovës i hodhi poshtë plan-programet e Serbisë, me se u krijua bazat për një sistem të ri dhe plotësisht të pavarur të arsimit shqiptar. Hapi i parë në këtë vendim ishte hartimi i planeve dhe të programeve të reja mësimore të miratuara më 24 gusht të vitit 1990 nga Pleqësia e Arsimit të Kosovës. Miratimi i këtyre planeve dhe programeve u

përdor si pretekst nga Serbia për ushtrimin e një dhune të paparë mbi arsimin shqiptar, me se fillon edhe kalvari 10 vjeçar i mbijetesës së arsimit shqip në Kosovë, deri në përfundim të luftës së vitit 1999. Ndërkohë, një ndihmesë të madhe, pothuajse titanike, e ofroi Bashkësia Islame e Kosovës, duke sistemuar mijëra nxënës në objektet e saja, të cilat u shndërruar në shkolla.

**Fjalët kyçe:** *Arsimi, Mbijetesa, Shkolla, Bashkësia Islame etj.*

## Hyrje

Me ndryshimet kushtetuese të Serbisë, të miratuara në vitin 1989, Pleqësisë së Arsimit të Kosovës iu mohuan edhe ato pak kompetenca që kishte deri atëherë. Për këtë qëllim, në vitin 1990, Pleqësia e Arsimit e Serbisë i kishte miratuar planet dhe programet e reja mësimore, si për shkollën fillore, ashtu edhe për shkollën e mesme, ndërsa Kosovës i kishte mbetur për obligim që ato t'i merrte, t'i shqyrtonte dhe eventualisht të bënte ndonjë vërejtje dhe si të tilla t'i miratonte, por me preambulë të Serbisë.<sup>1</sup>

Në maj të vitit 1990, me propozimin e Entit Pedagogjik të Kosovës, nga organet e Kosovës, Kuvendit të Kosovës, Këshillit Ekzekutiv dhe Ministrisë së Arsimit, kërkohet që të mos pranohen ligjet dhe planet e përgatitura nga Serbia dhe të ruhet sistemi i arsimit i Kosovës. Kjo letër qe shkak që, më 26 qershor të vitit 1990, Kuvendi i Kosovës të merrte vendim që të mos pranohen planet dhe programet e Serbisë, pra që të ndalohej zbatimi i ligjeve të arsimit të Serbisë. Me këtë vendim të Kuvendit të Kosovës, krijohen bazat e reja të një sistemi të ri dhe plotësisht të parvarur të arsimit shqiptar. Hapi i parë në këtë vendim ishte hartimi i planeve dhe të programeve të reja mësimore të miratuara më 24 gusht të vitit 1990 nga Pleqësia e Arsimit. Miratimi i këtyre planeve dhe programeve u

---

<sup>1</sup> Planet dhe programet mësimore të aprovuara në Pleqësinë Arsimore të Serbisë janë shpallur në Buletinin zyrtar "Prosvetni glasnik" nr. 4 deri në nr. 14 të vitit 1990.

përdor si pretekst nga Serbia për ushtrimin e një dhune të paparë mbi arsimin shqiptar.<sup>2</sup>

Pleqësia mori vendim që planet dhe programet mësimore të zbatoheshin në mënyrë suksesive që nga viti shkollor 1990/1991, duke filluar me klasën e parë dhe atë të pestë të shkollës fillore dhe me klasën e parë të shkollës së mesme.<sup>3</sup>

Miratimi i këtyre planeve dhe programeve, që për herë të parë në historinë e Kosovës frymonin shqip, u bë pretekst i ndjekjeve dhe përndjekjeve penale nga gjyqësia e instaluar serbe në Kosovë.

Fushatës antishqiptare, pushteti serb, i instaluar në Kosovë, ia kishte nisur edhe më herët, me helmimin e rinisë shkollore, sidomos me helmimin e nxënësve të shkollave të mesme (në mars të vitit 1989 si testi i parë) dhe pastaj, në të njëjtën kohë, me largimin me dhunë të të gjithë studentëve shqiptarë nga konvikti i Prishtinës, me motivacionin se po u rrezikohet jeta dhe rehatia e studentëve serbë, të ardhur diku nga Serbia.

Planet dhe programet mësimore të Pleqësisë së Arsimit të Kosovës u aplikuan në vitin shkollor 1990/1991, duke filluar me klasën I dhe V të shkollës fillore dhe me klasën I të shkollës së mesme. Sikurse në të gjitha shkollat e mesme të Kosovës, këto plane dhe programe për lëndë të përgjithshme mësimore u aplikuan edhe në klasën I të Medresesë “Alaudin”.

Reagimi i Serbisë ishte mjaft i ashpër, sepse Serbia nuk ishte “mësuar” të këtë mospranim të vendimeve të saj që nga viti 1945 e këndej. Kështu, prezenca e policisë serbe nëpër shkolla apo nëpër oborre të shkollave ishte përditshmëri. Me qëllim të futjes së frikës tek mësimdhënësit e shkollave, ata kërcënoheshin se çdonjëri që nuk i zbaton planet dhe programet mësimore të Serbisë, do të ndëshkohet, pra do të ketë pasoja.

Ndërkohë, pason akti më barbar i pushtetit policor serb, largimi i nxënësve dhe studentëve shqiptarë nga objektet e tyre shkollore. Ky proces fillon në dhjetor të vitit 1990, me mbylljen e shkollave të mesme në Podujevë, pastaj në janar të vitit 1991 me mbylljen e shkollave të mesme në

---

<sup>2</sup> Vendimi i Pleqësisë së Arsimit nr. 02 nr. 06-1224/90: Gazeta zyrtare e KSAK, nr. 29/90, dt. 24 shtator 1990,

<sup>3</sup> Mr. Zeqir Demi, vep. cit. fq. 27.

Obiliq, në Lipjan etj. Të gjithë mësimdhënësit e këtyre shkollave kishin ngelur pa të ardhura personale që nga 1 shtatori i vitit 1990.

Prej shtatorit të vitit 1990, pa të ardhura personale kishin ngelur të gjithë mësimdhënësit e klasave në të cilat u zbatuan planet dhe programet mësimore (kl. I dhe V të shkollës fillore dhe kl. I e shkollës së mesme), ndërsa prej janarit të vitit 1991 financimi iu ndërpre të gjithë mësimdhënësve shqiptarë, e nga prilli edhe të gjithë mësimdhënësve të shkollës fillore.<sup>4</sup>

Fillimi i gjysëmvetorit të dytë, në vitin shkollor 1990/1991, u politizua nga nxënësit dhe mësimdhënësit serbë, të cilët kërkonin që Serbia t'ua impononte me çdo kusht shqiptarëve që të punonin me plane dhe programe të Serbisë, si dhe të shtoheshin të ardhurat personale të mësimdhënësve sipas shtrenjtimit të kostos së jetesës. Për këtë qëllim, mësimdhënësit serbë u hodhën në grevë.<sup>5</sup> Grevat e nxënësve dhe mësimdhënësve serbë kanë zgjatur prej 21 janarit deri më 23 shkurt të vitit 1991, përkatësisht janë humbur 25 ditë mësimi.<sup>6</sup> Këto greva ndikuan që të krijohen të ardhura të diferencuara në mes mësimdhënësve shqiptarë dhe atyre serbë. Mësimdhënësit serbë, për të njëjtën punë me ata shqiptarë, realizonin deri në 50 për qind të ardhura financiare më të larta (në shkollat fillore).

Në fillim të vitit 1991, nëpër muret e shkollave ishin varur fotografitë e nacionalistëve serbë, të cilët ishin të njohur për urrejtjen e tyre ndaj shqiptarëve. Kjo bëhej me qëllim të provokimit të nxënësve e mësimdhënësve shqiptarë. Këtë komoditet atyre ua mundësonin drejtorët e dhunshëm serbë, meqë drejtorët shqiptarë ishin larguar më herët me dhunë nga shkollat.<sup>7</sup>

Përfundimi i vitit shkollor 1990/1991 u vështirësua tej mase. Drejtorët e dhunshëm serbë e malazias nuk pranuan që ky vit shkollor të ketë

---

<sup>4</sup> Mehmet Hajrizi, Ismail Kastrati, Bajram Shatri, Këshilli Qendror i Financimit i Kosovës, Prishtinë, 2007.

<sup>5</sup> Zijadin Gashi, Mbijetesa dhe pavarësia e shkollave fillore shqipe në Komunën e Prishtinës 1990-1999, Prishtinë, 2014, fq. 105.

<sup>6</sup> Prosvetni inspektori Radojko Gaçeviq i Millosh Markoviq, Rešenje - Nalaže se Gimnaziji "I. L. Ribar" u Prištini, 20.5.1991.

<sup>7</sup> R. Reshani, Nxënësit shqiptarë s'kanë të drejtë as të sëmuren!, "Shkëndija", nr. 13, mars 1991.

rrjedhë normale. Ata nuk lejuan që t'i vulosnin dëftesat e nxënësve shqiptarë. Të gjitha dëftesat dhe diplomat u nënshkruan nga drejtorët legjitimë shqiptarë, por pa vulosje.

Largimi me dhunë i nxënësve dhe i mësimdhënësve shqiptarë nga procesi i punës mësimore gjatë fundvitit shkollor 1990/1991 dhe sidomos gjatë vitit shkollor 1991/1992, pati jehonë të madhe si nga faktori vendor, ashtu edhe nga ai ndërkombëtar. Largimi më dhunë i nxënësve dhe studentëve shqiptarë ishte dëshmi së pushteti totalitar serb, i imponuar në Kosovë, nuk mund të pranonte emancipimin e rinisë shqiptare me një hov të paparë në analet e historisë së arsimit dhe kulturës.

Ndaj, të gjithë drejtorët e shkollave fillore dhe atyre të mesme, të cilët nuk i zbatuan planet dhe programet mësimore të Serbisë, nga gjykatat përkatëse, filluan të ndiqen për kundërvajtje e penalisht, duke u kërcënuar edhe me mbyllje të shkollave në gjuhën shqipe.<sup>8</sup>

“Për shkak të “përkeqësimit” të marrëdhënieve vetëqeverisëse, të “dëmtimit” të rëndë të interesave shoqërore dhe për moskryerjen e detyrave të përcaktuara me ligj, me vendim të Kuvendit të Republikës së Serbisë, në Krahinën Autonome të Kosovës e Metohisë, gjatë viteve 1990 dhe 1991 u aplikuan “masat e përkohshme” në organizatat dhe institucionet vijuese:

1. Qendrën e fëmijëve “Gjurgjevak” në Prishtinë, më 1.4.1991
2. Shkollën teknike “Nikolla Tesla” në Obiliq, më 26.11.1990
3. Shkollën teknike “Boris Kidriç” në Mitrovicë, më 24.5.1991
4. Qendrën e Arsimit të Mesëm në Lipjan, më 26.11.1990
5. Qendrën shkollore “Vëllezërit Ribar” në Istog, më 11.10.1990
6. Qendrën shkollore speciale “S. Mojsiq” në Prizren, më 28.12.1990
7. Shkollën e lartë teknike në Zveçan, më 1.7.1991
8. Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, më 31.7.1992
9. Rektoratin e Universitetit të Prishtinës, më 31.7.1990
10. Në të gjitha fakultetet e Universitetit të Prishtinës, më 26.7.1991
11. Qendrën e studentëve në Prishtinë, më 25.11.1991
12. Entin e Teksteve dhe Mjeteve Mësimore, më 23.10.1990

---

<sup>8</sup> Këshilli për Mbajtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut, Buletini, nr. 1/1991, f. 17.



13. Qendrën e studentëve dhe të nxënësve të shkollave të mesme “Todor Miliçeviq” në Mitrovicë, më 22.5.1991
14. Në konviktin e shkollës së mesme në Kamenicë, nëntor 1991<sup>9</sup>.

Megjithatë, viti shkollor 1991/1992 ishte viti më i vështirë në histori të arsimit shqip në Kosovë. Të gjithë nxënësit e arsimit parauniversitar dhe studentët e Universitetit të Prishtinës u larguan me dhunë nga objektet e tyre shkollore.

Pritja e fillimit të vitit shkollor 1991/92 ishte pritje e gjatë e me shumë dilema. U bënë demonstrata të formave të ndryshme me qëllim të lejitimit të fillimit të vitit shkollor në objektet shkollore, por të gjitha këto forma të protestës nuk patën sukses, përveç asaj se u sensibilizua çështja e së drejtës shqiptare për t’u shkolluar në gjuhën amtare.

Kishte dilema se si të veprohej për të filluar vitin shkollor apo të humbnin një vit shkollor duke menduar se faktori ndërkombëtar do të bënte presion mbi pushtetin serb, i cili do të detyrohej të lironte arsimin shqip në objektet shkollore. Dominoi bindja se megjithatë duhet të mos humbiste viti shkollor, sepse do të kishte pasoja të rënda për vitet vijuese.

Pas shumë përpjekjeve për të hyrë në objektet shkollore, pas shumë shtyrjeve për të filluar organizimi i mësimin në çfarëdo mënyre, më në fund, nga strukturat arsimore të Kosovës, u vendos që viti shkollor 1991/1992 të fillonte më 20 janar të vitit 1992 në objektet shtëpi-shkolla. Mobilizimi i popullatës shqiptare, në përgjithësi, dhe i punëtorëve të arsimit, në veçanti, ishte i paparë dhe i paimagjinuar. Edhe skeptikët më të mëdhenj nuk kanë mundur të parashihnin se populli shqiptar do të gjente mënyrë dhe rrugëdalje nga mbyllja e shkollave në gjuhën shqipe.

Më në fund, u bë zgjidhja e vetme e mundshme, organizimi i mësimin në lokalet shtëpi-shkolla. Në shtëpi-shkolla punuan mbi 40 shkolla fillore, të gjitha shkollat të mesme dhe të gjitha shkollat e larta dhe fakultetet e Universitetit të Prishtinës.

Viti shkollor 1991/92 nuk rifilloi në të gjitha shkollat e mesme më 20 janar. Disa prej tyre, për shkak të ndjekjeve që bënte policia, apo për

<sup>9</sup> Bajram Shatri, Arsimi dhe shkollat e mesme në Kosovë në shekullin XX (dorëshkrim).

shkak të pamundësisë për sigurimin e lokaleve përkatëse, u detyruan që procesin mësimor ta fillonin gjatë muajit shkurt. Shumica e shkollave punuan në shtëpi-shkolla, por pati disa prej tyre që procesin mësimor e organizuan sipas punkteve në lokalet e shkollave fillore, apo procesin mësimor e mbanin në formë të konsultave me nxënës, siç u veprua në Dragash etj.

Shkollat nuk kishin përvojë në organizimin e mësimimit në shtëpi-shkolla. Në disa komuna (Istog, Deçan, Suharekë, Shtime etj.) secila paralele mbante mësim në një shtëpi (odë burrash - nëpër fshatra) dhe kishte aq shtëpi sa kishte paralele. Mësimdhënësit udhëtonin prej një shtëpie në një shtëpi.<sup>10</sup> Ishin të rralla ato shkolla, të cilat ishin të sistemuara vetëm në një shtëpi. Orët e mësimimit mbaheshin “në bllok”. Një mësimdhënësi fondin javor të orëve e mbante për një ditë.

Në vitet vijuese, në shumicën e shkollave, nxënësit dhe mësimdhënësit u sistemuan në një apo disa lagje të qyteteve me numër më të vogël të shtëpive, por me numër më të madh të dhomave si në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren etj.

Gjatë viteve 1992-1999, shtëpitë e tyre i liruan mbi 3.000 kryefamiljarë, nga 1 deri në 20 dhoma.

Përveç pronarëve të lokaleve shtëpi-shkolla, kontribut të jashtëzakonshëm dhanë edhe bashkësitë fetare, sidomos Medreseja dhe mejtepet e xhamive anekënd Kosovës.

### **Medreseja “Alauddin” ndau fatin e njëjtë me të gjitha shkollat e Kosovës**

Fatin e arsimit shqiptar në përgjithësi e ndau edhe Medreseja “Alauddin”. Ajo, edhe pse nuk u pengua drejtpërdrejt për organizimin e mësimimit, pati pengesa të shumta, meqë u angazhua në rrjedhat e aktualitetit politik, shoqëror dhe arsimor e kulturor të Kosovës.

Mbijetesën, jo vetëm të arsimit, kjo medrese e ndihmoi në forma dhe në mënyra të ndryshme.

---

<sup>10</sup> Shih B. Shatri, *Arsimi shqip në Kosovë 1990-1999*, Prishtinë, 2010.

Medreseja “Aluadin” në Prishtinë, si shkollë e mesme e ulët vepron prej vitit 1951, ndërsa si shkollë e mesme profesionale pesëvjeçare fillon prej vitit shkollor 1962/63. Nxënësit e saj ishin ndër më të mirët. Për t’u regjistruar në këtë shkollë të mesme, nxënësit është dashur të kenë treguar sukses të shkëlqyeshëm në shkollën fillore. Vijuesit e kësaj shkolle ishin nga të gjitha trojet shqiptare të ish-Jugosllavisë.

Edhe mësimdhënësit e saj, që nga fillimi, ishin ndër profesionistët më të përgatitur të kohës. Në procesin mësimor, përveç mësimdhënësve të fesë, kishte edhe mësimdhënës nga shkollat tjera të mesme për lëndët e përgjithshme siç ishin: gjuha shqipe, historia, gjeografia, biologjia, psikologjia, pedagogjia, edukata fizike etj. Këto lëndë mësimore ishin të njëjta me shkollat e tjera profesionale, të miratuara nga Pleqësia e Arsimit të Kosovës.

Kushtet e punës në këtë shkollë ishin mjaft të volitshme, sidomos pas sistemimit në objektin e ri shkollor në vitin 1985.

Medreseja, gjatë gjithë periudhës së viteve të nëntëdhjeta, i pati dyert të hapura për të gjitha format e organizimit të jetës arsimore, kulturore, shkencore, politike, sportive etj.

Ky institucion i rëndësisë së veçantë për besimtarët myslimanë, gjatë dekadës së fundit të shekullit të kaluar, ishte simbol i rezistencës kombëtare ndaj politikës gllabëruese serbe.

Me rastin e dëbimit të studentëve nga konviktet në vitin 1989, solidariteti i popullatës së Prishtinës ishte shumë i lartë. Këtu prapë duhet veçuar Medreseja “Alauddin” e Prishtinës, përgjegjësit e së cilës i strehuan studentët e shumtë, të cilët kishin ngelur rrugëve, duke u siguruar strehim, ushqim, dhe përkujdesje prindërore.

Medreseja u ofroi ndihmë të pakursyer shumë institucioneve arsimore e shkencore të Kosovës, si Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Senatit të Universitetit të Prishtinës, Institutit Albanologjik, Institutit të Historisë, Ministrisë së Arsimit, Bashkimit të Pavarur të Sindikatave të Kosovës, partive politike etj.

Në amfiteatrin e Medresesë “u mbajtën 1230 tubime, që nga kongrese të ndryshme, seminare, sesione shkencore”. Pothuajse të gjitha partitë më të mëdha politike të Kosovës i mbajtën aty kuvendet e themelimit. U

mbajtën shumë manifestime, përvjetorë, koncerte, gara nxënësish në nivel të Kosovës e më gjerë, recitale, shfaqje filmash dhe dokumentarësh, shumë promovime librash, mbrojtje diplomash, magjistrature dhe doktore, mbledhje të Senatit të Universitetit të Prishtinës.

Kuvendi i Universitetit të Prishtinës i ka mbajtur disa mbledhje, në të cilat janë trajtuar çështje shumë të rëndësishme rreth funksionimit të arsimit të lartë. Isha prezent në mbledhje të Senatit të Universitetit të Prishtinës të mbajtur më 1 qershor të vitit 1994, në të cilën duhej të miratohej dekretligji i Universitetit. Posa filloi mbledhja, në sallë u fut policia, e cila i arrestoi rektorin Ejup Statovcin, Fetah Berishën (kryetar i senatit), Salih Maqedoncin, prof. dr. Xhavit Ahmetin dhe sekretarin e Universitetit, Destan Halimin<sup>11</sup>. Me këtë rast u maltretua dhe u mor në stacionin policor drejtori i Medresesë - Qazim Qazimi dhe u maltretua fizikisht një punëtor teknik i kësaj shkolle. Drejtori Qazim Qazimi, edhe në ato momente të vështira të maltretimt nga policia serbe, drejtuesve të Universitetit u premtoi se dyert e Medresesë do të jenë të hapura çdoherë.<sup>12</sup>

Fakulteti i Kulturës Fizike, mësimin teorik gjatë viteve 1992-1999 e ka mbajtur, sikurse të gjitha fakultetet e tjera, në lokalet shtëpi-shkolla, por kishte vështirësi për organizimin dhe mbajtjen e ushtrimeve fizike-sportive, të cilat kërkonin një hapësirë më të gjerë dhe Medreseja "Alaudin" u doli në ndihmë, duke ua siguruar sallën e edukatës fizike, që u shfrytëzua nga studentët dhe mësimdhënësit që nga fillimi, nga viti 1992 e deri në vitin 1999. Kushtet e kësaj sale ishin jashtëzakonisht të përshatshme për organizimin e të gjitha llojeve të ushtrimeve fizike dhe sportive.

Në mbarëvajtjen e punës së këtyre institucioneve u përkujdesën të gjithë punëtorët e kësaj shkolle: mësimdhënësit, punëtorët teknikë dhe punëtorët administrativë. Kontribut të veçantë në këtë aspekt dhanë sidomos drejtorët e shkollës, të cilët sakrifkuan veten, punëtorët dhe bashkëpunëtorët e shkollës, familjet e tyre, por asnjëherë nuk ishin në dilemë se a duhet të shndërrohej ky tempull i diturisë islame në tempull të dijes dhe të shkencës, tempull të arsimit dhe të kulturës shqiptare, tempull të shumë

<sup>11</sup> Raport i gazetarit Ymer Avdiu, "Bujku", 2 qershor 1994.

<sup>12</sup> Deklaratë e Destan Halimit, sekretar i Universitetit, më 1994.

vendimeve me karakter kombëtar e shtetëror. Këtu do t'i veçoja ata që patën fatin të kontribuojnë dhe t'i dëshmojnë vlerat kombëtare në dekadën e fundit të shekullit të kaluar. Pra, drejtorë ishin:

1. Resul Rexhepi 1987-1991;
2. Qazim N. Qazimi 1991-1995;
3. Naim Tërnavë 1995-1999 dhe 1999-2003 (në dy mandate), dhe
4. Sekretari Sylejman Osmani.

Me mbështetje të drejtorisë së Medresesë “Alauddin” dhe të parisë së Bashkësisë Islame, praktikën e kësaj medreseje e ndoqën edhe ish-nxënësit e saj të inkuadruar si imamë të xhamive anekënd Kosovës.

Mejtepet e xhamive dhe lokalet e bashkësive islame në shumë mjedise u shndërruan në shkolla shqipe<sup>13</sup>: në shkolla fillore, në shkolla të mesme, në shkolla të larta dhe në fakultete. Në disa sosh procesi mësimor është mbajtur për një kohë të shkurtër, për një apo dy vjet, por pati edhe të atilla në të cilat gjatë tërë kohës sa është vepruar dhe punuar jashtë objekteve shkollore, lokalet e tyre i kanë lënë në dispozicion të këtyre institucioneve. Raste të tilla pati kudo në Kosovë, ku më pak e ku më shumë, aq sa ishte e nevojshme dhe aq sa ishte kërkuar nga ato. Nuk dihet ndonjë rast që të jetë kërkuar nga udhëheqësit e këtyre xhamive që t'i lirojnë lokalet për organizimin e mësimin apo edhe të takimeve të tjera të përfaqësuesve të institucioneve të arsimit e që të kenë refuzuar.

Në vazhdim po i potencojmë xhamitë në të cilat është punuar gjatë viteve 1992-1999.

---

<sup>13</sup> Xhamitë kishin përvojë të gjatë të organizimit të mësimin në lokalet e tyre që nga viti 1945 e këndeje, sepse në mungesë të lokalit të mjaftueshëm mësimor nxënësit e shumë shkollave fillore sistemoheshin në mejtepet e këtyre xhamive. Në fshatin e vendlindjes sime, në Tomoc më se 5-6 vite (1945-1952) nxënësit shqiptarë të selisë së shkollës në Gurakoc, në mungesë të lokalit mësimor, ishin të sistemuar në xhaminë e fshatit. Në lokalet e xhamive gjatë periudhës së pas Luftës Dytë Botërore janë organizuar edhe kurset kundër analfabetizmit dhe kurset shëndetësore.

### **Dragash**

Nxënësit e shkollës së mesme “Emin Duraku” të Dragashit ishin dëbuar me dhunë nga objekti i tyre shkollor. Në ndihmë atyre u doli e tërë popullata shqiptare. Kontribut të veçantë për përkujdesjen dhe mirëvajtjen e procesit mësimor për nxënësit e kësaj shkolle dhanë imamët e xhamive në fshatrat Brodosanë, Buçe, Blaç, Kapre dhe Pllavë. Në këto objekte fetare nxënësit e shkollës së mesme u sistemuan që nga viti shkollor 1991/1992 e deri në vitin shkollor 1993/1994.

### **Ferizaj**

Shkolla fillore “Abetarja” në Softaj, paralelja e ndarë në Sazli u ndoq me dhunë nga objekti shkollor me rreth 60 nxënës, të cilët u sistemuan në mejtepin e xhamisë së fshatit Sazli, në dy lokale. Në këtë objekt u punua disa vite shkollore në dy ndërrime.

### **Istog**

Në xhaminë e fshatit Tomoc, Bashkësia Islame lejoi dhe ndihmoi në ngritjen e objektit mësimor në oborrin e saj. Objekti kishte 5 dhoma mësimi, në të cilat u sistemuan nxënësit e shkollës fillore të Gurakocit.

### **Gjakovë**

Gjimnazi “Hajdar Dushi” për një vit, përkatësisht 2 vjet, shkolla ka punuar në mejtepin e Xhamisë së Hadumit dhe në Teqenë e Bektashive.

Në të njëjtat objekte kanë punuar edhe nxënësit dhe mësimdhënësit e shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi” në Xhaminë e Hadumit dhe në Teqenë e Bektashive.

Shkolla e mesme ekonomike “Kadri Kusari”, për 6 vite shkollore ka punuar në xhaminë e Gecës dhe në Xhaminë e Sefës, klasat III dhe IV.

Shkolla e mesme teknike “Nexhmedin Nixha” ishte sistemuar në Xhaminë “Haxhi Ymeri”, ku në 3 dhoma kanë punuar 6 vite shkollore.

### **Obiliq**

Shkolla e mesme e Obiliqit, për një kohë, ishte e sistemuar në xhaminë e fshatit Dardhishtë.

### **Mitrovicë**

Shkollat e mesme të **Mitrovicës**, kush më shumë e kush më pak, i kanë shfrytëzuar dy xhami:

1. Xhaminë e Haxhi Veselit në Mitrovicë;
2. Xhaminë e lagjes së Zhabarit.

#### *Shkolla e Lartë Teknike e Mitrovicës*

Edhe studentët e kësaj shkolle të lartë për një kohë ishin të sistemuar në:

1. Lokalet e Bashkësisë Islame në Mitrovicë.

### **Pejë**

*Nxënësit e shkollës së artit figurativ “Odhise Paskali”* në Pejë u sistemuan edhe në lokalet e:

1. Hamamit të xhamisë afër shkollës fillore “8 Marsi”, ku është mbajtur mësimi i rregullt prej vitit 1995 deri në vitin 1999.

#### *Shkolla e Lartë Komerciale e Pejës*

Studentët dhe mësimdhënësit e kësaj shkolle të lartë, pas dëbimit nga objekti shkollor, u sistemuan në:

1. Lokalet e Xhamisë së Gjyl Fatynit, e cila i liroi 3 lokale në vitin shkollor 1994/95;
2. Bashkësia Islame në Pejë, liroi një lokal në vitet shkollore 1997/98 dhe 1998/99;

### **Prishtinë**

#### *Fakulteti Elektroteknik dhe një departament i Fakultetit Filologjik*

Procesin mësimor e mbajtën në Xhaminë “Sudi Efendi”, në një lokal, është punuar gjatë viteve 1992/93-1998/99;

Studentët dhe mësimdhënësit e këtyre fakulteteve prej vitit akademik 1992/93 e derisa u kthyen në objektin e tyre ishin të sistemuar në një lokal të Xhamisë së “*Mehmet Beg*”

*Fakulteti i Shkencave Natyrore Matematikore*

Gjatë viteve që është punuar jashtë objekteve të tyre shkollore studentët dhe mësime të tjerë kanë punuar edhe në mejtepin e Xhamisë së “*Jusuf Qelebi*” në Prishtinë.

**Prizren**

Në Komunën e Prizrenit të gjitha (5) shkollat e mesme në vitin shkollor 1991/92 ishin dëbuar nga objektet e tyre shkollore, sikurse edhe Shkolla e Lartë Pedagogjike.

Shkollat e mesme, procesin mësimor e kanë organizuar dhe zhvilluar në lokalet shtëpi-shkolla, por për një kohë edhe në xhami. Ndërkaq, Shkolla e Lartë Pedagogjike, prej vitit akademik 1991/92 e deri në vitin 1998/99, procesin mësimor me studentë e ka organizuar në lokalet e Bashkësisë Islame, përkatësisht në xhamitë e Prizrenit.

Në xhami, procesin mësimor e kanë zhvilluar këto shkolla:

*Shkolla e mesme ekonomike “Ymer Prizreni”*

1. Xhamia (Tusus), rruga “Ramiz Sadiku”, në tri vite shkollore, lëshoi 3 dhoma në të cilat mësonin nxënësit e 10 paraleleve, sepse punohet në dy ndërrime, duke filluar prej orës 8:30 deri në orën 13. Kanë mësuar klasat I dhe II në vitet shkollore 1993/94 dhe 1994/95 dhe 1995/96.

*Shkolla e mesme teknike “Gani Çavdërbasha”*

Nxënësit e kësaj shkolle për një kohë ishin të sistemuar në Xhaminë e Kurrillës.

*Qendra shkollore për rehabilitimin e personave në zhvillim me të meta dëgjimi*

Nga pushteti policor i Serbisë nuk u kursyen as nxënësit me nevoja të veçanta, siç ishte shkolla e mesme e shurdhmemecëve. Nxënësit e kësaj shkolle ishin sistemuar në Xhaminë e Kurrillës në vitet shkollore 1993/94 dhe 1994/95. Në këtë xhami ata i shfrytëzonin dy dhoma si mësonjëto.



*Shkolla fillore "Mushnikova" e Mushnikovës*

Mësimdhënësit dhe prindërit e fshatit Mushnikovë nuk kishin pranuar të punonin me planet dhe me programet e Serbisë, andaj nxënësit dhe mësimdhënësit u dëbuan nga lokalet e tyre shkollore. Për këtë arsye, procesi mësimor u organizua dhe u zhvillua në lokalet e vakëfit të fshatit Mushnikovë. Në këto lokale mësonin rreth 200 nxënës në gjuhën shqipe.

*Shkolla e Lartë Pedagogjike "Xhevdet Doda" e Prizrenit*

Gjatë gjithë kohës studentët dhe mësimdhënësit e tyre procesin mësimor e kanë zhvilluar në lokalet e Bashkësisë Islame, përkatësisht në këto xhami:

1. Xhamia e Emin Pashës liroi një dhomë për grupin e matematikës dhe pjesërisht grupin e mësimimit klasor. Në këtë lokal është punuar prej vitit shkollor 1991/92 e deri në vitin shkollor 1998/99;
2. "Bajrakli Xhamia" liroi një dhomë për grupin fizikë - kimi dhe pjesërisht grupin e mësimimit klasor, në vitin shkollor 1992/93 dhe 1993/94;
3. Xhamia e Terzi Mëhallës liroi një dhomë për grupin e gjuhës dhe letërsisë shqipe, prej vitit shkollor 1991/92 e deri në vitin shkollor 1998/99;
4. Xhamia e Qorr Agës liroi një dhomë për grupin e anglishtes, prej vitit shkollor 1991/92 deri në vitin shkollor 1998/99;
5. Xhamia e Terxhymen Iskënderit (Dragomanit) liroi një dhomë për grupin fizikë-kimi dhe pjesërisht për grupin e mësimimit klasor. Viti shkollor 1993/94 deri në vitin shkollor 1996/97;
6. Xhamia e Ali Efendi Myderrizit liroi 2 dhoma për administratën. Prej vitit shkollor 1991/92 deri në qershor të vitit 1996. Pastaj prej vitit shkollor 1997/98 dhe 1998/99, për grupin e matematikës dhe një pjesë grupit fizikë-kimi;
7. Xhamia e Mesxhidit liroi një dhomë për grupin fizikë-kimi, në vitet shkollor 1997/98 dhe 1998/99;

### **Rahovec**

Në Komunën e Rahovecit janë dëbuar nxënësit e shkollës së mesme, por edhe ata të shkollës fillore. Nxënësit e shkollës së mesme gjatë kohës kanë punuar në lokale shtëpi-shkolla, por kanë punuar edhe në lokale të shkollave fillore si dhe në xhami:

1. Xhamia e Kasumit në Rahovec, për nxënësit e kësaj shkolle lëshoi një dhomë në vitin shkollor 1991/92.
2. Në xhaminë e Bellacerkës, në një dhomë të saj, në vitin shkollor 1991/92, mësuan nxënësit e një paraleleje.

### **Viti**

Në Komunën e Vitisë u dëbuan, si nxënësit e disa shkollave fillore, ashtu edhe ata të shkollës së mesme. Nxënësit e këtyre shkollave ishin të shpërndarë nëpër disa punkte.

1. Xhamia (mejtëpi i xhamisë) në fshatin Terpezë liroi dy dhoma në vitin shkollor 1991/92.

## **Përfundim**

Duke u përpjekur të mbetem sa më pak borxh ndaj kontributeve të veçanta të cilat Medreseja e Prishtinës dhe përgjithësisht Bashkësia Islame e Kosovës me të gjitha institucionet e tjera të saj, i dhanë në këtë periudhë të vështirë të mbijetesës sonë kombëtare, madje në një segment tejet të rëndësishëm të jetës sonë; e ndiej të nevojshme të theksoj edhe një herë kontributin e të gjithë njerëzve që i kanë drejtuar dhe që kanë punuar në këto institucione e posaçërisht Myftiun e atëhershëm - Rexhep Bojën me stafin e tij në Kryesinë e Bashkësisë Islame, pa pëlqimin e të cilëve, por edhe pa sakrificën e të gjithë të tjerëve, ky kontribut i Medresesë dhe i xhamive nëpër komunat e shumta të Kosovës, nuk mund të realizohej. Populli i Kosovës, sidomos nxënësit dhe mësimsdhënësit e asaj kohe, do ta kujtojnë përherë, me respektin e pietetin më të lartë, këtë kontribut të jashtëzakonshëm të Bashkësisë Islame të Kosovës, në kohët më të vështira për popullin shqiptar në Kosovë.

*Bajram SHATRI*

**THE CONTRIBUTION OF THE ISLAMIC  
COMMUNITY OF KOSOVA AND ITS INSTITUTIONS  
TO THE SURVIVAL OF THE ALBANIAN  
EDUCATIONAL SYSTEM IN KOSOVA BETWEEN 1990  
AND 1999**

**(Summary)**

Following the constitutional changes in Serbia in 1989, discriminatory laws were introduced in Kosova and its autonomy which was guaranteed by the Yugoslav Constitution of 1974, was abolished. Among the first to be targeted by these changes was the field of education. As a reaction to these discriminatory laws, in May 1999, the Pedagogical Institute of Kosova called upon the Assembly and the Executive Council of Kosova to reject these laws and to protect the educational system of Kosova. In June 1990, the Assembly of Kosova rejected the introduction of a new curriculum by Serbia, which resulted in the setting of foundations for a new and completely independent educational system in Albanian. The first step in that direction was the introduction of a new curriculum, which was adopted on August 24, 1990. The latter was used as a pretext by Serbia to increase its pressure on the educational system in Albanian, leading to a 10-year struggle for the survival of the Albanian educational system in Kosova until the end of the war in 1999. The contribution of the Islamic Community of Kosova in this struggle was immense. All its facilities were made available to the educational system of Kosova.

بايرام شاطري

## مساهمة المشيخة الإسلامية الكوسوفية ومؤسساتها في بقاء

### التعليم الألباني في كوسوفا في الفترة ١٩٩٠-١٩٩٩

(خلاصة البحث)

بعد التغييرات الدستورية العنيفة في صربيا في عام ١٩٨٩ ، بدأ فرض القوانين التمييزية في كوسوفو ، حيث تم إلغاء الحكم الذاتي الذي كان يضمه الدستور اليوغوسلافي لعام ١٩٧٤ .

من بين المجالات الأولى التي استهدفتها هذه التغييرات الدستورية كان التعليم. ونظرا إلى أن هذه القوانين تمييزية، تم في مايو من عام ١٩٩٠، اقتراح من المعهد التربوي في كوسوفو، حيث طالب سلطات كوسوفو، البرلمان والمجلس التنفيذي واللجنة الإقليمية للتعليم بعدم قبول هذه القوانين والخطط المعدة من قبل صربيا و أن يتم الحفاظ والاستمرار على النظام التعليمي الكوسوفي. وفي ٢٦ يونيو ١٩٩٠ ، رفض برلمان كوسوفو المناهج الصربية ، مع وضع الأسس لنظام جديد ومستقل تماما للتعليم الألباني. وكانت الخطوة الأولى في هذا القرار هي تصميم المناهج وبرامج جديدة والمعتمدة في ٢٤ آب / أغسطس ١٩٩٠ من قبل المجلس الأعلى للتعليم في كوسوفو. هذه الإجراءات اتخذت كذريعة من قبل صربيا لممارسة اعمال عنف غير مسبوق على التعليم الألباني، ومن هنا يبدأ سير الموكب التعليمي والذي سيقم التعليم الألباني حيا لمدة ١٠ سنوات في كوسوفو حتى نهاية الحرب في عام ١٩٩٩. وفي الوقت نفسه، قدمت المشيخة الإسلامية في كوسوفو دعماً كبيراً، يكاد يكون محوريا، حيث جعلت مؤسساتها تستوعب آلاف التلاميذ في مرافقها التي تحولت إلى مدارس.



M.sc. Artan S. MEHMETI

## **MYSLIMANËT QË KONTRIBUAN NË ZHVILLIMIN E SHKENCËS SË GJEOGRAFISË - (III)**

### **Ibn 'ul-Fakih el Hamadani (shekulli X)**

*Të dhënat mbi jetën e këtij dijetari janë të pakta. Emri i tij i plotë tregon se paraardhësit e tij dhe ndoshta vetë Ibn 'ul-Fakihu erdhi nga Hamadani (qytet me veriperëndim të Iranit) dhe se babai i tij ishte jurist (fekih). Ka supozime se ai ka jetuar në Bagdad. Ibn 'ul-Fakih njihet për kontributin e dhënë në fushën e historisë dhe gjeografisë.*

Ibn 'ul-Fakih, i cili njihet ndryshe edhe si njeriu i letrave (shkrimeve), në gjuhën arabe shkroi librin me titull **“Muhtesar Kitab 'el-Buldan”**, një punim gjeografik, në të cilën kryesisht ka përshkruar botën islame me qendrat e saj në Arabi, Persi dhe Irak. Ibn 'ul-Fakih shkroi edhe dy vepra të tjera si **“Kitab 'ul-'axha'ib”**, të cilën e përmend vetë ai, si dhe veprën tjetër me titull **“Kitab dhikr esh-shu'ara' el-muhdatin wa'l-bulaga'u minhum...”**, e përmendur nga Ibn'ul-Nedim. Gjatë shkrimeve të tij, Ibn 'ul-Fakih shumë faqe ua kushton qyteteve të Hamadanit dhe Bagdadit, me ç'rast u njoh edhe me veprat e bashkëkohësve të tij. Në librat e tij ai, gjithashtu, citoi një shkrim nga Jakubi, i cituar më shumë se një herë,

kurse Ahmet b. Tajjib Sarahsiu e quajti studiues dhe “muhtesib” nga Bagdadi.

Përmes analizës dhe krahasimeve të raporteve, Alois Sprenger, Charles Rieu dhe Michael de Goeje erdhën në disa përfundime mbi ngjarjet historike dhe personat e përmendur në veprën **“Muhtesar Kitab ‘el-Buldan”** të Ibn ‘ul-Fakihut, e cila ishte shkruar rreth vitit 903. Teksti i plotë, i cili fillimisht përbëhej nga pesë vëllime dhe numëronte 1.000 fletë, nuk ka mbijetuar. Përkundrazi, ajo ekziston në dy versione të shkurtuara, një nga Abu’l-Hasan ‘Ali b. Xha’fer b. Ahmed Shajzari, kurse tjetri në një koleksion anonim të veprave gjeografike. Versioni i Shajzarit, *Muhtesar*, u botua nga de Goeje nga tri dorëshkrime. Një tjetër dorëshkrim u zbulua më vonë në Tashkent. Versioni anonim që përmban vetëm gjysmën e dytë të veprës, përfaqësohet nga një dorëshkrim unik në bibliotekën e Astan-e Qods-e Raçawi në Mash’had.

**“Muhtesar Kitab ‘el-Buldan”** përbëhet nga një hyrje e shkurtër, më pas flet për krijimin e tokës, detit përreth dhe mrekullive të detit, për të përshkruar Mekën, Arabinë, Medinën, Tuhamën, Nexhdin, Jemamën, Bahrejnin dhe Jemenin “duke e kthyer seriozitetin në satirë dhe satirën në seriozitet”. Pastaj flet me lëvdata për tokat e huaja gjatë udhëtimeve, ku përshkruan Nilin, Nubinë, Etiopinë, Magrebin dhe Sirinë. Ai vazhdon me përshkrimet e rajoneve Xhazira dhe Rum, lëvdata dhe kritika rreth ndërtesave, përshkrimet e Irakut përkatësisht qyteteve Kufa dhe Basra, kurse në hyrjen e pjesës së dytë, përmbledh përshkrimet e Farsit, Kermanit, Karmasin e Hamadanin të Nehavendës, Isfahanin, Kom, Ray dhe Damavand e Kazvin, Zanzhan, Abhar të Azerbajxhanit dhe Arabisë e Horasanit.

Në dorëshkrimin e ndodhur në Mash’had, teksti fillon në mes të pjesës që i dedikohet qytetit Kufa dhe përmban pjesën tjetër të kapitujve në *Muhtesar*, me përjashtim të futjes në pjesën e dytë dhe pjesëve në Azerbajxhan dhe Armeni. Ibn ‘ul-Fakih përfshin gjithsesi kapitujt shtesë mbi Waset, Nabatiya, Bagdad, Samarra, Sawad, Ahvaz, Aaraj dhe Khorasan, qytetet e turqve, titujt e mbretërve të Horasanit, Mashrikut, turqit dhe fqinjët e tyre. Po ashtu ai flet për ndërtimin e qyteteve që janë më të gjerë se ai i Muhtesarit, por të dy versionet janë të ngjashme dhe plotësuese.

Publikimi i parë në dorëshkrimin e Mash'hadit (Validov) çoi në një seri artikujsh dhe raportesh. Fragmente të tekstit janë botuar dhe interpretuar, por ekziston një nevojë urgjente për një edicion të plotë, kritik, duke përfshirë bashkërendimin e të dy versioneve ekzistuese me huazimet në veprat e mëvonshme, si dhe studimet përkatëse të burimeve. Është argumentuar se shpirti dhe proporcioni i brendshëm i punës së Ibn 'ul-Fakihut u ruajtën në përmbledhjen e tij dhe se ajo që mbijetoj nuk është shumë më e shkurtër sesa origjinali.

Libri i Ibn 'ul-Fakihut është më shumë i njohur si një monument i letërsisë apo një depozitar i informacionit kulturor sesa ai i gjeografisë, por titulli dhe organizimi i tij formal janë gjeografik. Shumica e kapitujve të tij janë emëruar sipas provincave, rendi i të cilave përkon me **“atlasin islamik”**.

Ibn 'ul-Fakih nuk ishte udhëtar, por ai përshkroi veprat e paraardhësve të tij dhe materialet e mbledhura nga informatorët bashkëkohorë, duke cituar ato me ose pa referencë. Të gjitha llojet e të dhënave gjeografike në gjuhën arabe, janë përdorur në punën e tij, si në pjesën matematikore, administrative, ekonomike, politike dhe etnografike.

Ibn 'ul-Fakihu nuk zbuloi hapësirën e plotë të burimeve të tij gojore dhe të shkruara. Është e qartë se dy autorë kanë ndikuar në vendosmërinë e tij, Ibn Kurtube dhe Xhahidhi. Plani i përgjithshëm i punës që mori drejtpërsëdrejti nga i pari, megjithëse ai ndryshoi rendin e pjesëve, hodhi detaje dhe rrallë i referohej numërimit të lokaliteteve dhe largësive, ose vlerat e taksave. Ka raste ku Ibn 'ul-Fakihu i shtoi shifrat e dhëna nga Ibn Kurtube. Temat më të preferuara të tij ishin pushtimet, taksat dhe themelimi i qyteteve. Ajo që spikat në tekstin e tij janë shënimet për të Dërguarin Muhamed, për kalifët Omerin dhe Aliun, Haxhaxh b. Jusufin dhe kalifët abasidë si: El-Mensuri, Harun Er-Rashidi dhe El-Me'muni. Ai gjithashtu tregoi tradita të lidhura me sundimtarët e tillë të lashtë si Solomoni dhe Aleksandri i Madh, të Dërguarit si Ibrahimimi dhe Musa, dhe mbretërit Sasanidë si Kavad, Anoshirvan, Kosrow II, Parvez dhe Bahram Gor.

Puna e Ibn 'ul-Fakihut disi paradoksalisht kombinon informacion të shëndoshë me legjendat. Autori trajtonte një sasi të madhe të materialit të



nxjerrë nga literatura dhe folklori: të proveniencës biblike, helenike, arabe-islame, si dhe nga persishtja e turqishtja. Megjithatë, puna e Ibn ‘ul-Fakihut ka vlerë të madhe përtej listës së zakonshme të të dhënave topografike dhe statistikore. Ai gjithashtu shpjegoi harta dhe integroi traditat e ndryshme kulturore, ku më me ndikim qenë ato të Persisë, duke zhvilluar kështu një lidhje të rëndësishme në zhvillimin e gjeografisë islame ndaj veprave klasike të llojit “*mesalîk ve memalîk*”.

### Ibn Xhubejri (1145 - 1217)

Muhammed ibn Ahmed ibn Xhubejr El-Kinani lindi në qytetin e Valencisë në Spanjë, kurse studimet i përfundoi në qytetin Jativ po ashtu në Spanjë. Ai ishte një gjeograf, udhëtar dhe poet andaluzian.

*Ibn Xhubejri në ditët e sotme pranohet gjerësisht si një udhëtar, gjeograf dhe historiani më i njohur islam i kohës së tij. Në librin e tij të titulluar “Rihletu*



*Ibn Xhubejri*

*Ibn Xhubejr”, ai jep një përshkrim të detajuar të vendeve që i vizitoi, të shoqëruar edhe me grafika. Libri i tij ndryshon nga librat e tjerë gjeografikë të kohës, sepse nuk përmban vetëm koleksione të toponimeve, apo përshkrime të thjeshta të monumenteve të ndryshëm, por libri i tij përmban vëzhgime të detajuara gjeografike.*

Në librin e tij Ibn Xhubejri shkruan edhe për eksperiencën e tij personale, vëzhgimet e tij rreth popullsisë me të cilët ai vetë u takua (si kulturën, besimet fetare, zakonet), marrëdhëniet në mes myslimanëve dhe të krishterëve, pozitën dhe gjendjen socio-ekonomike të popullsisë myslimane nëpër vendet e krishtera që myslimanët i kishin humbur kohë më parë (p.sh. Sicilia), gjendjen politike të vendeve nëpër të cilat kaloi, për stuhitë detare të cilat Ibn Xhubejr i përjetoi gjatë udhëtimeve në det, luftërat të cilat vetë i përjetoi (sulmin e Mbretit Salahudin që i bëri Frankut


gjatë epokës së kryqëzatës së tretë, në qytetin Nablus të Palestinës, e i cili ishte i sunduar nga të krishterët në krye me frankët), anekdota, poezi, mënyrën e kryerjes së haxhit, si dhe kohë pas kohe ai në këtë libër shënoi ajete kuranore. Gjithashtu në këtë libër Ibn Xhubejri jep disa informacione të dorës së parë, lidhur me ngjarjet që ndodhen në rajonin e Mesdheut, informacione që në ditët tona hedhin dritë mbi disa çështje që janë akoma aktuale. Shumë prej këtyre informacioneve çuditërisht pasqyrojnë disa nga ngjarjet e një pjese shumë të ngatërruar të historisë njerëzore.

Në hyrje të **“Rihletu Ibn Xhubejr”**, Ibn Xhubejri shpjegon arsyen për ndërmarrjen e udhëtimeve të tij. Në vitin 1182, ai vendosi që të udhëtonte drejt qytetit të shenjtë të Mekës, për ta kryer ritualin e shenjtë të haxhit. Udhëtimet e tij Ibn Xhubejri i filloi në moshën 38-vjeçare. Këto udhëtime do të përshkojnë zona të mëdha në tri kontinente, duke kaluar më mijëra kilometra rrugë detare dhe tokësore. Udhëtimet e tij zgjatën dy vjet. Gjatë kësaj kohe Ibn Xhubejri vizitoi vendet islame që ishin nën Perandorinë Islame, si dhe vendet që kishin qenë nën këtë perandori, por që ishin humbur dhe sot e asaj dite ndodhën jashtë Botës Islame. Popullsia myslimane në tokat e humbura nga Perandoria Islame, ose ishte kthyer në fenë e krishtere ose ishte dëbuar nga këto toka.

Sipas studiuesit Roxanne Euben, edhe udhëtarët tjerë myslimanë, si Ibn Batuta, edhe pse ka jetuar rreth 150 vite pas Ibn Xhubejrit, do ta vërtetojnë librin **“Rihla”** të Ibn Xhubejrit, duke huazuar fragmente të zgjeruara nga kujtimet e paraardhësit të tij.

Udhëtimet e Ibn Xhubejrit fillojnë kur ai u largua nga qyteti i Granadës së bashku më një mjek (shok i tij) i quajtur Ahmed Ibn Hassan, më 3 shkurt 1183. Ibn Xhubejri kalon Ngushticën e Gjibraltarit dhe arrin në qytetin Cueta, që asokohe i takonte Perandorisë Islame. Nga Cueta, ai me një anije arrin në qytetin italian Gjenova, ku nga ky qytet u nisë për në qytetin e Aleksandrisë. Udhëtimi i tij shkoi përgjatë Ishujve Balerike, e vazhdon përgjatë Ishullit të Sardenjës. Në mes Sardenjës dhe Sicilisë, anijen e goditi një stuhi e fortë, siç shkruan edhe vetë Ibn Xhubejri se nuk kishte parë në jetën e tij kësi lloj stuhie. Pas mbarimit të stuhisë anija vazhdoi rrugëtimin duke kaluar Ishullin e Sicilisë, Kretës, ku nga ky ishull u kthye për në jug duke arritur në Bregdetin e Afrikës, konkretisht në

portin e Aleksandrisë (26 mars 1183), nga i cili port Ibn Xhubejri mbeti i habitur nga madhështia dhe shkëlqimi i tij. Pas qëndrimit prej tetë ditësh nga Aleksandria u largua në drejtim të qytetit të Kajros. Nga Kajro ai lundroi më barkë përgjatë Nilit, duke arritur në qytetin Qus, nga aty me deve Ibn Xhubejri nisi rrugëtimin për në portin e Detit të Kuq i quajtur Aydhab. Nga ky port ai kaloi Detin e Kuq, duke arritur në Gadishullin Arabik përkatësisht në portin Xheddah. Nga ky portë Ibn Xhubejri u nis dhe arriti në qytetin e shenjtë të Mekës (gusht 1183).



*Harta e vendeve që i ka vizituar Ibn Xhubejri gjatë udhëtimeve të tij*

Pasi i përfundoi ritualet e haxhit, ai iu bashkua një karvani të haxhi-lerëve që udhëtonin për qytetin tjetër të shenjtë të Medinës. Më pas nga Medina, Ibn Xhubejri u nis për në Bagdad duke i kaluar shkretëtirat e mëdha të Hixhazit dhe Nexhdit, ku arriti në Bagdad. Nga aty ai vazhdoi në drejtim të tokave pjellore të Mesopotamisë, duke arritur në qytetin Mosul. Nga Mosuli Ibn Xhubejri mori rrugën në drejtim të Sirisë duke arritur në qytetin Haleb (Alepo), prej aty ai shkon në Damask ku qëndron rreth dy muaj. Damaskun Ibn Xhubejri e quajti “Parajsa e Orientit”. Nga

Damasku ai udhëtoi për në portin mesdhetar të Saint John d’Acre (‘Akka), që ende ishte i pushtuar nga një ushtri e krishterë. Ibn Xhubejri arriti në këtë qytet me qëllim për t’u kthyer në vendin e tij.

Akti i kthimit ka qenë i rrezikshëm, ngase gjatë lundrimit nëpër detin Mesdhe, disa erëra të fuqishme në ngushticën e Mesinës nuk mundësuan udhëtimin e mëtejshëm, duke e detyruar Ibn Xhubejrin që të qëndrojë për rreth katër muaj në ishullin e Sicilisë. Në Sicili ai gjeti mikpritje të ngrohtë nga Mbreti William II (i njohur si Williampi i mirë), për të cilën sjellje Ibn Xhubejri e admiroi. Kur erërat iu kthyen normalitetit ai vazhdoi rrugetimin nëpër Mesdhe, duke zbarkuar në portin andaluzian të Kartagjenës, kurse në shtëpinë e tij në Granadë Ibn Xhubejri arrin në prill 1185. Pas kthimit të tij, ai shkroi librin e tij **“Rihletu Ibn Xhubejr”**.

Më pas Ibn Xhubejri ndërmori edhe një udhëtim tjetër për të kryer haxhin, kurse në moshën 72-vjeçare ai ndërmori udhëtimin të tij të fundit, duke kaluar nëpër Mekë, Jerusalem, dhe Egjipt ku edhe vdiq. Dy udhëtimet e fundit të Ibn Xhubejrit nuk janë të regjistruara në librin e tij.

### Ibn Said (1213-1286)



*Ibn Said*

Ebu ‘l-Hasan ‘Ali ibn Musa ibn Said El-Magribi lindi në qytezën Alcala la Real afër Granadës, kurse u rrit në Marakesh. Studimet i kreu në Sevilë të Spanjës, e cila në atë kohë i përkiste perandorisë islame. Ai jetoi në Tunizi, Aleksandri, Kajro, Jerusalem dhe Aleppo. Ibn Said ishte një gjeograf, historian, poet, si dhe një koleksionist i poezisë andaluziane të shekujve XII dhe XIII.

Duke qenë një udhëtar i palodhur, Ibn Said ishte i interesuar për studime të thelluara në fushën e gjeografisë. Gjatë jetës së tij, ai shkroi disa libra gjeografikë për vendet që i kishte vizituar, duke punuar edhe disa harta gjeografike për këto vende. Në vitin 1250, Ibn Said shkroi librin në fushën e gjeografisë me titull **“Kitab bastil-erd fi-t-tuli vel ard”**.

Në librin, me titullin “**Kitab el-gjografija**”, shkruan për përvojën e tij gjatë udhëtimeve që u bëri vendeve të botës islame, si dhe brigjeve të Oqeanit Indian. Ai gjithashtu shkruan edhe për disa vende të Evropës Veriore, duke përfshirë ishujt e Irlandës dhe Islandës. Ibn Said më shumë është i njohur për krijimin e hartës klimatike të botës së njohur deri atëherë.



*Harta e gjetur në dorëshkrimin me titull  
“**Kitab el-bed’i ve’t-tarih**”*

Nga shumëllojshmëritë e hartave që janë punuar për botën islame dhe hapësirën e Oqeanit Indian, një hartë e këtillë është gjetur në Librarinë Bodleian tek një dorëshkrim i titulluar “**Kitab el-bed’i ve-t-tarih**” në vitin 1569-1570. Edhe pse viti i hartës është shumë i vonshëm, vërehet qartë burimi nga Ibn Havkal III. Ibn Saidi ka punuar në një hartë tre lloje hartash: një hartë klimatike, një hartë që përshkruante kontinentet dhe oqeanet, si dhe në fund një hartë të Botës pa karakteristikat klimatike.

Për hartën e gjetur në dorëshkrimin me titull “**Kitab el-bed’i ve-t-tarih**”, studiuesit e kësaj fushe si Manfred Kropp, Leo Bagrow e tjerë, kanë zhvilluar diskutime rreth: origjinës, mënyrës së punimit, ngjashmërisë së saj me hartat e tjera të punuara nga gjeografët e tjerë të mëherëshëm myslimanë, siç janë emërtimi i vendeve dhe disa karakteristika të tjera.

### Ali Kushçi (1403-1474)




Ali-Kushçi

*Alauddin Alij ibn Muhamed Ali Kushçi lindi në qytetin persian Samarkand, që në ditët e sotme i takon Uzbekistanit. Një pjesë të jetës së tij e jetoi në Stamboll. Ali Kushçi ishte student dhe bashkëpunëtor i astronomëve dhe matematikanëve shumë të njohur siç janë Kadizade-i Rumit dhe Ulug Begu, i cili themeloi Observatorin në Samarkand. Në këtë observator punuan shumë shkencëtarë të njohur. Ali Kushçi njihet për kontributin e dhënë në matematikë, mjekësi, fizikë dhe astronomi si dhe kozmografi e gjeografi.*

Si student dhe bashkëpunëtor i Ulug Begut dhe Kadizade-i Rumit, Ali Kushçi ishte thellësisht i interesuar për fushat e matematikës dhe astronomisë. Në vitin 1420, Ali Kushçi fshehurazi është zhvendosur në qytetin Kriman ku studioi astronominë (rreth viteve 1423-1427) dhe, së bashku me Molla Çamin, i studioi shkencat matematikore. Pas kthimit në Samarkand rreth vitit 1428, Ali Kushçi ia prezantoi Ulug Begut një monografi, në të cilën Ali Kushçi i zgjidhi disa probleme që lidheshin me planetin e Merkurit. Raportohet se Ulug Begu ishte mjaft i kënaqur me këtë monografi. Burimet theksojnë se Ulug Begu i referohet Ali Kushçit si “djali im virtuoz”.

Pas vdekjes së Kadizade-i Rumit, Ali Kushçi u emërua drejtor i Observatorit Samarkand. Gjatë kësaj kohe observatori ishte një qendër e rëndësishme e shkencës në gjysmën e parë të shekullit XV. Në këtë observator, Ali Kushçi punoi shumë, me qëllim që të shtonte kërkime të reja shkencore për njohuritë ekzistuese. Në veprën e tij të parë më titull **“Risaletu fi hal-l eshkal Mu’addil el-Kamer li-l-Masir”**, ai paraqiti edhe Ulug Begun. Ky libër trajton fazat e Hënës. Ali Kushçi së bashku më Ulug Begun, botuan librin më titull **“Zixh-i Xhedid Sultani”**. Ky libër ishte një katalog i madh i yjeve, si dhe paraqet punën më të rëndësishme të kohës së tij. Në këtë vepër autorët kanë paraqitur me saktësi distancat

midis trupave qiellorë dhe Tokës. Për të arritur deri te ky punim, ai ka punuar (studiuar) për rreth 30 vjet.



*Skema që paraqet llogaritjen e pjerrtësisë së ekliptikës, e ndodhur në librin “El-Risala el-Fet’hija”*

Pas vrasjes së Ulug Begut, Ali Kushçit i ndalohet të punojë në Observatorin e Samarkandit nga djali i Ulug Begut. Si rezultat i kësaj, Ali Kushçi e la Samarkandin dhe emigroi në qytetin Tabzir të shtetit të Akkoyunlu. Si shenjë respekti ndaj këtij shkencëtari, sundimtari i Akkoyunlut i quajtur Uzun Hasani, Ali Kushçin e emëroi si ambasador i vullnetit të mirë, mes tij dhe udhëheqësit të ri të Stambollit, Muhammedi II. Ali Kushçi propozimin e mbretit e pranoi, për çka edhe emigroi drejt Stambollit për ta ushtruar detyrën e re si ambasador. Më të arritur në Stam-

boll, Ali Kushçi u prit në mënyrë madhështore nga Sulltan Muhamedi II. Sulltani i cili ishte thellësisht i interesuar për shkencë, kërkoi nga Ali Kushçi të jepte mësim në Medresenë e Stambollit. Në fillim ai nuk e pranoi këtë detyrë më arsyetimin se ishte dërguar si ambasador, duke i premtuar Sulltan Muhammedit II se prapë do të kthehej në Stamboll, ku dhe iku për në qytetin Tabzir. Pas dy vjetëve qëndrim në këtë qytet, Ali Kushçi kthehet në Stamboll por tash jo si ambasador i vullnetit të mirë, por për t’u vendosur përgjithmonë. Pas ardhjes së tij, ai ia prezantoi Sulltan Muhammedit II, librin e tij mbi astronominë, të shkruar në gjuhën arabe me titull **“El-Risale el-Fet’hije”**, për shkak se këtë libër Ali Kushçi e përfundoi në ditën kur Sulltan Muhammedi II fitoi luftën ndaj Uzun Hasanit. Në Stamboll, Ali Kushçi themeloi shkollën e tij, nga e cila shkollë dolën dijetarë të shkëlqyer si Kiwamuddin Kasim, Sinanuddin Jusuf, Hafiz Muhammed ibn Ali. Për fat të keq, Ali Kushçi arriti të punonte ve-

tëm dy vite për Sulltan Muhamed II. Vdekja e tij e papritur i dha fund zhvillimit të astronomisë në perandori, si dhe e la Sulltanin të privuar nga veprat e tij sfiduese.

Libri i shkruar në gjuhen arabe më titull **“El-Risaletu el-Fet’hije”**, e të cilin Ali Kushçi ia bëri dhuratë Sulltan Muhamedit II, kur e fitoi luftën ndaj Uzun Hasanit, në vete përmban disa llogaritje astronomike. Në këtë libër, Ali Kushçi bënë llogaritjen e pjerrtësisë së ekliptikës, ku vlera nga llogaritja e tij tregon shumë pak ndryshim nga vlera e sotme. Ky libër përbëhet nga tre kapituj. Kapitulli i parë trajton numrin e planetëve rreth Tokës, mënyrën e formimit si dhe vendndodhjen e tyre. Në këtë kapitull theksohet se Toka është i vetmi planet që rrethohet nga nëntë planetë të tjerë që e rrethojnë atë, dhe së bashku lëvizin në një orbitë rreth Diellit. Ky kapitull gjithashtu merret edhe me disa planetë të tjerë të madhësive të ndryshme, me formën, pozicionin dhe lëvizjen e disa prej këtyre planetëve, pozitën e yjeve të cilët digjen, mospërputhja e rrugëve gjatë lëvizjeve në mes planetëve dhe yjeve etj.


Kapitulli i dytë ka të bëjë me formën e Tokës dhe klasifikimin e klimës. Po në këtë kapitull theksohet se Toka ka formë pothuajse të rrumbullakët. Gjithashtu në këtë kapitull ai shpjegon klimën ekuatoriale, orbitat e planetëve, datat dhe vitet, si dhe studimet rreth lindjes dhe pozitën e yjeve në kohë të caktuar. Kapitulli i tretë flet për trupat qiellorë dhe retë. Ali Kushçi në këtë kapitull merret me llogaritjen e sipërfaqes së Tokës, llogaritjen e rrezes së Tokës, dallimin mes diametrit të Hënës dhe diametrit të Tokës, si dhe jep informacione rreth planetëve të Merkurit dhe Venusit.

Në monografinë e tij teorike të titulluar **“Shejh el-mu’addil li-l-masir”**, Ali Kushçi kritikon dhe korigjon teoritë që kanë të bëjnë me planetin e Merkurit, të cilat janë treguar tek Almgasti i Ptolomeut. Një punim tjetër i tij është edhe libri i titulluar **“Risaletu fi asl’il-harixhi jumkinu fi ‘s-suflijejn”**, ku në këtë punim ai merret me mundësinë e përdorimit të një modeli jashtëqendror për planetët Merkur dhe Venus, siç thotë edhe vetë Ali Kushçi një teori që shkon kundër Ptolomeut dhe Kutbuddin Shirazit.



Ali Kushçi gjithashtu ishte i vetëdijshëm për nevojën e pastrimit të të gjitha disiplinave shkencore nga parimet e fizikës dhe metafizikës aristoteliane. Si pasojë e pikëpamjeve të tij antiaristoteliane, ai dha pohimin e tij të mrekullueshëm se Toka mund të jetë në lëvizje. Në këtë pohim, Ali Kushçi ndoqi linjën e gjatë të astronomëve myslimanë, të cilët i hodhën poshtë argumentet e vëzhgimeve të Ptolomeut për rrugët e planetëve. Ai gjithashtu nuk pranoi që t'i ndjekë as rrugët e planetëve të Aristotelit, të cilat ishin në varura nga provat filozofike, duke hapur kështu mundësinë për një fizikë të re në të cilën Toka ishte në lëvizje.

Pikëpamjet shkencore të Ali Kushçit u diskutuan për shumë shekuj edhe pas vdekjes së tij, si dhe ai pati ndikim të madh në vëzhgimet dhe mendimet shkencore turko-osmane, e në veçanti përmes medresesë dhe kurrikulës së saj. Ndikimi shkencor i Ali Kushçit, gjithashtu është shtrirë edhe në Azinë Qendrore dhe Iran, si dhe është argumentuar se ai mund të ketë pasur ndikim të drejtpërdrejtë apo tërthorazi në shkencën e hershme evropiane, e cila bart në vete ngjashmëri të habitshme me idetë e tij.



*Skema që tregon rrugën e lëvizjes së planetëve, e ndodhur në librin  
“El-Risala el-Fet’hiija”*

Përveç të gjitha këtyre arritjeve, Ali Kushçi gjithashtu shkroi edhe për teologjinë, lëndët fetare, gjuhën dhe gramatikën. Në kohën që punonte në Stamboll për Sulltan Muhamedin II, ai i rishikoi dhe i korrigjoi shkallën e

gjerësisë dhe gjatësisë gjeografike të Stambollit, ku sipas llogaritjeve të tij, Stambolli ndodhet në gjerësinë 41 dhe gjatësinë 59, të cilat vlera janë shumë të afërta me vlerat e sotme (vlerat e sotme gjerësi 41.01, gjatësi 58). Gjithashtu me urdhër të Sulltan Muhamedit II, Ali Kushçi ndërtoi edhe një orë diellore.

Këtu po i paraqesim të gjitha punimet e Ali Kushçit në fushën e astronomisë: 1. *“Sherh-i Zixh-i Ulug Beg”*, 2. *“Risaletu fi Hal-li Ashkal Mu’addil ’il-Kamer li’l-Masir”*, 3. *“El-Risaletu fi asl’il-harixhi Jumkin fi ’is-Suflijajn”*, 4. *“Sherh ’ala et-Tuhfat esh-shahijje fi’l-Hej’e”*, 5. *“El-Risaletu daru ’ilm’il-Hej’e”*, 6. *“El-Fet’ hijjetu fi ’ilmi’il-Hej’e”*, 7. *“El-Risaletu fi Hal-li ashkal’il-Kamer”*.

---

#### **Burimet:**

- Dr W. Hazmy C.H. Dr Zainurashid Z. Dr Hussaini R., BIOGRAPHY Muslim Scholars and Scientists, Published by: Islamic Medical Association of Malaysia N. Sembilan, (<https://docs.google.com/file/d/0B-e6qHPbxSdNd1oxMUVCVG82a0E/edit>),
- Muslim Scientist & Their Contribution, Muslim Scientist & Their Contribution, (<http://www.csspoint.yolasite.com/resources/Muslim%20Scientist%20%26%20Their%20Contribution.pdf>),
- Islamic Science 3 Stephen R. Addison September 30, 2003, (<https://faculty.uca.edu/saddison/SciBiog/Names.pdf>),
- <https://plato.stanford.edu/entries/al-kindi/>,
- <http://www-groups.dcs.st-and.ac.uk/history/Biographies/Al-Kindi.html>,
- [http://www.traditionalarabicmusic.com/The%20Old%20Masters/al\\_kindi.htm](http://www.traditionalarabicmusic.com/The%20Old%20Masters/al_kindi.htm),
- <https://en.wikipedia.org/wiki/Al-Kindi>,
- <http://www.muslimheritage.com/article/al-kindi>,
- [http://www.lchr.org/a/49/as/dijetare/al\\_kindi.html](http://www.lchr.org/a/49/as/dijetare/al_kindi.html),
- Salah Zaimeche, SICILIA, Nga gjuha angleze: Hanife Alija – Dauti, EDUKATA ISLAME, nr. 88, Prishtinë 2009,
- GERALD R. TIBBETTS, The BalkhI School of Geographers, ([http://www.press.uchicago.edu/books/HOC/HOC\\_V2\\_B1/HOC\\_VOLU ME2\\_Book1\\_chapter5.pdf](http://www.press.uchicago.edu/books/HOC/HOC_V2_B1/HOC_VOLU ME2_Book1_chapter5.pdf)),

- Authors Bevens, Walter Bascom. Publisher The University of Arizona. Al-Yaman and the Hadramawt: Translations from medieval Arabic geographers and analysis, ([https://repository.arizona.edu/bitstream/handle/10150/184338/azu\\_td\\_8814209\\_sip1\\_m.pdf?sequence=1&isAllowed=y](https://repository.arizona.edu/bitstream/handle/10150/184338/azu_td_8814209_sip1_m.pdf?sequence=1&isAllowed=y)),
- [https://en.wikipedia.org/wiki/Ibn\\_Hawqal](https://en.wikipedia.org/wiki/Ibn_Hawqal),
- <http://islamicencyclopedia.org/islamic-pedia-topic.php?id=388>,
- [http://cartographic-images.net/Cartographic\\_Images/213\\_Ibn\\_Hawqal.html](http://cartographic-images.net/Cartographic_Images/213_Ibn_Hawqal.html),
- [http://cartographic-images.net/Cartographic\\_Images/221\\_Ibn\\_Said.html](http://cartographic-images.net/Cartographic_Images/221_Ibn_Said.html),
- [https://en.wikipedia.org/wiki/Ibn\\_Sa%27id\\_al-Maghribi](https://en.wikipedia.org/wiki/Ibn_Sa%27id_al-Maghribi),
- <http://www.henry-davis.com/MAPS/EMwebpages/221mono.html>,
- <http://alfutuhah.com/islamiccivilization/Geography/Vast.html>,
- CHAPTER-V EMINENT ARAB-MUSLIM BOTANISTS AND THEIR WORKS, ([http://shodhganga.inflibnet.ac.in/bitstream/10603/52374/11/11\\_chapter%205.pdf](http://shodhganga.inflibnet.ac.in/bitstream/10603/52374/11/11_chapter%205.pdf)),
- [https://en.wikipedia.org/wiki/Abu\\_Hanifa\\_Dina%27ari](https://en.wikipedia.org/wiki/Abu_Hanifa_Dina%27ari),
- [http://www.theinfolist.com/php/SummaryGet.php?FindGo=Al-Dinawari%20\(0ther\)](http://www.theinfolist.com/php/SummaryGet.php?FindGo=Al-Dinawari%20(0ther)),
- <http://jenkinsmuslimscientistsandinventors.blogspot.com/2013/06/dinawari.html>,
- [http://www.academia.edu/12114531/Abu\\_Hanifa\\_al-Dinawari\\_the\\_First\\_Historian\\_of\\_Iran](http://www.academia.edu/12114531/Abu_Hanifa_al-Dinawari_the_First_Historian_of_Iran),
- IBN JUBAYR, Description of Sicily, 1184, (<http://www.napavalley.edu/people/shutton/Documents/Readings/Ibn%20Jubayr%20Desc%20of%20Sicily.pdf>),
- <http://archive.aramcoworld.com/issue/201501/travelers.of.al-andalus.part.1.the.travel.writer.ibn.jubayr.htm>,
- [http://www.essayjudge.com/document\\_detail.php?doc\\_id=816](http://www.essayjudge.com/document_detail.php?doc_id=816),
- <http://www.muslimheritage.com/article/ibn-jubair-capturing-decline-islamic-power>,
- <http://www.alrahalah.com/2015/02/ibn-jubayr-12th-century-ce-6th-century-ah-the-first-travel-eriter/>,
- <http://www.muslimheritage.com/uploads/ACF2C2C.pdf>,
- <http://www.muslimheritage.com/article/travels-ibn-jubair>,
- [https://en.wikipedia.org/wiki/Ibn\\_Jubayr](https://en.wikipedia.org/wiki/Ibn_Jubayr),
- <http://alfutuhah.com/islamiccivilization/Geography/Vast.html>,
- CHAPTER FOUR AL-ZARQALI ON INSTRUMENTATION Imama Karim Manba Ushama, Nassereldeen A. Kabashi Fac. of Eng.,

- International Islamic Univ. Malaysia (IIUM). Jalan Gombak, 53100 Kuala Lumpur, Malaysia, ([http://irep.iium.edu.my/25354/1/Chapter\\_4.pdf](http://irep.iium.edu.my/25354/1/Chapter_4.pdf)),
- <http://muslimheritage.com/article/abu-ishaq-ibrahim-ibn-yahya-al-zarqali>,
  - [https://islamsci.mcgill.ca/RASI/BEA/Zarqali\\_BEA.htm](https://islamsci.mcgill.ca/RASI/BEA/Zarqali_BEA.htm),
  - <http://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=650>,
  - <https://sq.wikipedia.org/wiki/Arza%C3%A7el>,
  - <http://www.unhas.ac.id/~rhiza/arsip/saintis/zarqali.html>,
  - <http://www.lchr.org/a/49/as/dijetare/zarkali.html>,
  - ([https://repository.arizona.edu/bitstream/handle/10150/184338/azu\\_td\\_8814209\\_sip1\\_m.pdf?sequence=1&isAllowed=y](https://repository.arizona.edu/bitstream/handle/10150/184338/azu_td_8814209_sip1_m.pdf?sequence=1&isAllowed=y)),
  - <http://www.iranicaonline.org/articles/ebn-al-faqih>,
  - [http://www.medievalnubia.info/dev/index.php/Ibn\\_al-Faqih](http://www.medievalnubia.info/dev/index.php/Ibn_al-Faqih),
  - <http://khazar-empire.blogspot.com/2013/03/ibn-al-faqih-al-hamadani.html>,
  - [http://islamsci.mcgill.ca/RASI/BEA/Qushji\\_BEA.htm](http://islamsci.mcgill.ca/RASI/BEA/Qushji_BEA.htm),
  - <http://www.ottomanhistory.net/node/210>,
  - <http://www.muslimheritage.com/article/ali-al-qushji-and-his-contributions-mathematics-and-astronomy>,
  - [https://en.wikipedia.org/wiki/Ali\\_Qushji](https://en.wikipedia.org/wiki/Ali_Qushji),
  - <http://muslimnews24.com/ali-al-qushji-one-of-the-most-noteworthy-scientists-in-the-islamic-world/>,
  - Dr. Muhammad Adil Afridi, CONTRIBUTION OF MUSLIM SCIENTISTS TO THE WORLD: AN OVERVIEW OF SOME SELECTED FIELDS, ([http://irep.iium.edu.my/8415/1/Contribution\\_of\\_Muslim\\_Scholars\\_to\\_the\\_world.pdf](http://irep.iium.edu.my/8415/1/Contribution_of_Muslim_Scholars_to_the_world.pdf)),
  - <http://www.ibnalhaytham.com/discover/who-was-ibn-al-haytham/>,
  - [https://en.wikipedia.org/wiki/Ibn\\_al-Haytham](https://en.wikipedia.org/wiki/Ibn_al-Haytham),
  - <http://1001inventions.com/ibnalhaytham>,
  - <http://lostislamichistory.com/ibn-al-haytham-the-first-scientist/>,
  - <http://www-history.mcs.st-andrews.ac.uk/Biographies/Al-Haytham.html>,
  - [http://www.lchr.org/a/49/as/dijetare/el\\_haithami.html](http://www.lchr.org/a/49/as/dijetare/el_haithami.html)



## Përmbajtja

HIXHRETI PIKËKTHESA HISTORIKE E YMETIT ISLAM ....	5
Sabri BAJGORA	
ABDULLHAMID MUHAMED KISHKU DHE TEFSIRI I TIJ “FI RIHABI-T-TEFSIR” .....	9
Dr. Belkasim EL-GALI	
IMAM MATURIDIU DHE ARGUMENTIMI I EKZISTENCËS SË ALLAHUT - (II) .....	25
Ramadan SHKODRA	
PAVARËSIMI I BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS - (IV)...	43
Dr. Nehat KRASNIQI - Dr.Sadik MEHMETI	
VËSHTRIM KOMENTIMIT TË SURES “JÂSÎN” NGA SELIM “SAMI” EF. DREJTA .....	59
Dr. Ajni SINANI	
RREGULLIMI I GJYQEVE TË SHERIATIT DHE E DREJTA E SHERIATIT (Roli dhe rëndësia e Bashkësisë Islame në Kosovë: sfidat dhe perspektiva).....	75
Mr. Driton ARIFI	
FETVATË LAJTHITËSE NË OPTIKËN E KRITEREVE JURIDIKE ISLAME .....	87
Dr. Hatixhe AHMEDI	
“ARNAUT HOXHA” - HYSREV EF. NUMANI (AYDINLAR) (1883-1953) .....	103
Sezai SULEJMANI	
VËSHTRIM HISTORIK RRETH KALIFATIT ISLAM.....	119
Mr. Vedat SHABANI	
NAMAZI DHE FSHEHTËSITË E TIJ .....	141
Dr. Islam ISLAMI	
IMAM GAZALIU: SHKOLLAR DHE URTAK TEJKOHOR...	153

Enes KARIQ	
ME RASTIN E PETICIONIT PËR REVIZION DHE FSHIRJE TË AJETEVE KURANORE NË FRANCË (Kë e qorton në të vërtetë Kurani?!)	169
Ma. sc. Refik GËRBESHI	
XHAMITË, MEJTEPET DHE SHKOLLAT E PARA NË GALLAP	181
Bajram SHATRI	
KONTRIBUTI I BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS DHE INSTITUCIONEVE TË SAJ NË MBIJETESËN E ARSIMIT SHQIP NË KOSOVË NË PERIUdhËN E VITEVE 1990-1999	203
M.sc. Artan S. MEHMETI	
MYSLIMANËT QË KONTRIBUUAN NË ZHVILLIMIN E SHKENCËS SË GJEOGRAFISË – (III)	221
Përmbajtja	237